



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË MUZEUN HISTORIK  
KOMBËTAR

# **RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT**

## **AUDITIM FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRIE NË “MUZEUN HISTORIK KOMBËTAR”**

Tiranë, Korrik 2019



**RAPORT AUDITIMI**  
**(auditim financiar dhe përputhshmërie)**  
**“MUZEU HISTORIK KOMBËTAR”**

	<b>Faqe</b>
<b>PËRMBAJTJA E LËNDËS</b>	
<b>I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....</b>	<b>4-9</b>
<b>II. HYRJA (Të dhënat mbi raportin e auditimit).....</b>	<b>9-12</b>
a. Objektivat dhe qëllimi	
b. Identifikimi i çështjes	
c. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	
d. Përgjegjësitë e audituesve	
e. Kriteret e vlerësimit	
f. Standardet e auditimit	
<b>III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT.....</b>	<b>12-13</b>
<b>IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET</b>	
<b>1. Mbi hartimin dhe zbatimin e planit të buxhetit</b>	
a. Zbatimi i kriterëve në planifikimin e buxhetit, mbështetur në ligjet vjetore të buxhetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave.....	13-18
b. Zbatimi i kriterëve në çeljen e buxhetit sipas viteve, detajimi i planit fillestar, transferimet dhe rialokimet e fondeve buxhetore gjatë viteve ushtrimore, si dhe planin përfundimtar.....	18-21
c. Realizimi i planit të buxhetit.....	21-23
d. Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave dytësore.....	23-31
<b>2. Zbatimi i dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave</b>	
a. Respektimi i strukturave organike të miratuara dhe krahasimi me faktin.....	32-37
b. Respektimi i dispozitave ligjore për pagat e punonjësve.....	37-41
<b>3. Zbatimi i dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare:</b>	
a. Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve të kryera nëpërmjet, bankës dhe arkës në lekë dhe në valutë.....	41-55



b. Saktësia dhe rregullariteti i veprimeve të kryera në magazinë. ....	55-61
c. Inventarizimi i pronës shtetërore.....	61-73
<b>4. Auditimi i llogarive vjetore të administratës së institucionit:</b>	
a. Auditimi i bilancit kontabël dhe plotësimi i pasqyrave financiare përkatëse në zbatim të UMF nr. 14, datë 28.12.2006, “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006, për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësitë që varen prej tyre”, i ndryshuar me UMF nr. 26, datë 27.12.2007; .....	73-77
b. Vlerësimi nëse aktivi dhe pasivi janë llogaritur saktë dhe në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse si edhe rakordimi me pasqyrat e tjera financiare.....	73-77
c. Auditimi i të të ardhurave dhe shpenzimeve .....	77-80
ç. Auditimit të pasqyrës së fluksit të mjeteve monetare.....	80-83
<b>5. Prokurimet e fondeve publike.....</b>	<b>83-115</b>
<b>6. Mbi vlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe Kontrollit.....</b>	<b>115-125</b>
<b>7. Vlerësimi i Auditimit të Brendshëm<sup>1</sup></b>	
<b>8. Zbatimi i rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme<sup>2</sup></b>	
<b>IV. KONKLUZIONE DHE OPINIONI I AUDITIMIT.....</b>	<b>125-127</b>
<b>V. DOKUMENTACIONI SHOQËRUES</b>	
Aneksi 1 : Urdhër shpenzimet, objekt verifikimi nga grupi i KLSH-së	
Aneksi 2: Artikuj me fletëhyrje dhe fletëdaljenë të njëjtën datë	
Aneksi 3: Sqarim rreth llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga KLSH.	
Aneksi 4: Qasja dhe metodologjia e auditimit	
Aneksi 5: Regjistri i Prokurimeve, viti 2017 si dhe procedurat e audituara nga KLSH	
Aneksi 6: Regjistri i Prokurimeve , viti 2018 si dhe procedurat e audituara nga KLSH	

<sup>1</sup> MHK nuk ka Njësi të Auditit të Brendshëm

<sup>2</sup> MHK nuk është audituar ndonjëherë nga KLSH me program të vecantë



## I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

### I/a. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.

Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH) auditoi MHK, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme, ndër të tjera, çështjeve që lidhen me:

1. Njohjen me aktivitetin ekonomik-financiar të MHK dhe organizimin e funksionimit sipas rregulloreve të miratuara,
2. Vlerësimin dhe funksionimin sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe
3. Auditimin e pasqyrave financiare të MHK, si dhe
4. Auditimin e procedurave të prokurimeve

### I/b. Përshkrim i përmbledhur i gjetjeve dhe rekomandimeve nga auditimi

NR	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDËSI A	REKOMANDIMI
1.	<p>Nga auditimi rezultoi se, ikona e "Shën Athanasit" e cila është kthyer e restauruar nga IMK, më 27.05.2015, është ridërguar për restaurim më 23.10.2017. Në dokumentacionin që lidhet më çështjen në fjalë<sup>3</sup> konstatoam se në relacionin e IMK-së, cilësohet fakti që <b>"në rastin e ikonës "Shën Athanasi" problematika e përsëritur është pasojë e kushteve të papërshtatshme të konfortit ku ato konservohen dhe ekspozohen. Ato ekspozohen jo vetëm në kushte të papërshtatshme të mikroklimës, por edhe nën ndikimin e luhatjeve të theksuara të temperaturës dhe të % së lartë të lagështisë. Këto temperatura gjatë verës arrijnë vlera maksimale ekstreme."</b></p> <p>Duke konsideruar sa më sipër, në PBA 2018-2020 (faza I), MHK<sup>4</sup> ka propozuar miratimin e projektit të investimeve "Ruajtja e temperaturës në ambientet e MHK-së, mbrojtja nga degradimi " për total shumë 58,023 mijë lekë, i cili gjithashtu është propozuar edhe në fazën e dytë të PBA 2018-2020, propozime këto të cilat nuk janë marrë parasysh nga Ministria e Kulturës. Propozime të tjera të paraqitura nga MHK për investime që lidhen me ruajtjen dhe përmirësimin e kushteve të</p>			<p>Ministria e Kulturës si ministria përgjegjëse gjatë miratimit të buxheteve për Muzeun Historik Kombëtar, duhet të analizojë dhe vlerësojë kërkesat për investime që lidhen direkt me përmbushjen e funksionit primar të Muzeut që është ruajtja dhe mbrojtja e trashëgimisë kulturore, dhe që përfshin veprimtaritë që lidhen me: <b>administrimin e koleksioneve, analizën e rrezikut dhe zhvillimin e kapaciteteve për gatishmërinë dhe planet e emergjencës, sigurinë, konservimin parandalues<sup>5</sup> e përmirësues, si dhe restaurimin e objekteve muzeore, për të siguruar integritetin e koleksioneve muzeore.</b></p>

<sup>3</sup> Shkresa e IMK nr. 1649, datë 01.08.2018 që shoqëron relacionin mbi ndërhyrjet konservuese-restauruese në ikonat e Pavijonit të Artit Mesjetar, në MHK

<sup>4</sup> Në nenin 14 të rregullores së brendshme të MHK parashikohet se, Sektori I Konservimit të Koleksioneve: - është përgjegjës, ndër të tjera, për ruajtjen e koleksioneve; si dhe - harton projekte konkrete për konservimin e objekteve sipas kriterëve shkencorë

<sup>5</sup> "**Konservimi parandalues**", është një ndër strategjitë e menaxhimit të aktiveve në MHK, që konsiston në të gjitha masat e ndërmarra që nuk kërkojnë ndërhyrje direkte në pasuritë kulturore materiale, sic janë krijimi i kushteve të përshtatshme (lagështi relative, temperature, pastërti nga ndotja atmosferike, dëmtimi biologjik dhe fizik në fonde, ekspozimi dhe transporti), me qëllim parandalimin e cdo lloji dëmtimi, dhe si i tillë i duhet dhënë rëndësia që i takon në buxhetet vjetore



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT AUDITIMI "PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË MUZEUN HISTORIK KOMBËTAR

NR	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDËSI A	REKOMANDIMI
	<p>objekteve të trashëgimisë kulturore, konstatuam gjithashtu edhe në PBA 2017-2019 (faza II-të) ku MHK ka propozuar buxhet për investime për "Sigurimin e temperaturës për pajisje ngrohje-ftohje" në shumën 53,200 mijë lekë; investime për rikonstruksion në total 316,509 mijë lekë konkretisht për rikonstruksionin e pavijonit të arkeologjisë, 220,000 mijë lekë, si dhe për rikonstruksionin e pavijonit të pavarësisë 40.000 mijë lekë. Rikonstruksion i vetratave 38,601 mijë lekë). <b>Të gjitha sa më sipër nuk janë miratuar nga Ministria e Kulturës, duke mos u çelur asnjë fond për investime si për vitin 2017 ashtu edhe për vitin 2018. Të rrezikuarit e kushteve në të cilat mbahen objektet muzeale, veçanërisht ikonat rrezikon të çënojë funksionin primar të muzeut që ka të bëjë me ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.</b></p>			
2.	<p>Nga verifikimet e grupit të auditimit, rezultoi se në praktikën e të ardhurave dytësore që dorëzohet në Sektorin e Financës, në asnjë rast Biletaria nuk ka dorëzuar kuponin tatimor që të shoqërojë raportimet ditore të të ardhurave nga shitja e biletave, duke mos dhënë siguri mbi shifrën e të ardhurave të realizuara (për vitin 2018 sipas deklaratës në tatime, të ardhurat nga biletaria rezultuar 8,428 mijë lekë, ose 295 mijë lekë më pak nga sa deklaruar nga MHK);</p> <p>U konstatuan raste të paraportuara të biletave të pavlefshme dhe të padorëzuara në Sektorin e Financës, (me procesverbalet përkatëse), duke shtuar kështu riskun rishitjes së tyre, në kushtet e mungesës se kontrolleve mbi procesin.</p> <p><b>Në përfundim</b> konstatuam se në asnjë rast nuk është kryqëzuar informacioni i sjellë nga Biletaria me: (1) deklarin sipas kasës fiskale; (2) raportin e gjeneruar nga sistemi elektronik I Biletarise<sup>6</sup>; (3) nuk janë mbajtur procesverbale dhe nuk janë dorëzuar fizikisht biletet e dala "te pavlefshme"si dhe (4) nuk janë kryer inventarizime periodike mbi gjendjen e biletave pas shitjes</p>			<p>Në terma të forcimit të kontrolleve të brendshme të institucionit, Sektori i Financës duhet të krijojë dhe ndjekë proceset e nevojshme për të përmbushur misionin e vet nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- kryerjes së inventarizimeve periodike gjendjes fizike të biletave për të verifikuar saktësinë e shifrës së deklaruar.</li><li>- celjes së aksesit në sistemin elektronik të biletave (Nëpunësit Zbatues) për të gjeneruar të gjitha ato raporte që vlerëson se forcojnë kontrollet që lidhen më deklarimin e të ardhurave nga shitja e biletave.</li><li>- kontrollit nëse procesverbalet e dorëzuar nga biletaria po respektojnë sistemin e dy nënshkrimeve</li><li>- kontrollit nëse bashkëngjitur procesverbalit është edhe kuponi tatimor i gjeneruar nga kasa, i cili duhet të rakordojë me shifrën e raportuar në procesverbal dhe arkëtuar në bankë;</li><li>- të verifikojë nëse ka pasur raste të biletave të pavlefshme dhe të sigurohet që ato të dorëzohen fizikisht në Financë shoqëruar me procesverbalet përkatëse</li></ul>

<sup>6</sup> Attendance & Revenue Report



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT AUDITIMI "PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË MUZEUN HISTORIK KOMBËTAR

NR	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDËSI A	REKOMANDIMI
3.	<p>Nga auditimi mbi zbatimin e dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale dhe monetare, rezultuan problematika që lidhen me:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Inicimin e kërkesës për materiale jo nga sektorët përkatës,</li><li>- Procesverbale të marrjes në dorëzim të shërbimeve pa u konfirmuar nga MHK,</li><li>- Mungesë të planit të shpërndarjes,</li></ul> <p>Mungesë procedurash për aktivet që hyjne dhe dalin në të njëjtën datë;</p>			<p><b>a.</b> Me qëllim gjetjen e një balance të saktë midis mbajtjes së një gjendjeje të mjaftueshme aktivesh për përmbushjen e kërkesave operacionale, me minimumin e riskut dhe kostos për mbajtjen e tyre, nevojitet që në çdo rast kërkesa për aktive të iniciohet nga sektorët përkatës nga buron nevoja dhe jo ndryshe.</p> <p><b>b.</b> Përpara kryerjes së pagesës, me qëllim forcimin e kontroleve që vërtetojnë kryerjen e shërbimit të rojeve, nevojitet që Nëpunësi Zbatues (NZ) në çdo rast likuidimi të kërkojë procesverbalet nga punonjësit e autorizuar të MHK-së, ku të konfirmohet se cilësia e shërbimeve është e njëjtë me sa parashikuar në kontratë.</p> <p><b>c.</b> Me qëllim dokumentimin e lëvizjes së aktiveve si pjesë e rëndësishme e kontrollit të brendshëm, në çdo rast dalja e aktiveve nga magazina të bëhet ndër të tjera mbi bazën e planit të shpërndarjes së kartelës.</p> <p><b>d.</b> Për ato aktive që bëhen hyrje-dalje pa kaluar në magazinë (psh rastet e ikonave, rastet e materialeve për ekspozita, ose rampat, etj) , nevojitet që Nëpunësi Autorizues (NA) i njësisë publike, të miratojë procedura të qarta të lëvizjes, të shoqëruara me përgjegjësitë respektive.</p>
4.	<p>Nga auditimi mbi zbatimin e dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale dhe monetare, rezultuan problematika që lidhen me:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Mos regjistrimin në kohë të faturave të hyrje/daljeve në ditarët e magazinës;</li><li>- Kontabilizuar si inventar i imët objekte me vlera mbi 10,000 lekë</li></ul>			<p>Me qëllim eliminimin e tyre si pasojë e riskut operacional të shtuar nga mungesa e një sistemi të mirëfilltë kontabël, rekomandojmë blerjen e një sistemi të tillë.</p> <p>NA të marrë masa për rivlerësimin e 3 objektet me vlera mbi kufirin e vlerësimit prej 10,000 lekë me qëllim njohjen dhe kontabilizimin e drejtë të tyre sipas klasifikimit përkatës, si Aktive afatshkurtra materiale (imët/konsum) apo AAGJ materiale</p>
5.	<p>Nga auditimi mbi inventarizimin e pronës shtetërore rezultoi se, pasaportat/kartelat e 3 ikonave, të cilat i janë nënshtruar restaurimeve nga IMK, nuk ishin plotësuar me informacionin përkatës rreth ndërhyrjeve të kryera mbi to</p>			<p>Titullari i institucionit të ngrejë grupet e punës për rishikimin e Rregullores së Brendshme të MHK, me qëllim së pari</p>



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT AUDITIMI "PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË MUZEUN HISTORIK KOMBËTAR

NR	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDËSI A	REKOMANDIMI
	ndër vite (përfshirë edhe ndërhyrjet e fundit). Gjithashtu konstatohet se formati i "Kartelës së restaurimit dhe Konservimit" nuk ka elementë sigurie			reflektimin e kërkesave që burojnë nga Ligji i ri për Muzetë si dhe plotësimin me tej të kësaj rregulloreje me përshkrimin e proceseve që duhen ndjekur për zhvendosjen e ikona (por jo vetëm) duke parashikuar qartë rolet dhe përgjegjësitë e sektorëve/pozicioneve të përfshirë në proces Për sa restauruar deri tani, të merren masa që <b>te gjitha ndërhyrjet të pasqyrohen në pasaportën/kartelën e objektit</b> . Në kushtet kur këto dokumente të rëndësishëm nuk kanë asnjë element sigurie, të merren masa që pasi të plotësohen me informacionin e përditësuar, të protokollohen dhe arkivohen.
6.	Nga auditimi u konstatua se, aktualisht zhvendosja e vlerave të trashëgimisë kulturore me qëllim ruajtjen e vlerave të tyre në mjedise të përshtatshme, nga pikëpamja e sigurisë ose mikroklimës, në varësi të natyrës së objektit, deri tani është bërë nga Instituti i Monumenteve të Kulturës (IMK). Por konstatohet se nuk ka gjurmë të dokumentuara për përgatitjen e studimeve paraprake, <b>përpara</b> kryerjes së zhvendosjes së objekteve të trashëgimisë kulturore, sikundër e dikton neni 10 i ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003 "Për trashëgiminë kulturore", I shfuqizuar me ligjin nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë". Aktualisht zhvendosja e aktiveve është bërë në përputhje vetëm me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 <sup>7</sup> . Kontrollat teknike paraprake krijojnë kushtet edhe për parashikimin e kalendarit të punimeve mbi afatin e fillimit dhe mbarimit të punimeve, i cili gjithashtu ka munguar			Në kushtet kur MHK nuk ka ekspertë për restaurimin, rekomandohet që në çdo rast të zhvendosjes së vlerave të trashëgimisë kulturore për qëllime restaurimi, konservimi, etj të kërkohej që nga ekspertët e IMK-së të kryen kontrolle teknike paraprake, ku në përfundim të specifikohen nevojat konkrete për restaurim, të shoqëruara me kalendarët e punimeve. Këto dokumente të rëndësishëm duhet t'i bashkëngjiten praktikës së dosjes, pasi vetëm duke pasur një relacion fillestar mbi kushtet e objektit dhe nevojat për restaurim, arrihet të monitorohet procesi duke u identifikuar në përfundim punimet që u kryen dhe a i shërbyen këto punime përmirësimit të kushteve sipas relacionit fillestar. Dokumentimi tejet i kujdesshëm i këtij procesi forcon kontrollat e brendshme që lidhen me zhvendosjen e objekteve të trashëgimisë kulturore dhe minimizon risqet e

<sup>7</sup> Psh në referencë të shkresës së MHK-së nr. 301, datë 14.04.2017 "Në zbatim të detyrave të lëna nga auditi I Ministrisë së Kulturës mbi ecurinë e restaurimit të tre ikonave, me vlerë 3,151,000 lekë, ku si bazë ligjore citohet vetëm udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011. Deri tani nuk ka gjurmë të kryerjes së ndonjë kontrolli teknik përpara se të merret vendimi për zhvendosjen e tyre, por kjo duket e sistemuar me ligjin e ri nr 27/2018, neni 71, "Kontrolli teknik"



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT AUDITIMI "PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË MUZEUN HISTORIK KOMBËTAR

NR	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDËSI A	REKOMANDIMI
7.	<p>Administrata e Muzeut Historik Kombëtar zhvillon aktivitetin e saj në zbatim të rregullores së brendshme, e cila është miratuar me urdhrin e brendshëm të Drejtorit të Muzeut me Nr.608/1 prot. , datë 14.07.2016. Kjo rregullore e brendshme nuk është e përditësuar me strukturën e vitit 2017 dhe asaj 2018, ndaj ka mospërputhje midis tyre. Nga auditimi rezultoi se, në ligjin e ri për "Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë" në nenin 201, pika b parashikohet që, "Muzeu realizon punë kërkimore dhe siguron hulumtimin e plotë të koleksioneve të muzeut e të studimit në disiplinën shkencore". Sa më sipër e bën absolutisht të domosdoshme ristrukturimin e organikës dhe gjithashtu përditësimin e rregullores së brendshme, në përputhje me përmbushjen e objektivave që ligji parashikon për Muzeun Historik Kombëtar.</p> <p>Mosplotësimi i strukturës me pozicionet e parashikuara, në kushtet kur parimi 3, i Komponentit 1 të Kontrollit të Brendshëm "Mjedisi i Kontrollit" dikton nevojën që <i>menaxhimi të krijojë një strukturë organizative ku të caktojë përgjegjësi për të arritur objektivat e njësisë, mbart risqe të mosfuzionimit me efektivitet të kontrolleve të brendshme.</i></p>			<p>abuzimit/mashtrimit me to.</p> <p>Drejtimi duhet të krijojë një strukturë organizative të nevojshme për t'i lejuar njësisë që të planifikojë, zbatojë, kontrollojë dhe vlerësojë MHK-në në arritjen e objektivave të tij. Në këto kushte, MHK jo vetëm që duhet të plotësojë strukturën me pozicionet e specialistit të BNJ, magazinierit dhe Zv/Drejtorit, por gjithashtu duhet ta rishikojë këtë strukturë nën dritën e kërkesave që burojnë nga Ligji i ri "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë", duke konsideruar edhe funksionet e reja që i shtohen veprimtarisë së tij (si psh kërkimi shkencor).</p>

#### I/c. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit.

##### **Opinion mbi përputhshmërinë (i kualifikuar)**

Ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së MHK me kriteret e vlerësimit përfshirë kuadrin ligjor, rregullat, rregulloret dhe marrëveshjet që lidhen dhe ndikojnë në përdorimin e fondeve/burimeve të MHK-së. Gjithashtu auditimi përfshiu një analizë të sistemeve të kontrollit të brendshëm (KB) me qëllim vlerësimin e hartimit, implementimit dhe funksionimit me efektivitet të kontrolleve të brendshme, ku në përfundim u konstatuan thyerje të tyre përgjatë hartimit dhe implementimit e si pasojë edhe funksionimit të këtyre sistemeve. Është përgjegjësi e drejtimit që të hartojë procedura dhe politika që i përshtaten rrethanave të njësisë dhe të kërkojë implementimin e tyre si pjesë integrale e operacioneve të njësisë, në mënyrë që kontrollet e brendshme të funksionojnë në mënyrë efektive, duke mundur kufizimin e risqeve të keqpërdorimit të fondeve publike, dhe duke mos rrezikuar realizimin e objektivave të institucionit.

Mbështetur mbi punën audituese në përfundim rezultoi se, në opinionin tonë, aktiviteti i Muzeut Historik Kombëtar, me përjashtim të çështjeve të trajtuara në bazën për kualifikimin e opinionit ku u konstatuan shmangie nga kuadri rregullator ose mungesë e tij, është në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e vlerësimit, si dhe me parimet dhe rregullat e aplikueshme.

**Baza për kualifikimin e opinionit mbi përputhshmërinë**

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAIs). Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin "Përgjegjësitë e Audituesit për auditimin e Pasqyrave Financiare", pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 4000 "Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë". Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin nr. 27, datë 20.04.2008, të Kryetarit të KLSH-së. Auditimi ynë përfshin kryerjen e procedurave me qëllim marrjen e evidencave të auditimit mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e transaksioneve. Procedurat janë përzgjedhur mbështetur mbi gjykimin profesional të audituesit, përfshirë marrjen në konsideratë të risqeve të mospërputhshmërisë materiale të transaksioneve me kriteret e parashikuara.

Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e marra gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e **opinionit të kualifikuar të auditimit**.

- Nga evidencat e marra rezultuan thyerje materiale të sistemeve të kontrollit përgjatë procesit të transferimit të ikonave për qëllime restaurimi, pasi kanë munguar procedura/rregullore të brendshme që të përshkruajnë proceset që duhen ndjekur për zhvendosjen e tyre shoqëruar me përcaktimin e qartë të roleve dhe përgjegjësi të sektorëve/pozicioneve/palëve të përfshira në proces; gjithashtu mosplotësimi i kartelave dhe pasaportave të ikonave, me informacionin përkatës mbi historikun e restaurimeve/konservimeve të kryera ndër vite, ka cënuar gjurmimin e procesit në vetvete; mungesa e buxheteve për krijimin e kushteve të përshtatshme të konfortit ka shkaktuar dëmtime dhe problematika të përsëritura (rasti i ikonës së Shën Athanasit).

Sa më sipër ka bërë që këto objekte të trashëgimisë kulturore, me vlera të pazëvendësueshme të pasurisë kombëtare, të jenë vazhdimisht të ekspozuara përpara riskut të prishjes, humbjes, vjedhjes, pra "degradimit" të tyre.

- Nga evidencat e marra rezultuan thyerje të kontroleve përgjatë procesit të krijimit të të ardhurave dytësore (shitja e biletave), duke kufizuar audituesit në dhënien e sigurisë së arsyeshme mbi shifrat e deklaruara për këtë zë. Duke qenë burim kryesor i të ardhurave që menaxhohen nga vetë Muzeu, për proceset që gjenerojnë këtë kategori të ardhurash, duhet të tregohet kujdesi i duhur në mënyrë që ato t'i nënshtrohen menjëherë rregullave të disiplinës financiare.

- Nga evidencat e marra rezultuan thyerje të sistemeve të kontrollit që lidhen me mungesën e procedurave transparente të rekrutimit, shtuar kësaj mungesën e përshkrimit të punës dhe si pasojë mungesën e kualifikimeve të kërkuara për pozicionet.

**Opinion mbi pasqyrat financiare (I pakualifikuar)**

Ne audituam pasqyrat financiare të MHK-së më datë 31.12.2017, të cilat përbëhen nga Bilanci, Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve, Pasqyra e Fluksit të Arkës, dhe Pasqyra e Lëvizjes së Kapitalit si dhe shënimet shpjeguese që shoqërojnë pasqyrat.

Në opinionin tonë, veprimet përgjatë raportimit financiar dhe transaksionet e kryera për ekzekutimin e buxhetit janë në përputhje me ligjin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, si



dhe me ligjet dhe rregullat përkatëse të financave publike, përfshirë rregullat për prokurimet dhe ato të buxhetit.

### **Baza për opinionin mbi pasqyrat financiare**

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAIs). Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin "*Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare*", pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 4000 "Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë". Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin nr. 27, datë 20.04.2008, të Kryetarit të KLSH-së. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e **opinionit të pakualifikuar të auditimit**.

### **Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjet nën auditim:**

Drejtimi i MHK<sup>së</sup> është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Stafi drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjithë bazën ligjore dhe rregullatorë në fuqi.

### **Përgjegjësia e Audituesve të KLSH:**

Objektivi ynë lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme mbi përputhshmërinë e aktivitetit të MHK, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, si dhe mbi përdorimin e duhur dhe eficient të burimeve financiare të institucionit. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese.

Gjithashtu ne krijojmë një ide fillestare mbi kontrollin e brendshëm në mënyrë që të planifikojmë procedurat e auditimit që i përshtaten situatës aktuale.

Ne komunikojmë me drejtuesit ndër të tjera, edhe për planifikimin në kohë dhe përmbajtjen e auditimit si dhe konkluzionet/gjetjet, duke përfshirë edhe të metat e kontrollit të brendshëm, që ne kemi identifikuar gjatë auditimit tonë.

Ne identifikojmë çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.



## II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin 154/2014 Datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksonimin e KLSH", në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 1441/1, datë 04.01.2019, i ndryshuar me programin nr. 1441/2, datë 07.01.2019, në Muzeun Historik Kombëtar, nga data 07.01.2019 deri në 28.02.2019, për periudhën nga 01.01.2017 deri në 31.12.2018, u krye auditimi financiar dhe i përputhshmërisë në Muzeun Historik Kombëtar (MHK)

**Titulli:** Raporti i Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë në Muzeun Historik Kombëtar (MHK).

**Marrësi:** Ky Raport i adresohet Muzeun Historik Kombëtar, Drejtorit të Përgjithshëm.

### **METODOLOGJIA DHE OBJEKTIVAT E AUDITIMIT**

#### **a) Objektivat dhe qëllimi i auditimit:**

Objektivat specifike të auditimit ose pohimet për marrjen e garancive për besueshmërinë e pasqyrave financiare janë:

-Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim si; përkatësia, plotësia, saktësia, periudha, klasifikimi, ligjshmëria dhe rregullsia.

-Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhës si; ekzistenca, të drejtat dhe detyrimet, plotësia, vlerësimi dhe alokimi.

-Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese si; transaksione, të drejtat dhe detyrimet, plotësia, klasifikimi dhe kuptueshmëria, saktësia dhe vlerësimi.

Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është të rrisim shkallën e besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinioni nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë financiare. Gjithashtu, lidhur ky qëllim me aspektin e përputhshmërisë ligjore dhe rregullative të këtyre transaksioneve, mundësohet një qasje më e gjerë e analizimit të aktivitetit të këtij institucioni në tërësi. Kjo përgjegjshmëri ka të bëjë drejtpërdrejt me menaxhimin e shëndoshë financiar si dhe me faktin që, rezultatet e përdorimi i burimeve janë të paraqitura drejt dhe në përputhshmëri me kornizën e raportimit financiar. Audituesit shtetërorë do të japin sigurinë ose jo nëse informacioni i paraqitur mbi shpenzimin e parave publike në programet publike përfaqëson në mënyrë të përshtatshme situatën financiare.

Gjithashtu ky auditim ka për qëllim edhe kryerjen e auditimit të përputhshmërisë (pajtueshmërisë) me qëllim përcaktimin nëse të ardhurat dhe shpenzimet janë realizuar në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, si psh me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin; si dhe nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes me integritet të zyrtarëve të sektorit publik.

#### **b) Identifikimi i çështjes:**



Përgatitja dhe miratimi i Pasqyrave Financiare në MHK, është realizuar në mbështetje të Ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar, dhe akteve të tjera nënligjore në fuqi, në funksion të këtij ligji. Pasqyrat financiare janë dorëzuar brenda afateve të parashikuara në ligjet dhe aktet nënligjore të sipërcituara si edhe shoqërohen me relacion shpjegues (si lista e kreditorëve, e debitorëve, akt-rakordimet me sistemin e Thesarit, si edhe shpjegime të tjera sa i takon evidentimit të transaksioneve në llogaritë respektive). Ndërsa pasqyrat financiare për vitin ushtrimor 2018, mbështetur në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” ende nuk ishin mbyllur.

Për ushtrimin e aktivitetit, MHK mbështetet në Kushtetutën e RSH, ligjin nr. 9048, datë 07.04.2003 “Për trashëgimin kulturore”, I ndryshuar, ligjin nr. 9386, datë 04.05.2005 “Për muzetë”, I ndryshuar, sa më sipër të shfuqizuar me ligjin nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, statutin e Muzeut Historik Kombëtar, miratuar me Urdhrin nr. 49, datë 07.03.2016, të Ministrisë të Kulturës. Struktura dhe organika e MHK miratohet me urdhër të Kryeministrit pas propozimit të Ministrisë të Kulturës. Drejtimi dhe organizimi i veprimtarisë së MHK realizohet nga titullari i institucionit që është Drejtori i MHK-së.

Aktivitetet që do të jenë objekt vlerësimi nga ana e grupit të auditimit, janë parashikuar sipas drejtimeve të miratuara nga Kryetari I KLSH-së, në programin e auditimit 1441/1, datë 04.01.2018, i ndryshuar.

#### **c) Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar**

Drejtori i Përgjithshëm i MHK (*Nëpunësi autorizues*), Përgjegjësi i Sektorit të Financës (*Nëpunësi zbatues*), janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare. Staf i drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjithë kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.

#### **d) Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë**

Objektivat e punës sonë lidhen me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomali materiale, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Anomali të mund të lindin nga gabimet apo mashtrimet dhe konsiderohen si materiale, nëse individualisht ose në tërësi ato influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të pasqyrave financiare.

Objekivi ynë është gjithashtu dhënia e një opinion mbi përputhshmërinë e aktivitetit të institucionit, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, si dhe përdorimin e duhur dhe eficient të burimeve financiare të institucionit. Përveç standardeve të ISSAI, ne gjithashtu aplikojmë edhe gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe përpunojmë riskun e anomalive materiale të pasqyrave financiare, për shkak të gabimeve apo mashtrimeve, planifikojmë dhe kryejmë procedura auditimi sipas risqeve të identifikuar, dhe grumbullojmë evidencë të mjaftueshme e të përshtatshme për formulimin e opinionit tonë. Risku që vjen nga mos identifikimi i këtyre anomalive për shkak



të mashtrimeve, është më i lartë se ai i gabimeve, sepse mashtrimi mund të përfshijë falsifikime, fshirje të qëllimshme, keqinterpretime, apo edhe mungesë të qëllimshme të kontrollit të brendshëm.

- Krijojmë një ide fillestare mbi kontrollin e brendshëm në mënyrë që të planifikojmë procedurat e auditimit që i përshtaten situatës aktuale, por jo duke patur si qëllim kryesor dhënien e një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të MHK.
- Vlerësojmë nëse politikat kontable të zgjedhura nga stafi drejtues janë të duhurat dhe të arsyeshme.
- Krijojmë një konkluzion final nëse çështjet rutine të kontabilitetit janë kryer në mënyrën e duhur dhe bazohemi në evidencën e marrë nga auditimi, për ekzistencën e ndonjë dyshimi material mbi ngjarjet apo kushtet që mund të çojnë në një dyshim edhe më të madh mbi aftësinë e institucionit për të funksionuar normalisht. Nëse ne arrijmë në konkluzionin se ekziston një pasiguri e arsyeshme, ne duhet të kushtojmë më tepër rëndësi këtyre çështjeve gjatë auditimit tonë, dhe të modifikojmë opinionin. Konkluzionet tona janë të bazuara në punën audituese, deri në përgatitjen e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarje apo kushte specifike në të ardhmen mund të ndryshojnë situatën aktuale të institucionit.
- Vlerësojmë informacionin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë edhe shënimet, për të evidentuar nëse pasqyrat financiare përfaqësojnë transaksione rutinë dhe ngjarje të prezantuara drejt.

Ne komunikojmë me drejtuesin nëse, ndër çështjet e tjera, planifikimin në kohë dhe përmbajtjen e auditimit dhe gjetjet, duke përfshirë edhe të metat e kontrollit të brendshëm, që ne kemi identifikuar gjatë auditimit tonë.

Gjithashtu, ne u mundësojmë drejtuesve një deklaratë në lidhje me kërkesat etike të pavarësisë sipas të cilave ne kemi kryer punën tonë audituese, dhe komunikojmë me ta në rastet kur ekziston konflikt interesi apo çështje të tjera lidhur me etikën.

Ne identifikojmë çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

Auditimi gjithashtu është kryer në përputhje me ISSAI 4200 (Auditim Përputhshmërie lidhur me Auditimin e Pasqyrave Financiare), i cil ka për qëllim të vlerësojë nëse:

- nëse të ardhurat dhe shpenzimet janë realizuar në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin; dhe

- nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes me integritet të zyrtarëve të sektorit publik

#### **e) Kriteret e vlerësimit:**

- Ligji nr. 9048, datë 07.04.2003 "Për trashëgimin kulturore", I ndryshuar,

- Ligji nr. 9386, datë 04.05.2005 "Për muzetë", I ndryshuar, sa më sipër të shfuqizuar me ligjin nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë",

- Ligji nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe Pasqyrat financiare"



- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, I ndryshuar
- Ligji për Prokurimin Publik dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij
- Ligji nr. 57, datë 02.06.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar , si dhe aktet nënligjore për përgatitjen e buxhetit, monitorimin dhe zbatimin e tij.
- VKM nr. 432, datë 28.06.2006 “ Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave, që krijojnë institucionet buxhetore”
- Udhëzimi nr. 23, datë 28.12.2016 “Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2017”
- Udhëzimi nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2018”
- Udhëzimi nr. 14, datë 28.12.2006, “Per përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore te vitit 2006 per institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njesive qe varen prej tyre si dhe te njesive te menaxhimit / zbatimit te projekteve e marrveshjeve me donatore te huaj”, i ndryshuar, etj
- Statuti i Muzeut Historik Kombëtar, miratuar me Urdhrin nr. 49, datë 07.03.2016, të Ministrit të Kulturës.
- etj

#### **f) Standardet e Auditimit**

Auditimi u bazua në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, Manualin e Auditimit Financiar të KLSH, Manualin e Auditimit të Përpunueshmërisë të KLSH, si dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit Publik (ISSAI).

### **III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT**

#### **1. Informacion i përgjithshëm**

Muzeu Historik Kombëtar është institucion kombëtar, me statusin e personit juridik publik, në varësi të Ministrisë së Kulturës. Ai është institucion kërkimor-shkencor, buxhetor, i pavarur nga partitë apo shoqatat politike, institucionet apo organizatat fetare. Funksioni primar i Muzeut është ndër të tjera: ruajtja, mbrojtja e trashëgimisë kulturore e cila përfshin veprimtaritë që lidhen me administrimin e koleksioneve, analizën e rrezikut dhe zhvillimin e kapaciteteve për gatishmërinë dhe planet e emergjencës, sigurinë, konservimin parandalues e përmirësues, si dhe restaurimin e objekteve muzeore, për të siguruar integritetin e koleksioneve muzeore.

Muzeu Historik Kombëtar ka këto detyra:

- Zbaton politikën e Ministrisë së Kulturës në fushën e trashëgimisë kulturore, material dhe jo material, duke zhvilluar kërkime shkencore në fushën e ekspozimit, pasurimit, propagandimit, studimit, mbrojtje, konservimit dhe restaurimit të vlerave të trashëgimisë kulturore
- Përfton, ruan dhe studion provat material dhe jomateriale të trashëgimisë historike dhe kulturore të Shqipërisë, të cilat i komunikon dhe i paraqet në një mjedis që nxit edukimin



dhe argëtimin. Ai organizon dhe mundëson gjithashtu aktivitetet që përkrahin vizionin dhe emisionin e tij, etj

Për periudhën objekt auditimi, veprimtaria e Muzeut është mbështetur në Kushtetutën e RSH, ligjin nr, 9048, datë 07.04.2003 “Për trashëgimin kulturore”, I ndryshuar, ligjin nr. 9386, datë 04.05.2005 “Për muzetë”, I ndryshuar, sa më sipër të shfuqizuar me ligjin nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, statutin e Muzeut Historik Kombëtar, miratuar me Urdhrin nr. 49, datë 07.03.2016, të Ministrisë të Kulturës si dhe rregullore dhe udhëzime të brendshme.

## **2. Objekti, qëllimi dhe fushëveprimi i auditimit**

- a. Objekt i këtij auditimi është rregullshmëria dhe përputhshmëria e operacioneve financiare të MHK përgjatë vitit 2017 dhe vitit 2018.
- b. Qëllimi i auditimit: Garantimi i siguri së arsyeshme mbi përputhshmërinë e aktivitetit të MHK, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, si dhe mbi përdorimin e duhur dhe eficient të burimeve financiare të institucionit
- c. Fushëveprimi i auditimit: Vlerësimi i aktivitetit të MHK me qëllim dhënien e opinionit, është shtrirë sipas drejtimeve të programit të auditimit.

## **IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET**

### **1. MBI HARTIMIN DHE ZBATIMIN E PLANIT TË BUXHETIT**

Referuar statutit Muzeut Historik Kombëtar, miratuar me Urdhër të titullarit nr. 49, datë, 09.08.2016, neni 13 parashikon se, burimet e financimit të Muzeut Kombëtar janë:

a) Buxheti i shtetit

b) Të ardhurat nga shitja e biletave. Formatit dhe cmimi i biletës miratohen me urdhër të Ministrisë të Kulturës. Të ardhurat e realizuara nga shitja e biletave administrohen bazuar në udhëzimin e përbashkët nr. 52, datë 09.02.2015 të Ministrisë të Financave dhe Ministrisë të Kulturës “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave buxhetore në institucionet e sistemit të Ministrisë së Kulturës”.

c) Sponsorizimet dhe donacionet

c) të ardhura të tjera të ligjshme (si psh shërbime ndaj të tretëve duke vënë në dispozicion hapësirat që disponon kundrejt tarifave të miratuara – neni 15 I Statutit, ose nga shitja e artikujve të ekspozuar në këndet e shërbimit “SAL” (souvenir, art dhe libra)

**a. Zbatimi i kriterëve në planifikimin e buxhetit, mbështetur në ligjet vjetore të buxhetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit për vitet 2017 dhe 2018**



**Konstatim:** Ajo që vihet re është se, edhe pse kërkesat e Muzeut kanë ardhur në rritje nga njëra fazë e PBA-së 2017-2019, në tjetrën (nga 207,058 mijë lekë në 381,367 mijë lekë), limitet e miratuar nga Ministria përgjegjëse përveçse shume larg vlerave të kërkuara, kanë ardhur në rënie (nga 65,513 mijë lekë në 60,156 mijë lekë).

- Ligji për Muzetë
- Ligji për trashëgiminë kulturore;
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH", i ndryshuar me ligjin nr. 57, datë 02.06.2016
- Ligji nr. 130/2016 "Për buxhetin e vitit 2018"
- Ligji nr. 109/2017 "Për buxhetin e vitit 2018"
- VKM nr.80, datë 03.02.2016 "Për miratimin e kuadrit makroekonomik e fiskal për periudhën 2017-2019"
- UMF nr. 4, datë 29.02.2016 "Për përgatitjen e PBA 2017-2019"
- UMF nr. 10, datë 28.02.2017 "Për përgatitjen e PBA-së 2018-2020"
- Udhëzimi nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standare të zbatimit të buxhetit"
- Udhëzimi nr. 2, date 06.02.2012 "Për procedurat standare të zbatimit të buxhetit"

Mbështetur në shkresën e Ministrisë së Kulturës nr. 1153/1, datë 09.03.2016 "Mbi përgatitjen e PBA-së 2017-2019" në zbatim të Udhëzimit nr. 4, datë 29.02.2016 "Për përgatitjen e PBA 2017-2019", Muzeu Historik Kombëtar ka hartuar project buxjetin PBA Faza I, I cili iu dërgua Ministrisë së Kulturës me shkresën nr. 2071/1, datë 16.03.2016, duke respektuar afatet e parashikuara.

Faza e II-të e PBA-së është dërguar me shkresën nr. 660/1, datë 26.08.2016, duke respektuar afatet e parashikuara në përpunje me kërkesat ligjore që burojnë nga VKM nr.80, datë 03.02.2016 "Për miratimin e kuadrit makroekonomik e fiskal për periudhën 2017-2019" dhe UMF nr. 4, datë 29.02.2016 "Për përgatitjen e PBA 2017-2019".

Ng auditimi rezultoi se, për vitin 2017 Muzeu Historik Kombëtar, ka kërkuar në total fonde për të mbuluar shpenzimet në shumën 207,058 mijë lekë, ose 141,545 mijë lekë më shumë përtej limiteve të miratuara nga Ministria e Kulturës në shumën 65,513 mijë lekë. Në fazën e dytë të përgatitjes së PBA-së, Muzeu ka rishikuar kërkesat për mbulimin e shpenzimeve duke kërkuar në total 381,367 mijë lekë, ndërkohë që limitet e miratuara nga Ministria përgjegjëse janë ulur në 60,156 mijë lekë, sikundër paraqiten në tabelën në vijim (pra 321,211 mijë lekë më shumë):

**Tabela 1: Parashikimi I shpenzimeve ne te dy fazat e PBA 2017-2019**

**në mijë lekë**

Llogaria	Emertimi	Kerkesa Muzeu	Limiti I miratuar (fillestar)	Kerkesa Muzeu	Limiti I rishikuar
600	Paga	38,903	38,903	38,813	38,813
601	Sigurime shoqërore	6,541	6,541	6,526	6,526
602	Mallra shërbime	34,540	19,985	36,968	14,733
604	Transferta të brendshme	14,560	-	143,264	-
605	Transferta të ajshme	84	84	84	84
230	Shpenzime kapitale të trupëzuara	-	-	200	-
231	Shpenzime kapitale të trupëzuara	112,430	0	155,512	-
602	Mallra shërbime	-	-	-	-
	<b>TOTAL</b>	<b>207,058</b>	<b>65,513</b>	<b>381,367</b>	<b>60,156</b>


Nga auditimi u konstatua se, në fazën e parë të PBA-së kërkesat e Muzeut tejkalojnë limitet e parashikuara nga Ministria në zërat "Mallra dhe shërbime" për 14,555 mijë lekë kërkuar më



shumë; “Transferta të brendshme” për 14,560 mijë lekë kërkuar më shumë; “Shpenzime kapitale të trupëzuara në shumën 112,430 mijë lekë, ose kërkuar më shumë nga limiti I Ministrisë


112,430 mijë lekë. Në përfundim rezultoi se, në fazën e parë të përgatitjes së PBA-së, Muzeu ka kërkuar një buxhet prej 207,058 mijë lekë ose rreth 141,545 mijë lekë më shumë nga sa miratuar limitet Ministria përgjegjëse. Grafiku më poshtë paraqet kërkesat e Muzeut përkundrejt limiteve të Ministrisë, në fazën e parë të përgatitjes së PBA-së:

*Grafiku: Krahasimi kërkesë- limit, faza I e PBA 2017-2019*



Nga auditimi u konstatua se, në fazën e dytë të PBA-së kërkesat e Muzeut tejkalojnë limitet e parashikuara nga Ministria në zërat “Mallra dhe shërbime” për shumën 36,968 mijë lekë ose 22,235 mijë lekë kërkuar më shumë nga limitet; “Transferta të brendshme” për shumën **143,246 mijë** lekë ose kërkuar më shumë po 143,246 mijë lekë; Shpenzime kapitale të trupëzuara në shumën 155,512 mijë lekë, ose kërkuar më shumë nga limiti I Ministrisë rreth 155,512 mijë lekë. Në përfundim rezultoi se, në fazën e dytë të përgatitjes së PBA-së, Muzeu ka kërkuar një buxhet rreth 321,211 mijë lekë më shumë nga sa miratuar limitet nga Ministria përgjegjëse. Grafiku më poshtë paraqet kërkesat e Muzeut përkundrejt limiteve të Ministrisë, në fazën e dytë të përgatitjes së PBA-së:

*Grafiku: Krahasimi kërkesë- limit, faza II e PBA 2017-2019*



Nga auditimi i relacioneve që shoqërojnë pasqyrat e PBA-së, u konstatua se, rreth 62% të zërit “Mallra dhe shërbime” e zë paga e rojeve, dhe pjesa tjetër energji elektrike vecanërisht për kondicionimin e sallave për të ruajtur parametrat e domosdoshëm teknike për objektet muzeore, me qëllim moslejimin e degradimit të tyre. Në realcionin që shoqëron kërkesën për buxhet afatmesëm të Muzeut, konstatojmë se, mbështetur në projektet e institucionit për lidhjet me muzetë e ndryshme, brenda dhe jashtë vendit, diktohet nevoja për buxhet gjë që është e pamundur për shkak të limitit të miratuar.

Luhatjet më të mëdha vihen re në Artikullin 604, ku Muzeu kërkon një fond buxhetor prej 14,560 mijë lekë, të nevojshëm për realizimin e ekspozitës “Shqipëria gjatë luftës së ftohtë”; “Piktorët e huaj për Shqipërinë”; realizimin e tre projekteve të konservimit si: “Ndërhyrjet konservuese në 400 monedha, pjesë e korpusit të monedhave të MHK”, projekti “Ndërhyrje konservuese në 150 objekte të ekspozuara në Pavijonin e Lashtësisë” si dhe “Mirëmbajtja e ikonave ne Fonde

Programi Buxhetor Afatmesëm (PBA) **2018-2020** është hartuar në mbështetje të shkresës së Ministrisë së Kulturës nr. 1734, datë 28.03.2017 “Mbi përgatitjen e p/buxhetit 2018-2020”, në zbatim të UMF nr. 10, datë 28.02.2017 “Për përgatitjen e PBA-së 2018-2020”.

Muzeu historik Kombëtar, ka dërguar në Ministrinë e Kulturës, me shkresën nr. 264, datë 07.04.2017 PBA 2018-2020.

*Konstatojmë se, edhe për vitin 2018, ka mospërputhje të kërkesave buxhetore të Muzeut ndaj limiteve të miratuara nga Ministria e Kulturës*

*Theksojmë se, në referencë të ligjit nr 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, Ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore **koordinon, organizon dhe mbikëqyr** aktivitetet që lidhen ndër të tjera, me metodologjinë dhe përcaktimin e rregullave për ruajtjen e vlerave të paluajtshme kulturore dhe mjedisin e tyre. Gjithashtu ky ligj parashikon se ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore ushtron funksionet e ruajtjes, mbrojtjes, vlerësimit dhe administrimit të pasurive kulturore në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi.*



Vlen për tu përmendur vecanërisht kërkesa e institucionit referuar Formularit të Propozimit të Projektit të Investimit (Shtojca 2A sipas Udhëzimit nr. 4, datë 29.02.2016), ku MHK ka kërkuar fonde për investime me qëllim rritjen e sigurisë dhe ruajtjen e objekteve me vlera historike pasi:

- Sistemi I sigurisë së institucionit paraqet problem dhe defekte të ndryshme
- Sistemi antizjarr në MHK prej kohësh nuk funksionon duke diktuar problematika emergjente.

Në kushtet kur kërkesat e MHK-së për sa më sipër nuk janë marrë në konsideratë, Ministria përgjegjëse riskon të mos përmbush një nga funksionet e saj në lidhje me **organizimin dhe mbikëqyrjen** e aktiviteteve që lidhen ndër të tjera, me metodologjinë dhe përcaktimin e rregullave për ruajtjen e vlerave të paluajtshme kulturore dhe mjedisin e tyre.

Gjithashtu referuar PBA 2018-2020 (faza I), MHK ka propozuar miratimin e projektit të investimeve "Ruajtja e temperaturës në ambjentet e MHK-së, mbrojtja nga degradimi" për total shumë 58,023 mijë lekë (**e cila na rezultoi të mos jetë marrë në konsideratë nga Ministria përgjegjëse për miratimin e buxhetit**).

Edhe në fazën e dytë të PBA 2018-2020, MHK ka vijuar të propozojë në listën e investimeve projektin "Për ruajtjen e temperaturës në ambjentet e MHK-së, mbrojtja nga degradimi", në shumë 58,023 mijë lekë, **I pamiruar edhe ky**.

Sipas PBA 2017-2019 (faza II-të) në listën e propozuar për investime konstatuam se MHK ka propozuar edhe buxhet për investime "Sigurimi I temperaturës për pajisje ngrohje-ftohje" në shumë 53,200 mijë lekë. Gjithashtu në këtë formular janë propozuar edhe investime për rikonstruksion në total 316,509 mijë lekë (për rikonstruksionin e pavijonit të arkeologjisë, 220,000 mijë lekë; rikonstruksion pavijoni I pavarësisht 40.000 mijë lekë; rikonstruksion i vetratave 38,601 mijë lekë (**Fonde këto të pamiruar nga Ministria**).

*Në referencë të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit public", I ndryshuar është parashikuar se, aktivet afatgjata materiale duhen mbikëqyrtur rregullisht në drejtim të jetëgjatësisë së pjesëve përbërëse të tyre. Në një program mirëmbajtjeje të planifikuar ky informacion përdoret për të orientuar shpenzimet drejt punës parandaluese se sa drejt riparimit të avarive. Cdo njësi publike duhet të hartojë planin e mirëmbajtjes së aktiveve me qëllim planifikimin e fondeve të nevojshme si dhe sigurimin e eficiencës në përdorimin e aktiveve. Nga sa më sipër, duke iu referuar PBA-së konstatohet se përgjatë dy viteve objekt auditimi, fondet e nevojshme për planin e mirëmbajtjes së aktiveve nuk janë miratuar nga Ministria përgjegjëse.*

Pavarësisht sa më sipër, për tu siguruar se aktivet janë të vlefshme, nevojitet **krijimin I një mekanizmi kontrolli** bazuar në informacionin historic apo të pritshëm mbi situatat ku aktivet afatgjata mund të mos jenë të mjaftueshme/përshtatshme për arritjen e objektivave të tyre.

Në këto kushte, diktuar edhe nga kërkesat e Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, cdo njësi e sektorit public duhet të plotësojë planin e vet me njohje të mirë të bazës së aktiveve që duhen për të përmbushur objektivat e saj. **Strategjitë e menaxhimit të aktiveve** duhet të synojnë që të krijojnë, ruajnë dhe sipas nevojave të përmirësojnë strukturën e aktiveve (...). NA I të gjithë niveleve të njësisë publike janë përgjegjës për përgatitjen dhe monitorimin e sistemeve dhe



ruajtjen dhe mbrojtjen e aktiveve dhe dokumentacionit të njësive që mbulojnë kundrejt humbjeve, vjedhjeve, keqpërdorimit dhe përdorimit të paautorizuar të tyre<sup>8</sup>.

*Një ndër startegjitë e menaxhimit të aktiveve në MHK është edhe “Konservimi paraprak”, që konsiston në të gjitha masat e ndërmarra që nuk kërkojnë ndërhyrje direkte në pasuritë kulturore materiale, sic janë krijimi i kushteve të përshtatshme (lagështi relative, temperature, pastërti nga ndotja atmosferike, dëmtimi biologjik dhe fizik në fonde, ekspozimi dhe transporti), me qëllim parandalimin e cdo lloj dëmtimi. Titullari i njësisë publike është përgjegjës për miratimin e rregullave specifike dhe procedurave për ruajtjen, mbrojtjen dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve<sup>9</sup>*

---


<sup>8</sup> Paragrafet 7 dhe 7 të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011

<sup>9</sup> Paragrafi 5 I udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011




## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË MUZEUN HISTORIK KOMBËTAR



**Grafiku 3: PBA 2018-2020, Faza 1**  
*Krahasimi kerkese-limit I miratuar (në mijë lekë)*



**Grafiku 4: PBA 2018-2020, Faza 2**  
*Krahasimi kerkese-limit I miratuar (në mijë lekë)*

*Përgatiti: Grupi I auditimit, KLSH*

#### **1.b) Zbatimi I kriterëve në celjen e buxhetit sipas viteve, detajimi I planit fillestar, transferimet dhe rialokimet e fondeve buxhetore gjatë viteve ushtrimore si dhe planin përfundimtar, për vitet 2017, 2018**

Detajimi i limitit mujor të fondeve të Muzeut është bërë mbështetur në ligjin nr. 130, datë 15.12.2016 “Për buxhetin e vitit 2017”, UMF nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit”, si dhe në mbështetje të shkresës së Ministrisë së Financave nr. 17911, datë 30.01.2017, dhe shkresës nr. 366, datë 25.01.2017 të Ministrisë së Kulturës. Ne vijim paraqiten gjithë ndryshimet që ka pësuar buxheti i MHK gjatë vitit 2018:



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT AUDITIMI "PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË MUZEUN HISTORIK KOMBËTAR

#### Viti 2017

Artikulli	Shuma	Komente
600	3,243,596	Me shkresen nr.2639prot, date 08.05.2017 eshte akorduar <b>shtese</b> fondi 3243596 lek (600) pasi eshte celur buxheti me pak nga vete Ministria
	(2,372,160)	Me shkresen nr.6095/1 prot, date12.05.2017 eshte <b>pakesuar</b> fondi me 2372160 lek (600)
	(74,000)	Me shkresen nr.13971/1 prot, date12.10.2017 eshte <b>pakesuar</b> fondi me 74000 lek (600)

Artikulli	Shuma	Komente
601	52,760	Me shkresen nr.2639prot, date 08.05.2017 eshte akorduar <b>shtese</b> fondi 52760 leke (601) pasi eshte celur buxheti me pak nga vete Ministria
	(372,158)	Me shkresen nr.6095/1 prot, date12.05.2017 eshte <b>pakesuar</b> fondi me 372158 leke (601)
	(48,000)	Me shkresen nr.13971/1 prot, date12.10.2017 eshte <b>pakesuar</b> fondi 48000 lek (601)

Artikulli	Shuma	Komente
602	(1,000,000)	Me shkresen nr.6095/1 prot, date12.05.2017 eshte <b>pakesuar</b> fondi me 1000000 lek tek (602)
	1,000,000	Me shkresen nr.6095/3 prot, date12.05.2017 eshte akorduar <b>shtese</b> fondi 1000000 lek tek (602)

*Burimi: Sektori I Financës, MHK*



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Muzeun Historik Kombëtar

**Ndërsa për vitin 2018**, detajimi I buxhetit është bërë në zbatim të ligjit nr. 109, datë 30.11.2017 “Për buxhetin e vitit 2018”, UMF nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit”, I ndryshuar si dhe në mbështetje të shkresës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me nr. 19433/96, datë 17.01.2018, MHK ka bërë detajimin e buxhetit për vitin 2018. Ne vijim paraqiten gjithë ndryshimet që ka pësuar buxhetit i MHK gjatë vitit 2018:

#### Viti 2018

Artikulli	Vlera	Komente
600		Me shkresat nr.112 prot, date 01.02.2018 dhe shkresen 112/1, date 19.02.2018 është kërkuar <b>shtese</b> fondi (1945000+911745)per 45 punonjes plus punonjesit me kontrate( 3-punonjes )
	3,352,854	Akordimi per <b>shtese</b> fondi është bere me shkresen nr6400/2 , date 29.08.2018 ne vleren 3 352 854 lek
	(400,000)	Me shkresen 7344/2 prot.date 26.10.2018 është bere <b>pakesim</b> I fondit te pagave dhe kalimi I ketij fondi tek shpenz.operative (602) (është bere nga vete Min.Kultures ,sepse është bere ndryshim I pergjegjeses se Finances,Shih e-mailin)

Artikulli	Vlera	Komente
601	(84,952)	Pakesimi i fondit është bere me shkresen nr6400/2 , date 29.08.2018 ne vleren 84 952 lek
	(400,000)	Me shkresen 7344/2 prot.date 26.10.2018 është bere <b>pakesim</b> I fondit te sig . dhe kalimi I ketij fondi tek shpenz.operative (602) (është bere nga vete Min.Kultures ,sepse është bere ndryshim I pergjegjeses se Finances)
	230,000	Me shkresen 8894/3 prot.date 26.11.2018 është bere <b>shtim</b> I fondit te sig . Eka bere vete Min.Kultures

Artikulli	Vlera	Komente
602	800,000	Me shkresen 7344/2 prot.date 26.10.2018 është bere <b>pakesim</b> I fondit te pagave+sig shoq dhe kalimi I ketij fondi tek shpenz.operative (602) (është bere nga vete Min.Kultures ,sepse është bere ndryshim I pergjegjeses se Finances,Shih e-mailin)

Artikulli	Vlera	Komente
606	42,840	Me shkresen nr.221 prot,date 28.02.2018 kerkese per celje fondi per shperblim dalje ne pension nje punonjes ne vleren 42840 leke, akordimi është bere me shkresen nr1752/2 ,date 10.04.2018
	70,000	Me shkresen nr.420 prot,date 08.05.2018 kerkese per celje fondi per shperblim dalje ne pension nje punonjes ne vleren 70 000leke, akordimi është bere me shkresen nr3434/3 ,date 20.06.2018
	91,500	Me shkresen nr.728 prot,date 03.09.2018 kerkese per celje fondi per shperblim dalje ne pension nje punonjes ne vleren 91500 leke, akordimi është bere me shkresen nr7114/2 ,date 05.11.2018
	48,827	Me shkresen nr.737 prot,date 06.09.2018 kerkese per celje fondi per shperblim dalje ne pension nje punonjes ne vleren 48 827 leke, akordimi është bere me shkresen nr7114/2 ,date 05.11.2018



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në "Muzeun Historik Kombëtar"

Artikulli	Vlera	Komente
604	171,000	Me shkresën nr.201prot,date 21.02.2018 kërkohej fondi për realizimin e ekspozitës me koleksionin e Znj.Patricia Nugee në kuadrin e vitit mbarekombëtar të Skenderbeut dhe me shkresën nr.2977 prot,date 30.04.2018 dërgohej akordimi I fondit
	580,000	Me shkresën nr.522 prot,date 12.06.2018 kërkohej fondi për mbështetjen e ekspozitës "Nga Skenderbeu tek Pavaresia" me autor botuesin Ylli Sula dhe me shkresën nr.4044/2 prot,date 03.07.2018 dërgohej akordimi I fondit

*Burimi: Sektori I Financës, MHK*

#### 1.c) Realizimi i planit të buxhetit për vitin 2017

*Konstatim: Mungesa e raportimit dhe monitorimit sipas kërkesave të diktuara nga udhëzimi nr. 22, datë 18.11.2016, ka bërë thuajse të pamundur krahasimin e treguesve faktikë të performancës me ata të planifikuar, duke vështirësuar ndjekjen dhe si pasojë realizimin e objektivave të synuar.*

Në udhëzimin nr.2, datë 06.02.2012 "Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit", neni 43 parashikon se, NA i njësisë së qeverisjes qendrore i paraqet NPA sa here i kërkohej informacion lidhur me buxhetin, por jo me pak se 3 herë në vit lidhur me raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit për performancën financiare, produktet dhe objektivat e realizuar për çdo program.

Nga auditimi u konstatua se, për vitin 2017, MHK ka realizuar një buxhet total prej **56,305** mijë lekë ndaj 56,457 leke buxhet përfundimtar i miratuar (ose realizuar plani me rreth 99.73%), ku peshën më të madhe e kanë zënë shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore në masën 73% (ose 40,339 mijë lekë në total ose 76 mijë lekë më pak se plani); 25% e kanë zënë shpenzimet operative (në shumën 13,448 mijë lekë ose realizuar 52 mijë lekë më pak nga plani).

Viti 2017						në mijë lekë	
08220	plan 2017	ndrysh	pl.ndrysh 2017	fakt 2017	difer	%	
600	34,228	797	35,026	34,949	(76)	99.78%	
601	6,214	(367)	5,847	5,836	(11)	99.81%	
602	13,500	-	13,500	13,448	(52)	99.61%	
602/5	2,000	-	2,000	2,000	-	100.00%	
604	-	-	-	-	-	-	
605	84	-	84	72	(12)	85.40%	
tot.ap.trash	56,027	430	56,457	56,305	152	99.73%	

*Burimi: Sektori I Financës, MHK*

Artikulli 600 "Pagat" ka përfshirë pagën bazë dhe shtesat mbi pagë, mbështetur në VKM nr. 589, datë 17.07.2013 dhe VKM nr.610 datë 24.07.2013. Gjatë ëmuajit shkurt 2017 kanë rezultuar 3 pozicione vakante. Struktura e MHK dhe numri i punonjësve janë likuiduar në përputhje me Urdhrin e Kryeministrit nr. 19, datë 25.01.2014 "Për miratimin e strukturës dhe organikës së MHK", i ndryshuar me Urdhrin nr. 43, datë 07.04.2017 (ku numri nga 50 u bë 45 punonjës).



Gjithashtu janë likuiduar edhe 4 punonjës me kontratë të përkohshme<sup>10</sup> (4 ore pune ne dite), sipas VKM nr.7, datë 11.01.2017 “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2017, në njësitë e qeverisjes vendore”.

Derdhja dhe likuidimi i kontributeve – artikulli 601 - është bërë në përputhje me Ligjin nr. 184/2013 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10383, datë 24.02.2011 “Për sigurimin e detyrueshëm t ëkujdesit shëndetsor në RSH” ,si dhe VKM nr. 77, datë 28.01.2015 dhe VKM nr. 399. Datë 03.05.2017.

Artikulli 602 “Shpenzime operative” në shumën 13,448 mijë lekë është realizuar në respektim të limiteve të detajuara nga Ministria e Kulturës, sipas shkresës nr. 702, datë 08.02.2017 “Detajimin i limitit mujor për vitin 2017”. Nga auditimi rezultoi se, fondet e miratuara janë prokuruar dhe realizuar në masën 99.62%.

Krahas shlyerjes së nevojave bazë që janë shërbimi i rojeve, energji,, ujë, dezinfektimi, janë realizuar gjithashtu edhe blerje materialesh elektrike, kancelarie, botime, shtypje te biletave elektronike, materiale pastrimi, etj.

Gjatë vitit 2017 janë likuiduar gjithashtu edhe detyrimet për zbatimin e vendimeve gjyqësore, për punonjës të larguar nga puna (2,120 mijë lekë për 3 punonjës), pasi një pjesë e fondit që ishte planifikuar për likuidimin e energjisë u përballua me të ardhurat dytësore. Gjithashtu gjatë vitit 2017, MHK si pasojë e fitimit të gjyqit të nisur më parë me OSHEE, në shumën 615,600 lekë, OSHEE zbriti nga detyrimi i MHK-së për faturimin e muajit prill 331,486 lekë dhe atë të muajit maj për 306,494 mijë lekë.

Artikulli 605 “Tarnsferta korrente me jashtë” e planifikuar në shumën 84 mijë lekë është celur për anëtarësimin e MHK-së në ICOM dhe në NEMO. Kështu nga auditimi rezultoi se janë likuiduar në 270 Euro në shkurt 2017 (për anëtarësimin në ICOM) dhe 250 Euro në prill 2017 (për anëtarësimin në NEMO). Ky fond rezultoi me një tepriçë prej 12 mijë lekë si rezultat i kursit të këmbimit Euro/Lekë.

## Viti 2018

Nga auditimi u konstatua se, për vitin 2018, MHK ka realizuar një buxhet total prej **55,227** mijë lekë ndaj 58,163 leke buxhet përfundimtar i miratuar (ose realizuar plani me rreth 94.95 %), ku peshën më të madhe e kanë zënë shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore në masën 70% (ose 40,339 mijë lekë në total ose 89 mijë lekë më pak se plani); 24% e kanë zënë shpenzimet operative (në shumën 14,073 mijë lekë ose realizuar 227 mijë lekë më pak nga plani).

## Viti 2018

*në lekë*

08220	plan 2018	ndrysh	pl.ndrysh 2018	fakt 2018	difer	%
600	31,900	2,953	34,853	34,796	(57)	99.84%
601	5,830	(255)	5,575	5,543	(33)	99.41%
602	13,500	800	14,300	14,073	(227)	98.41%
602/5	2,600	-	2,600	2,600	-	100.00%
604		751	751	559	(192)	74.45%
605	84	-	84	69	(15)	82.71%
606			253	253	-	100%
tot.ap.trash	53,914	4,249	58,416	57,893	(523)	99.10%

**Burimi: Sektori I Financës, MHK**

<sup>10</sup> 3 për periudhën vjetore dhe një për muajt prill-tetor



Artikulli 600 "Pagat" përfshin pagën bazë dhe shtesat mbi pagë, në zbatim të VKM nr.589, datë 30.04.2018. Për vitin 2018, referuar VKM nr. 60, datë 31.01.2018 "Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2018 në njësitë e qeverisjes qendrore" MHK ka punësuar 3 punonjës me kontratë të përkohshme (për të cilët është kërkuar 912 mijë lekë).

*Artikulli 602 "Shpenzime operative"* është detajuar me shkresën e Ministrisë së Kulturës nr. 536/1, datë 31.01.2018. Në këtë zë janë përfshirë shërbimet bazë si: shërbimi i rojeve (6,237 mijë lekë), energji elektrike (4,253 mijë lekë), ujë (452 mijë lekë), dezinfektimi (216 mijë lekë), janë realizuar gjithashtu edhe blerje materiale elektrike, kancelarie, botime, shtypje te biletave elektronike, materiale pastrimi, materiale për ekspozita, per laborator, etj.

*Artikulli 604 "Transferta korente të brendshme"* realizuar në masën 74%, ose 559 mijë lekë nga 751 mijë lekë që ishin planifikuar.

- Me shkresën nr.2977, datë 30.04.2018 është celur fondi prej 171 mijë lekë për realizimin e ekspozitës me koleksionin e znj. Patricia Nugec, i cili është realizuar në masën 90 mijë lekë (ose 53%).
- Me shkresën nr.v4044/2, datë 03.07.2018 është celur fondi prej 580 mijë lekë për mbështetjen e ekspozitës "Nga Skënderbeu tek Pavarësia" i z. Ylli Sula.

*Artikulli 605 "Transferta korente me jashtë"* është realizuar në masën 69 mijë lekë (ose realizuar 83% ndaj planit) nga 84 mijë lekë që ishte planifikuar përbëhen nga pagesat për anëtarësimin e MHK në ICOM (270 Euro) dhe në NEMO (250 Euro), me një diferencë nga kursi i këmbimit prej rreth 14 mijë lekë.

*Artikulli 606 "Transferta nga buxhetet familjare"* është realizuar në shumën 253 mijë lekë dhe është përdorur plotësisht për shpërblimin e punonjësve për daljen në pension, konkretisht:

- Me shkresën nr. 1752/2, datë 10.04.2018 është celur fondi prej 43 mijë lekë;
- Me shkresën nr. 3434/3, datë 20.06.2018 është celur fondi prej 70 mijë lekë;
- Me shkresën nr. 7114/2, datë 05.11.2018 është celur fondi prej 140 mijë leke

Nga auditimi rezultoi se MHK nuk ka hartuar raporte periodike të monitorimit të buxhetit, duke mos bërë gjithashtu një analizë të (mos) realizimit të zërave (artikujve) krahasuar me planin, si dhe një analizë të faktorëve që kanë ndikuar në mosrealizim në rast se ka pasur, në kundërshtim kjo me kërkesat e Udhëzimit nr. 22, datë 18.11.2016 "Për procedurat standard të monitorimit të buxhetit në NJQQ.

Muzeu edhe pse Njësi e Qeverisjes Qendrore e krijuar me VKM të vecantë, **nuk ka zbatuar kërkesat e Udhëzimit nr. 22, datë 18.11.2016 "Për procedurat standard të monitorimit të buxhetit në NJQQ"** konkretisht janë të detyrshme për tu zbatuar anekset e monitorimit si më poshtë:

Aneksi 1 "Raporti i Shpenzimeve sipas Programeve"

ANEKSI nr.2 "Raporti i Shpenzimeve të Programit sipas Shpenzimeve"

ANEKSI nr.3 "Raporti permbledhes i realizimit te treguesve te performances/produkteve te programit"

ANEKSI nr.4 "Raporti i realizimit te objektiveve te politikes se programit"

ANEKSI nr.5 "Projektet e investimeve me financim te brendshem dhe me financim te huaj"

Është detyrë e institucionit edhe publikimi I këtyre raporteve në faqen zyrtare.



**-Monitorimi është një process vlerësimi performance, i cili realizohet nëpërmjet krahasimit të treguesve faktikë të performancës me ata të planifikuar dhe ka për qëllim:**

**-Të ndjekë dhe arrijë objektivat e synuar**

**-Të evidentojë nëse realizimi I produkteve është në përputhje me planin dhe nëse jo, të propozojë ndërmarrjen e veprimeve korrigjuese, duke rialokuar burimet, etj, me qëllim evidentimin e impaktit potencial në performancën e objektivave të lidhura me to.**

Moskryerja e këtij procesi ndikon pikërisht në mosrealizimin e qëllimeve të parashikuara më sipër, të cilat lidhen direkt me realizimin e objektivave të cdo institucioni publik si dhe analizimin e shkaqeve nëse këto objektiva nuk realizohen. Kryerja e raporteve të monitorimit në vetvete është hallkë e rëndësishme e sistemeve të kontrollit të brendshëm.

*MHK ka kthyer përgjigje mbi projekt raportin, me shkresën nr. 2/8, datë 25.04.2019, ku citon përsëri se MHK nuk është përdorues i SIFQ, por Ministria e Kulturës (MK) është edhe për institucionet e saj të varësisë, duke përforcuar edhe njëherë që është institucioni qendror (Ministria) që kryen raportimet periodike të monitorimit të buxhetit dhe bën analizën e realizimit të zërave.*

**Përgjigjia e grupit të auditimit:**

*Në kuptimin e nenit 4 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, "njësitë e qeverisjes qendrore" janë njësitë e pushtetit ekzekutiv, legjislativ dhe gjyqësor, të krijuara me Kushtetute ose me ligj (sic është rasti i Muzeut Historik Kombëtar), që kanë si veprimtari të tyre parësore përmbushjen e funksioneve të qeverisjes qendrore. "Njësia e qeverisjes qendrore" përfshin organin qendror dhe njësitë e varësisë të kontrolluara prej saj (sic është MHK). Në këto kushte observacioni nuk merret parasysh dhe grupi i auditimit i qëndron konstatimit.*

#### **1. d) Parashikimi dhe realizimi I të ardhurave dytësore**

*Qasja dhe metodologjia e auditimit e trajtuar më hollësisht në Aneksin 4 të këtij projekt-raporti përmban informacion mbi çështjet e përzgjedhura dhe mbulimin me auditim të të ardhurave dytësore.*

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të listuar edhe te baza ligjore më poshtë konstatohet që, nga ana e MHK janë zbatuar pjesërisht përcaktimet ligjore të bëra në:

- 1) Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", I ndryshuar
- 2) Udhëzimin nr.2 datë 06. 02. 2012 "për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit",
- 3) Statutin e Muzeut Historik Kombëtar, miratuar me Urdhrin nr. 49, datë 07.03.2016, të Ministrisë të Kulturës s.
- 4) Rregulloren e MHK-së

*Është për t'u vlerësuar trendi në rritje i të ardhurave dytësore nga njëri vit në tjetrin konkretisht realizuar të ardhura rreth 4,272 mijë lekë më shumë gjatë vitit 2018 në krahasim me vitin 2017, ku peshën më të madhe e kanë zënë të ardhurat nga shitja e biletave (rreth 66% të total të ardhurave dytësore), të cilat janë rritur me 2,331 mijë lekë (ose rreth 36% më shumë nga viti 2017); gjithashtu të ardhurat nga aktivitetet e tjera (si dhënia me qera e sallave zënë 30% të total të ardhurave dytësore) janë rritur me 2,063 lekë ose rreth 10% më shumë nga një vit më parë.*

*Pavarësisht trendit pozitiv të të ardhurave dytësore, theksojmë rëndësinë e forcimit të kontroleve përgjatë gjithë procesit të krijimit të të ardhurave dytësore (nga biletat konkretisht), pasi nga auditimi rezultoi se kontrollet e brendshme lidhur me këtë proces kanë qenë thuajse inekzistente, për sa kohë që kanë munguar: hartat e proceseve dhe gjurmët e auditimit që lidhen me këtë proces specifik.*

**Baza ligjore:**

- 1) VKM nr. 432, datë 28.06.2006 “ Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave, që krijojnë institucionet buxhetore”
- 2) Ligji nr. 9048, datë 07.04.2003 “Pë r trashë gimin kulturore”, I ndryshuar,
- 3) Ligji nr. 9386, datë 04.05.2005 “Për muzetë ”, i ndryshuar, sa më sipë r të shfuqizuar me ligjin nr. 27/2018 “Pë r trashë giminë kulturore dhe muzetë ”,
- 4) Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, I ndryshuar
- 5) Udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Kulturës dhe të Financave , nr.52, datë 09.02.2015 “Pë r krijimin dhe administrimin e të ardhurave buxhetore në institucionet e sistemit të Ministrisë së Kulturës”.
- 6) Udhëzimi nr.2 datë 06. 02. 2012 “për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”,
- 7) Statuti i Muzeut Historik Kombë tar, miratuar me Urdhrin nr. 49, datë 07.03.2016, të Ministrit të Kulturës.
- 8) Rregullorja e MHK-së
- 9) Akt-rakordimet e MHK-së me Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave, pë r të ardhurat dytë sore
- 10) Manuali i Ministrisë së Financave “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”
- 11) Udhëzimi I përbashkët I MF dhe Ministrisë së Kulturës nr. 52, datë 09.02.2015 “Për përdorimin e të ardhurave dytësore:

Nga auditimi rezultoi se, gjatë vitit 2017, institucioni I MHK-së ka realizuar të ardhura dytësore, në shumën 11,345 mijë nga të cilat derdhur në buxhetin e shtetit shuma prej 6,999 mijë lekë në përputhje me kërkesat e VKM nr. 432, datë 28.06.2006 “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave, që krijojnë institucionet buxhetore” si më poshtë:

**Tabela: Realizimi I të ardhurave dytësore , Viti 2017**

Burimet e te ardhurave	në lekë					
	Te ardhura	Pesha %	Rritje e autorizuar	Pesha e rritjes se autorizuar	Derdhur ne buxhet	Pesha e derdhjes ne buxhet
Biletat	6,391,622	56%	1,440,289	23%	4,951,333	77%
Aktivitete (qera salle)	1,867,000	16%	418,500	22%	1,448,500	78%
Pika e shitjes	599,462	5%	-	-	599,462	100%
Sponsorizime	541,936	5%	541,936		-	0%
Grante	1,945,500	17%	1,945,500		-	0%
<b>Total</b>	<b>11,345,520</b>	<b>100%</b>	<b>4,346,225</b>		<b>6,999,295</b>	

Përdorimi i të ardhurave dytësore mbështetet në Udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Kulturës dhe të Financave , nr.52, datë 09.02.2015. Plani i miratuar nga Ministria e Kulturës për përdorimin e të ardhurave është 2,000,000 lekë dhe për 12 - mujorin e vitit 2017 ky fond u përdor:

- për likuidimin e një pjese të energjisë elektrike në shumën prej 1,999,760 lekë, si dhe
- në shumën prej 240 lekë për likuidimin e një pjese të detyrimit ndaj UKT.



Nga auditimi rezultoi se, për vitin 2017 rreth 65% të të ardhurave dytësore të MHK i kanë zënë të ardhurat nga shitja e biletave (në shumën 6,391,622 lekë), për të cilat miratuar si rritje e autorizuar nga Ministria përgjegjëse shuma prej 1,440,289 lekë (ose rreth 23%), ndërsa derdhur në buxhet shuma prej 4,951,333 lekë (ose rreth 77% e total të ardhurave të krijuara nga ky aktivitet).

**Për vitin 2018**, realizimi dhe përdorimi I të ardhurave dytësore rezultoi si më poshtë vijon:

*Tabela: Realizimi I të ardhurave dytësore , Viti 2018*

*Në lekë*

Burimet e te ardhurave	Te ardhura	Pesha %	Rritje e autorizuar	Pesha e rritjes se autorizuar	Derdhur ne buxhet	Pesha e derdhjes ne buxhet
Biletat	8,723,580	66%	1,729,840	20%	6,993,740	80%
Aktivitete (qera salle)	3,930,000	30%	765,900	19%	3,164,100	81%
Pika e shitjes	476,972	4%	104,260	22%	372,712	78%
Sponsorizime	0	-	-	-	-	-
Shitje librash	11,980	-	-	-	11,980	-
<b>Total</b>	<b>13,142,532</b>	<b>100%</b>	<b>2,600,000</b>		<b>10,542,532</b>	

**Gjatë vitit 2018**, të ardhurat dytësore janë realizuar në masën 13,142,532 lekë, nga të cilat 2,600,000 lekë, derdhur në Degën e Thesarit dhe përdorur nga Muzeu në përputhje me kërkesat e diktuar nga VKM nr. 432, datë 28.06.2006 “ Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave, që krijojnë institucionet buxhetore”, dhe Udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Kulturës dhe të Financave, nr. 52, datë 09.02.2015 “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave buxhetore në institucionet e sistemit të Ministrisë së Kulturës”.

Nga verifikimi i zërave u konstatua se, janë realizuar:

- të ardhura nga shitja e biletave në vlerën 7,723,580 lekë, pra rreth 66% e totalit të të ardhurave dytësore është;
- të ardhura nga dhënia me qera e sallave në shumën 3,930,000 lekë, pra rreth 30% e totalit të të ardhurave dytësore; dhe
- të ardhura nga pika e shitjes 476,972 lekë, ose 4% e të ardhurave dytësore.

Në kushtet kur të ardhurat nga shitja e bileteve përgjatë dy viteve të njëpasnjëshëm, objekt auditimi kanë zënë peshën më të madhe në krijimin e të ardhurave dytësore, grupi i auditimit kreu inspektim fizik te Biletaria e MHK-së për të kuptuar procesin e shitjes së biletave, nga ku rezultoi si vijon:

1. Punonjësja e Biletarisë tërheq blloqet e biletave nga magazina.
2. Tek biletaria biletat, sapo kalojnë te makineria respective, marrin barcode si dhe vlerë sipas cmimeve të shitjes për 3 kategori (ose me cmim 0 lekë për kategoritë përkatëse). Për gjithë biletat që dalin të pavlefshme u konstatua se, nuk mbahet asnjë procesverbal, duke mos iu dorëzuar biletat e pavlefshme Sektorit të Financës. Në këtë mënyrë humb



cdo lloj kontrolli ndaj monitorimit të shitjeve duke riskuar që biletat e dala të pavlefshme, të rishiten. Baza ligjore e tatimeve parashikon se, në rastet kur si rezultat i

një gabimi të pavullnetshëm, nga ana e tatimpaguesit, është regjistruar një veprim shitjeje i porealizuar (gabim) nga ana e tatimpaguesit veprohet si më poshtë:

- Tatimpaguesi do të njoftojë në drejtorinë tatimore rajonale ku është i regjistruar, me një procesverbal (klikohet e shkarkohet nga faqja eëë.tatime.gov.al, në linkun : <https://eëë.tatime.gov.al/d/4/96/161/115/formulare-te-pajisjevefiskale>

- Pas kësaj ai do të vazhdojë të raportojë shitjet, raportime

- DPT do të bëjë reflektimin e këtij gabimi në të dhënat e regjistruara në serverin e raportimeve të shitjeve në DPT duke e stornuar atë (nëpërmjet pasqyrimit në një kolonë të veçantë). Pas zbritjes së gabimit (korrigjimit/rregullimit), subjekti do të vazhdojë raportimin e shitjeve, dhe nga zbritja e gabimit bërë nga DPT shifra e raportuar do të korrigjohet për të treguar xhiron reale. Konstatuam se në asnjë rast nuk është bërë anulim kuponi, për biletat e pavlefshme.

3. Klienti hyn në Muze, duke check-uar barcodin;

4. Në momentin që pritet bileta, automatikisht gjenerohet kuponi tatimor nga kasa fiksale, që deklarohet on line te tatimet<sup>11</sup>. Nga auditimi u konstatua se Njësia e Financës nuk rakordon në asnjë moment me faturën e gjeneruar nga kasa fiskale, pasi nga sa rezultoi edhe nga inspektimi fizik, kuponi printohej edhe ne raste kur bileta nuk merrte barcode, ose doli e pavlefshme. Verifikuam xhiron totale vjetore te Tatimet per subjektin Muzeun Historik Kombëtar e cila rezultoi:

- per vitin ushtrimor 2017, MHK deklaroi të Tatimet 6,373,580 leke (ose 18,042 lekë më pak nga sa deklaruar në pasqyrat financiare të MHK);

- për vitin ushtrimor 2018, MHK deklaroi të Tatimet 8,428,600 lekë (ose 294,980 lekë më pak nga sa deklaruar në pasqyrat financiare të MHK);

Te ardhura nga:	2017	2018
Biletaria	6,391,622	8,723,580
Kasa fiskale	6,373,580	8,428,600
Diferenca	(18,042)	(294,980)

5. Një ditë më pas, punonjësja përgjegjëse e Biletarisë (Sektori I Vizitorëve) përgatit raportin e shitjeve shoqë ruar me mandatpagesë n e bankë s mbi fondet e derdhura ditore dhe e dorëzon te punonjësja përgjegjë se për kontabilizimin e shumës<sup>12</sup>.

Nga verifikimet e grupit të auditimit, rezultoi se në praktikën e të ardhurave dytësore që dorëzohet në Sektorin e Financës, në asnjë rast Biletaria nuk ka dorëzuar kuponin tatimor që të shoqërojë raportimet ditore të të ardhurave nga shitja e biletave, duke mos dhënë siguri mbi shifrën e të ardhurave të realizuara (në fakt kuponi tatimor në vetvete nuk jep siguri pasi printohet edhe per biletet e pavlera dhe nuk

<sup>11</sup> Mungesa e inventarizimit -

<sup>12</sup> Dokumenti duhet te jetë I sigluar edhe nga përgjegjësi I sektorit, jo vetëm nga punonjësja.



anullohet më pas). Gjithashtu rezultoi se procesverbali mban vetëm një firmë, atë të punonjësës së Biletarisë, në kundërshtim me vetë kërkesat e Rregullores së

Brendshme të Muzeut, ku në nenin 17 të saj parashikon se, proces-verbale të dorëzohen cdo të premte në zyrën e financës pasi të konfirmohen me siglën e drejtorit.

Në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, është i rëndësishëm që titullari i njësisë publike të miratojë veprimtaritë e kontrollit, të përgatitura për të dhënë siguri të arsyeshme që risqet janë kufizuar brenda kufijve të pranueshëm, të përcaktuar gjatë procesit të menaxhimit të riskut. Veprimtaritë e kontrollit, duhet të përmbajnë ndër të tjera sistemin e dy në nshkrimeve, që nuk lejon që angazhimi financiar / pagesa, të kryhet pa marrë nënshkrimet e NA dhe NZ, apo të nëpunësve të tjerë të deleguar prej tyre sipas shkallës përkatëse të riskut<sup>13</sup>.

Për më tepër që, nga Sektori I Financës, ky informacion nuk kryqëzohet, as me të dhënat e gjeneruara nga sistemi elektronik i biletave dhe/ose nëpërmjet inventarizimit periodik (psh mujor: sa bileta u tërhoqën nga magazine, sa u shitën nga biletaria/sa gjendje). Konkretisht për muajt Tetor, nentor, verifikuam të dhënat e gjeneruara nga sistemi (konkretisht Raportin Attendance & Revenue Report) nga ku rezultuan mospërputhje shifrash si vijon:

*Tabela: Krahasimi i të dhënave të deklaruara mes Sistemit elektronik dhe evidencave nga Biletaria në copë*

	Shtator		Tetor		Nentor		Dhjetor	
	Sipas Sitemit IT	Sipas Biletarise	Sipas Sitemit IT	Sipas Biletarise	Sipas Sitemit IT	Sipas Biletarise	Sipas Sitemit IT	Sipas Biletarise
Bileta 200 leke	368	6,816	4,567	4,866	1,255	1,143	178	583
Bileta 100 leke	60	46	26	31	91	91	4	72
Bilete 60 leke	56	575	1,414	1,470	2,203	2,195	290	496
Vlera 0 leke	78	259	994	1,147	1,033	2,877	177	41
Total (cope)	562	7,696		-	-	-		-

*Gjithë sa më sipër bën plotësisht të pamundur verifikimin mbi saktësinë e shifrës së realizuar. Ky raport aktualisht mund të gjenerohet vetëm nga punonjësi i IT-, për më tepër që me Urdhrin e Kryeministrit nr. 110, datë 31.07.2018 “Pë r disa ndryshime në urdhrin nr.19, date 25.01.2014, të KM, “Për miratimin e strukturës dhe organikës së MHK-së”, të ndryshuar, në Sektorin e Komunikimit dhe Zhvillimit pozicioni I punonjësit të IT-së nuk është më, dhe këtë funksion e kryen një punonjës i AKSHI-t. Në kushtet kur këto raporte duhet t’ i shërbejnë funksionimit të kontrolleve të brendshme, mungesa e aksesit eliminon kontrollet. Për këtë vlerësojmë se NA i MHK-së duhet të kërkojë akses të menjëhershëm për të gjeneruar të gjitha ato raporte që vlerëson se forcojnë kontrollet që lidhen me deklarimin e të ardhurave nga shitja e biletave.*

Nga ana tjetër, praktikat ditore mbi shitjet e biletave dhe arkëtimet e shumave përkatëse, që punonjësja e biletarisë dorëzon në Sektorin e Financës, duhet të shoqërohen patjetër me kuponin

<sup>13</sup> Neni 22, ligji për MFK-në, pika 1 dhe 2/b, c.



tatimor, si dhe me procesverbal për biletat që rezultuan të pavlefshme, të cilat duhen gjithashtu të dorëzohen fizikisht. Formulari i deklarimit të të ardhurave duhet të firmoset edhe nga përgjegjësi I sektorit të vizitorëve, si dhe të siglohet nga NZ. Konstatohet që kjo praktikë jo e saktë është ndjekur si në vitin 2017 ashtu edhe në vitin ushtrimor 2018.

Gjithashtu rekomandojmë që, në fund të cdo muaji, të bëhet inventarizimi i biletave për të saktësuar shifrën e deklaruar. Në terma të forcimit të kontrolleve të brendshme të institucionit, Sektori I Financës duhet të krijojë dhe ndjekë proceset e nevojshme për të përmbushur misionin e vet.

Në kushtet kur, ka munguar dokumentimi I procesit, grupi i auditimit kreu testim duke marrë librat e finances, bllokun e magazinës dhe krahasuar me raportet që gjeneron IT, nga ku në përfundim rezultoi se:

- Formati i të dhënave mbi shitjet e biletave i gjeneruar nga sistemi nuk përputhet me formatin e financës
- Nga verifikimet e informacionit që përmban ky format, të dhënat e deklaruar nga IT nuk përputhen me të dhënat e financës, duke rezultuar kështu në një informacion jo cilësor dhe I papërdorshëm. Gjithashtu në kushtet e biletave elektronike (pra me barkode dhe jo letrat me vlerë) sistemi elektronik I biletave duhet të përdoret si hallkë kontrolli nga njësia përgjegjëse për kontabilizimin, pasi aktualisht të dhënat mbi të ardhurat nga shitja e biletave merren vetëm nga një burim, që është biletaria, mosfunksionimi I të cilit tregon se kontrollet nuk kane funksionuar.
- Nuk bëhen rakordime periodike mes biletave të tërhequra nga magazine, atyre të shitura, biletave të dala të pavlefshme dhe biletave gjendje, për të saktësuar shifrën e deklaruar.

Konstatuam se, sistemi elektronik I biletarise, operon në ambjentet e Muzeut dhe është aktiv që prej datës 27.07.2018, është marrë në dorëzim nga komisioni I ngritur me urdhrin e brendshëm nr. 549/1, datë 28.06.2018 në përputhje me kërkesat e date 27.12.2011, I ndryshuar, ku parashikohet si vijon:

**“Pika 42:** *Titullari i njesise miraton urdherin per ngritjen e komisionit per marrjen ne dorezim te aktiveve te furnizuara per sasinë, cilësinë, llojin, plotesine e tyre dhe te dokumentacionit shoqerues.*

Nga verifikimet u konstatua se, me Urdhrin e Ministrit të Kulturës nr. 884, datë 31.12.2018 “Për kalimin kapital të pajisjeve të sistemit të biletarise elektronike në sitet kulturore dhe muzetë” është urdhëruar të bëhet kalimi kapital nga ministria e Kulturës tek MHK I këtij sistemi.

Nga auditimi i dokumentacionit plotësuar nga MHK me observacionet e sjella me shkresën nr. 2/8, datë 25.04.2019 vumë re se komisioni përbëhet nga 3 punonjës të MHK-së, nga ku nuk ka ndonjë specialist të fushës sikundër e kërkon pika 43 e Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, e cila parashikon se: *“Komisioni përbëhet nga specialistë te fushes sipas llojit të aktiveve dhe, në rast nevojë, edhe nga ekspertë të jashtëm. Në komision bëjnë pjesë jo më pak se tre veta, duke përfshirë edhe punonjësin me përgjegjësi materiale.”*



**Konstatim:** Konstatohet se, janë hartuar pjesërisht sisteme të kontrollit të brendshëm që lidhen me procesin e shitjes së biletave.

Për sa më sipër rekomandojmë që, Titullari i njësisë të miratojë menjëherë urdhërin për ngritjen e komisionit për të verifikuar dhe analizuar me kujdes dokumentacionin si dhe gjithë produktet që ofron ky sistem me qëllim evidentimin e gjithë problematikave dhe shtimin e atyre elementëve që japin siguri se të dhënat e gjeneruara janë të saktat, me qëllim përdorimin e tyre si evidence të besueshme dhe të mjaftueshme nga vetë institucioni.

**Edhe pse sistemi është blerë nga Ministria e Kulturës, e cila është direct përgjegjëse për mosfunksionimin e tij,** mbetet detyrë e MHK-së të raportojë mbi çdo mangësi, pasi në kushtet kur një investim i tillë nuk plotëson objektivat për të cilat është blerë, atëherë risqet që të jenë cënuar parimet e efektivitetit, eficiencës dhe ekonomicitetit janë të mëdha.

Spektori I Financës raportoi se **gjendja fizike e biletave në Biletarinë e MHK-së , më datë 21.02.2019 është 2,662 copë ,** ndërsa shitjet deri në këtë datë janë 1,959 copë. Nga kryqëzimi i të dhënave me Magazinën rezultoi se për biletat, për vitin 2019 nuk është bërë asnjë dalje nga magazine, **por grupit të auditimit nuk iu vu në dispozicion asnjë evidencë e saktë dhe e besueshme mbi gjendjen kontabël të biletave më datë 31.12.2017 dhe 31.12.2018 (vecanërisht tek Biletaria), duke krijuar kështu kushtet që grupi I auditimit të mos ofrojë siguri të arsyeshme mbi saktësisht e shifrës së raportuar**

Te ardhura të tjera për Muzeun janë ato nga sponsorizimi i derdhur nga Ambasada Spanjolle për prodhimin e diçiturave, në shumën e arkëtuar prej 541,936 lekë dhe përdorur prej 538,800 lekë. Gjithashtu nga Muzeu Judetean de Istorie Brasov ardhur granti prej 1,945,500 lekë, në kuadër të projektit "I eas citizen of Stalin toën".

Nga auditimi rezultoi se, në evidencën e të ardhurave me kodin 7211100 llogaria "Grande" është në shumën prej 2,004,292 lekë që përfshin derdhjen prej 1,945,500 lekë si dhe 58,792.26 lekë kthim shumë mbasi rezultoi se ishte xhiruar më shumë (udhëtim dieta). Nga ky fond si 12-mujor, u përdorën 2,356,724 lekë.

**Në përfundim të konstatimeve nga auditimi mbi hartimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, po paraqesim gjetjet dhe rekomandimet si më poshtë:**

Titulli i Gjetjes 1:	Mungesa e monitorimit periodik
Situata:	Nga auditimi rezultoi se MHK nuk ka hartuar raporte periodike të monitorimit të buxhetit, duke mos bërë gjithashtu një analizë të (mos) realizimit të zërave (artikujve) krahasuar me planin, si dhe një analizë të faktorëve që kanë ndikuar në mosrealizim të tyre . Muzeu edhe pse Njësi e Qeverisjes Qendrore e krijuar me VKM të vecantë, nuk ka zbatuar kërkesat e Udhëzimit nr. 22, datë 18.11.2016 "Për procedurat standard të monitorimit të buxhetit në NJQQ" konkretisht janë të detyrueshme për tu zbatuar anekset e monitorimit si më poshtë: ANEKSI 1 "Raporti i Shpenzimeve sipas Programeve"



	<p>ANEKSI nr.2 "Raporti i Shpenzimeve të Programit sipas Shpenzimeve"</p> <p>ANEKSI nr.3 "Raporti permbledhes i realizimit te treguesve te performances/produkteve te programit"</p> <p>ANEKSI nr.4 "Raporti i realizimit te objektivave te politikës se programit"</p> <p>ANEKSI nr.5 "Projektet e investimeve me financim te brendshem dhe me financim te huaj" .</p> <p>Është detyrë e institucionit edhe publikimi I këtyre raporteve në faqen zyrtare.</p> <p>Monitorimi është një process vlerësimi performance, i cili realizohet nëpërmjet krahasimit të treguesve faktikë të performancës me ata të planifikuar dhe ka për qëllim:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>-Të ndjekë dhe arrijë objektivat e synuar</li><li>-Të evidentojë nëse realizimi I produkteve është në përputhje me planin dhe nëse jo, të propozojë ndërmarrjen e veprimeve korrigjuese, duke rialokuar burimet, etj, me qëllim evidentimin e impaktit potencial në performancën e objektivave të lidhura me to</li></ul>
<b>Kriteri:</b>	Udhëzimit nr. 22, datë 18.11.2016 “Për procedurat standard të monitorimit të buxhetit në NJQQ”
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Moskryerja e procesit të monitorimit ndikon pikërisht në mosrealizimin e qëllimeve të parashikuara më sipër, të cilat lidhen direkt me realizimin e objektivave të cdo institucioni publik si dhe analizimin e shkaqeve nëse këto objektiva nuk realizohen. Kryerja e raporteve të monitorimit në vetvete është hallkë e rëndësishme e sistemeve të kontrollit të brendshëm.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë
<b>Rekomandime:</b>	Me qëllim ndjekjen dhe arritjen e objektivave të synuar, MHK nevojitet që të përgatisë raportet periodike të monitorimit të buxhetit ku ndër të tjera: <ul style="list-style-type: none"><li>- të analizojë shkallën e realizimit të buxhetit dhe faktëret që kanë ndikuar në mosrealizimin e tij; si dhe</li><li>- të evidentojë nëse realizimi I produkteve është në përputhje me planin dhe nëse jo, të propozojë ndërmarrjen e veprimeve korrigjuese, duke rialokuar burimet, etj, me qëllim evidentimin e impaktit potencial në performancën e objektivave të lidhura me to, nëpërmjet plotësimit të : "Raportit të Shpenzimeve sipas Programeve”, "Raportit të Shpenzimeve të Programit sipas Shpenzimeve", "Raportit permbledhes të realizimit te treguesve te performances/produkteve te programit", "Raportit të realizimit te objektivave te politikës se programit", "Projektet e investimeve me financim te brendshem dhe me financim te huaj"</li></ul>



<b>Afati për zbatim:</b>	<b>Në vazhdim</b>
--------------------------	-------------------

<b>Titulli i Gjetjes 2:</b>	<b>Mungesa e veprimtarive të kontrollit / Të ardhurat dytësore nga shitja e biletave</b>
<b>Situata:</b>	<p><b>a.</b> Nga verifikimet e grupit të auditimit, rezultoi se në praktikën e të ardhurave dytësore që dorëzohet në Sektorin e Financës, në asnjë rast Biletaria nuk ka dorëzuar kuponin tatimor që të shoqërojë raportimet ditore të të ardhurave nga shitja e biletave, duke mos dhënë siguri mbi shifrën e të ardhurave të realizuara (për vitin 2018 sipas deklaratës në tatime, të ardhurat nga biletaria rezultuar 8,428 mijë lekë, ose 295 mijë lekë më pak nga sa deklaruar nga MHK).</p> <p><b>b.</b> Gjithashtu rezultoi se procesverbalet, dorëzuar nga punonjësja e Biletarisë, në Sektorin e Financës mbajnë vetëm një firmë, atë të punonjësës së Biletarisë, në kundërshtim me vetë kërkesat e Rregullores së Brendshme të Muzeut, ku në nenin 17 të saj parashikohet se, procesverbalet dorëzohen cdo të premtë në zyrën e financës pasi të konfirmohen me siglën e drejtorit. Sistemi I dy nënshkrimeve merr rëndësi nga pikëpamja e veprimtarive të kontrollit në kuadër të forcimit të kontrolleve të brendshme.</p> <p><b>c.</b> Sektori I Financës raportoi se gjendja fizike e biletave në Biletarinë e MHK-së , më datë 21.02.2019 është 2,662 copë , ndërsa shitjet deri në këtë datë janë 1,959 copë. Nga kryqëzimi i të dhënave me Magazinën rezultoi se për biletat, për vitin 2019 nuk është bërë asnjë dalje nga magazine, por grupit të auditimit nuk iu vu në dispozicion asnjë evidencë e saktë dhe e besueshme mbi gjendjen kontabël të biletave më datë 31.12.2017 dhe 31.12.2018 (vecanërisht tek Biletaria), duke krijuar kështu kushtet që grupi I auditimit të mos ofrojë siguri të arsyeshme mbi saktësisinë e shifrës së raportuar.</p> <p><b>d.</b> U konstatuan raste të paraportuara të biletave të pavlefshme dhe të padorëzuara në Sektorin e Financës,(me procesverbalet përkatëse), duke shtuar kështu riskun rishitjes së tyre, në kushtet e mungesës se kontrolleve mbi procesin.</p> <p><b>e.</b> Grupi I auditimit kreu testimet ku përzgjodhi muajt shtator, tetor, nëntor , dhjetor nga ku rezultoi se ka mospërputhje edhe mes të dhënave që gjeneron Raporti I IT-së, dhe atyre të deklaruara, për më tepër që dy formatet kanë përmbajtje jo të njëjta çfarë e bën të vështirë krahasimin. Gjithashtu konstatuam se Nëpunësi Zbatues nuk ka askes në sitemin elektronik të biletave, I cili duhet ti shërbejë për të gjeneruar raportet, me qëllim verifikimin e të ardhurave. Në kushtet kur këto raporte duhet t' i shërbejnë funksionimit të kontrolleve të brendshme, mungesa e aksesit eliminon kontrollet</p> <p><b>Në përfundim</b> konstatuam se në asnjë rast nuk është kryqëzuar</p>



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Muzeun Historik Kombëtar

	informacioni i sjellë nga Biletaria me: (1) deklarin sipas kasës fiskale; (2) raportin e gjeneruar nga sistemi elektronik I Biletarise <sup>14</sup> ; (3) nuk janë mbajtur procesverbale dhe nuk janë dorëzuar fizikisht biletet e dala “te pavlefshme”si dhe (4) nuk janë kryer invnetarizime periodike mbi gjendjen e biletave pas shitjes.
<b>Kriteri:</b>	Rregullorja e Brendshme e Muzeut (neni 17) <i>Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar</i>
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>- Forcimi I dokumentimit të procesve që lidhen me inventarizmin fizik të biletave në biletari, pasuar nga ndjekja me kujdes e rasteve kur biletat kanë dalë të pavlefshme; si dhe</li><li>- Kryqëzimi i informacioneve nga burime të ndryshme, ekzistente dhe të gatshme për tu përdorur (sistemi I IT-së, kasa fiskale, inventarizimet),</li><li>- minimizojnë riskun e mashtrimit dhe parregullive</li></ul>
<b>Shkaku:</b>	Mungesa e kontroleve/ moshartimi i proceseve të punës
<b>Rëndësia:</b>	E lartë
<b>Rekomandimi</b>	<p><b>1.</b> Me qëllim mirë menaxhimin e të ardhurave dytësore (nga shitja e biletave), Drejtori i institucionit duhet të marrë masa të menjëhershme për të cuar procesin drejt rregullshmërisë ligjore dhe financiare. Në funksion të sa më sipër, Sektori i Financës duhet të krijojë dhe ndjekë proceset e nevojshme për të përmbushur këtë misionin, nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- kryerjes së inventarizimeve periodike gjendjes fizike të biletave për të verifikuar saktësinë e shifrës së deklaruar.</li><li>- celjes së aksesit në sistemin elektronik të biletave (Nëpunësi Zbatues) për të gjeneruar të gjitha ato raporte që vlerëson se forcojnë kontrollin që lidhen me deklarin e të ardhurave nga shitja e biletave.</li><li>- kontrollit nëse procesverbalet e dorëzuar nga biletaria po respektojnë sistemin e dy nënshkrimeve</li><li>- kontrollit nëse bashkëngjitur procesverbalit është edhe kuponi tatimor I gjeneruar nga kasa, I cili duhet të rakordojë me shifrën e raportuar në procesverbal dhe arkëtuar në bankë;</li><li>- të verifikojë nëse ka pasur raste të biletave të pavlefshme dhe të sigurohet që ato të dorëzohen fizikisht në Financë shoqëruar me procesverbalet përkatëse</li></ul> <p><b>2.</b> Në përfundim të evidentohet dhe të na vihet në dispozicion gjendja kontabël e biletave në magazinë më datë 31.12.2017 dhe 31.12.2018. me qëllim verifikimin e saktësisë së shifrës së deklaruar.</p>
<b>Afati për zbatim:</b>	<b>Menjëherë</b>

<sup>14</sup> Attendance & Revenue Report



## 2. ZBATIMI I DISPOZITAVE LIGJORE PËR MARRËDHËNIET E PUNËS DHE PAGAVE

Administrata e Muzeut Historik Kombëtar zhvillon aktivitetin e saj në zbatim të rregullores së brendshme e cila është miratuar me urdhrin e brendshëm të Drejtorit të Muzeut me Nr.608/1 prot., datë 14.07.2016. Struktura e NHK-së është miratuar me VKM nr.893, datë 17.12.2014.

*Qasja dhe metodologjia e auditimit e trajtuar më hollësisht në Aneksin 4 të këtij raporti përmban informacion mbi çështjet e përzgjedhura dhe mbulimin me auditim të shpenzimeve për paga.*

### a. Respektimi i strukturave organike të miratuara dhe krahasimi me faktin

#### *Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:*

Administrata e Muzeut Historik Kombëtar zhvillon aktivitetin e saj në zbatim të rregullores së brendshme e cila është miratuar me urdhrin e brendshëm të Drejtorit të Muzeut me Nr.608/1 prot. , datë 14.07.2016. Kjo rregullore e brendshme nuk është e përditësuar me strukturën e vitit 2017 dhe asaj 2018, ndaj ka mospërputhje midis tyre. Në rregullore parashikohen funksioni e zv/drejtorit, i cili në strukturat e përmendura me lartë nuk ekziston si pozicion pune. Gjithashtu rregullorja ka të parashikuar funksione për specialistin e burimeve njerëzore si p.sh. në nenin 21, pika 5, por në strukturë nuk ka një pozicion pune të specifikuar për specialistin e burimeve njerëzore, duke e lënë të paplotësuar këtë funksion të rëndësishëm.

Referuar ligjit Nr.10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, (i azhurnuar me Ligjin nr.110/2015 datë 15.10.2015), neni 20“Mjedisi i kontrollit” / pika 1. Titullarët e njësisve të sektorit publik janë përgjegjës për ngritjen, gjendjen dhe përmirësimin e mjedisit të kontrollit. 2. Mjedisi i kontrollit përmban: .... pika ç) politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore....

#### *Procesi i miratimit të strukturës referuar vkm nr.893, datë 17.12.2014.*

**Hapi i I:** Ndërtimi i strukturës dhe organikes së institucioneve të administratës shtetërore përgatitet për Kryeministrin nga Departamenti i Administratës Publike, në bazë të propozimit të marrë nga ministri propozues. (Pika 31)

**Hapi i II:** Departamenti i Administratës Publike, përpara dërgimit të propozimit të Kryeministri, merr mendimin e Ministrisë së Financave për kostot financiare të propozimit përkatës. (Pika 32)  
Në kuadër të zbatimit të këtyre hapave të miratimit të strukturës është e domosdoshme që përmbushja e kriterëve të reja që ka sjellë ligji për “Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë” në nenin 201, pika b “realizon punë kërkimore dhe siguron hulumtimin e plotë të koleksioneve të muzeut e të studimit në disiplinën shkencore” nga ana e institucionit e bën absolutisht të domosdoshme



ristrukturimin e organikës dhe gjithashtu përditësimin e rregullores së brendshme, në përputhje me përmbushjen e objektivave që ligji parashikon për Muzeun Historik Kombëtar.

Ndaj në këto kushte titullari i MHK duhet të vër në dijeni Ministrinë e Kulturës, nga e cila ka varësi dhe Ministrinë e Financave, mbi domosdoshmërinë që MHK ka, në lidhje me përditësimin e rregullores dhe strukturës së institucionit.

**Ndarja e detyrave sipas hallkave të procesit** në mënyrë që objektivat e njësisë të realizohen me eficiencë si dhe mos të ketë hapësire për abuzim nga asnjë instancë e hierarkisë. Si p.sh. kohë shënuesi duhet të firmoset nga përgjegjësi i sektorit dhe më pas nga drejtori, në këtë mënyrë eliminohet risku i abuzimit nga një instancë për të shtrembëruar të dhënat. Sistemet e brendshme të kontrollit që ngre institucioni për të kryqëzuar vërtetësinë e të dhënave minimizojnë riskun e shkeljes së bazës ligjore në fuqi dhe konkretisht mos zbatimin e rregullores së brendshme. Konkretisht referuar Udhëzimi 30, datë 27.12.2011 *“PËR MENAXHIMIN E AKTIVEVE NË NJËSITË E SEKTORIT PUBLIK”, pika 69 “Listëpagesat plotësohen nga punonjësi i caktuar për pagat, duke u mbështetur në të dhënat e dokumentacionit bazë (listëprezenca e firmosur nga menaxheri i strukturës përkatëse) për shërbimin e kryer. Ato kontrollohen dhe nënshkruhen nga punonjësi i caktuar me menaxhimin e burimeve njerëzore dhe nëpunësi zbatues ose i deleguari i tij.”*

Konstatohet se në **sektorin e komunikimit dhe zhvillimit** dhe në **sektorin e programeve edukative** të strukturës së vitit 2017 dhe strukturës së vitit 2018 nuk ka pozicion pune që të kryejë funksionin e përgjegjësit të sektorit dhe referuar VKM nr.893, datë 17.12.2014 pika 3 *“Institucionet e administratës shtetërore të organizohen mbështetur në parimin e hierarkisë, sipas të cilit vartësit, në çdo nivel, duhet të ndjekin zinxhirin vendimmarrës dhe të komunikojnë me eprorët e tyre vetëm nëpërmjet eprorit më të afërt në hierarki.”*, pra, sa më sipër cituar mund të themi se ky zinxhir vendimmarrës, si dhe komunikimi në respektimin e hierarkisë nuk është i plotësuar ndaj dhe çënohen sistemet e kontroleve të brendshme por në të njëjtën kohë këto dy pjesë të strukturës nuk mund ti quajmë sektor kur nuk kanë eprorin me të afërt në hierarki për t'i emërtuar të tillë.

Në bazë të ligjit nr.10296, *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”* neni 22, pika 3, *‘Veprimtaria e kontrollit’*, cilësohet se përmbajnë sistemin e dy nënshkrimeve, i cili nuk lejon që angazhimi financiar të kryhet pa marrë nënshkrimet e nëpunësit autorizues dhe të nëpunësit zbatues të njësisë apo të nëpunësve të deleguar prej tyre sipas shkallës së riskut të lidhur me të, të vlerësuar për çdo angazhim, që ndërkohë në listë prezencën e nxjerrë nga borderoja e subjektit, rezulton që kohëshënuesi, në disa sektorë nuk është nënshkruar nga përgjegjësi i sektorit dhe drejtori por vetëm nga Drejtori i Muzeut.

Struktura e miratuar e Muzeut Historik Kombëtar nuk ka në përbërjen e saj një pozicion pune për menaxhimin e burimeve njerëzore, por në bazë të vkm nr.893, datë 17.12.2014 pika 28 citoj: *“Në institucionet, që kanë të paktën 30 (tridhjetë) pozicione pune, duhet të ekzistojë një pozicion pune për menaxhimin e burimeve njerëzore...”*.

Gjithashtu në strukturën e miratuar mungon pozicioni i punës së një magazinieri dhe konkretisht në bazë të urdhrit Nr. 181, datë 19.02.2018 të Drejtorit të Muzeut është ngarkuar një punonjës mirëmbajtje të zëvendësor punonjësien e cila edhe ajo ka qenë e ngarkuar të kryej punën e magazinieres me urdhrin Nr.178/2, datë 25.2.2014 pasi edhe në strukturën e asaj periudhe nuk ka qenë i parashikuar ky pozicion për të përmbushur këtë funksion pune, por referuar vkm



nr.893, datë 17.12.2014 pika 29 citoj: "*Funksioni i mbajtjes së magazinës së institucionit duhet të vendoset në një pozicion të ndryshëm nga ai i mbajtjes së financës së institucionit....*". **Konkretisht këtë pozicion pune e kryen një nga punëtorët e mirëmbajtjes, por rëndësia që ky pozicion mbart në lidhje me hyrjen dhe daljen e mallit nga magazina, rakordomi me sektorin e financës dhe me biletarinë e MHK, e bënë të domosdoshme që në strukturë të parashikohet një vend pune i dedikuar për të kryer funksionin e magazinierit.**

Rekrutimi i punonjësve në Muze, parashikohet në nenin 21 "*Procedurat e rekrutimit të punonjësve të rinj*" në Rregulloren e Brendshme, miratuar me urdhrin e brendshëm të Drejtorit të Muzeut, me nr.608/1 Prot., datë 14.07.2016. Ndërkohë që subjekti nuk disponon dokumentacionin që vërteton kryerjen e procedurave të rekrutimit, si dhe të garantojë se personat e përzgjedhur përmbushin kriteret dhe janë zgjedhur nepërmjet një procesi të drejtë dhe transparent.

*Konkretisht fazat e procesit të rekrutimit sipas nenit 21 janë këto:*

- 1- Punësimi pranë Muzeut Historik Kombëtar, do të kryhet përmes konkurseve publike.*
- 2- Konkursët do të zhvillohen me nismën e institucioneve kur konstatohen pozicione të lira pune në strukturë.*
- 3- Pozicionet e lira të punës do të publikohen me anë të njoftimit në internet, në faqen zyrtare të Muzeut Historik Kombëtar dhe do t'i komunikohen Ministrisë së Kulturës për publikimin e vendeve vakante dhe në faqen e tyre zyrtare.*
- 4- Njoftimi për vende të lira pune do të shoqërohet me emërtimin e pozicionit të punës, dokumentacionin ligjor që duhet të paraqesin kandidatët, kriteret dhe specifikat përkatëse në varësi të pozicionit të punës, si dhe afatet kohore të dorëzimit të kërkesës dhe dokumentacionit përkatës.*
- 5- Shqyrtimi i kërkesës dhe dokumentacioni i paraqitur do të realizohet nga një grup pune i përbërë nga jo më pak se tre anëtarë, në përbërje të së cilës janë Drejtori i Muzeut Historik Kombëtar, Specialisti i Burimeve Njerëzore dhe sipas rastit një specialist tjetër i përcaktuar nga Drejtori.*
- 6- Afatet për paraqitjen e dokumenteve nga kandidatët me urdhër të veçantë nga Drejtori i Muzeut Historik Kombëtar.*
- 7- Shpallja e fituesit do të publikohet me anë të një njoftimi në internet, në faqen zyrtare të Muzeut Historik Kombëtar.*

Nga auditimi i dokumenteve që na u vu në dispozicion nga MHK nuk gjendeshin dokumentet e rekrutimit sipas fazave si më sipër cituar, pra nuk ka një publikim në faqen zyrtare me datën reale për shpalljen e vendit vakant, nuk ka një njoftim për vend të lirë punë të shoqëruar me emërtimin e pozicionit të punës, dokumentacionin ligjor që duhet të paraqesin kandidatët, kriteret dhe specifikat përkatëse në varësi të pozicionit të punës, nuk është mbajtur procesverbal se sa kandidatë kanë marrë pjesë dhe pse pikërisht është zgjedhur ky kandidat fitues dhe jo një kandidat tjetër.

Gjithashtu grupi i punës i cili shqyrton dokumentacionin nuk përbëhet asnjëherë nga një punonjës i burimeve njerëzore sepse në strukturën e MHK nuk ka një punonjës të tillë dhe së fundi shpallja e fituesit në internet nuk është i dokumentuar.

Gjendur në këto kushte dhe referuar këtyre rrethanave të paqarta dalim në konkluzionin se procedurat e rekrutimit nuk janë kryer në përputhje me rregulloren dhe mbi të gjitha nuk janë



transparente. Mungesa e transparencës në mbajtjen e akteve që vërtetojnë çdo fazë rrit riskun e përzgjedhjes së fituesit jo në bazë të meritokracisë.

Për sa më lartë, të merren masa nga titullari që procedurat e rekrutimit të jenë të dokumentuara sipas fazave që janë të parashikuara në Rregulloren e Brendshme të MHK.

Në kontekstin e mësipërm merr rëndësi përcaktimi i qartë i detyrave për çdo pozicion pune me përshkrimin përkatës, i cili konstatohet të ketë munguar. Aktualisht përshkrimi i pozicioneve të punës kufizohet vetëm në sa shprehet Rregullorja e mësipërme, duke mbetur në nivel tejet të përgjithshëm. Mungesa e një Rregulloreje për Përshkrimin e Detyrave vështirëson jo vetëm rekrutimin, por edhe realizimin dhe monitorimin e kryerjes së detyrave përkatëse, sipas përgjegjësisë të gjithësecilit.

*Referuar ligjit të ri nr.27/2018 “Për trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, për periudhën nga data 17.05.2018 e në vijim institucioni funksionon në zbatim të ligjit të ri i cili me hyrjen në fuqi ka shfuqizuar ligjet e sipërcituara, por ligji i ri ka parashikuar që aktet ligjore dhe nënljore të dalin në zbatim të ligjit 9048, datë 07.04.2003, “Për trashëgiminë Kulturore” i ndryshuar, dhe ligjit 9386, datë 04.05.2005 “Për muzetë” të miratuara para hyrjes në fuqi të këtij ligji që nuk bien ndesh me të do të zbatohen derisa nuk janë miratuar aktet nënljore të parashikuara me këtë ligj.*

*Ndaj pretendimi se rregullorja e MHK nuk ka pasur fuqi veprimi pas miratimit të ligjit të ri, nuk është i bazuar ligjërisht, gjithashtu edhe për periudhën objekt auditimi viti kalendarik 2017 nuk ka vlerë observimi duke qënë se ligji i ri ka hyrë në fuqi në vitin 2018. Edhe observimi se dy punonjësit që janë rekrutuar kanë qënë pjesë e Praktikës së Punës pranë Ministrisë së Kulturës nuk është një pretendim i bazuar ligjërisht, por edhe sikur të ishte një nga punonjëset e rekrutuara së fundmi vjen nga një eksperiencë pune në privat dhe jo në MK. Pra, referuar konstatimit dhe faktit se observimet nuk janë të bazuara ligjërisht, konkludojmë se procedurat e rekrutimit të stafit janë bërë në shkelje të rregullores dhe observimi nuk merret në konsideratë.*

Në kuadër të ndarjes së detyrave në mënyrë specifike, konkretisht në lidhje me sektorin e financës grupi i auditimit ka hasur shumë vështirësi në marrjen e informacionit pasi specialistja nuk pranon të bashkëpunojë sepse ka ngarkesa të tjera pune. Nisur nga ky problem në ushtrimin e auditimit dhe referuar rregullores së brendshme të Muzeut, dalim në konkluzionin se në mënyrë emergjente rregullorja duhet të ndryshohet duke parashikuar në mënyrë specifike detyrat e specialistit të financës dhe detyrat e përgjegjësit të sektorit. Në rregulloren e brendshme, në nenin 11 parashikohen detyrat e specialistit por në mënyrë përgjithësuese të çdo specialisti në sektor të ndryshëm. Ndaj, në këto kushte shquhet nevoja urgjente që të specifikohen detyrat e çdo specialist sipas sektorit ku ushtron funksionin e tij. Referuar ligjit Nr.10 296, datë 8.7.2010 “për menaxhimin financiar dhe kontrollin” (I azhornuar me Ligjin nr.110/2015 datë 15.10.2015), neni 20 “Mjedisi i kontrollit” pika c) strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit omissis. Pra, rregullorja e MHK është në shkelje të hapur me ligjin Nr.10 296, datë 8.7.2010 “për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

Nga auditimi i kontratave të punës vihet re se çdo punonjës në nenin 1 “Qëllimi i Kontratës”, pika 1.3 thuhet se “ sipas nevojave të punëdhënësit, punëmarrësit mund ti ngarkohen edhe detyra



të tjera. Pra, edhe një herë del e qartë se ngarkesa në punë e punonjësit është e pacaktuar në mënyrë eksplicite.

Muzeu aktualisht ka 44 punonjës, nga shqyrtimit i dosjeve personale të punonjësve të Muzeut, rezultoi se pozicioni i punës që ato ushtrjnë përputhet me kualifikimin e tyre. 1 Drejtor, 5 Përgjegjës Sektori, 23 Specialistë, 4 Vëzhgues, 3 Punonjës Mirëmbajtjeje, 8 Pastrues, gjithashtu MHK për shkak të nevojës për këto pozicione pune ka punësuar 3 Punonjës me kohë të pjesshme (6 orë) ku 1- Pastrues dhe 2- Teknikë të Mesëm.

Referuar tek VKM-ja nr. 202, datë 15.03.2017 për disa ndryshime dhe shtesa në VKM. 717, datë 23.6.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për pagat e punonjësve mbështetës buxhetorë të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore”, të ndryshuar, lidhja nr.1, në bazë të urdhrin nr.19, datë 25.01.2014 të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të Organizatës së Muzeut Historik Kombëtar”, të ndryshuar për pagat dhe kategoritë e punonjësve të këtij subjekti paraqiten si mëposhtë:

Pozicioni	Kategoria	Pagat
Drejtori	II-b	100,000
Specialisti	IV-a	49,000
Përgjegjës Sektori	III-a/1	70,500
Bibliotekar	IV-a	49,000
Vëzhgues	IV	33,400
Teknikë	IV	26,741
Pastrimi	I	30,000

Gjithashtu MHK për shkak të nevojës për gjithë periudhën objekt auditimi (por edhe në periudhat e mëparshme) ka vijuar të punësojë **3 Punonjës me kohë të pjesshme** (6 orë) nga ku: 1 Pastrues dhe 2 Teknikë të Mesëm. Mundësia e punësimeve të përkohshme mbart risqe që lidhen me ndryshime të shpeshta të stafit. Duke qenë se nevoja për këta punonjës konstatohet të jetë e vazhdueshme (për më tepër kur në rastet e shpeshta të nevojës ata kanë shërbyer në punë edhe jashtë këtij orari), vlerësojmë se MHK duhet të shqyrtojë punësimin me kohë të plotë të kësaj kategorie punonjësish, ku të rishikojë strukturën e institucionit, duke minimizuar kështu edhe riskun që në këto pozicione të punësohen persona të ndryshëm.


**Në kuadër të këtyre rrethanave ne vlerësojmë se këto pozicione duhet të bashkëngjiten strukturës së përhershme të MHK, me kohë të plotë, pra 8 orë.**

Nga auditimi i kontratave të punonjësve të MHK u konstatua se një pjesë e punonjësve janë në marrëdhënie pune me kontratë 1 vjeçare dhe pjesa tjetër me kontratë me afat të pacaktuar. Më poshtë paraqitet në vlera reale ky raport<sup>15</sup>.

<sup>15</sup> Sa më sipër subjekt trajtimi edhe për shkak të shkresë-ankesës së ardhur në KLSH me email, protokolluar me nr. 79, datë 25.11.2019, nga ku në përfundim rezultoi se për periudhën objekt auditimi nuk ka patur punonjës me kontrata 6 mujore si edhe pretendohet në ankesë.



## Llojet e kontratave



Referuar shkresës së Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Kulturës me nr.1025 prot. datë 13.02.2018, e cila bazohet në VKM me nr. 60 datë 31.01.2018 “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2018 në njësitë e qeverisjes qendrore” ku parashikohet se Muzeu Historik Kombëtar në strukturën e tij i janë caktuar 3 punonjës, për një periudhë 1- vjeçare, në pozicionet teknike të mesëm dhe sanitare. Në bazë të lidhjes nr.1, pika 12 është përcaktuar orari ditor me 6 orë në ditë.

Mandati i drejtorit të Muzeut është 3-vjeçar, ndërkohë që në këtë subjekt drejtori është me emërim të përkohshëm, i cili ka zgjatur 2 vite.

Referuar urdhërit të Ministrit të Kulturës me nr.61 prot. datë 13.02.2017, i cili bazohet në VKM nr.173 datë 07.03.2003 “Për emërimin, lirimin ose shkarkimin nga detyra të drejtuesve të institucioneve, në varësi të Këshillit të Ministrave, Kryeministrit ose Ministrit”, është emëruar me emërim të përkohshëm drejtori aktual në detyrën e Drejtorit të Muzeut Historik Kombëtar. Këtij urdhri i bashkëngjitet, shkresa e Drejtorit të Përgjithshëm të Ministrisë së Kulturës me nr.61/1 prot. datë 13.02.2017. Emërimi i përkohshëm ka filluar në 13.0.2017 dhe vazhdon të kryej funksionet e Drejtorit të Muzeut Historik Kombëtar, pra po mbushen dy vite. Në këto kushte kuptimi i termit “i përkohshëm” e ka humbur sensin pasi referuar ligjit Nr. 27/2018 “Për trashëgimin kulturore”, neni 199, pika 1 përcaktohet se drejtorët e muzeve kanë një mandat tre vjeçar, ndaj jemi në kushtet kur po plotësohet afati i një mandati të plotë. Emërimi i përkohshëm i Drejtorit aktual të Muzeut është i referuar në bazën ligjore VKM nr.173, datë 07.03.2003 “Për emërimin, lirimin ose shkarkimin nga detyra të drejtuesve të institucioneve, në varësi të Këshillit të Ministrave, Kryeministrit ose Ministrit”, e cila rregullon marrëdhëniet e punës për punonjës me status të nëpunësit civil, por marrëdhënia punëmarrës/punëdhënës është e rregulluar me anë të një kontratë pune e lidhur midis Drejtorit dhe Ministrit të Kulturës të cilën nuk na është venë në dispozicion nga subjekti, **këto dy baza ligjore përjashtojnë njëra tjetrën ndaj edhe nuk është e qartë se me çfarë baze ligjore rregullohet kjo marrëdhënie pune.**

Nga auditimi mbi rregullshmërinë financiare në Muzeun Historik Kombëtar në zbatim të pikës 2 të drejtimeve kryesore të programit të auditimit Nr.1441/1, datë 04.01.2019, mbi “respektimin e dispozitave ligjore për pagat e punonjësve” ka rezultuar si më poshtë:



Me observacionet ardhur me shkresën nr. 2/8, datë 25.04.2019, MHK observon se duke qenë se procedura e rekrutimit për arsye se rregullorja e brendshme nuk është më në fuqi si pasojë e ndryshimit të ligjit, aktualisht kjo procedurë kryhet në bazë të nenit 11 “Punësimi” të Statutit të MHK-së, si i vetmi dokument ligjor në fuqi.

Në përgjigje të observacionit të MHK-së, grupi i auditimit pasi u njoh më nenin e sipërcituar, pika 1 konstatoi se punësimi në MHK bëhet me kontratë individuale sipas kriterëve të hartuara dhe miratuara nga MHK për secilin punonjës, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Deri më tani na rezulton se, këto kritere janë parashikuar në rregulloren ekzistuese, e cila në këtë observacion pretendohet të mos jetë në fuqi, në kushtet kur kuadri ligjor dhe rregullator ekzistues sipas ligjit të ri duhet të vijojë të mbetet në fuqi deri në miratimin e akteve të tjera nënligjore dhe rregullatore, në zbatim të tij, për sa kohë që ato nuk bien ndesh me këtë të fundit. Për sa më sipër observacioni nuk merret parasysht dhe KLSH i qëndron konstatimit.

## **b. Respektimi i dispozitave ligjore për pagat e punonjësve**

### **Për pagat e punonjësve për vitin 2017**

Nga auditimi i listëpagesave rezulton se ndalesat në pagë janë për kujdesin shëndetësor siç parashikohet në bazë të vëkm nr. 77 datë 28.01.2015 kreu II pika 4, germa a “jo më pak se sa paga minimale, e barabartë me 22 000 (njëzet e dy mijë) lekë dhe deri në shumën e pagës bruto, sipas deklaratës së listëpagesës, për personat e punësuar” në Kreu II, pika 3 germa a, “jo më pak se sa paga minimale mujore, e barabartë me 22,000 (njëzet e dy mijë) lekë dhe deri në 97,030 (nëntëdhjetë e shtatë mijë e tridhjetë) lekë, për personat e punësuar”.

- 1- Në lidhje me përcaktimin e vështirësisë në punë në bazë të VKM Nr. 717, datë 23.06.2009, pika 9 “Për pagat e punonjësve mbështetës së institucioneve buxhetore” Lidhja III “Kriteret për dhënien e shtesës së pagës, për punë të vështira dhe të dëmshme në shëndet”, është parashikuar se:
- 2- 1. Punonjës mirëmbajtës: Përfshihet në shkallën e I/a, d, e, g, të II /f, c dhe III/b
- 3- Vëzhgues salle/ruajtës fondesh: Përfshihet në shkallën e I/g dhe të II/f
- 4- Punonjës pastrimi: Përfshihet në shkallën e I/a, d dhe të II/f
- 5- Teknik i mesëm: përfshihet në shkallën e I/a dhe të II/f.

në 000/lekë

Nr.	Emërtimi	Plani	Ndryshim Plani	Plani i Ndryshuar	Fakti	%	%
1	Paga(600)	35,025,769	3,243,596	38,269,365	34,949,315	91.32%	99.78%
2	Sigurimet Shoqërore(601)	5,847,005	52,760	5,899,765	5,835,933	98.92%	99.81%
3	Mallra , shërbim. të tjerë(602)	13,500,000	-	-	13,447,990	-	99.61%
	<b>Totali</b>	<b>54,372,774</b>		<b>44,169,130</b>	<b>54,233,238</b>	<b>122.8%</b>	<b>99.74%</b>

Gjatë periudhës objekt auditimi, në muajin Maj 2017 me Urdhërin e Brendshëm nr.359 Prot., datë 03.05.2017 “Për ngritje në detyrë”, mbi bazën ligjore nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Urdhërin e Kryeministrit nr.43, datë 07.04.2017 “Për disa ndryshime” në Urdhërin nr.19, datë 25.01.2014, të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Muzeut Historik Kombëtar”, nenin 9 të Statutit të Muzeut Historik



Kombëtar, miratuar me Urdhrin nr.49, datë 02.03.2016 të Ministrit të Kulturës, Rregulloren e Brendshme të Institucionit, me qëllim organizimin dhe funksionimin sa më efektiv të administratës, një punonjës me pozicion punë specialist u ngrit në detyrë në pozicionin e punës përgjegjës sektori në sektorin e Menaxhimit të Koleksioneve.

Referuar shkresës së Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Kulturës me nr.2478 Prot., datë 27.04.2017 "Për mënyrën e funksionimit dhe përgjegjësitë e institucioneve të artit dhe trashëgimisë kulturore gjatë sezonit turistik veror", në zbatim të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003 "Për trashëgiminë kulturore", i ndryshuar, neneve 14 dhe 20 të ligjit nr. 9386, datë 04.05.2005 "Për muzetë", Urdhrit të Kryeministrit nr. 33, datë 29.03.2017 "Për miratimin e planit të masave përgatitore për sezonin turistik veror për vitin 2017 dhe për krijimin e Task-Forcës së Menaxhimit të sezonit turistik veror", për të plotësuar 40 orë punë në javë nga ora 09.00-19.30, disa punonjës të Muzeut Historik Kombëtar janë caktuar të punojnë ditën e dielë, për shkak të natyrës që ky institucion ka, për të pritur vizitorët dhe gjatë ditëve të pushimit, u është dhënë e hëna pushim, bazuar në Urdhërin e Brendshëm nr.449/1 Prot. dhe nr.451 Prot., datë 30.05.2017.

### **Për pagat e punonjësve për vitin 2018**

Nga auditimi me përzgjedhje i listë pagesave të vitit 2017 dhe 2018, rezultoi që kishte përputhshmëri në përlllogaritjen e pagave të punonjësve me pozicione të ndryshme, konkretisht :

- 1- Përgjegjës sektori
- 2- Specialist
- 3- Vëzhgues
- 4- Punonjës mirëmbajtjeje
- 5- Pastrues

Referuar shkresës së Ministrisë së Kulturës nr. 1514/3, datë 24.04.2018 "Për mënyrën e funksionimit dhe përgjegjësitë e institucioneve të trashëgimisë kulturore dhe artit gjatë sezonit turistik veror 2018" në zbatim të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003 "Për trashëgiminë kulturore", i ndryshuar, nenit 14 të ligjit nr. 9386, datë 04.05.2005 "Për muzetë", Urdhrit të Kryeministrit nr. 39, datë 28.02.2018 "Për miratimin e planit të masave përgatitore për mbarëvajtjen e sezonit turistik veror për vitin 2018 dhe ngritjen e grupit ndërinstytucional të punës, Task-Forcës për menaxhimin e sezonit turistik veror", për të plotësuar 40 orë punë në javë nga ora 09.00-19.00, disa nga punonjësit e Muzeut Historik Kombëtar janë caktuar të punojnë ditën e dielë, për shkak të natyrës që ky institucion ka, për të pritë vizitorët dhe gjatë ditëve të pushimit, u është dhënë e hëna pushim, bazuar në Urdhrin e Brendshëm nr.395/1, datë 02.05.2018.

Në 000/lekë

Nr.	Emërtimi	Plani	Ndryshim Plani	Plani i Ndryshuar	Fakti	%	%
1	Paga(600)	31,900,000	2,952,854	34,852,854	34,796,243	99.84%	109.1%
2	Sigurimet Shoqërore(601)	5,830,003	254,592	5,575,408	5,542,742	99.41%	95.1%
3	Mallra, shërbim, të tjerë(602)	13,500,000	800,000	14,300,000	14,072,721	98.41%	104.2%
	<b>Totali</b>	<b>51,230,003</b>	<b>4,007,446</b>	<b>54,728,262</b>	<b>54,411,706</b>	<b>297.66%</b>	<b>106.2%</b>

Në bazë të auditimit të kryer në Muzeun Historik Kombëtar në zbatim të pikës nr. 2 të programit të auditimit, u kërkua dokumentacioni i mëposhtëm:

- Shkresën e urdhrin nga Kryeministri për punonjësit me kohë të pjesshme, 6 orë në ditë.



- Shkresa për emërimin e drejtorit të Muzeut Historik Kombëtar, për emërimin e përkohshëm.
- Kontratat e punës për secilin punonjës.
- Listë prezencat në punë.
- Listëpagesat dhe libri i pagave për periudhën ushtrimore të vitit 2017 dhe 2018

**Në përfundim të konstatimeve nga auditimi mbi zbatimin e dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave, po paraqesim gjetjet dhe rekomandimet si më poshtë:**

**Titulli i Gjetjes 1:** Çështje që lidhen me:

- Rregulloren
- Strukturën

**Situata:**

Administrata e Muzeut Historik Kombëtar zhvillon aktivitetin e saj në zbatim të rregullores së brendshme, e cila është miratuar me urdhrin e brendshëm të Drejtorit të Muzeut me Nr.608/1 prot., datë 14.07.2016. Kjo rregullore e brendshme nuk është e përditësuar me strukturën e vitit 2017 dhe 2018, ndaj ka mospërputhje midis tyre<sup>16</sup>. Konkretisht:

- në rregullore parashikohet funksioni i zv/drejtorit, i cili në fakt, në strukturat e përmendura me lart nuk parashikohet si pozicion pune<sup>17</sup>,
- në nenin 21, pika 5 të rregullores është parashikuar një pozicion për specialistin e burimeve njerëzore<sup>18</sup>, ndërkohe që në fakt, në strukturë nuk ekziston një pozicion i tillë,
- në strukturën e miratuar mungon pozicioni i punës së një magazinieri dhe konkretisht në bazë të urdhrin Nr. 181, datë 19.02.2018 të Drejtorit të Muzeut një punonjës mirëmbajtjeje është ngarkuar që të kryejë punën e magazinierit, pozicion ky i rëndësishëm në kushtet kur në vetë strukturën e MHK-së parashikohet një vend pune i dedikuar për të kryer këtë funksion<sup>19</sup>,
- në sektorin e komunikimit dhe zhvillimit dhe në sektorin e programeve edukative të strukturës së vitit 2017 dhe strukturës së vitit 2018 nuk ka pozicion pune që të kryejë funksionin e përgjegjës të sektorit<sup>20</sup>.

<sup>16</sup> Ligji Nr.10 296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", (I azhurnuar me Ligjin nr.110/2015 datë 15.10.2015),neni 20 "Mjedisi i kontrollit" 1. Titullarët e njësisve të sektorit publik janë përgjegjës për ngritjen, gjendjen dhe përmirësimin e mjedisit të kontrollit. 2. Mjedisi i kontrollit përmban: .... pika ç) politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore

<sup>17</sup> VKM nr. 893, datë 17.12.2014 pika 3 "Institucionet e administratës shtetërore të organizohen mbështetur në parimin e hierarkisë, sipas të cilit vartësit, në çdo nivel, duhet të ndjekin zinxhirin vendimmarrës dhe të komunikojnë me eprorët e tyre vetëm nëpërmjet eprorit më të afërt në hierarki."

<sup>18</sup> Pika 28, VKM nr.893, datë 17.12.2014 "Në institucionet, që kanë të paktën 30 (tridhjetë) pozicione pune, duhet të ekzistojë një pozicion pune për menaxhimin e burimeve njerëzore..."

<sup>19</sup> VKM nr. 893, datë 17.12.2014, pika 29 citoj: "Funksioni i mbajtjes së magazinës së institucionit duhet të vendoset në një pozicion të ndryshëm nga ai i mbajtjes së financës së institucionit..."

<sup>20</sup> Ligji nr.10296, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" neni 22, pika 3, "Veprimtaria e kontrollit..."

b) ndarjen e detyrave në fushën e dhënies së autorizimit në atë formë, në mënyrë që i njëjti punonjës të mos jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për propozimin, miratimin, zbatimin, kontabilitetin dhe kontrollin, sipas udhëzimit të Ministrisë të Financave;

c) sistemin e dy nënshkrimeve, i cili nuk lejon që angazhimi financiar të kryhet pa marrë nënshkrimet e nëpunësit autorizues dhe të nëpunësit zbatues të njësisë;

**Kriteri:**

Në ligjin e ri për “Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë” në nenin 201, pika b) parashikohet që, “Muzeu realizon punë kërkimore dhe siguron hulumtimin e plotë të koleksioneve të muzeut e të studimit në disiplinën shkencore”. Për sa u trajtua më sipër, bëhet absolutisht i domosdoshëm ristrukturimi i organikës dhe përditësimin e rregullores së brendshme, në përputhje me përmbushjen e objektivave që ligji parashikon për Muzeun Historik Kombëtar.

Ligjit Nr.10 296, datë 8.7.2010 “PËR MENAXHIMIN FINANCIAR DHE KONTROLLIN”, (I azhurnuar me Ligjin nr.110/2015 datë 15.10.2015), neni 20 “Mjedisi i kontrollit” 1. Titullarët e njësive të sektorit publik janë përgjegjës për ngritjen, gjendjen dhe përmirësimin e mjedisit të kontrollit. 2. Mjedisi i kontrollit përmban: .... pika ç) politikën dhe praktikën e menaxhimit të burimeve njerëzore....

VKM nr.893, datë 17.12.2014 pika 3 “Institucionet e administratës shtetërore të organizohen mbështetur në parimin e hierarkisë, sipas të cilit vartësit, në çdo nivel, duhet të ndjekin zinxhirin vendimmarrës dhe të komunikojnë me eprorët e tyre vetëm nëpërmjet eprorit më të afërt në hierarki.”

Pika 28 “Në institucionet, që kanë të paktën 30 (tridhjetë) pozicione pune, duhet të ekzistojë një pozicion pune për menaxhimin e burimeve njerëzore...”

pika 29 citoj: “Funksioni i mbajtjes së magazinës së institucionit duhet të vendoset në një pozicion të ndryshëm nga ai i mbajtjes së financës së institucionit...”

Ligjit nr.10296, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 22, pika 3, ‘Veprimtaria e kontrollit...

b) ndarjen e detyrave në fushën e dhënies së autorizimit në atë formë, në mënyrë që i njëjti punonjës të mos jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për propozimin, miratimin, zbatimin, kontabilitetin dhe kontrollin, sipas udhëzimit të Ministrit të Financave;

c) sistemin e dy nënshkrimeve, i cili nuk lejon që angazhimi financiar të kryhet pa marrë nënshkrimet e nëpunësit autorizues dhe të nëpunësit zbatues të njësive;

ç) sistemin e dy nënshkrimeve, i cili nuk lejon që pagesa të kryhet pa marrë nënshkrimet e nëpunësit autorizues dhe të nëpunësit zbatues të njësive apo të nëpunësve të deleguar prej tyre...”

**Ndikimi/Efekti:**

Mosplotësimi i strukturës me pozicionet e parashikuara, në kushtet kur parimi 3, i Komponentit 1 të Kontrollit të Brendshëm “Mjedisi i Kontrollit” dikton nevojën që menaxhimi të krijojë një strukturë organizative ku të caktojë përgjegjësi për të arritur objektivat e njësive, mbart risqet të mosfunksionimit me efektivitet të kontroleve të brendshme.

ç) sistemin e dy nënshkrimeve, i cili nuk lejon që pagesa të kryhet pa marrë nënshkrimet e nëpunësit autorizues dhe të nëpunësit zbatues të njësive apo të nëpunësve të deleguar prej tyre...”



<b>Shkaku:</b>	Mosplanifikim i drejtë i nevojave për pozicionet konkrete
<b>Rëndësia:</b>	I ulët
<b>Rekomandime:</b>	Drejtimi të marrë masa për krijimin e një strukture organizative të nevojshme për t'i lejuar njësisë që të planifikojë, zbatojë, kontrollojë dhe vlerësojë MHK-në në arritjen e objektivave të tij. Në këto kushte, MHK jo vetëm që duhet të plotësojë strukturën me pozicionet e specialistit të BNJ, magazinierit dhe Zv/Drejtorit por gjithashtu duhet ta rishikojë këtë strukturë nën dritën e kërkesave që burojnë nga Ligji i ri “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, duke konsideruar edhe funksionet e reja që i shtohen veprimtarisë së tij (si p.sh. kërkimi shkencor).
<b>Afati i zbatimit:</b>	<b>Brenda datës 31.12.2019</b>

<b>Titulli i Gjetjes 2:</b>	Cështje që lidhen me: -Rekrutimin në përputhje me rregulloren, dhe - Përshkrimin e pozicionit të punës, si kriter për rekrutim
<b>Situata:</b>	Nga auditimi rezultoi se, subjekti nuk disponon dokumentacionin që vërteton:(a) kryerjen e procedurave të rekrutimit, në mënyrë që të garantojë se personat e përzgjedhur përmbushin kriteret (pasi këto kriterë mungojnë); si dhe (b) të jenë përzgjedhur nëpërmjet një procesi të drejtë dhe transparent (sikundër parashikohet në rregullore <sup>21</sup> ). Nga auditimi i dokumenteve që na u vunë në dispozicion nga MHK rezultoi se: nuk gjendeshin dokumentet e rekrutimit sipas fazave të parashikuara në nenin 21, të Rregullores së Brendshme, pra nuk ka një publikim në faqen zyrtare me datën reale për shpalljen e vendit vakant; nuk ka një njoftim për vend të lirë punë të shoqëruar me emërtimin e pozicionit të punës, dokumentacionin ligjor që duhet të paraqesin kandidatët, kriteret dhe specifikat përkatëse në varësi të pozicionit të punës; nuk është mbajtur procesverbal se sa kandidatë kanë marrë pjesë dhe pse pikërisht është zgjedhur ky kandidat fitues dhe jo një tjetër. Gjithashtu vumë re se, në përbërjen e grupit të punës, i cili shqyrton dokumentacionin, në asnjë rast nuk ka pasur punonjës të burimeve njerëzore, për faktin se në strukturën e MHK një pozicion i tillë nuk ekziston; dhe së fundi shpallja e fituesit në internet nuk është e dokumentuar.
<b>Kriteri:</b>	Rregullore e Brendshme, nenin 21 “ <i>Procedurat e rekrutimit të punonjësve të rinj</i> ” miratuar me urdhrin e brendshëm të Drejtorit të Muzeut, me nr.608/1 Prot., datë 14.07.2016;
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Risqe të mospërputhjes së pozicioneve të punës me kualifikimin e kërkuar të cilat mund të çenojnë realizimin e objektivit që lidhet me pozicionin përkatës.

<sup>21</sup> Rregullorja e Brendshme, miratuar me urdhrin e brendshëm të Drejtorit të Muzeut, me nr.608/1 Prot., datë 14.07.2016, neni 21 “Procedurat e rekrutimit të punonjësve të rinj” miratuar me urdhrin e brendshëm të Drejtorit të Muzeut, me nr.608/1 Prot., datë 14.07.2016



<b>Shkaku:</b>	Mungesa e rregullore së përshkrimit të detyrave; rekrutime jo në përputhje me rregulloren e brendshme
<b>Rëndësia:</b>	I mesëm
<b>Rekomandime:</b>	Titullari i Institucionit të marrë masa: - të hartojë rregulloren për përshkrimet e punës; si dhe - të lidh në mënyrë racionale fazat e rekrutimit të parashikuara në rregulloren e brendshme të MHK-së me përshkrimet e punës dhe kualifikimet që përkon cdo pozicion për të cilin do të zhvillohen procedura rekrutimi
<b>Afati i zbatimit:</b>	<b>Brenda datës 31.12.2019</b>

### 3. ZBATIMI I DISPOZITAVE LIGJORE PËR ADMINISTRIMIN, RUAJTJEN, DOKUMENTIMIN DHE QARKULLIMIN E VLERAVE MATERIALE DHE MONETARE

#### a. Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve të kryera nëpërmjet bankës dhe arkës

*Qasja dhe metodologjia e auditimit e trajtuar më hollësisht në Aneksin 4 të këtij projekt-raporti përmban informacion mbi çështjet e përzgjedhura dhe mbulimin me auditim të shpenzimeve operative.*

Për periudhën e kohës objekt auditimi, njësia shpenzuese ka kryer rregullisht regjistrimin dhe dokumentimin e veprimeve kontabile në ditarin e bankës, dhe ka transferuar shumat e ditarëve në pasqyrat e bilancit të vitit 2017. Dokumentacioni i bankës është mbajtur dhe kontabilizuar konformë rregullave të kontabilitetit si dhe udhëzimit për menaxhimin financiar dhe kontrollin. Dokumentacioni përgjithësisht është kontabilizuar **në mënyrë kronologjike** dhe sistematike në ditarin e bankës (përveç faturave të cilësuara në Aneksin 1, të këtij projektraporti), të cilat për ng avlera nuk janë materiale. Urdhër-shpenzimet janë bazuar në dokumentacionin justifikues dhe në çdo rast kanë nënshkrimin e personit të autorizuar në Degën e Thesarit.

Nga grupi i auditimit për periudhën buxhetore të vitit 2017 dhe 12 mujorin e 2018 u bë një përzgjedhje të disa transaksioneve me palët e treta.

Realizimi i shpenzimeve për periudhën objekt auditimi ishin:

- Të gjitha Urdhër Shpenzimet e kontabilizuara në ditarin e bankës për muajin vitin 2017 në vlerën totale 58,661,695 lekë (këtu përfshirë edhe shpenzimet e pagave dhe sigurimet shoqërore që do të trajtohen si pikë më vete e këtij projekti)
- Të gjitha Urdhër Shpenzimet e kontabilizuara në ditarin e bankës për muajin 12 mujorin e 2018 në vlerën totale 54,411,706 lekë (nga këto 16, 703,512 lekë për shpenzimet operative – artikulli 602)



Nga këto grupi i auditimit, me përzgjedhje auditoi transaksionet sipas urdhërshpenzimeve paraqitur në Aneksin 1, bashkëngjitur këtij projektraporti për shpenzimet operative si dhe pagat trajtuar më hollësisht në pikën respektive të këtij projekti auditimi.

Urdhër Shpenzimet e filtruara u audituan në funksion të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik” vecanërisht sa i takon regjistrimit të veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit bazuar në dokumente origjinale që përdoren për këtë qëllim si; *Dokumentet autorizues, Dokumente vërtetues, Dokumente të kontabilitetit, etj.*

*Nga auditimi rezultoi:*

- Veprimet ekonomike që kryhen nga njësia si dhe faktet që kanë sjellë ose mund të sillnin ndryshime në pasurinë që ato kanë në administrime ruajtje, përgjithësisht janë pasqyruar kurdoherë në dokumentet përkatëse dhe menjëherë pasi kryhet veprimi (*përvec rastit të konstatuar për mosregjistrimin e 5 faturave të hyrje-daljeve dhe mos kontabilizimin e sistemit elektronik të biletarisë në asetet e MHK-së*)

- Regjistrimi i veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit është bazuar në dokumente origjinale që përdoren për këtë qëllim *Dokumentet autorizues, Dokumente vërtetues, Dokumente të kontabilitetit, etj, (përvec procesit të arkëtimit të të ardhurave nga shitja e biletave ku regjistrimi I veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit nuk është bërë plotësisht bazuar mbi dokumenta që përdoren për këtë qëllim – dokumenta vërtetues).*

- Marrja në dorëzim e shërbimeve sipas kontratave të lidhura për mallra/shërbime përgjithësisht janë të konfirmuara dhe dokumentuara rregullisht nga një komision i ngritur nga Titullari I MHK-së, sikundër e kërkojnë përcaktimet e dispozitave dhe kuadrit nënligjor mbi menaxhimin financiar, kontrollin e brendshëm dhe kontabilitetin public (*përvec disa rasteve të trajtuara te nencështja e prokurimeve*).

Nga krahasimi i shpenzimeve korente të MHK-së për dy periudhat e njëpasnjëshme (viti 2017 dhe 2018), konstatuam ndryshime të vogla nga njëri vit në tjetrin, në rënie me 694 mijë lekë më pak në vitin 2018, krahasuar me një vit më parë. Shpërndarja e shpenzimeve sipas muajve për të ëdy periudhat paraqitet si më poshtë:

Muaji	Shpenzime 2017	Pesha	Shpenzime 2018	Pesha
Janar	3,837,635	7%	3,943,469	7%
Shkurt	4,395,672	7%	4,426,197	8%
Mars	3,775,823	6%	5,167,622	9%
Prill	5,281,979	9%	4,576,188	8%
Maj	3,973,936	7%	4,156,301	7%
Qeshor	4,198,175	7%	4,431,996	8%
Korrik	5,275,277	9%	5,001,808	9%
Gusht	4,354,771	7%	4,100,711	7%
Shtator	6,048,965	10%	4,557,915	8%
Tetor	5,566,493	9%	5,940,657	10%
Nentor	5,759,164	10%	5,729,823	10%
Dhjetor	6,235,245	11%	5,976,644	10%
<b>Total</b>	<b>58,703,135</b>	<b>100%</b>	<b>58,009,331</b>	<b>99%</b>

Pavarësisht sa më sipër, kosntatohet se struktura e shpërndarjes së shpenzimeve gjatë muajve pothuajse nuk ka ndryshuar. Rreth 30% të total shpenzimeve vjetore ka vijuar të shpërndahet në 3 muajt e fundit të vitit.

Vihet re se shpenzimet operative gjatë vitit 2018 paraqiten në shumen totale prej 16,673 mijë lekë nga të cilat 2,600 mijë lekë janë mbuluar nga të ardhurat dytësore. Këto shpenzime janë rritur me rreth 16.673 mijë lekë më shumë se një vit më parë (ose më shumë 7.9%):



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në "Muzeun Historik Kombëtar"

Programi 08220	fakt 2017 (1)	fakt 2018 (2)	Diferenca (2)-(1)	Diferenca %
602	13,447,990	14,072,721	624,731	4.6%
602/5	2,000,000	2,600,000	600,000	30.0%
<b>tot.ap.trash</b>	<b>15,447,990</b>	<b>16,672,721</b>	<b>1,224,731</b>	<b>7.9%</b>

*Nga auditimi i shpenzimeve për vitin 2018 rezultoi se struktura e shpenzimeve të MHK është si vijon:*

- 44% për pagesat e rojeve;
- 13% energji elektrike;
- rreth 4% shkojnë për Shpenzime materiale dhe shërbime specifike Expozita;
- 4% Libra dhe publikime profesionale flet-palosje promocion;
- 4% Blerje materiale elektrike;
- 4% Blerje bileta elektronike;
- nga 3% për Blerja materiale pastrimi, blerja materiale kanceleri, dhe blerje uniforma, etj, të cilat në mënyrë më të detajuar jepen si më poshtë:

#### Viti 2018

Emertimi	Nen llog	shuma	Pesha
dieta me jashte	6024200	206,449	1%
energji elektrike	6022001	1,842,490	13%
uji	6022002	236,340	2%
Telefoni	6022003	81,344	1%
rojet	6022008	6,237,455	44%
karburant	6023100	179,999	1%
Shpenzime per mirembajtjen e objekteve specifike Dizinfektimi	6025200	216,000	2%
Shpenzime materiale dhe shërbime specifike Expozita <sup>22</sup>	6021099	526,320	4%
Blerje materiale ndertimi	6021099	108,000	1%
Blerje materiale ndertimi rrampa	6021099	343,200	2%
Transport materiale ekspozita	6022099	235,200	2%
Blerja materiale trajnimi	6021099	96,000	1%
Shpenzime mirembajtje lysterje	6021099	81,000	1%
Libra dhe publikime profesionale flet-palosje promocion	6021007	582,000	4%
blerja materiale kanceleri	6020100	441,035	3%
Blerja materiale pastrimi	6020200	424,188	3%
Blerje materiale elektrike	6020200	593,999	4%
Blerje materiale Laboratori	6021009	94,560	1%
Blerje bileta elektronike	6021099	586,320	4%
blerje uniforma		380,600	3%
Fikse zjarri		278,400	2%
<b>Totali</b>		<b>13,770,899</b>	

#### **Konstatim:**

*Nga verifikimi i urdhërshpenzimeve për të dy periudhat objekt auditimi në përfundim rezultoi se:*

*- në më të shumtën e rasteve **kërkesa për blerje materiale** është iniciuar nga Sektori i Shërbimit të Vizitorëve, sa më sipër jo plotësisht në përputhje me paragrafin 18 të Udhëzimit nr.*

<sup>22</sup> U verifikuan 3 urdher shpenzimet nr. 156, date 19.10.2018 (276,000 leke), USH nr. 79, date 24.05.2018 (75,720 lekë); USH nr11, datë 16.01.2018 (105,000 lekë).



30, datë 27.12.2011, ku përcaktohet se cdo njësi e sektorit publik duhet të plotësojë planin e vetë me një njohje të mirë të bazës së aktiveve që nevojiten, për të përmbushur objektivat e saj (rastet e kosntatuara në shpenzimet për dezinfektim, materiale kancelarie, rimbushje dhe kolaudim, etj) - kemi konstatuar raste të **mungesës së listës (plani) së shpërndarjes ku shpërndarja e artikujve është bërë pa liste**, në kundërshtim kjo me kërkesat e Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, ku kërkohet që dalja e aktiveve nga magazina bëhet ndër të tjera edhe mbi bazën e fletëkërkesës dhe planit të shpërndarjes (rastet e kosntatuara në kryerjen e shpenzimeve për blerjen e kostumeve, si dhe trainimi Re-Org);

- kemi konstatuar raste të dërgimit të aktiveve drejtpërdrejt nga furnizuesi dhe **bërje hyrje-dalje pa kaluar në magazinë**, por NA i njësisë publike për këto lloj lëvizjesh nuk ka miratuar procedura standarde të lëvizjes, të shoqëruara me përgjegjësitë respektive sipas parashikimit në paragrafin 41 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, (rastet e cilësuar në Aneksin 2 janë bërë hyrje dalje pa kaluar në magazinë; rastet e ikonave gjithashtu);

- kemi konstatuar urdhërshpenzime, të cilat **nuk kanë ndjekur renditjen kronologjike** të efekteve të veprimeve ekonomike të kryera, të marra nga dokumentet bazë ose dokumentet plotësuese, në kundërshtim me ligjin nr.9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare<sup>23</sup>”, i ndryshuar (urdhërshpenzime të cilësuar në Aneksin e këtij projekti)

- kemi konstatuar raste të **mungesës së procesverbaleve të marrjes në dorëzim të shërbimit të rojeve**, mbi bazë të të cilit duhet të bëhet edhe likuidimi i fondeve **ose kur këto procesverbale nuk janë firmosur nga MHK** në mënyrë që të konfirmojnë marrjen e shërbimit (urdhërshpenzimet për pagesat e shërbimit të rojeve).

1. Nga analiza e nenllogarisë 6020100 “Blerje material kanceleri”, në shumën 441,035 lekë (ose rreth 3% të total llogarisë 602) rezultoi se, furnizimet për bojrat e printerave janë bërë **pa u mbështetur** në analizë të detajuar të nevojës reale të institucionit. Konkretisht nga analiza e normë së **Qarkullit të Inventarit rezultoi se me gjëndjet faktike në magazinë, ky artikull kërkon rreth 189 ditë për të qarkulluar<sup>24</sup> ose rreth 2 herë në vit, gje e cila nuk justifikon**

<sup>23</sup> Mbajtja e kontabilitetit është regjistrimi kronologjik në ditar dhe në llogari I të gjithë veprimeve dhefakteve që I përkasin njësisë ekonomike

<sup>24</sup> Norma e Qarkullimit të Inventarit =  $(\text{Inventar fillim} + \text{Inventar ne fund})/2 / \text{KMSH} * 365 \text{ ditë}$ . Duke qenë se luhajtjet në kosto nuk janë materiale, përlllogaritjet janë bërë vetëm me sasi.

Gjendja më datë	3
01.03.2018	copë
Hyrë deri më 23.07.2018	37
Dalë deri më 23.07.2018	(17)
Gjendja më datë	23
23.07.2018	copë
Hyrë deri më 25.11.2018	12
Dalë deri më 25.11.2018	(10)
Gjendja më datë	25
25.11.2018	cope
Inventari mesatar	14
COGS (daljet ne rastin konkret)	27
Norma e Inventarit (dite)	189 dite




## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në "Muzeun Historik Kombëtar

**furnizimet më të shpeshta se kjo normë.** Sa më sipër të mbahet parasysh që në momentin e planifikimit të buxhetit me qëllim evdientimin e qartë të nevojave që në momentet e planifikimit. Gjithashtu përpara hartimit të kërkesës për materiale, të justifikohet nevoja duke vlerësuar fillimisht gjendjen e inventarit në magazinë për materialin në fjale, dhe dokumentimin e nevojës sipas sektorëve. Nga të dhënat e marra nga librat e bankës rezultoi sa më poshtë:

	USH nr. 44, date 20.03.2018			USH nr. 107 date 24.07.2018			USH nr. 212, date 26.12.2018		
	SASIA	CMIMI PA TVSH	VLERA	SASIA	CMIMI PA TVSH	VLERA	SASIA	CMIMI PA TVSH	VLERA
Samsung ML 2160	6	1,583	9,498	2	2,142	4,284	6	1,500	9,000
samsung ML 1640	6	1,583	9,498	2	1,667	3,334	2	1,500	3,000
Dell printer 1710 N	2	2,667	5,334	1	1,833	1,833	2	3,000	6,000
Toner conica 162									
Laser jet HP 1200 SERIE	2	1,500	3,000	1	1,542	1,542	2	833	1,666
Kyocera, ECOSYS fs 1370 DN	-	-	-	1	1,521	1,521	2	3,000	6,000
samsung CLX 3300	1	8,308	8,308	1	12,500	12,500	2	2,083	4,166
HP deskjet F2420	2	3,333	6,666	1	4,555	4,555	2	3,333	6,666
HP 1015	2	1,500	3,000	1	1,458	1,458	1	792	792
HP DesignJet T520	2	5,833	11,666	1	5,083	5,083	4	3,333	13,332
<b>Total boje printeri</b>	<b>23</b>		<b>56,970</b>	<b>11</b>		<b>36,110</b>	<b>23</b>		<b>50,622</b>

Janë blerë bojra për 9 printera të ndryshëm sipas USH nr. 44, datë 20.03.2018, USH nr. 107, datë 24.07.2018, dhe USH nr. 212, datë 26.12.2018 për shumat respektive 56,970 lekë, 36,110 lekë dhe 50,622 lekë dhe në sasi të 23 copë në mars, 11 copë në korrik dhe 23 copë në dhjetor. Edhe pse jo materiale për nga vlera, rezultoi se, cmimet e bojës kanë ardhur në rritje nga njëra porosi në tjetrën si vijon:



**2. Nga auditimi i urdhër shpenzimeve në lidhje me pagesat e vendimeve gjyqësore në favor të përfituesve nga MHK u konstatua se gjatë vitit 2017, janë kryer shpenzime për 3 ish punonjës të**



larguar nga puna, në bazë të vendimeve të gjykatës sipas tabelës së mëposhtme, në shumën totale prej 2,199 mijë lekë (për vitin 2018 nuk është kryer asnjë shpenzim dhe nuk ka lindur asnjë detyrim i këtij lloji ):

Në lekë

Rendi	Punonjesis e larguar	Detyrimi I krijuar me Vedmin nr	Shuma fillestare e detyrimit	Shuma e detyrimit me 31.12.2016	Likuiduar gjate vitit 2017	Likuiduar gjate vitit 2018
a	F. Gega	Nr.1652,dt.15.06.2016	654,535	654,535	654,535	0
b	V.Rupi	Nr.3214,dt.12.10.2016	378,627	378,627	378,627	0
c	S.Kadria	Nr.278(86-2017-253)dt.01.02.2017	1,166,469	0	1,166,469	0
	<b>Total</b>		<b>2,199,631</b>		<b>2,199,631</b>	<b>0</b>

a. Me vendimin nr.2764 datë 29.05.2014 , Gjykata Administrative e shkallës së parë ka vendosur pranimin pjesërisht të padisë së paditëses **Fatbardha Gega** duke vendosur:

1-detyrimin e palës së paditur MHK ti paguajë paditëses Fatbardha Gega 3 muaj pagë X 37.402 lekë dëmshpërblim për mosrespektim të afatit të njoftimit për zgjidhjen e kontratës së punës.

2-detyrimin e palës së paditur MHK ti paguajë paditëses Fatbardha Gega 2 muaj pagë X 37.402 lekë dëmshpërblim për mosrespektim të afatit procedurës për zgjidhjen e kontratës së punës.

detyrimin e palës së paditur MHK ti paguajë paditëses Fatbardha Gega 2.5 muaj pagë X 37.402 lekë dëmshpërblim për shpërblim për vjetërsi në punë. Rrëzimin për pjesën tjetër të padisë.

Me vendimin nr. 1652 datë **15.06.2016** , Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur pranimin pjesërisht të padisë së paditëses Fatbardha Gega duke vendosur lënien në fuqi të vendimit nr.2764 datë 29.05.2014 , të Gjykatës Administrative të shkallës së parë.

Nga ana e MHK pranë Gjykatës së Lartë është bërë rekurs lidhur me vendimin e gjykatës.

Duke qenë se vendimi ka marrë formë të prerë nga ana e ish-punonjësës Fatbardha Gega, kanë filluar procedurat ligjore për ekzekutimin e vendimit gjyqësor duke ju drejtuar shoqërisë përmbarimore "Prestige Bailiff Services"sh.p.k

Nga korrespondenca e dokumentacionit shkresor për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë u konstatua se:

Me shkresën nr.2050-695 prot, datë **22.07.2016** shoqëria përmbarimore "Prestige Bailiff Services" sh.p.k ka dërguar debitorit MHK shkresën " Lajmërim për ekzekutim vullnetar" për përmbushjen dhe ekzekutimin vullnetarisht të detyrimit që përmban Titulli ekzekutiv i vendimit gjyqësor të formës së prerë për paditësen Fatbardha Gega në vlerën 654,535 lekë Tarifa përmbarimore e përllogaritur nga Shoqëria përmbarimore lidhur me vëninën në ekzekutim të vendimit është llogaritur në masën 24,000 lekë me tvsh. Tarifa për kryerjen e ekzekutimit të detyruar në masën 43,985 lekë me tvsh, dhe pagimin e shpenzimeve përmbarimore në vlerën 5000 lekë.

Në total detyrimi i debitorit institucionit MHK , ndaj kreditorit Fatbardha Gega bashkë me tarifën përmbarimore është përllogaritur në masën 727,520 lekë .

Me shkresën nr.2072-695 prot, datë **27.07.2018** shoqëria përmbarimore "Prestige Bailiff Services" sh.p.k ka dërguar debitorit MHK shkresën " Lajmërim për ekzekutim të detyrueshëm "për shkak të mospërmbushjes dhe ekzekutimin vullnetarisht të detyrimit që përmban titulli ekzekutiv i vendimit gjykatës.



Me shkresën nr.622/2 prot, datë 27.07.2016, debitori MHK ka kthyer përgjigje shkresave të shoqërisë përmbarimore “Prestige Bailiff Services” sh.p.k dhe ka në dijeni Degën e Thesarit Tiranë se MHK ka paraqitur rekurs pranë Gjykatës së Lartë dhe kërkesë për pezullim ekzekutim vendimi të formës së prerë.

Me shkresën nr.622/3 prot, datë 28.07.2016, debitori MHK në vijim të korrespondencës me shoqërinë përmbarimore “Prestige Bailiff Services” sh.p.k ka kthyer përgjigje shkresave të shoqërisë dhe ka në dijeni Degën e Thesarit Tiranë se MHK nuk disponon fonde të mjaftueshme për likuidimin e kreditorës Fatbardha Gega..

Me shkresën nr.2084-695 prot, datë 29.07.2016 në zbatim të titullit ekzekutiv të vendimit gjykatës shoqëria përmbarimore “Prestige Bailiff Services” sh.p.k ka kërkuar ekzekutimin e vendimit gjyqësor.

Me shkresën n.4473/1 prot, datë 01.08.2016 drejtuar shoqërinë përmbarimore “Prestige Bailiff Services” sh.p.k Dega e Thesarit Tiranë , në vijim të procedurës së ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë ka vënë në dijeni dhe debitorin MHK se detyrime për palën kreditore fatbardha gega do të planifikohet për tu shlyer me fondet buxhetore të vitit 2017, nga institucioni debitor .

Me shkresën nr.2517-695 prot, datë 26.09.2016 shoqëria përmbarimore “Prestige Bailiff Services” sh.p.k ka paraqitur kërkesë për ekzekutim të vendimit gjyqësor pranë palës debitore MHK duke paralajmëruar se do të procedohet nga ana e tyre me gjobë për pengim ekzekutimi vendimi gjyqësor të formës së prerë.në masën 500.000 lekë dhe në rastet e kushteve për kallzim penal do procedohet sipas nenit 320 të Kodit Penal

Me shkresën nr.80 -695 prot, datë 14.01.2017 shoqëria përmbarimore “Prestige Bailiff Services” sh.p.k ka paraqitur kërkesë për ekzekutim të vendimit gjyqësor pranë palës debitore MHK duke paralajmëruar se për pengim ekzekutimi vendimi gjyqësor të formës së prerë.do të procedohet nga ana e tyre me gjobë në masën 500.000 lekë dhe në rastet e kushteve për kallzim penal do procedohet sipas nenit 320 të Kodit Penal

Me shkresën nr.15/1 prot, datë 17.01.2017 ,MHK në vijim të shkresës nr.80 -695 prot, datë 14.01.2017 ka njoftuar shoqërinë se detyrimin ndaj kreditorit fatbardha gega e ka përfshirë në projekt buxhetin e dërguar pranë Ministrisë së kulturës dhe nuk ka ardhur plani miratuar për këtë vit. Gjithashtu ky detyrim është paraqitur si detyrim i pashlyer pranë Ministrisë së Kulturës Nga shoqëria përmbarimore “Prestige Bailiff Services” sh.p.k janë drejtuar dy shkresa ndaj MHK me lëndë për tërheqje vëmëndje shkresat nr.531-695 prot, datë 23.02.2017 dhe shkresa nr.545-695 prot, datë 09.03.2017 .

Me shkresën nr.545-695 prot, datë 09.03.2017, shoqëria përmbarimore “Prestige Bailiff Services” sh.p.k i është drejtuar MHK me lëndë tërheqje vëmëndje për paralajmërim të përsëritur me gjobë, pasi megjithëse shoqëria ka respektuar procedurat ligjore për ekzekutimin e vendimit të gjykatës së formës së prerë akoma dhe pasi ka kaluar 1 vit ky vendim është ekzekutuar .

Paditesi	Likujdime totale te parashikuara	Taksa permbarimore e parashikuar	Likujdime totale te ekzekutuara	Taksa permbarimore e ekzekutuar
----------	----------------------------------	----------------------------------	---------------------------------	---------------------------------



Fatbardha Gega	654,535 lekë	5,000 lekë.	654,535 lekë	5,000 lekë.
----------------	--------------	-------------	--------------	-------------

b. Me vendimin nr.5302 datë **01.10.2014** Gjykata Administrative e Shkallës së parë Tiranë ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesë padisë së paditëses **Violanda Rupi** kundër të paditurit MHK, duke detyruar të paditurin MHK për të dëmshpërblyer paditësen Violanda rupi me 9 paga mujore nga të cilat 3 paga mujore për zgjidhje pa shkak të justifikuar, 2 paga mujore për mosrespektim të afatit të njoftimit , 2 paga mujore për mosrespektim procedure, 2 paga mujore për shpërbllim për vjetërsi në punë. Rrëzimin e padisë për pjesën tjetër.

Me vendimin nr. 2764, datë **29.05.2014** të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë është vendosur pranimi i padisë së paditëses Fatbardha Gega kundër palës së paditur Muzeu Historik Kombëtar me objekt dëmshpërbllim page.

Me vendimin nr.3214 datë **12.10.2016** Gjykata Administrative e Apelit Tiranë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr.5302 datë **01.10.2014** . Nga ana e MHK është bërë rekurs në Gjykatën e lartë i regjistruar datë **21.02.2017**.

Me shkresën nr.133 prot, datë **15.02.2017** nga përmbauesi gjyqësor Altin Vako është dërguar kërkesë drejtuar degës së Thesarit Tiranë për vendosjen e masës së sekuestros konservative për njësinë shpenzuese MHK.

Vendimi nr.5302 datë **01.10.2014** i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë lënë në fuqi me vendimin nr.3214, datë **12.10.2016** të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë,duke qenë se debitori megjithëse ka marrë njoftim për lajmërim vullnetar nuk i është përgjigjur respektimit të afatit dhe kërkesave të lajmërimit

Pas fillimit të procesit të ekzekutimit të detyrueshëm përmbauesi i ka dërguar debitorit MHK lajmërim nr.143 datë **26.01.2017**, për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimin që përmban. Me shkresën nr. 48/1 prot, datë 03.02.2017 në përgjigje të shkresës 140 prot, datë **26.01.2017** MHK ka njoftuar përmbauesin gjyqësor privat Z. Altin vako lidhur me detyrimin që ka institucioni ndaj punonjëses Violeta rupi e ka përfshirë në projekt-buxhetin e dërguar pranë ministrisë së Kulturës., duke e paraqitur si detyrim të pashlyer sipas kërkesës MHK. Me shkresën nr.414 prot, datë **04.04.2017** dhoma kombëtare e përmbauesve gjyqësor privat i ka kthyer përgjigje MHK-së që vendimi gjyqësor është i ekzekutueshëm brenda 6 muajve nga dita që ai merr formë të prerë, duke bërë me dije se institucioni është i detyruar që brenda 6 muajve të kryejë pagesën e plotë të detyrimin kundrejt palës kreditore Violanda Rupi, dhe tarifës përmbaimore në shumën totale prej 378,627 lekë , me një këst të vetëm .

Paditesi	Likujdime totale te parashikuara	Taksa përmbaimore e parashikuar	Likujdime totale te ekzekutuara	Taksa përmbaimore e ekzekutuar
Violanda Rupi	339,627 leke	-	339,627 leke	-

c. Me vendimin nr.5695,datë 10.11.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së parë Tiranë është vendosur pranimi i pjesëshëm i padisë së paraqitur nga paditësi z. **Sali Kadria**, i paditur Muzeu Historik Kombëtar, me objekt; detyrimi i palës së paditur që të dëmshpërblejë paditësin me 12 rroga mujore, për zgjidhjen e kontratës së punës në mënyrë të mënjëhershme dhe të



pajustificuar, dëmshpërblimi i paditësit me 2 paga mujore për mosrespektimin e procedurës për zgjidhjen e kontratës së punës të parashikuara nga neni 144/5 të K.Punës, dëmshpërblimi i paditësit me 3 paga mujore për mosrespektimin e afatit të njoftimit sipas nenit 143 të K.Punës si dhe dëmshpërblimi i tij me 4.5 rroga mujore si shpërblim për vjetërsi në punë, bazuar në ligjin 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e marrëveshjeve", neni 143,144,145,149,153,155 të K.Punës.

Paditësi ka paraqitur ankim brenda afatit ligjor në datën 25.11.2015, ndërsa MHK ka paraqitur ankim jashtë afatit ligjor, në datën 26.11.2015.

Gjykata ka vendosur detyrimin e palës së paditur MHK të dëmshpërblejë paditësin me 2 paga mujore për mosrespektimin e procedurës për zgjidhjen e kontratës së punës të parashikuara nga neni 144/5 të K.Punës. Rrëzimin për pjesën tjetër,

Me vendimin nr.253 datë 01.02.2017 të Gjykatës Administrative të Apelit, është vendosur :

1. ndryshimi i vendimit nr.5695, datë 10.11.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së parë Tiranë ,

2. pranimin pjesërisht të padisë

3. detyrimin e palës së paditur të dëmshpërblejë paditësin Sali Kadria me pagën e 2 (dy) muajve për mosrespektimin e procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës sipas K.Punës

4. detyrimin e palës së paditur të dëmshpërblejë paditësin Sali Kadria me pagën e 8 (tetë) muajve për shkak të zgjidhjes së kontratës së punës pa shkaqe të justifikuara

5. detyrimin e palës së paditur të dëmshpërblejë paditësin Sali Kadria me pagën e 3 (tre) muajve për mosrespektimin e afatit të njoftimit për zgjidhjen e kontratës.

6. detyrimin e palës së paditur të dëmshpërblejë paditësin Sali Kadria me pagën e 4 katër muajve për vjetërsi në punë.

Referuar shkresës së Përmbauesit nr 165 Prot., datë **06.04.2017** drejtuar MHK, konstatohet që shpenzimet gjyqësore të parapaguara nga paditësi në shumën 25,500 ( njëzetë e pesë mijë e pesëqind ) lekë i ngarkohen palës së paditur.

Me shkresën nr.151 Prot.,datë **18.04.2017** janë dërguar aktet përmbaimore dhe dokumentet nga Përmbauesi gjyqësor privat Dorjan Egerçi, Me shkresën nr.182 datë 18.04.2017 Përmbauesi gjyqësor privat Dorjan Egerçi ka dërguar vendimin për fillimin e ekzekutimit të detyrueshëm të vendimit gjyqësor nga debitori MHK.Me shkresën nr.324 prot, datë 24.04.2017 drejtori I MHK sqaron përmbauesin se në buxhetin e vitit të aprovuar nuk janë miratuar fonde për këtë qëllim.

Me shkresën nr.326 prot, datë **24.04.2017** në zbatim të lajmërimit për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë drejtori i muzeut njofton degën e thesarit se në buxhetin e aprovuar nuk janë miratuar fonde për këtë qëllim. Me urdhër nr.209/1 prot, datë **03.05.2017** është urdhëruar nga Përmbauesi gjyqësor privat Dorjan Egerçi, "Për vënien e sekuestros" në llogarinë e palës debitore MHK zëri 602 në shumën e detyrimit 1199123 lekë. Me shkresën nr.35085/1 prot, datë **05.05.2017** dega e thesarit Tiranë ka njoftuar MHK dhe ka vënë në dijeni përmbauesin se duhet të procedohet dhe të informohet në lidhje me këtë praktikë brenda afatave ligjore, Me shkresat nr.410 prot datë **16.05.2017** drejtori i MHK i është drejtuar Znj. Mimoza Kavaja (përgjegjëse e sektorit të financës dhe shërbimeve mbështetëse të kryhet pagesa mujore në favor të kreditorit në vlerën 64,460 lekë në zbatim të shkresës së ardhur nga Përmbauesi gjyqësor privat Dorjan Egerçi . Me shkresat nr.410/1 prot datë **08.06.2017** ka bërë ndryshim të urdhrit të brendshëm nr.410 prot datë **16.05.2017**, duke ndryshuar shumën që do



likujdohet çdo muaj në vlerën 65,195 lekë dhe jo në shumën 64,460 lekë, duke kryer dhe likujdimet e diferencave të dy muajve të kryera prej 735 lekë në muaj.

Paditesi	Likujdime totale te parashikuara	Taksa permbarrimore e parashikuara	Likujdime totale te ekzekutuara	Taksa permbarrimore e ekzekutuar
Sali Kadriu	1,166,469 leke	32,654 leke	1,199,123 leke	<b>65,308 leke</b>

3. Nga auditimi I urdhër-shpenzimit nr. 141, datë 03.10.2018 “Shërbim dezinfektimi dhe deratizim ambient, faza e dytë”, në shumën 108,000 lekë u konstatua se, bashkëngjitur praktikës **nuk** ndodhet kërkesa për dezinfektim nga Sektori i Konservimit të Koleksioneve, i cili në bazë të Rregullores së Brendshme për Organizimin dhe Funksonimin e MHK-së, neni 14/j propozon dhe ndjek dezinfektimim e përvitshëm të gjithë pavijoneve dhe fondeve të MHK-së, pasi kjo kërkesë është iniciuar përgjegjësi I Sektorit të Menaxhimit të Shërbimeve për Vizitorët. Konkretisht, bashkëngjitur praktikës së shpenzimit nr. 60, datë 12.04.2018 “Shërbim dezinfektimi dhe deratizim ambient, faza e parë”, në shumën 108,000 lekë ndodhet **kërkesa për dezinfektim e cila është bërë dhe firmosur nga përgjegjësi I Sektorit të Menaxhimit të Shërbimeve për Vizitorët**, dhe një specialiste e Sektorit të Konservimit të Koleksioneve, ndërkohë që në bazë të Rregullores së Brendshme për Organizimin dhe Funksonimin e MHK-së, neni 14/j parashikon se është Sektori i Konservimit të Koleksioneve, që propozon dhe ndjek **dezinfektimim e përvitshëm** të gjithë pavijoneve dhe fondeve të MHK-së; Sektori I Menaxhimit të Shërbimeve për Vizitorët ka të tjera përgjegjësi të cilat nuk përfshijnë dhe lidhen me konservimin e koleksioneve.

*Në bazë të programit të shërbimit kompanisë “Alpen Pulito” e cila përveç se duhet të ofrojë shërbimin e Dezinfektim, Dezinfektim dhe Deratizim për MHK, në përfundim të kryerjes së shërbimeve të pajisë subjektin me certifikatën e kryerjes së shërbimeve, në mbështetje të ligjit nr.10138, datë 11.05.2009 “Për shëndetin public”, I ndryshuar, ligjin nr. 10107, datë 30.03.2009 “Për kujdesin shëndetsor në RSF”, i ndryshuar, me ligjin nr. 7761, datë 19.10.1993 “Për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse\_Nga auditimi u konstatua se certifikata pohon kryerjen e shërbimeve ndërhyrëse higjieno-sanitare-shëndetësore duke konfirmuar vetëm në vija të përgjithshme sa më poshtë<sup>25</sup>:*

- ✓ *Dezinfektuar/sipërfaqe e brendshme/sipërfaqe e jashtme,*
- ✓ *Dezinsektuar/ sipërfaqe e brendshme/sipërfaqe e jashtme, dhe*
- ✓ *Deratizuar/ sipërfaqe e brendshme/sipërfaqe e jashtme.*

*Nga auditimi u konstatua se, edhe pse kontrata parashikon se, procesi do të kryhet në dy faza, në asnjë rast nuk parashikohen se çfare do të përfshijë secila prej fazave. Në kushtet kur dezinfektimi, dezinfektimi dhe deratizimi i shërbejnë më së shumti kujdesit të vazhdueshëm të koleksioneve vecanërisht ruajtjen, mirëmbajtjen dhe jetëgjatësinë e artefakteve, moskryerja e të cilit sjell deri dëmtim të pakthyesëm të objekteve deri në humbje të vlerave të tyre<sup>26</sup>, gjykojmë tejet të rëndësishme detajimin e procesit dhe evidentimin e saktë dhe të plotë të cdo ambjenti/objekti që i është nënshtruar këtij procesi.*

<sup>25</sup> Pa detajuar ambjentet përkatëse individualisht

<sup>26</sup> Sipas regjistrimit të riskut të MHK-së: Objektivi 3



Procesi

*Kërkesa për DDD  
inicohet nga Sektori I  
Konservimit*

*Prokurimi/lidhja e  
kontratës*

*Certifikata e kryerjes së  
shërbimit/ Procesverbalit I  
sektorit përgjegjës*

Realizimi

*Kërkesa për DDD është  
iniciuar edhe nga Sektori  
Menaxhimit të  
Shërbimeve për  
Vizitorët*

*Kontrata parashikon kryerjen  
e shërbimit në dy faza por  
nuk parashikon çfarë do të  
përfshijë secila fazë.*

*Certifika e pa specifikuar  
Procesverbal nr. Prot. Extra,  
datë 31.03.2018, përfshirë  
gjithashtu sektori I  
vizitorëve (firmosur  
specialiste nga sekt. I  
konservimit dhe përfaqësues)*

Në kushtet kur që në momentin që iniciohet kërkesë, nuk është specifikuar se çfarë do të përfshijë dezinfektimi, për secilën fazë dhe cilat janë pavijonet/fondet/etj që do t'i nënshtrohen dezinfektimit (kontrata specifikon vetëm sipërfaqen totale prej 18,000 m<sup>2</sup>), rezultoi se në të dyja fazat janë përfshirë të njëjtat njësi idem (referuar respektivisht procesverbalit me nr. Ekstra, datë 31.03.2018, dhe atij me nr. 792, datë 24.09.2018). Nga faza e parë në të dytë ka vetëm një ndryshim në kimikatet e përdorura, ndërkohë që arsyet e përdorimit janë identike në të dy fazat, konkretisht: “Këto kimikate u përdorën për luftimin e insekteve furtareve, mizave, mushkonjave, si dhe për luftimin e brejtësve në bodrume dhe puseta”, sa më sipër diktuar idem në Manualin e Kujdesit ndaj Objekteve<sup>27</sup>.

4. Nga auditimi u konstatua se me urdhër-shpenzimin nr. 188, datë 26.11.2018, janë likuiduar fonde në shumën 343,200 lekë për blerje materiale dhe shërbime speciale (rampat) kontabilizuar në llogarinë ekonomike 6021099. Nga auditimi I praktikës bashkëngjitur urdhërshpenzimit rezultoi se, objekti I procedurës së prokurimit është “**Rampat e shkallëve për personat me aftësi të kufizuara**”, ndërkohë që specifikimet teknike të mallit janë material ndërtimi si: tubular celiku profil 60\*30 mm, strukturë e varfër panele druri, vida vetëfiletuese, veshje me linoleum, pragje alumini, këndorë alumini, etj. Në përfundim vumë re se, fatura tatimore e shitjes është prerë për “**Materiale për rampat e shkallëve**”. Materialet janë bërë hyrje-dalje në magazinë me fletë-hyrjen nr 28, datë 14.11.2018 dhe fletë-daljen nr. 241, datë 14.11.2018. Në këto kushte ngel i paqartë fakti se, nëse firma fituese furnizoi MHK-në me material ndërtimi, po ndërtimin e rampave (I cili është edhe objekti I prokurimit dhe I kontratës), kush e bëri? Referuar Udhëzimit nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, konstatuam se, nuk lejohet, transferimi i fondeve nga shpenzimet korrente në kapitale dhe anasjelltas, pasi këta tregues janë miratuar në ligjin e buxhetit me tabela të veçanta dhe totali i

<sup>27</sup> paragrafi që lidhet me dezinfektimin.



tyre është pjesë e ligjit (neni 8 dhe 11). Cdo rialokim I këtij lloji kërkon miratim të Ministrisë së Financave.

Nga auditimi rezultoi se në fakt, firma e ndërtimit ka ofruar gjithë shërbimin e plotë, pra deri në ndërtimin e rampave, dhe jo materialet e ndërtimit vetëm, Si pasojë shuma prej 343,200 lekë e kontabilizuar si mall konsumi (llogaria 31 ), në fakt duhet të prekte llogarinë 211-218 “Mjete Kryesore” dhe ti shtohet vlerës së ndërtesës.

**5. Me Urdher shpenzimin nr.213, datë 26.12.2018 është prekur llogaria 602 në shumën 380,600 lekë për “Blerje uniforme pune”, mbështetur ne Urdhrin e prokurimit nr. 994, datë 19.11.2018, fletë-hyrjen nr. 30, datë 3.12.2018, dhe faturës së thjeshtë tatimore me nr. 124, datë 03.12.2018.**

Nga verifikimi i ditarëve rezultoi se ky artikull është kontabilizuar si mall konsumi duke prekur llogarinë 311<sup>28</sup> (klasa 3). Në referencë të Udhëzimit nr 30, datë 26.12.2011, kufiri minimal për pragun e vlerësimit të aktiveve afatgjata materiale është 10,000 lekë dhe afat përdorimi mbi një vit; nëpunësi autorizues I njësisë duhet të vendosë një prag të arsyeshëm për vlerësimin e aktiveve afatshkurtra në afatgjata, nëse nuk plotësohet njëri nga dy kushtet e mësipërme. Në kushtet kur një uniformë pune ka kushtuar 17,300 lekë, pra mbi 10,000 lekë, ky artikull duhej të kategorizohej si AQT dhe jo Aktiv Qarkullues.

*Në fakt kontabilizimi është bërë saktë, pasi referuar kërkeses me nr. 991, datë 16.11.2018, “1 kostum pune civile” përmban:*

- Për meshkujt (1 xhakete, 2 palë pantallona)
- Për femra (1 xhakete, 1 fund , 1 palë pantallona).

Por sa më sipër do të thotë se, si **porosia ashtu edhe procesverbali i marrjes në dorëzim duhej të ishin specifike si vijon:**

Artikuj	Meshkuj (cope)	Femra (cope)	Porosia (cope)
funde	-	12	12
pantallona	20	12	32
xhakete	10	12	22

**Nga auditimi rezultoi se kostumet janë tërhequr nga punonjës të MHK sipas fletëdaljeve të magazinës ku përsëri nuk janë specifikuar artikujt vec e vec duke u shënuar thjesht “kostum”. E njëjta gjë vihet re edhe në faturën tatimore nr. 124, datë 03.12.2018 ku shitësi I referohet si “22 kostume”dho jo specifikisht 12 funde, 32 palë pantallona dhe 12 xhaketa për femra dhe 10 për meshkuj.** Në dosje mungon kërkesa specifike me emrat e punonjësve që duhet të pajisen me uniforma (lista), sa më sipër për të krahasuar nëse personat që I kanë tërhequr kostumet janë sipas listes s për shpërndarjen e objekteve në përputhje me kërkesat e Udhëzimit nr. 30, datë 27.11.2011 ”Prë inventarizimin e aktiveve në njësitë e sektorit public”. Nga auditimi rezultoi se, në praktikën e urdhër shpenzimit ndodhet procesverbali “Mbi dorëzimin e mallrave”, më datë 03.12.2018, firmosur nga Komisioni I Blerjeve me vlerë të vogël: Alban Saqellari, Andre Llukani dhe Stefan Tetollari, me prezencën e: Fatmir Boshnjaku, Redis Marku dhe Vladimir Mece (punonjësin me përgjegjësi material).

<sup>28</sup> “Materiale te para, sipas Planit Kontabël



6. Me USH nr. 168, datë 09.01.2011 është kryer pagesa për “Shpërblim pensioni” në shumën 119,278, mbështetur mbi urdhër-shpërblimin e Drejtorit të MHK-së nr. 950, datë 08.11.2018, për kryerjen e pagesave për dalje në pension të 2 punonjësve. Ky urdhër ka dalë në zbatim të shkresës së ardhur nga Ministria e Kulturës me nr. 7114/2, datë 05.11.2018 “Akordim fondi për përdorim fondi të vecantë”, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 109, datë 30.11.2017 “Për buxhetin e vitit 2018” dhe udhëzimit plotësues të Ministrisë së Financave nr. 2, datë 19.01.2018 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018”

7. Me USH nr. 173, datë 12.11.2018 është kryer pagesa për “Blerje materiale ndërtimi” në shumën 108,000 lekë, mbështetur në kërkesën për blerje materiale ndërtimi me nr.879, datë 19.10.2018.

8. Me USH nr. 175, datë 15.11.2018 është kryer pagesa për “Blerje materiale elektrike” në shumën 359,999 lekë. Kërkesa është iniciuar nga Përgjegjësi i Sektorit për Menaxhimin e Vizitorëve, specialist i këtij sektori dhe magazinieri dhe jo nga Sektori i Menaxhimit të Koleksioneve dhe Sektori i Konservimit të Koleksioneve. Konstatuam se nevoja për këto materiale lidhet direkt me pavijonet pasi parametrat e tyre duhet të jenë sipas standardeve që kërkojnë objektet në këto paviojone, përgjegjës për të cilat sipas Rregullores së MHK-së janë Sektori i Menaxhimit të Koleksioneve dhe Sektori i Konservimit të Koleksioneve<sup>29</sup>. Vecanërisht Sektori i Konservimit kujdeset për mirëmbajtjen e objekteve muzeore.

9. Me USH nr. 176, datë 15.11.2018 është kryer pagesa për “Blerje materiale për trajnimin e Re-Org (ri-organizimi i fondeve ne muze) në shumën 54,000 lekë .

Me USH nr. 177, datë 15.11.2018 është kryer pagesa për “Blerje materiale për trajnimin e Re-Org (ri-organizimi i fondeve ne muze) në shumën 54,000 lekë . Kërkesa për materialet e trajnimit është iniciuara nga Përgjegjësi i Sektorit të Menaxhimit të ekspozitave, por pa u identifikuar numri i pjesëmarrësve që do të shërbejë gjithashtu si listë për shpërndarjen e objekteve në përputhje me kërkesat e Udhëzimit nr. 30, datë 27.11.2011. Mallrat janë bërë dalje nga magazina me Dletëdaljen nr.227, datë 31.10.2018 dhe nr. 228, datë 31.10.2018 nga përgjegjësja e sektorit, përsëri pa i sjellë listën emërore të personave që tërhoqën materialet.

*Me observacionet e ardhura nga MHK, për projekt-raportin e dërguar në subjekt nga KLSH, me shkresën me nr. 02/8, datë 25.04.2019, subjekti ka sjellë listën e pjesëmarrësve e cila nuk është e siglur as nga pjesëmarrësit dhe as nga organizatorët. Duke konsideruar sa më sipër ky observacion nuk merret parasysh dhe KLSH vijon t’i qëndrojë konstatimit dhe rekomandimit që në të gjitha rastet në vijm kjo listë e plotësuar sipas kërkesave që dikton udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011, të jetë pjesë e praktikës që shoqëron USH si kusht i domosdoshëm për kryerjen e pagesës nga Sektori i Financës.*

10. Me USH nr. 181, datë 19.11.2018 është kryer pagesa për “Shërbimin e rojeve private” në shumën 594,378 lekë në bazë të kontratës së shërbimit nr. 374, datë 25.04.2018 “Shërbimi i

<sup>29</sup> Të cilat janë përgjegjës për regjistrimin, dokumentimin, kërkimin dhe ruajtjen e koleksioneve, si ato që janë të ekspozuara dhe ato të fondeve



ruajtjes dhe sigurisë fizike të institucionit të MHK-së” me roje private nga subjekti Dea Security shpk. Në praktikën që shoqëron urdhërshpenzimi gjendet procesverbali i kompanisë Dea Security me nr. 030, datë 31.10.2018 ku kjo kompani pohon se për periudhën 01.10 – 31.10.2018, realizimi i kontratës është kryer konform kushteve të përcaktuara. Ky procesverbal **nuk është firmosur nga asnjë përfaqësues i MHK-së**, ndërkohë që vlerësojmë se Sektori për Menaxhimin e Shërbimeve për Vizitorët është përgjegjës për sigurimin e objekteve në MHK, sipas Rregullores së Brendshme të MHK-së. Edhe pse i pakonfirmuar nga MHK, Shërbimi i rojeve është paguar në bazë të faturës tatimore me nr 407, datë 31.10.2018.

**11.** Me USH nr. 154, datë 17.10.2018 është kryer pagesa për “Shërbimin e rojeve private” në shumën 575,204 lekë në bazë të kontratës së shërbimit nr. 374, datë 25.04.2018 “Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike të institucionit të MHK-së” me roje private nga subjekti Dea Security shpk. Në praktikën që shoqëron urdhërshpenzimi gjendet procesverbali i kompanisë Dea Security me nr. 112, datë 30.09.2018 ku kjo kompani pohon se për periudhën 01.09 – 30.09.2018, realizimi i kontratës është kryer konform kushteve të përcaktuara. **Ky procesverbal nuk është firmosur nga asnjë përfaqësues i MHK-së**, ndërkohë që vlerësojmë se Sektori për Menaxhimin e Shërbimeve për Vizitorët është përgjegjës për sigurimin e objekteve në MHK, sipas Rregullores së Brendshme të MHK-së. Edhe pse i pakonfirmuar nga MHK, Shërbimi i rojeve është paguar në bazë të faturës tatimore me nr 373, datë 30.09.2018.

**12.** Me USH nr. 202, datë 12.12.2018 është kryer pagesa për “Shërbimin e rojeve private” në shumën 575,204 lekë në bazë të kontratës së shërbimit nr. 374, datë 25.04.2018 “Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike të institucionit të MHK-së” me roje private nga subjekti Dea Security shpk. Në praktikën që shoqëron urdhërshpenzimi gjendet procesverbali i kompanisë Dea Security me nr. 112, datë 30.09.2018 ku kjo kompani pohon se për periudhën 01.11 – 30.11.2018, realizimi i kontratës është kryer konform kushteve të përcaktuara. Ky procesverbal **nuk është firmosur nga asnjë përfaqësues i MHK-së**, ndërkohë që vlerësojmë se Sektori për Menaxhimin e Shërbimeve për Vizitorët është përgjegjës për sigurimin e objekteve në MHK, sipas Rregullores së Brendshme të MHK-së. Edhe pse i pakonfirmuar nga MHK, Shërbimi i rojeve është paguar në bazë të faturës tatimore me nr 373, datë 30.09.2018

*Me observacionet e ardhura nga MHK, pas projekt raportit të dërguar në subjekt nga KLSH, me shkresën me nr. 02/8, datë 25.04.2019, na u vunë në dispozicion procesverbalet për monitorimin e zbatimit të kontratës së shërbimit të rojeve, të cilët konstatuam se nuk janë mbajtur në prani edhe të kontraktorit, sikundër udhëzon neni 77 i VKM nr. 914, datë 29.12.2014 duke qenë kështu të njëanshëm. Nga ana tjetër procesverbalet e monitorimit nuk zëvendësojnë procesverbalin i cili konfirmon kryerjen e plotë të shërbimit konform kushteve të përcaktuara në kontratë përpara kryerjes së pagesës, i cili duhet të jetë pjesë e praktikës që shoqëron urdhër-shpenzimin dhe pa të cilin Sektori i Fiancës nuk duhet të bëjë asnjë likuidim.*

*Në përfundim procesverbalet e dorëzuara janë marrë parasysh, por nuk ndikojnë konstatimin e KLSH-së, mbështetur në sa u tha më sipër i cili lidhet specifikisht me firmosjen e dyanshme të procesverbalit që i duhet bashkëngjitur praktikës së USH përpara likuidimit të pagesës.*



**13.** Me USH nr. 209, datë 20.12.2018 është kryer pagesa për "Rimbushje dhe kolaudim" në shumën 278,400. Kërkesa është iniciuar nga Përgjegjësi i Sektorit të Menaxhimit të vizitorëve, një specilisit i këtij sektori dhe magazinieri.

**Janë konstatuar raste të mosrenditjes kronologjike të urdhërshpenzimeve si më poshtë vijon:**

**1.** Urdhërshpenzimi nr.78 datë 30.05.2017, me objekt shpenzimi 'Udhëtim jashtë shtetit', me shumë totale 70,522 lekë, **nuk** është paraqitur në rendin kronologjik të duhur. Ky urdhërshpenzim për nga rendi kronologjik I korrespondon muajit qershor, kur ndërkohë ai është I paraqitur në muajin maj.

**2.** Në urdhërshpenzimet gjatë muajit gusht **nuk** është ruajtur rendi kronologjik I tyre, pasi urdhërshpenzimi nr.115 dhe urdhërshpenzimi nr.116 (sipas renditjes i takojnë muajit gusht) janë kaluar në urdhërshpenzimet e muajit korrik, përkatësisht urdhërshpenzimi nr.115 datë 14.07.2017, me objekt shpenzimi 'Blerje bileta elektronike', me shumë totale 98,910 lekë dhe urdhërshpenzimi nr.116 datë 14.07.2017, me objekt shpenzimi 'Blerje material pastrimi', në shumë totale 123,744 lekë.

**3. Në urdhërshpenzimin nr. 104 datë 14.07.2017**, me objekt shpenzimi 'Blerje material mirëmbajtjeje' dhe 'Shpenzime mirëmbajtjeje, lysterje, stukim, kartonxhes', me vlerën totale 40,680 lekë ka faturë tatimore shitje datë 11.07.2017 me këtë vlerë totale, ndërkohë në fletëhyrje është paraqitur vetëm shuma totale 10,800 lekë, blerje e materialeve të mirëmbajtjes.

**4.** Gjatë muajit gusht të vitit 2018, **nuk** është ruajtur rendi kronologjik duke filluar me urdhërshpenzimin nr.111 dhe urdhërshpenzimin nr.112, konkretisht:

Urdhërshpenzimi nr.111 mbulohet nga dy data :

- ✓ I datës 01.08.2018 me objekt shpenzimi 'Rrogat' me shumë totale 2,008,295 lekë, dhe
- ✓ I datës 16.08.2018 me objekt shpenzimi 'Sigurimetshoqërore' me shumë totale 517,781 lekë.

Urdhërshpenzimi nr.112 mbulohet nga dy data:

- ✓ i datës 01.08.2018, me objekt shpenzimi 'Rrogat' me shumë totale 167,697 lekë, dhe
- ✓ I datës 15.08.2018, me objekt shpenzimi 'Blerje baneri, roli, broshur për ekspozitën "Unë jam Shqipëtar" Prishtinë', me shumë totale 69,600 lekë.

*Gabimet njerëzore flasin për risqe operacionale të cilat në kushtet e mungesës së një sistemi kontabël rriten.*

Verifikuam në mënyrë më të detajuar vlerat e biletave (letrat me vlere) që mbahen në Arkën e insitucionit, ng aku mbështetur në udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njëitë e sektorit publik", si dhe në zbatim të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", në Muzeun Historik Kombëtar gjendja e biletave në arkë dhe në biletarinë elektronike në fund të viteve 2017 dhe 2018 rezultoi si më poshtë:

**Gjendja në arkë deri më dt.29.12.2017**

Bileta 200 lekëshe -65 blloqe.

Bileta 200 lekëshe: Nr.Serie

65x50 fije = 3250 fije x 200 lekë= 650.000 lekë.

009250-006001



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në "Muzeun Historik Kombëtar"

Bileta 100 lekëshe - 54 blloqe.	54x50 fije = 2700 fije x 100 lekë = 270.000 lekë
Bileta 100 lekëshe: Nr.Serie	000250-000001 dhe 003500-001051
Bileta 60 lekëshe - 15 blloqe.	15x50 fije = 750 fije x 60 lekë = 45.000 lekë
Bileta 60 lekëshe; Nr.Serie	010000-009251

**Gjithsej gjendja në arkë deri më dt.29.12.2017 është 965.000 lekë.**

#### Gjendja e biletave në biletarinë elektronike në MHK më datë 29.12.2017 është:

Bileta 200 lekëshe :Nr.Serie	002929-002901 gjithsej 29 fije x 200=5.800 lekë
Bileta 200 lekëshe :Nr.Serie	002900-002751 gjithsej 150 fije x 200= 30.000 lekë
Bileta 200 lekëshe :Nr.Serie	009500-009251 gjithsej 250 fije x 200= 50.000 lekë

Gjithsej bileta 200 lekëshe 429 fije x 200 = 85.800 lekë

Bileta 100 lekëshe :Nr Serie	000428-000401 28 fije x100 = 2.800 lekë
Bileta 100 lekëshe :Nr Serie	000400-000251 150 fije x100 =15.000 lekë
Bileta 100 lekëshe :Nr Serie	001050-001001 50 fije x100 = 5.000 leke

Gjithsej bileta 100 lekëshe 228 fije x 100 = 22.800 lekë

Bileta 60 lekëshe :Nr Serie	010031-010001 31 fije x 60 =1.860 lekë
Bileta 60 lekëshe :Nr Serie	010500-010251 250 fije x 60= 15.000 lekë

Gjithsej bileta 60 lekëshe 281 fije x 60 = 16.860 lekë

#### **Gjithsej gjendja në biletarinë e MHK-së deri më dt.29.12.2017 është 125.460 lekë**

#### **VITI 2018**

#### **Gjendja në arkë deri më dt.29.12.2018 është**

Bileta 200 lekëshe -65 blloqe.	65x50 fije = 3250 fije x 200 lekë= 650.000 lekë.
Bileta 200 lekëshe: Nr.Serie	009250-006001

Bileta 100 lekëshe - 54 blloqe.	54x50 fije = 2700 fije x 100 lekë = 270.000 lekë
Bileta 100 lekëshe: Nr.Serie	000250-000001 dhe 003500-001051

Bileta 60 lekëshe - 15 blloqe.	15x50 fije = 750 fije x 60 lekë = 45.000 lekë
Bileta 60 lekëshe; Nr.Serie	010000-009251

**Gjithsej gjendja në arkë deri më dt.29.12.2018 është 965.000 lekë.**

#### Gjendja e biletave në biletarinë elektronike në MHK më datë 29.12.2018 është

Bileta 200 lekëshe :Nr.Serie	009283-009251 gjithsej 33-fije x 200=6.600 leke
------------------------------	---



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Muzeun Historik Kombëtar

Bileta 100 lekëshe :Nr.Serie 001010-001001 gjithsej 10 fije x 100= 1.000 leke  
Bileta 100 lekëshe :Nr.Serie 000400-000251 gjithsej 150 fije x 100= 15.000 leke

Gjithsej bileta 100-lekëshe 160 fije x100 = 16.000 leke

Bileta 60 lekëshe :Nr Serie 010384-010351 34 fije x 60 = 2.040 lekë  
Bileta 60 lekëshe :Nr Serie 010350-010301 50 fije x 60 = 3.000 lekë

Gjithsej bileta 60-lekëshe 84 fije x 60 = 5.040 lekë

### **Gjithsej gjendja në biletarine e MHK-së deri më dt.29.12.2018 është 27.640 lekë**

Në përfundim gjendja kontabël rakordon me gjendjen fizike të biletave – letra me vlerë në Arkë dhe Biletari.

#### **b. Saktësia dhe rregullariteti i veprimeve të kryera në magazinë**

Sa i takon Ditarit të magazinës nga auditimi rezultoi se, është mbajtur dhe veprimet janë hedhur periodikisht.

- U audituan me të zgjedhur dokumentacioni i magazinës për vitin 2017 dhe 2018. Fletë daljet dhe fletë hyrjet e aktiveve përgjithësisht janë të hartuara sipas rendit kronologjik dhe pa korrigjime<sup>30</sup>. Hyrja e aktiveve në magazinë dokumentohet në çdo rast me fletëhyrjen përkatëse, të hartuar sipas gjendjes fizike të tyre. Fletëhyrjet lëshohen nga magazinieri, pasi është bërë më parë verifikimi fizik i sasisë, i cilësisë dhe i çmimit, në përputhje me përcaktimet e paragrafit 37, kreu III, të udhëzimit të ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për *menaxhimin e aktiveve në sektorin publik*”, i ndryshuar, përvec rasteve të cilësuara në Aneksin 2<sup>31</sup>

Kontabilizimet e fletë daljeve dhe fletë hyrjeve janë bërë në mbështetje të planit kontabël **dhe përgjithësisht në mënyrë kronologjike** e sistematike në ditarët e magazinës, përvec 8 fletëhyrjevetë periudhës qershor-korrik 2018 të cilët u evidentuan si të pakontabilizuara në ditarët përkatës nga grupi i KLSH-së. Dokumentacioni i magazinës përpilohet nga administratori i vlerave materiale, ndërsa kontabilizimi i veprimeve kryhet nga një specialiste e sektorit të financës.

**1. Nga auditimi I pasqyrave financiare, deri tani, nga verifikimi flete hyrjeve dhe fletë daljeve të magazinës dhe krahasimit të tyre me urdhër shpenzimet përkatëse, si dhe me ditarët e bankës konstatuam se kishte mbetur pa u kontabilizuar shuma 580,240 lekë sa më poshtë:**

*Në lekë*

Flete hyrje nr	datë	Llog 31	Llog 32
10	02.05.2018	94,560	

<sup>30</sup> Përvec disa korregjimeve jomateriale përgjatë vitit 2017

<sup>31</sup> Aneksi 2 “Artikuj me fletëhyrje dhe fletëdaljenë të njëjtjen datë”



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Muzeun Historik Kombëtar

11	11.06.2018	2,140	
12	11.07.2018	150,000	
13	11.07.2018	73,275	
14	11.07.2018	52,725	
15	16.07.2018	127,080	
16	16.07.2018	27,660	
7	16.07.2018		52,800
<b>Total</b>		<b>527,440</b>	<b>52,800</b>

Për sa më sipër, Sektori I Financës duhet menjëherë të marrë masa të kontabilizojë faturat e mësipërme në ditarët e magazinës.

2. Objektet sipas tabelës më poshtë, të cilat rezultojnë me vlerë mbi 10,000 lekë ndërkohë që janë kontabilizuar si inventar i imët:

Nr.Flete Dalje	Data	Emertimi I Mallit	Vlera (leke)
nr.26	19.05.2017	Portret me Molle	12,960
nr.27	19.05.2017	Pasqyre Dekorative	10,000
nr.28	30.05.2017	Stativ flamuri Bronxi	13,000

Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësië e sektorit publik”, i ndryshuar, paragrafi 29 parashikon se kufiri minimal për pragun e vlerësimit të aktiveve afatgjata (AAGJ) materiale është 10,000 lekë dhe afat përdorimi mbi një vit. Në vijim përcaktohet se aktivet atraktive si punimet e artit, objektet me vlerë historike, etj mund të përfshihen si aktive afatgjata edhe kur janë në pragun e vlerësimit të sipërpërmendur. Në këto kushte të rishikohet kategorizimi i objekteve të listuara në tabelën e mësipërme, si AAGJ, në përputhje me kërkesat e Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011

*Me observacionet e ardhura nga MHK, pas projekt raportit të dërguar në subjekt nga KLSH, me shkresën me nr. 02/8, datë 25.04.2019, theksohet se tre objektet e listuara më sipër megjithëse me vlera mbi 10,000 lekë nuk janë të ndonjë rëndësie të vecantë / nuk janë objektë të trashëgimisë kulturore dhe nuk kanë numër inventari për tu konsideruar si të tilla.*

*Në përgjigje të sa më sipër, KLSH thekson se Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 e specifikon qartë se kufiri minimal për pragun e vlerësimit të aktiveve afatgjata (AAGJ) materiale është 10,000 lekë dhe afat përdorimi mbi një vit. Për sa më sipër observacioni nuk merret parasysh dhe KLSH vijon t'i qëndrojë konstatimit.*

**Në përfundim të konstatimeve nga auditimi mbi zbatimin e dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale dhe monetare, po paraqesim gjetjet dhe rekomandimet si më poshtë:**

**Titulli i Gjetjes 1:** Cështje të konstatuara në procesin e qarkullimit të aktiveve që lidhen me:

- Inicimin e kërkesës për materiale jo nga sektorët përkatës
- Procesverbale të marrjes në dorëzim të shërbimeve pa u konfirmuar nga MHK
- Mungesë procedurash për aktivet që hyjne dhe dalin në të njëjtën datë

**Situata:**

**a.** Në disa raste nuk gjetëm gjurmë të justifikimit të nevojës për materiale, përpara hartimit të kërkesës për këto të fundit, nëpërmjet vlerësimit fillimisht të gjendjes së inventarit në magazinë për materialin në fjalë, si dhe dokumentimin e nevojës sipas sektorëve, në kundërshtim me sa parashikon Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011.

Sa më sipër përforcohet edhe nga analiza e nën-llogarisë 6020100 "Blerje material kancelari- bojra printeri", në shumën 441,035 lekë (ose rreth 3% të total llogarisë 602) nga ku rezultoi se, kërkesa është iniciuar nga Sektori i Menaxhimit të Vizitorëve dhe jo nga sektorët që kanë nevojë konkrete për materialet. Për më tepër që konstatuam se, ky artikull kërkon rreth 189 ditë për të qarkulluar<sup>32</sup> ose rreth 2 herë në vit, gjë e cila nuk justifikon furnizimet më të shpeshta se kjo normë.

Në urdhër-shpenzimin nr. 141, datë 03.10.2018 "Shërbim dezinfektimi dhe deratizim ambienti, faza e dytë", në shumën 108,000 lekë u konstatua se, bashkëngjitur praktikës është kërkesa për dezinfektim e iniciuar nga përgjegjësi i Sektorit të Menaxhimit të Shërbimeve për Vizitorët dhe nga një specialist nga Sektori i Konservimit të Koleksioneve, në kundërshtim me Rregulloren e Brendshme për Organizimin dhe Funkionimin e MHK-së, neni 14/j ku parashikohet se Sektori i Konservimit të Koleksioneve propozon dhe ndjek dezinfektimin e përvitshëm të gjithë pavijoneve dhe fondeve të MHK-së;

**b.** Në disa raste, praktikës së urdhër shpenzimeve për shërbimin e rojeve, nuk i është bashkëngjitur procesverbali i marrjes në dorëzim, mbi bazë të të cilit duhet të bëhet edhe likuidimi i fondeve, ose dhe në rastet kur ky

<sup>32</sup> Norma e Qarkullimit të Inventarit =  $(\text{Inventar fillim} + \text{Inventar ne fund})/2 / \text{KMSH} * 365 \text{ ditë}$ . Duke qenë se luhatjet në kosto nuk janë materiale, përlllogaritjet janë bërë vetëm me sasi.

<b>Gjendja më datë 01.03.2018</b>	<b>3 copë</b>
Hyrë deri më 23.07.2018	37
Dalë deri më 23.07.2018	(17)
<b>Gjendja më datë 23.07.2018</b>	<b>23 copë</b>
Hyrë deri më 25.11.2018	12
Dalë deri më 25.11.2018	(10)
<b>Gjendja më datë 25.11.2018</b>	<b>25 cope</b>
Inventari mesatar	14
COGS (daljet ne rastin konkret)	27
<b>Norma e Inventarit (dite)</b>	<b>189 dite</b>



procesverbal ka qenë pjesë e praktikës, nuk është firmosur nga pala e MHK-së, në mënyrë që të konfirmohet marrjen e plotë e shërbimit që siguron se, cilësia e shërbimeve është e njëjtë me sa parashikuar në kontratë, në përputhje me kërkesat e Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", neni 165.

c. Janë konstatuar raste të dërgimit të aktiveve drejtpërdrejt nga furnizuesi dhe bërë hyrje-dalje pa kaluar në magazinë, ku për këto lloj lëvizjesh, NA i njësisë publike nuk ka miratuar procedura standarde të lëvizjes, të shoqëruara me përgjegjësitë respektive sipas parashikimit në paragrafin 41, të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, (rastet e cilësuara në Aneksin 2 bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit janë bërë hyrje dalje pa kaluar në magazinë; rastet e ikonave gjithashtu).

**Kriteri:**

- Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011

- Udhëzimi nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", neni 165 parashikon se për të gjitha shpenzimet e kryera, NZ kryen kontrollet para pagesës lidhur me mjaftueshmërinë e fondeve (...), si dhe kontrollon dokumentet origjinale të mjaftueshme që vërtetojnë kryerjen e shërbimit. Në vijim të sa më sipër neni 77 i VKM nr. 914, datë 29.12.2014 parashikon se, për tu siguruar nëse cilësia e shërbimeve është e njëjtë me sa parashikuar në kontratë, AK duhet të monitorojë zbatimin e kontratës. AK gjatë kontrolleve mban procesverbal me shkrim në prani të kontraktorit.

- Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, paragrafi 41

**Ndikimi/Efekti:**

Qëllimi i zbatimit të kërkesave të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 është detyrimi që njësitë e sektorit publik kanë për të marrë gjithë masat e nevojshme për dokumentimin, mbrojtjen, qarkullimin (...) e aktiveve, **me qëllim menaxhimin me efektivitet dhe ruajtjen e tyre nga dëmtimi dhe keqpërdorimi**. Mosrespektimi i sa më sipër mbart risqe të menaxhimit jo efektiv të aktiveve të njësisë publike.

**Shkaku:**

- Moszbatimi i kërkesave të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011;

- Moszbatimi i kërkesave të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit, VKM nr. 914, datë 29.12.2014

**Rëndësia:**

E mesme



**Rekomandime:**

**a.** Me qëllim gjetjen e një balance të saktë midis mbajtjes së një gjendjeje të mjaftueshme aktivesh për përmbushjen e kërkesave operacionale, me minimumin e riskut dhe kostos për mbajtjen e tyre, nevojitet që në çdo rast kërkesa për aktive të iniciohet nga sektorët përkatës nga buron nevoja dhe jo ndryshe.

**b.** Përpara kryerjes së pagesës, me qëllim forcimin e kontrolleve që vërtetojnë kryerjen e shërbimit të rojeve, nevojitet që Nëpunësi Zbatues (NZ) në çdo rast likuidimi të kërkojë procesverbalet nga punonjësit e autorizuar të MHK-së, ku të konfirmohet se cilësia e shërbimeve është e njëjtë me sa parashikuar në kontratë. Ky dokument duhet të jetë pjesë e praktikës bashkëngjitur urdhër-shpenzimit përkatës.

**c.** Nëpunësi Autorizues (NA) i njësisë publike, të marrë masa për ngritjen e grupit të punës me specialistë të fushës, për hartimin dhe miratimin e procedurave standarde dhe të qarta, të shoqëruara me përgjegjësitë respektive, për lëvizjet e aktiveve, të cilat deri më tani janë bërë hyrje-dalje formalisht në magazinë. Veçanërisht për zhvendosjen e objekteve të trashëgimisë kulturore (si p.sh. ikonat) të përshkruhen proceset që duhen ndjekur për zhvendosjen e tyre, duke parashikuar qartë rolet dhe përgjegjësitë e sektorëve/pozicioneve të përfshirë në proces.

**Në vazhdim (për pikat a, b); Brenda datës 31.12.2019 (për pikën c)**

**Afati për zbatim:**

**Titulli i Gjetjes 2:** Cështje të konstatuara në procesin e qarkullimit të aktiveve që lidhen me:

- Mos regjistrimi në kohë i faturave të hyrje – daljeve në ditarët e magazinës
- Renditje jo kronologjike e disa urdhërshpenzimeve
- Kontabilizuar si inventar i imët objekte me vlera mbi 10,000 lekë

**Situata:** U konstatuan problematika që lidhen me: mos regjistrime në kohë të faturave të hyrje–daljeve në ditarët e magazinës; regjistrime në ditarët e bankës jo në mënyrë kronologjike të disa urdhërshpenzimeve; në disa raste janë bërë regjistrime në kontabilitet si inventar i imët objekte që janë me vlera mbi 10,000 lekë. Më konkretisht:

-Nga verifikimi i fletë hyrjeve dhe fletë daljeve të magazinës dhe krahasimit të tyre me urdhër shpenzimet përkatëse, si dhe me ditarët e bankës konstatuam se kishin mbetur pa u regjistruar në ditarët e magazinës 8 fatura “hyrje mallrash në magazinë” në shumën totale prej 580,240 lekë<sup>33</sup>.

<sup>33</sup> Fletë-hyrje të pa kontabilizuara në ditarët e magazinës, të cilat u plotësuan gjatë kohës së auditimit në terren.



-Janë konstatuar raste të mos-renditjes kronologjike të urdhër shpenzimeve, si vijon:

1) Urdhër shpenzimi nr.78 datë 30.05.2017, me objekt shpenzimi ‘Udhëtim jashtë shtetit’, me shumë totale 70,522 lekë, i takon muajit maj por që për nga rendi kronologjik i korrespondon muajit qershor;

2) Urdhër shpenzimet nr.115 datë 14.07.2017, dhe nr.116 datë 14.07.2017, me objekt respektivisht ‘Blerje bileta elektronike’, në shumën totale 98,910 lekë dhe ‘Blerje material pastrimi’ në shumën totale 123,744 lekë, i takojnë muajit korrik, por për nga rendi kronologjik I korrespondojnë muajit gusht;

3) Gjatë muajit gusht, 2018, janë harruar të kontabilizohen: urdhër shpenzimin nr.111, që mbulohet edhe nga data 01.08.2018 me objekt shpenzimi ‘Rrogat’ me shumën totale 2,008,295 lekë, dhe nga data 16.08.2018 me objekt shpenzimi ‘Sigurimet shoqërore’ me shumën totale 517, 781 lekë; urdhër shpenzimi nr.112 që mbulohet edhe nga data 01.08.2018, me objekt shpenzimi ‘Rrogat’ me shumën totale 167,697 lekë, edhe nga data 15.08.2018, me objekt shpenzimi ‘Blerje baneri, roli, broshura për ekspozitën “Unë jam Shqiptar” Prishtinë’, me shumën totale 69,600 lekë. Si pasojë nuk është ruajtur rendi kronologjik i tyre.

-Objektet sipas tabelës më poshtë<sup>34</sup>, ishin kontabilizuar si inventar i imët, edhe pse rezultuan me vlerë mbi pragun e vlerësimit të aktiveve afatgjata (AAGJ) materiale prej 10,000 lekë, jo në përputhje me kërkesat e Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, paragrafi 29 parashikon se kufiri minimal për pragun e vlerësimit të AAGJ materiale është 10,000 lekë dhe afat përdorimi mbi një vit.

**Kriteri:**

Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësië e sektorit publik”, i ndryshuar, paragrafi 29 parashikon se kufiri minimal për pragun e vlerësimit të AAGJ materiale është 10,000 lekë dhe afat përdorimi mbi një vit; Ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin

10	02.05.2018	94,560	
11	11.06.2018	2,140	
12	11.07.2018	150,000	
13	11.07.2018	73,275	
14	11.07.2018	52,725	
15	16.07.2018	127,080	
16	16.07.2018	27,660	
7	16.07.2018		52,800
	<b>Total</b>	<b>527,440</b>	<b>52,800</b>

<sup>34</sup> Objekte me vlerë mbi 10,000 leke kontabilizuar si “inventar i imët”

Flete Dalje	Data	Emërtimi I Mallit	Vlera (leke)
nr.26	19.05.2017	Portret me Mollë	12,960
nr.27	19.05.2017	Pasqyre Dekorative	10,000
nr.28	30.05.2017	Stativ flamuri Bronxi	13,000



<b>Ndikimi/Efekti:</b>	dhe pasqyrat financiare"; Udhëzimi nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit".
<b>Shkaku:</b>	Risqe që lidhen me keqmenaxhimin e aktiveve në njësitë publike
<b>Rëndësia:</b>	Mos-zbatimi i kriterëve të përcaktuar amë sipër (baza ligjore në fuqi) I mesëm - Sektori i Financës, në çdo rast të bëjë regjistrimet në kontabilitet në mënyrë kronologjike rendore të urdhër shpenzimeve dhe të çdo dokumenti tjetër financiar dhe justifikues.
<b>Afati i zbatimit:</b>	<b>Në vijimësi</b> - Me qëllim eliminimin e riskut operacional të shtuar, që vjen si pasojë e mungesës së një sistemi të mirëfilltë kontabël (deri tani është punuar me "Excel sheets"), MHK duhet të mundësojë blerjen e një sistemi elektronik kontabël.
<b>Afati i zbatimit:</b>	<b>Në vijimësi</b> - NA të marrë masa për rivlerësimin e 3 objektet me vlera mbi kufirin e vlerësimit prej 10,000 lekë me qëllim njohjen dhe kontabilizimin e drejtë të tyre sipas klasifikimit përkatës, si Aktive Afatshkurtra Materiale (imët/konsum) apo AAGJ materiale.
<b>Afati i zbatimit:</b>	<b>Brenda datës 30.09.2019</b>

<b>Titulli i Gjetjes 3:</b>	<b>Transferim i shpenzimeve korente në investime kapitale</b>
<b>Situata:</b>	Me urdhër-shpenzimin nr. 188, datë 26.11.2018, janë likuiduar fonde në shumën 343,200 lekë për blerje materiale dhe shërbime speciale (rampat). Sipas dokumentacionit bashkëlidhur urdhër shpenzimit, objekti i prokurimit është "Rampat e shkallëve për personat me aftësi të kufizuara", si dhe specifikimet teknike të mallit janë materiale ndërtimi si: tubular celiku profil 60*30 mm, strukturë e varfër panele druri, vida vetëfiletuese, veshje me linoleum, pragje alumini, këndorë alumini, etj. Pra ky objekt është prokuruar si kontratë pune, e vërtetuar kjo edhe nga fatura tatimore e shitjes, e cila është prerë për "Materiale për rampat e shkallëve". Mirëpo vlera e këtij objekt prej 343,200 lekë është kontabilizuar si mall konsumi (llogaria 31), në fakt është kontratë pune (investim) dhe duhej të prekte llogarinë 212 "Ndërtime dhe Konstrukione", duke shtuar me po të njëjtën shumë, vlerën e ndërtesës.
<b>Kriteri:</b>	Udhëzimit nr. 2, date 06.02.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit"
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Mosraportimi i drejtë i vlerës së ndërtesës së MHK-së
<b>Shkaku:</b>	Kontabilizimi i gabuar;
<b>Rëndësia:</b>	I mesëm



<b>Rekomandime:</b>	Të merren masa që vlera e investimit prej 343,200 leke, për ndërtimin e rampave të shkallëve për personat me aftësi të kufizuara, të kontabilizohet në llogarinë 212 “Ndërtime dhe Konstruksione.” Në çdo rast, Nëpunësi Zbatues përpara njohjes së shpenzimit dhe klasifikimit të zërave, të verifikojë me kujdes gjithë dokumentacionin që justifikon shpenzimin e kryer, me qëllim mos- transferimi i fondeve nga shpenzimet korrente në kapitale dhe anasjelltas pa marrë miratimet përkatëse.
<b>Afati për zbatim:</b>	<b>Menjëherë</b>
<b>Rekomandime:</b>	-Me qëllim mos shtrembërimin e destinacionit të shpenzimit, në çdo rast, Nëpunësi Zbatues duhet të kontrollojë <sup>35</sup> nëse kërkesa për kryerjen e një shpenzimi është në përputhje me buxhetin e miratuar. Në raste të nevojës për rishpërndarje fondesh që sjellin ndryshime midis kapitujve dhe artikujve buxhetorë dhe/ose projekteve të investimeve brenda një programi buxhetor, NZ duhet të depozitojë zyrtarisht pranë Nëpunësit të Parë Autorizues, kërkesën për sa më sipër, shoqëruar me analizë ku të identifikohet arsyeja, rezultatet e pritshme, kontributi në arritjen e qëllimit dhe objektiveve, risqet respektive, dhe pasojat.
<b>Afati për zbatim:</b>	<b>Menjëherë dhe në vazhdim</b>

### C. Inventarizimi i Pronës shtetërore

Baza për raportimin e aktiveve në bilanc është ekzistenca e kontrollit efektiv të tyre, sipas UMF nr. 4292, datë 15.06.2006 “Për shpalljen e standardeve kontabël kombëtare dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre”.

Në zbatim të të programit të auditimit nr. 1441, datë 04/01/2019, të Kryetarit të KLSH-së, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- 12) VKM nr. 432, datë 28.06.2006 “ Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave, që krijojnë institucionet buxhetore”
- 13) Ligji nr, 9048, datë 07.04.2003 “Për trashëgimin kulturore”, I ndryshuar,
- 14) Ligji nr. 9386, datë 04.05.2005 “Për muzetë ”, i ndryshuar, sa më sipër r të shfuqizuar me ligjin nr. 27/2018 “Pë r trashë giminë kulturore dhe muzetë ”,
- 15) Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, I ndryshuar
- 16) Udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Kulturës dhe të Financave , nr. 52, datë 09.02.2015 “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave buxhetore në institucionet e sistemit të Ministrisë së Kulturës”.
- 17) Udhëzimi nr.2 datë 06. 02. 2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”,
- 18) Statuti i Muzeut Historik Kombëtar, miratuar me Urdhrin nr. 49, datë 07.03.2016, të Ministrit të Kulturës.

<sup>35</sup> Paragrafët 74, 75 të udhëzimit nr.2 datë 06. 02. 2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Muzeun Historik Kombëtar

- 19) Rregullorja e MHK-së
- 20) Akt-rakordimet e MHK-së me Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave, për të ardhurat dytësore
- 21) Manuali i Ministrisë së Financave “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që, nga ana e MHK janë zbatuar pjesërisht përcaktimet ligjore të bëra në:

- 1) Udhëzimit nr 30, datë 26.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në një sitë e sektorit publik”
- 2) Ligji nr. 9048, datë 07.04.2003 “Për trashëgimin kulturore”, I ndryshuar;
- 3) Ligji nr. 9386, datë 04.05.2005 “Për r muzetë ”, I ndryshuar, sa më sipër të shfuqizuar me ligjin nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë ”,
- 4) Statutin e Muzeut Historik Kombëtar, miratuar me Urdhrin nr. 49, datë 07.03.2016, të Ministrisë të Kulturës.
- 5) Rregulloren e MHK-së

Grupi i auditimit mori në shqyrtim dosjen e inventarizimit me qëllim saktësimin e zërave të pasqyruar edhe në pasqyrat financiare të institucionit, nga ku nga kryqëzimet e informacionit, rezultoi sa vijon:

**Tabela: Rezultatet e inventarizimit sipas pavijoneve**

*Në lekë*

Aktivitet	Vlera ne fillimi	Mjeti kryesor	Shtesa gjate vitit	Dalje nga instituc	Jashte perdorimit	Vlera ne fund
Magazina	5,184,468	5,184,468				5,184,468
Zyra	27,478,384	27,478,384	114,760	(182,050)	(3,812,919)	23,598,175
Fondi	881,440,321	881,440,321	21,149,000	(7,933,160)		894,656,161
Pavijoni I Etnografise	4,367,407	4,226,441				4,226,441
Pavijoni Terrori Komunist	2,168,657	1,646,840				1,646,840
Pavijoni I Ikonografia	484,896,600	484,896,600	7,932,300	(19,180,000)		473,648,900
Pavijoni I Rilindjes	637,989	637,989				637,989
Pavijoni I Lashtësisë	8,259,284	8,259,284	1,100,000			9,359,284
Pavijoni LANC	4,414,725	3,511,826				3,511,826
Pavijoni I Mesjetes	4,691,759	4,600,759		(50)		4,600,709
Pavijoni I Pavarësisë	1,263,021	878,901	670,800			1,549,701
TOB ne ruajtje			5,942,895			5,942,895
Biblioteka/librat	1,571,662	1,571,662	25,000			1,596,662
Ndërtesa	164,227,168	164,227,168		(60,008)	(18,879)	164,148,281
<b>Total</b>	<b>1,590,601,445</b>	<b>1,588,560,643</b>	<b>36,934,755</b>	<b>(27,355,268)</b>	<b>(3,831,798)</b>	<b>1,594,308,332</b>

**Përgatiti: Grupi I auditimit, KLSH**



Nga auditimi rezultoi se janë bërë disa shtesa dhe pakësime gjatë vitit sipas zërave përkatës, të cilët u morën në shqyrtim nga grupi I auditimit, sa më poshtë:

### 1. FONDI – Hyrje në shumën 21,149,000 lekë e përbërë nga:

#### - Shuma: 1,370,000 lekë

Bërë hyrje nga pavijoni I Ikonografisë. Me urdhrin e Brendshëm të Drejtorit të MHK nr. 1035, datë 29.12.2017 “Për lëvizjen e përkohshme të ikonës Deisis nga Pavijoni i Ikonave në Fondin e MHK-së, është ngritur grupi i punës prej 6 anëtarësh, në përfundim të të cilit është mbajtur procesverbali përkatës. Ky transferim ka kaluar në Fond pasi ka qenë e dëmtuar dhe po mbahet në këtë Fond derisa të shkojë për restaurim në IMK.

#### - Shuma: 17,450,000 lekë

Në vijim të Urdhrit të Ministrit të Kulturës nr. 123, datë 24.03.2017 “Mbi lëvizjen e 476 objekteve të trashëgimisë kulturore, fond në ruajtje në MHK me qëllim shpërndarjen e tyre në muzetë kombëtar”, I ndryshuar si dhe Urdhrit nr. 377, datë 13.06.2017 “Miratimin për lëvizjen e përhershme të 91 objekteve në fondin në ruajtje e MHK”, ka dalë Urdhri I brendshëm I titullarit të MHK-së nr. 854, datë 27.10.2017 është ngritur grupi I punës për vlerësimin e 91 objekteve të fondit “Thimio”, për të cilët në përfundim është mbajtur procesverbali përkatës.

#### - Shuma: 2,329,000 lekë

Në bazë të Urdhrit të Ministrit të Kulturës nr. 69, datë 26.03.2014 “Për dhënien e 4 ikonave Institutit të Monumenteve të Kulturës (IMK), për restaurim”, MHK ka dorëzuar 4 ikonat, shoqëruar me procesverbalin date 10.04.2014 (Urdhri i brendshëm i titullarit nr. 344/1, date 10.04.2014). Vihet re se ikona “Shën Athanasi” është restauruar dhe kthyer në MHK në 27.05.2015 (pra rreth 1 vit me pas), 2 ikonat e tjera, Mandili I Krishtit dhe Shen Maria me Krishtin janë kthyer **pas më shumë se 3 vitesh**, ndërsa vijon të jetë në IMK për restaurim “Mbledhja e Kryeëngjëjve”<sup>36</sup>, konkretisht sipas tabelës më poshtë:

Nr	Objekte, derguar ne IMK 2014	Kodi I QKIPK	Kthyer në Muze
1	Mandili I Krishtit	6324	11.10.2017
2	Shen Maria me Krishtin	6297	11.10.2017
3	Mbledhja e Kryeëngjëjve	6822	01.03.2019 (mbi 4 vjet)
4	Shen Athanasi	6511	27.05.2015

Referuar informacionit mbi ecurinë e restaurimit të ikonës “Mbledhja e Kryeëngjëjve”, që drejtori I MHK-së ka kërkuar në mënyrë të vazhdueshme drejtuar IMK-së, konstatuam se deri në 13.11.2018 (data e korespondencës më të fundit mes MHK dhe IMK) kjo ikonë ende nuk ishte kthyer në MHK. *Me observacion e ardhur nga MHK me shkresën nr. 189, datë 06.03.2019 na u bë me dije se ikona ka ardhur në MHK më datë 01.03.2019 (p/verbali nr. 172, datë 01.03.2019 dhe “Relacioni mbi marrjen e dorëzimit të ikonës” nr. 172/1, datë 01.03.2019.*

Rregullorja e brendshme e MHK parashikon se, *cdo levizje e objekteve muzeore për restaurim jashtë institucionit behet sipas ligjit nr. 9048, date 07.04.,2003 “Per trashëgimime kulturore” dhe vetem Sektori I konservimit të koleksioneve merr nje nisem te tille. Pas cdo nderhyrjeje te bere nga institucione te tjera mbi objektet, MHK I dërgohet relacioni përfundimtar, ku pasqyrohen hollesisht ndërhyrjet e bera dhe rekomandimet perkatese. Para, përgjatë dhe pas*

<sup>36</sup> Referuar relacionit të IMK nr. 701/1, datë 20.04.2017, ku specifikohet se kjo ikonë është ende në proces restaurimi për shkak të problematikës së rënduar dhe si e tillë do të vazhdojë të trajtohet e monitorohet në vazhdimësi, **për një periudhë më të zgjatur**



*cdo nderhyrje konservuese te gjitha nderhyrjet pasqyrohen ne pasaporten e objektit dhe ne kartelen e konservimit. Cdo nderhyrje duhet te pasqyrohet me problematikat dhe nderhyrjet e parashikuara.*

Nga verifikimi rezultoi se, pasaportat/kartelat e ikonave të sipërpërmendura nuk ishin plotësuar me informacionin përkatës rreth ndërhyrjeve të kryera mbi to, ndër vite (përfshirë edhe ndërhyrjet e sipërpërmendura) dhe u plotësuan pjesë risht pasi u konstatuan nga KLSH.

**Ajo që vijon të konstatohet është se formati i "Kartelës së restaurimit dhe Konservimi" nuk ka asnjë element sigurie.** Gjykojmë që cdo kartelë me gjithë historikun e ndryshimeve duhet të plotësohet me elementë sigurie dhe gjithashtu të protokollohet dhe arkivohet.

Në këto kartela rezultoi se:

- Në asnjë rast nuk identifikohet "Konstatuesi" – emër, mbiemër, firmë, sikundër e kërkon formati, dhe që sikundër e kërkon rregullorja konstatimi i nevojës duhet të vijë gjithmonë nga Sektori i Konservimit
- Fusha të paplotësuar duhet të plotësohen me shënimin "Nuk ka" dhe jo të lihen bosh;
- Datat se kur ka hyrë dhe kur ka dalë objekti nga Laboratori nuk janë plotësuar me informacion;
- Emrat e personave që kanë kryer punimet janë shkruajtur, por jo firmat për secilin prej tyre, sikundër e kërkon vetë formati;
- Paragrafi "Nga kontrolli i bërë me date \_\_\_\_\_ rezultoi se gjendja e objektit është si më poshtë \_\_\_\_\_" është i paplotësuar për rastet objekt auditimi që janë: a. Objekti "Aureolë e Krishtit", me nr inventari 5727; b. Objekti "Mbulesa e ikonës së Shën e Premtes" me nr inventari 5677; dhe c. Objekti "Mbulesa e ikonës së Shën Gjergjit", me nr. inventari 5675.

Gjithashtu nga verifikimi i pashaportave të disa objekteve rezultoi se:

a. Për ikonën e Shën Athanasit me vlerë 2,055,000 lekë, "Fjetja e Shën Mërisë" me vlerë 12,330,000 lekë dhe "Ngritja e Kryqit", me vlerë 3,425,000 lekë vihet re se:

- mungon firma dhe vula e Drejtorit të Qendrës Kombëtare të Inventarizimit të Pasurisë Kombëtare (QKIPK), sikundër e kërkon vetë formati, çfarë e bën këtë pashaportë të pasigurtë (Pasaporta mban firmën vetëm të skeduesit që njëkohësisht është edhe punonjësi që ka në ngarkim objektin në fjalë - përgjegjësi i Sektorit të Konservimit)
- Nuk është plotësuar Nr. i Regjistrimit dhe Nr. i Inventarit të ikonës
- Pasaporta nuk është firmosur as nga Drejtori i Muzeut Historik Kombëtar, në kundërshtim me kërkesat e Rregullores së Brendshme të MHK-së dhe formatit të vetë pasaportës.

## **2. PAVIJONI I IKONOGRAFIA – Dalje në shumën 17,810,000 lekë**

Me anë të shkresës së titullarit të MHK nr. 833, datë 23.10.2017, "3 ikona kanë nevojë për trajtim të specializuar", drejtuar IMK-së:

- Fjetja e Shën Mërisë
- Shen Athanasi
- Ngritja e Kryqit

Me Urdhrin e Ministres nr. 7084/2, datë 13.11.2017 u miratua lëvizja e përkohshme e tre objekteve të trashëgimisë kulturore me qëllim restaurimin e tyre, në bazë të të cilit kanë dalë të



gjitha aktet e tjera të nevojshme deri në dorëzimin e objekteve duke u mbajtur procesverbali përkatës nr. 1012/1, datë 28.12.2017.

Nr	Objekte, dërguar ne IMK 23.10.2017	Kodi I QKIPK
1	Fjetja e Shen Merise	6391
2	Shen Athanasi	6511
3	Ngritja e Kryqit	6504

Ajo që vihet re, edhe në këtë rast është mosreflektimi në pasaportat e objekteve muzeale të restaurimeve të bëra ndër vite (në disa raste thjesht shkruhet “është restauruar”). Konkretisht ikona “Shën Athanasi” është dërguar përsëri për restaurim, kur në fakt është kthyer e restauruar më 27.05.2015. Në dokumentacionin që lidhet me çështjen në fjalë<sup>37</sup> konstatoam se cilësohet fakti që në rastin e ikonës “Shën Athanasi” **problematika e përsëritur** është pasojë e kushteve të papërshtatshme të konfortit ku ato konservohen dhe ekspozohen. Ato ekspozohen jo vetëm në kushte të papërshtatshme të mikroklimës, por edhe nën ndikimin e luhatjeve të theksuara të temperaturës dhe të % së lartë të lagështisë. Këto temperatura gjatë verës arrijnë vlera maksimale ekstreme.

***Ky fakt duhet marrë në konsideratë gjithashtu edhe nga optika e buxheteve, me qëllim analizën dhe vlerësimin e nevojave reale të MHK, për të përmbushur objektivat dhe misionin e tij, duke konsideruar parashikimin në buxhet të këtyre fondeve jetike, për objektet muzeale.*** Gjithashtu kemi konstatuar se, në nenin 14 të rregullores së brendshme të MHK parashikohet se, Sektori I Konservimit të Koleksioneve:

- është përgjegjës, ndër të tjera, për ruajtjen e koleksioneve; si dhe
- harton projekte konkret e për konservimin e objekteve sipas kritereve shkencore .

Kështu psh referuar PBA 2018-2020 (faza I), MHK ka propozuar miratimin e projektit të investimeve “Ruajtja e temperaturës në ambjentet e MHK-së, mbrojtja nga degradimi “ për total shumë 58,023 mijë lekë.

Edhe në fazën e dytë të PBA 2018-2020, MHK ka vijuar të propozojë në listën e investimeve projektin “Për ruajtjen e temperaturës në ambjentet e MHK-së, mbrojtja nga degradimi”, në shumë 58,023 mijë lekë.

Sipas PBA 2017-2019 (faza II-të) në listën e propozuar për investime konstatoam se MHK ka propozuar edhe buxhet për investime “Sigurimi I temperaturës për pajisje ngrohje-ftohje” në shumë 53,200 mijë lekë. Gjithashtu në këtë formular janë propozuar edhe investime për rikonstruksion në total 316,509 mijë lekë (për rikonstruksionin e pavijonit të arkeologjisë, 220,000 mijë lekë; rikonstruksion pavijoni I pavarësisë 40.000 mijë lekë. Rikonstruksion I vetratave 38,601 mijë lekë.

**Të gjitha sa më sipër nuk janë marrë në konsideratë gjatë miratimit të buxheteve të MHK-së, nga ana e Ministrisë së Kulturës, duke mos celur asnjë fond për investimi si gjatë vitit 2017 ashtu edhe në vitin 2018, duke rrezikuar kushtet në të cilat mbahen objektet muzeale, vecanërisht ikonat.**

Nga ana tjetër, në përputhje me kërkesat e Ligjit “Për trashëgiminë kulturore” (neni 18), fondet e siguruar nga përdorimi i monumenteve të kulturës, nga të ardhurat e përdorimit të tyre, si dhe nga cdo e ardhur tjetër e ligjshme, mund të përdoren për mirëmbajtjen dhe restaurimin e vlerave

<sup>37</sup> Shkresa e IMK nr. 1649, datë 01.08.2018 që shpreh relacionin mbi ndërhyrjet konservuese-restauruese në ikonat e Pavijonit të Artit Mesjetar, në MHK



të trashëgimisë kulturore. Në këto kushte të ardhurat dytësore mund të planifikohen më mirë në funksion të sa më sipër, me qëllim përmbushjen e misionit të MHK-së

*Në referencë të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit public”, I ndryshuar është parashikuar se, aktivet afatgjata materiale duhen mbikëqyrur rregullisht në drejtim të jetëgjatësisë së pjesëve përbërëse të tyre. Në një program mirëmbajtjeje të planifikuar ky informacion përdoret për ti orientuar shpenzimet drejt punës parandaluese se sa drejt riparimit të avarive. Cdo njësi publike duhet të hartojë planin e mirëmbajtjes së aktiveve me qëllim planifikimin e fondeve të nevojshme si dhe sigurimin e eficiencës në përdorimin e aktiveve, Nga sa më sipër, duke iu referuar PBA-së konstatojmë se përgjatë dy viteve objekt auditimi, fondet e nevojshme për planin e mirëmbajtjes së aktiveve nuk janë miratuar nga Ministria përgjegjëse.*

Pavarësisht sa më sipër, për tu siguruar se aktivet janë të vlefshme, nevojitet ***krijimin I një mekanizmi kontrolli*** bazuar në informacionin historic apo të pritsëm mbi situatat ku aktivet afatgjata mund të mos jenë të mjaftueshme/përshtatshme për arritjen e objektivave të tyre. Në këto kushte, diktuar edhe nga kërkesat e Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, cdo njësi e sektorit public duhet të plotësojë planin e vet me njohje të mirë të bazës së aktiveve që duhen për të përmbushur objektivat e saj. ***Strategjitë e menaxhimit të aktiveve*** duhet të synojnë që të krijojnë, ruajnë dhe sipas nevojave të përmirësojnë strukturën e aktiveve (...). NA I të gjithë niveleve të njësisë publike janë përgjegjës për përgatitjen dhe monitorimin e sistemeve dhe ruajtjen dhe mbrojtjen e aktiveve dhe dokumentacionit të njësisë që mbulojnë kundrejt humbjeve, vjedhjeve, keqpërdorimit dhe përdorimit të paautorizuar të tyre<sup>38</sup>.

*Një ndër strategjitë e menaxhimit të aktiveve në MHK është edhe “Konservimi paraprak”, që konsiston në të gjitha masat e ndërmarra që nuk kërkojnë ndërhyrje direkte në pasuritë kulturore materiale, sic janë krijimi I kushteve të përshtatshme (lagështi relative, temperature, pastërti nga ndotja atmosferike, dëmtimi biologjik dhe fizik në fonde, ekspozimi dhe transporti), me qëllim parandalimin e cdo lloj dëmtimi.*

Nga auditimi u konstatua se, aktualisht zhvendosja e vlerave të trashëgimisë kulturore, për ruajtjen e vlerave të tyre në mjedise të përshtatshme, nga pikëpamja e sigurisë ose mikroklimës, në varësi të natyrës së objektit, është bërë nga IMK. Por konstatojmë se nuk ka gjurmë të dokumentuara për përgatitjen e studimeve përkatëse përpara kryerjes së zhvendosjes së objekteve të trashëgimisë kulturore, sikundër e dikton neni 10 i ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, I shfuqizuar me ligjin nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”.

*Nuk ka gjurmë të kryerjes së ndonjë kontrolli teknik përpara se të merret vendimi për zhvendosjen e aktiveve. Aktualisht zhvendosja e aktiveve është bërë në përputhje vetëm me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011<sup>39</sup>, pa asnjë udhëzim të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore lidhur me këtë çështje – pra zhvendosjen e objekteve të trashëgimisë kulturore<sup>40</sup>*

<sup>38</sup> Paragrafet 7 dhe 7 të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011

<sup>39</sup> Psh referoju shkresës së MHK-së nr. 301, datq 14.04.2017 “Në zbatim të detyrave të lëna nga auditimi I Ministrisë së Kulturës mbi ecurinë e restaurimit të tre ikonave, me vlerë 3,151,000 lekë, ku si bazë ligjore citohet vetëm udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011

<sup>40</sup> Sa më sipër është sistemuar me ligjin e ri nr 27/2018, neni 71, Kontrolli teknik



***Nuk ka një calendar të punimeve, të miratuar nga organet kompetente, mbi afatin e fillimit dhe mbarimit të punimeve. Në këto kushte konstatohen procese restaurimi që kanë zgjatur deri në 4 vite<sup>41</sup>.***

Nga auditimi mbi procedurat e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve u konstatua se, me urdhrin nr. 1002, datë 28.12.2016 është ngritur komisioni për vlerësimin e aktiveve me 7 anëtarë, me kryetar Nëpunësin Zbatues në përputhje me kërkesat e Udhëzimit nr. 30, datë 17.12.2011 “Për inventarizimin e aktiveve”, I ndryshuar. Në bazë të Udhëzimit nr 30, datë 26.12.2011, vlerësimi i aktiveve është një proces që kryhet mbi bazën e të dhënave kontabël si viti I vënies në punë, kohën e përdorimit, vlerën fillestare, vlerën e mbetur, vlerën e rivënies dhe mbajtjes në punë, vlerësimin kosto-pë rfitim.

Në vijim është ngritur komisioni për nxjerrje jashtë përdorim me urdhrin nr 1003 datë 30.12.2016, I cili është shfuqizuar me Urdhri nr. 493, datë 09.06.2017, ku vihet re ndryshimi I numrit të anëtarëve të komisionit të nxjerrjes jashtë përdorimit nga 7 në 6. Tabela në vijim pasqyron komisionin e vlerësimit të aktiveve sipas urdhrave përkatës:

	<b>urdhri nr. 1002 Date 28.12.2016</b>	<b>urdhri nr. 1003 Date 30.12.2016</b>	<b>Urdhri nr. 493 Date 09.06.2017</b>
<b>Nr</b>	<b>Komisioni per vleresim aktivesh</b>	<b>Komision per nxjerrjen jashte përdorimit</b>	<b>Komision per nxjerrjen jashte përdorimit</b>
1	M. Kavaja	T. Hakani	L. Xhoxhi
2	A. Saqellari	E. Demollari	B. Braho
3	B. Braho	A. Llukani	A. Kaba
4	R. Marku	S. Paja	F. Lala
5	S. Nika	F. Lala	S. Babaliu
6	A. Pojani	A. Kaba	A. Llukani
7	E. Kote	K. Hoxha	

Komisioni I vlerësimit të aktiveve në përfundim ka mbajtur procesverablet respective, ndër të cilat përmendim sa vijon:

Procesverbali vlerësimit nr.9, date 28.12.2016 “Mbi vlerësimin e gjendjes teknike të aktiveve në ngarkim të znj. Blerina Braho me detyrë specialiste, mbështetur në urdhrin e brendshëm nr. 1002, datë 28.12.2016 “Për ngritjen e komisionit për vlerësimin e aktiveve”, konstatohet nga grupi I vlerësimit se, njësia qendrore PCH 7100 (me vlerë 7,561 lekë ) është dëmtuar dhe pas shumë përpjekjesh për formatimin dhe rregullimin e saj nuk u bë I mundur rikthimi në gjendje pune. Komisioni ka dalë në përfundimin se ky aktiv duhet të nxirret jashtë përdorimit. **Nga auditimi rezultoi se nuk ka asnjë vlerësim të kryer nga specialist IT (përveç rasteve kur punonjësi IT ka qenë I pranishëm por jo anëtar, për më tepër kur konstatohet se ky punonjës ka qenë edhe pjesë e Komisionit të nxjerrjes jashtë përdorimit, në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit nr. 30, datë 26.12.2011, në paragrafin 97 të të cilit parashikohet se, në të gjitha rastet komisioni i vlerësimit të aktiveve ka përbërje tjetër komisioni I nxjerrjes jashtë përdorimit).**

<sup>41</sup> Nëse I referohemi ligjit të ri, neni 222, pika 5 parashikon rëndësinë e hartimit të masave ndër të tjera edhe për qarkullimin e objekteve muzeore, propozimi I të cilave është përgjegjësi e IKRTK-së, IKTK-së, ndërsa miratimi I KKM-së (deri tani vijohet pa asnjë procedura). Gjithashtu ligji I ri, në nenin 78 “Leja për ndërhyrjet në pasuritë kulturore”, pika 7 ka parashikuar se afati I përfundimit të punime përcaktohet në bazë të kalendarit të punimeve të miratuar nga KKTkM-ja. Cdo shtyrje afati kryhet nga autoriteti që ka miratuar lejen, me kërkesë të subjektit



*Paragrafi 99 i udhëzimit nr. 30, datë 26.12.2011 parashikon se, Komisioni I vlerësimit përbëhet nga jo më pak se 3 persona të cilët janë menaxherë ose specialistë të financës si dhe specialistë përkatës sipas natyrës së aktiveve që propozohet dalje jashtë përdorimit. Kur specialistë të lartë nuk mund të sigurohen nga strukturat përkatëse, aktivizohen specialistë të jashtëm sipas procedurave ligjore.*

Sipas procesverbalit të vlerësimit nr. 13, datë 29.12.2016 “Mbi vlerësimin e gjendjes teknike të aktiveve në ngarkim të z. Redis Marku me detyrë specialist” janë propozuar për tu nxjerrë jashtë përdorimit ndër të tjera:

- Kompjuter, vlerësuar 23,500 lekë (asnjë specialist IT ne Komsion)
- Kompjuetr, vlerësuar 78,000 lekë (asnjë specialist IT ne Komsion)

Sipas procesverbalit të vlerësimit nr. 18, datë 29.12.2016 “Mbi vlerësimin e gjendjes teknike të aktiveve në ngarkim të z. Ajten Toptani me detyrë specialist” është propozuar për tu nxjerrë jashtë përdorimit :

- Kompjuter, vlerësuar 28,500 lekë (asnjë specialist IT ne Komsion)

Sipas procesverbalit të vlerësimit nr. 12, datë 29.12.2016 “Mbi vlerësimin e gjendjes teknike të aktiveve në ngarkim të z. Besnik Panariti me detyrë vëzhgues” është propozuar për tu nxjerrë jashtë përdorimit :

- kamera, vlerësuar 189,306 leke lekë (asnjë specialist I fushës ne Komsion)
- kamer objektiv, vlerësuar 57,288 lekë asnjë specialist I fushës ne Komsion)

*Në përfundim aktivet në fjalë janë vlerësuar “në prani të punonjësit të IT-së, z. Ardit Kaba”, ku është i paqartë roli i tij si “i pranishëm” në këtë proces, kur specialisti i fushës (në rastet e kompjuterave dhe TV-ve, punonjësi i IT-së) duhet të ishte në përbërjen e Komisionit të Vlerësimit, sikundër e dikton Udhëzimi nr.30, datë 27.12.2011, paragrafi 99.*

*Nga ana tjetër, nëse prania e punonjësit të IT-së në Komisionin e Vlerësimit (si “i pranishëm” por jo në përbërje të Komisionit të vlerësimit) do të vijojë të argumentohet si e drejtë nga MHK, atëherë caktimi i tij në Komisionin për nxjerrje jashtë përdorimit, është totalisht i padrejtë dhe në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimi nr.30, datë 27.12.2001, paragrafi 97.*

*Në të dy skenarët e mësipër vlerësojmë se, procesi i vlerësimit të aktiveve në fjalë ka qenë jo i drejtë dhe si pasojë edhe nxjerrja e tyre jashtë përdorimit është bërë në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimi nr.30, datë 27.12.2011*

*MHK me shkresën nr. 2/8, datë 25.04.2019 ka sjellë observacionet për projektraportin e KLSH-së ku vijnë të përsëriten argumentat si më poshtë:*

*“Sa i takon mosplotësimin me informacion të kartelave dhe pasaportave të ikonave, MHK sqaron se, jemi në procesin e plotësimit të kartelave të reja sipa standardeve ndërkombëtare që kemi marrë në Qendren Kombëtare të Inventarizimit të Pasurive Kulturore. Gjithashtu sqarohet se në kartelën e re, rubrika “Restaurimi” është vetëm 6 rreshta dhe kjo nuk mjafton për të përshkruar*



*gjithë procesin e restaurimit të një ikone ndër vite. Për këtë MHK është mbështetur në relacionet që i dërgon IMK.*

*Në përgjigje të këtij observacioni KLSH sqaron se mos-pasja vend mjaftueshëm në kartelë nuk është argument për të mos plotësuar kartelën. Kartela është një format i miratuar nga vetë MHK që do të thotë, nëse një element i sistemit të kontrollit nuk është hartuar sic duhet, atëherë nga ai nuk pritët të implementohet sic duhet. Duhet ripare hartimi dhe jo verifikuar implementimi. Për më tepër, gjykojmë që edhe në formatin sic është fusha në fjalë mund të plotësohet me numrat e protokollit të relacioneve të IMK, të cilat së bashku me këtë kartelë duhej të ishin protokolluar nga IMK dhe arkivuar. **Për sa më sipër observacioni nuk pranohet.***

*Sa i takon plotësimin të kartelës me elementë sigurie, MHK sqaron se kartela është për përdorim të brendshëm dhe është nënshkruar nga drejtuesi i projektit (restaurator), KLSH sqaron se “përdorimi i brendshëm” për një dokument (për më tepër për çështje që lidhen me ruajtjen e objekteve të trashëgimisë kulturore) nuk është arsye për të mos protokolluar dhe arkivuar dokumentin. Elementët e sigurisë i shërbejnë pikërisht forcimit të kontrolleve të brendshme. **Për sa më sipër observacioni nuk pranohet.***

**Në përfundim të konstatimeve nga auditimi mbi inventarizimin e pronës shtetërore, po paraqesim gjetjet dhe rekomandimet si më poshtë:**

<b>Titulli i Gjetjes 1:</b> <b>Situata:</b>	<p><b>Cështje që lidhen me, mosplotësimin e kartelave / pasaportave</b></p> <p>Në lidhje me inventarizimin e pronës shtetërore u konstatua se, në <b>pasaportat</b> e 3 ikonave: “Shën Athanasi” me vlerë 2,055,000 lekë ; “Fjetja e Shën Mërisë ” me vlerë 12,330,000 lekë; dhe “Ngritja e Kryqit”, me vlerë 3,425,000 lekë, të cilat iu nënshtruan restaurimeve nga IMK, mungonte informacioni përkatës rreth ndërhyrjeve të kryera mbi to ndër vite (përfshirë edhe ndërhyrjet e fundit). Konkretisht, nga verifikimi i këtyre pasaportave u konstatua se:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- mungon firma dhe vula e Drejtorit të Qendrës Kombëtare të Inventarizimit të Pasurisë Kombëtare (QKIPK), sikundër e kërkon vetë formati, çfarë e bën këtë pasaportë të pasigurve (Pasaporta mban firmën vetëm të skeduesit që njëkohësisht është edhe punonjësi që ka në ngarkim objektin në fjalë - përgjegjësi i Sektorit të Konservimit);</li><li>- Nuk është plotësuar Nr. i Regjistrimit dhe Nr. i Inventarit të ikonës;</li><li>- Pasaporta nuk është firmosur as nga Drejtori i Muzeut Historik Kombëtar, në kundërshtim me kërkesat e Rregullores së Brendshme së MHK-së dhe formatit të vetë pasaportës.</li></ul> <p>Po kështu edhe nga verifikimi i <b>kartelave</b> u konstatua se, formatet i “Kartelës së restaurimit dhe Konservimit” nuk përmbajnë elementë sigurie si dhe:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- në asnjë rast nuk është plotësuar/identifikuar fusha “Konstatuesi”, sikundër e kërkon rregullorja, ku konstatimi i nevojës duhet të vijë gjithmonë nga Sektori i Konservimit.</li><li>- datat se kur ka hyrë dhe kur ka dalë objekti nga Laboratori nuk janë</li></ul>
--	---



	<p>plotësuar me informacionin përkatës;</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- emrat e personave që kanë kryer punimet janë plotësuar, por jo firmat për secilin prej tyre, sikundër e kërkon vetë formati;</li><li>- Paragrafi “Nga kontrolli i bërë me datë _____ rezultoi se gjendja e objektit është si më poshtë _____” është i paplotësuar për rastet objekt auditimi që janë: a. Objekti “Aureolë e Krishtit”, me nr inventari 5727; b. Objekti “Mbulesa e ikonës së Shën e Premtes” me nr inventari 5677; dhe c. Objekti “Mbulesa e ikonës së Shën Gjergjit”, me nr. inventari 5675.</li></ul> <p>Mungesa e informacionit historik, cenon gjurmimin e procesit ndër vite dhe shton risqet e mashtrimit.</p>
<b>Kriteri:</b>	Rregullorja e Brendshme e MHK-së, Ligji nr. 9048, date 07.04.,2003 “Per trashëgimime kulturore.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Mungesa e informacionit historik, cënon gjurmimin e procesit ndër vite dhe shton risqet e mashtrimit.
<b>Shkaku:</b>	Mungesa e hartimit të kontrolleve të brendshme që lidhen me zhvendosjen e ikonave (konkretisht një rregullore e vecantë, ose urdhër i brendshëm)
<b>Rëndësia:</b>	E lartë
<b>Rekomandime:</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>- Për ikonat që janë restauruar deri tani por edhe ato që do t'i nënshtrohen këtij procesi në vijim, të merren masa që të gjitha ndërhyrjet të pasqyrohen në pasaportën dhe në kartelën e objektit të restauruar.</li><li>- Në kushtet kur këto dokumente të rëndësishëm nuk kanë asnjë element sigurie, të merren masa që pasi të plotësohen me informacionin e përditësuar, të protokollohen dhe arkivohen.</li></ul>
<b>Afati për zbatim:</b>	<b>Brenda datës 30.09.2019</b>

<b>Titulli i Gjetjes 2:</b>	<b>Mungesa e kontrolleve teknike paraprake dhe kalendarëve të punimeve të ikonave</b>
<b>Situata:</b>	<p>Nga auditimi u konstatua se, aktualisht zhvendosja e vlerave të trashëgimisë kulturore me qëllim ruajtjen e vlerave të tyre në mjedise të përshtatshme, nga pikëpamja e sigurisë ose mikroklimës, në varësi të natyrës së objektit, deri tani është bërë nga Instituti i Monumenteve të Kulturës (IMK). Por konstatojmë se nuk ka gjurmë të dokumentuara për përgatitjen e studimeve paraprake, përpara kryerjes së zhvendosjes së objekteve të trashëgimisë kulturore, sikundër e dikton neni 10 i ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, i shfuqizuar me ligjin nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”.</p>



	<p>Aktualisht zhvendosja e aktiveve është bërë në përputhje vetëm me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011<sup>42</sup>.</p> <p>Kontrollet teknike paraprake krijojnë kushtet edhe për parashikimin e kalendarit të punimeve mbi afatin e fillimit dhe mbarimit të punimeve, i cili gjithashtu ka munguar</p> <p>Në këto kushte konstatoam se proceset e restaurimit kanë zgjatur edhe mbi 4 vjet<sup>43</sup>. Konkretisht, në bazë të Urdhrit të Ministrisë të Kulturës nr. 69, datë 26.03. 2014 “Për dhënien e 4 ikonave Institutit të Monumenteve të Kulturës (IMK), për restaurim”, MHK ka dorëzuar 4 ikonat, shoqëruar me procesverbalin date 10.04.2014 (Urdhri i brendshëm i titullarit nr. 344/1, date 10.04.2014)., nga ku vihet re se ikona “Shën Athanasi” është restauruar dhe kthyer në MHK në 27.05.2015 (pra rreth 1 vit me pas), 2 ikonat e tjera, Mandili I Krishtit dhe Shen Maria me Krishtin janë kthyer <b>pas më shumë se 3 vitesh</b><sup>44</sup>, ndërsa “Mbledhja e Krye-ëngjëjve”<sup>45</sup> është kthyer pas më shumë se <b>4 vitesh</b>.</p>
<b>Kriteri:</b>	Ligji nr. 9048, datë 07.04.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, I shfuqizuar me ligjin nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Mungesa e kontrolleve teknike paraprake dhe evdientimi i problematikave paraprakisht, con në tejzgjatje të afateve të restaurimit pa asnjë lloj monitorimi; proces i pamonitoruar dobëson kontrollet e brendshme dhe rrit risqet për abuzime.
<b>Shkaku:</b>	Mos hartimi i kontrolleve të brendshme që lidhet me hartimin e proceseve për objektet që kanë nevojë për restaurime dhe dokumentimin e tyre.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë
<b>Rekomandime:</b>	Në kushtet kur MHK nuk ka ekspertë për restaurimin, në çdo rast të zhvendosjes së vlerave të trashëgimisë kulturore për qëllime restaurimi, konservimi, etj, të kërkohet që nga ekspertët e IMK-së të

<sup>42</sup> Psh referoju shkresës së MHK-së nr. 301, datë 14.04.2017 “Në zbatim të detyrave të lëna nga auditi I Ministrisë së Kulturës mbi ecurinë e restaurimit të tre ikonave, me vlerë 3,151,000 lekë, ku si bazë ligjore citohet vetëm udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011. Deri tani nuk ka gjurmë të kryerjes së ndonjë kontrolli teknik përpara se të merret vendimi për zhvendosjen e tyre, por kjo duket e sistemuar me ligjin e ri nr 27/2018, neni 71, “Kontrolli teknik”

<sup>43</sup> Nëse I referohemi ligjit të ri, neni 222, pika 5 parashikon rëndësinë e hartimit të masave ndër të tjera edhe për qarkullimin e objekteve muzeore, propozimi I të cilave është përgjegjësi e IKRTK-së, IKTK-së, ndërsa miratimi I KKM-së (deri tani vijohet pa asnjë procedurë). Gjithashtu ligji I ri, në nenin 78 “Leja për ndërhyrjet në pasuritë kulturore”, pika 7 ka parashikuar se afati I përfundimit të punime përcaktohet në bazë të kalendarit të punimeve të miratuar nga KTKM-ja. Cdo shtyrje afati kryhet nga autoriteti që ka miratuar lejen, me kërkesë të subjektit

<sup>44</sup> konkretisht: ikona “Mandili I Krishtit” dhe “Shen Maria me Krishtin” janë kthyer në Muze më datë 11.10.2017 (3.5 vite më pas); ikona “Mbledhja e Kryeëngjëjve”, kthyer më datë 01.03.2019 (mbi 4 vjet); ikona “Shen Athanasi” kthyer ne Muze më datë 27.05.2015 (1.2 vjet)

<sup>45</sup> Referuar relacionit të IMK nr. 701/1, datë 20.04.2017, ku specifikohet se kjo ikonë është ende në process restaurimi për shkak të problematikës së rënduar dhe si e tillë do të vazhdojë të trajtohet e monitorohet në vazhdimësi, **për një periudhë më të zgjatur**



kryhen kontrole teknike paraprake, ku në përfundim të specifikohen nevojat konkrete për restaurim, të shoqëruara me kalendarët e punimeve. Këto dokumente të rëndësishëm duhet t'i bashkëngjiten praktikës së dosjes, pasi vetëm duke pasur një relacion fillestar mbi kushtet e objektit dhe nevojat për restaurim, arrihet të monitorohet procesi duke u identifikuar në përfundim punimet që u kryen dhe a i shërbyen këto punime përmirësimit të kushteve sipas relacionit fillestar. Dokumentimi tejet i kujdesshëm i këtij procesi forcon kontrollet e brendshme që lidhen me zhvendosjen e objekteve të trashëgimisë kulturore dhe minimizon risqet e abuzimit/mashtimit me to.

**Afati për zbatim:** Në vijimësi

**Titulli i Gjetjes 3:** **Mungesa e buxheteve që lidhen me shpenzimet për mirëmbajtjen e ikonave**

**Situata:**

U konstatua se, ikona e “Shën Athanasit”, e cila është kthyer e restauruar nga IMK më 27.05.2015, është ridërguar për restaurim më 23.10.2017. Në dokumentacionin që lidhet më çështjen në fjalë<sup>46</sup> konstatuam se në relacionin e IMK-së, cilësohet fakti që **“në rastin e ikonës “Shën Athanasi” problematika e përsëritur është pasojë e kushteve të papërshtatshme të konfortit ku ato konservohen dhe ekspozohen. Ato ekspozohen jo vetëm në kushte të papërshtatshme të mikroklimës, por edhe nën ndikimin e luhatjeve të theksuara të temperaturës dhe të % së lartë të lagështisë. Këto temperatura gjatë verës arrijnë vlera maksimale ekstreme.”**

Duke konsideruar sa më sipër, në PBA 2018-2020 (faza I), MHK<sup>47</sup> ka propozuar miratimin e projektit të investimeve “Ruajtja e temperaturës në ambientet e MHK-së, mbrojtja nga degradimi “ për total shumë 58,023 mijë lekë, i cili gjithashtu është propozuar edhe në fazën e dytë të PBA 2018-2020, propozime këto të cilat nuk janë marrë parasysh nga Ministria e Kulturës.

Propozime të tjera të paraqitura nga MHK për investime që lidhen me ruajtjen dhe përmirësimin e kushteve të objekteve të trashëgimisë kulturore, konstatuam gjithashtu edhe në PBA 2017-2019 (faza II-të) ku MHK ka propozuar buxhet për investime për “Sigurimin e temperaturës për pajisje ngrohje-ftohje” në shumë 53,200 mijë lekë; investime për rikonstrukcion në total 316,509 mijë lekë konkretisht për

<sup>46</sup> Shkresa e IMK nr. 1649, datë 01.08.2018 që shoqëron relacionin mbi ndërhyrjet konservuese-restauruese në ikonat e Pavijonit të Artit Mesjetar, në MHK

<sup>47</sup> Në nenin 14 të rregullores së brendshme të MHK parashikohet se, Sektori I Konservimit të Koleksioneve:

- është përgjegjës, ndër të tjera, për ruajtjen e koleksioneve; si dhe

- harton projekte konkrete për konservimin e objekteve sipas kriterëve shkencore .



	<p>rikonstrukcionin e pavijonit të arkeologjisë, 220,000 mijë lekë, si dhe për rikonstrukcionin e pavijonit të pavarësisë 40.000 mijë lekë. Rikonstrukcion i vetratave 38,601 mijë lekë).</p> <p>Të gjitha sa më sipër nuk janë miratuar nga Ministria e Kulturës, duke mos u çelur asnjë fond për investime si për vitin 2017 ashtu edhe për vitin 2018.</p>
<b>Kriteri:</b>	Ligji “Për Muzetë”, Rregullorja e brendshme e MHK-së
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Cënohet funksioni primar i muzeut që ka të bëjë me ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore
<b>Shkaku:</b>	Mungesa e buxheteve
<b>Rëndësia:</b>	E lartë
<b>Rekomandime:</b>	Muzeun Historik Kombëtar ti kërkojë Ministrisë së Kulturës si ministri përgjegjëse që ti miratojë fonde për investime në buxhetet pasardhëse që lidhen direkt me përmbushjen e funksionit primar të Muzeut që, është ruajtja dhe mbrojtja e trashëgimisë kulturore, dhe kryesisht për: <i>administrimin e koleksioneve, sigurinë e tyre, konservimin parandalues<sup>48</sup> e përmirësues, si dhe restaurimin e objekteve muzeore, et,</i>
<b>Afati për zbatim:</b>	Në vazhdim

<b>Titulli i Gjetjes 4:</b>	<b>Mbi nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve</b>
<b>Situata:</b>	<p>Me urdhrin nr. 1002, datë 28.12.2016, të Drejtorit të MHK-së, është ngritur Komisioni për Vlerësimin e Aktiveve; ndërsa me Urdhrin nr. 1003, datë 30.12.2016, i ndryshuar me Urdhrin nr. 493, datë 09.06.2017 të Drejtorit të MHK-së, është ngritur Komisioni për Nxjerrje Jashtë Përdorimi të Aktiveve, në MHK. Konstatuam se janë nxjerrë jashtë përdorimit ndër të tjera edhe 3 kompjuterë (me vlerë totale prej 130,000 lekë) dhe 2 kamera profesionale (me vlerë totale prej 246,594 lekë), të cilat janë vlerësuar “në prani të punonjësit të IT-së”, roli i të cilit si “i pranishëm” në këtë proces, është i paqartë, në kushtet kur specialisti i fushës (në rastet e kompjuterëve dhe televizorit - punonjësi i IT-së) duhet të ishte në përbërjen e Komisionit të Vlerësimit, sikundër e dikton Udhëzimi nr.30, datë 27.12.2011, paragrafi 99. Në këto kushte gjykojmë që procesi i vlerësimit të jetë kryer në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011. Po kështu, ky punonjës ka qenë në përbërje të</p>

<sup>48</sup> “**Konservimi parandalues**”, është një ndër strategjitë e menaxhimit të aktiveve në MHK, që konsiston në të gjitha masat e ndërmarra që nuk kërkojnë ndërhyrje direkte në pasuritë kulturore materiale, siç janë krijimi i kushteve të përshtatshme (lagështi relative, temperatura, pastërti nga ndotja atmosferike, dëmtimi biologjik dhe fizik në fonde, ekspozimi dhe transporti), me qëllim parandalimin e çdo lloj dëmtimi, dhe si i tillë i duhet dhënë rëndësia që i takon në buxhetet vjetore



Komisionit për Nxjerrje Jashtë Përdorimit, në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimi nr.30, datë 27.12.2001, paragrafi 97.

<b>Kriteri:</b>	Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, para. 97 dhe para. 99
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Risqe që të mos jenë kryer sic duhet vlerësimi dhe nxjerrja jashtë përdorimi i aktiveve të përmendura.
<b>Shkaku:</b>	Mospërputhje me kërkesat ligjore (udhëzimi)
<b>Rëndësia:</b>	E ulët
<b>Rekomandime:</b>	Në çdo rast të vlerësimit të aktiveve specifike (si kompjuterë apo pajisje elektronike), Komisioni i Vlerësimit të Aktiveve duhet të ketë në përbërje një specialist të fushës. Anëtarë të këtij komisioni në asnjë rast nuk duhet të jenë në përbërje të Komisionit për nxjerrje jashtë përdorimi të aktiveve
<b>Afati për zbatim:</b>	<b>Në vazhdim</b>

#### 4. AUDITIMI I LLOGARIVE VJETORE TË ADMINISTRATËS SË MUZEUT HISTORIK KOMBËTAR

Nga auditimi u konstatua se:

Mbajtja e kontabilitetit dhe mbyllja e llogarive vjetore në MHK, për vitin 2017 është bërë në përputhje me:

- 1) ligjin nr. 9248, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" i ndryshuar,
- 2) VKM nr. 248, datë 10.04.1998 "Për miratimin e planit kontabël publik të organeve të Pushtetit Lokal, Institucioneve Shtetërore Qendrore si dhe njësive që varen prej tyre", ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001 "Për disa shtesa e ndryshime të VKM nr. 248, datë 10.04.1998".
- 3) Udhëzimi nr. 23, datë 28.12.2016 "Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2017"
- 4) Udhëzimi nr. 8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2018"
- 5) Udhëzimi nr. 14, datë 28.12.2006, "Per përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore te vitit 2006 per institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njesive qe varen prej tyre si dhe te njesive te menaxhimit / zbatimit te projekteve e marrveshjeve me donatore te huaj", i ndryshuar
- 6) Udhëzimi I Ministrisë së Financave nr. 26, datë 27.12.2007 "Për disa shtesa e ndryshime në Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 14, datë 28.12.2006 "Për përgatitjen dhe



raportimin e Pasqyrave Financiare Vjetore të vitit 2006 për Institucionet Qendrore, Organet e Pushtetit Vendor dhe njësisë që varen prej tyre si dhe njësisë të menaxhimit/zbatimit të Projekteve e Marrëveshjeve me Donatorë të Huaj” ,ndryshuar me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 10, datë 27.02.2008

Bilanci kontabël i vitit 2017 (llogaria vjetore 2017) është përpiluar nga Sektori i Financës si dhe konfirmuar nga Drejtori . Kopja e bilancit është dërguar në Degën e Thesarit Tiranë me shkresën nr. 42/1, datë 22.02.2018. Nga Dega e Thesarit Tiranë është bërë edhe vulosja e bilancit dhe formateve të pasqyrave financiare si dhe është respektuar afati i dorëzimit sipas kërkesave të Udhëzimit nr. 14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e Pasqyrave Financiare Vjetore

të vitit 2006 për Institucionet Qendrore, Organet e Pushtetit Vendor dhe njësisë që varen prej tyre si dhe njësisë të menaxhimit/zbatimit të Projekteve e Marrëveshjeve me Donatorë të Huaj”, i ndryshuar. Bilanci kontabël është shoqëruar me pasqyrat financiare sipas formateve të miratuara nga Ministria e Financave.

Nga auditimi rezultoi se, dokumentet justifikuese për kryerjen e veprimeve ekonomike, janë plotësuar konform dispozitave ligjore në fuqi. Veprimet kontabël në këtë institucion janë të regjistruara me programin Excel çfarë ka bërë që risku i gabimit njerëzor të jetë i lartë. Janë kontabilizuar veprimet me “Bankën”, “Hyrjet dhe Daljet e magazinës”, veprimet lidhur me “Pagat” dhe veprimet lidhur me shpenzimet operative dhe për investime. Të gjitha sistemimet dhe mbylljet e llogarive të regjistruara në ditarin e “Veprimeve të ndryshme”, janë kryer konform dispozitave ligjore, Udhëzimit nr. 2, datë 10.01.2002 të Ministrisë së Financave dhe udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 të Ministrisë së Financave “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. Janë bërë rakordimet e situacionit të shpenzimeve dhe të të ardhurave me Degën e Thesarit Tiranë, të cilat paraqiten në Pasqyrën Financiare me vlerën e tyre reale.

Për të arritur në hartimin e bilanci njësisë shpenzuese (sektori i financës) ka punuar duke përdoruar ditarët përkatës të kontabilizimeve, si: i hyrjeve e daljeve të bankës; hyrjeve e daljeve të magazinës; hyrje e dalje të arkës (kryesisht të valutës) dhe të arkëtimit të të ardhurave në vlera të vogla, listë pagesave të punonjësve; veprimeve të ndryshme, të shoqëruar edhe me librat përkatës të nën llogarive.

Si përfundim llogaria vjetore e MHK-së 2017, përmban:

1. Bilancin Kontabël (Aktivi dhe Pasivi sipas formateve nr.1 dhe 2);
2. Pasqyra e shpenzimeve dhe të ardhurave (formatet nr.3/1 dhe 3/2);
3. Burimet dhe shpenzimet lidhur me investimet (formati nr.4);
4. Pasqyra mbi lëvizjen “CASH” (formati nr.5);
5. Pasqyra mbi gjendjen dhe ndryshimet në Aktivet e Qëndrueshme si dhe Amortizimin e tyre (formati nr.6 dhe nr.7);
6. Pasqyra e lëvizjes së fondeve (formati nr.8);
7. Pasqyra mbi numrin e punonjësve dhe fondin e pagave (formati nr.9);
8. Pasqyra e konsoliduar e gjendjes financiare të vitit 2015 (formati nr.10);
9. Pasqyra e konsoliduar e të ardhurave të shpenzimeve të funksionimit (formati nr.11);



10. Pyetëtori dhe shënime shpjeguese për hartimin e llogarive të administrimit financiar (formati nr.12).

Gjithashtu bilanci kontabël është shoqëruar edhe me relacionin shpjegues, duke paraqitur edhe pozicionet përkatëse të llogarive dhe nën llogarive. Llogaria vjetore është paraqitur e plotë duke përfshirë edhe të dhënat shpjeguese të pyetëtorit përkatës nga njësia shpenzuese, sipas udhëzimit të Ministrisë së Financave.

Llogaria vjetore është shoqëruar gjithashtu me situacionin e rakorduar për shpenzimet dhe të ardhurat në “CASH”.

#### **a. AKTIVI I BILANCIT KONTABËL (Formulari nr. 1)**

Shuma e aktivitetit të pasqyrës financiare pasqyron aktivitetet e qëndrueshme, aktivitetet qarkulluese kërkesat për t'u arkëtuar dhe mjete monetare në llogarinë e thesarit që i shërbejnë institucionit për zhvillimin e aktivitetit të tij.

**a. Objektivat e auditimit** të aktiveve të qëndrueshme, janë që të sigurohemi se:

Aktivitetet ekzistojnë fizikisht; ato i përkasin subjektit; janë të vlerësuara në mënyrë korrekte; janë regjistruar në mënyrë korrekte; është bërë mirë ndarja midis shpenzimeve korrente dhe aktiveve të qëndrueshme; informacionet që ndodhen në aneksin përkatës janë të plota dhe e korrekte.

**b. Kontrollat të përgjithshme të llogarive dhe dokumenteve:**

Për auditimin e aktiveve të qëndrueshme, paraprakisht u kryen një numër kontrollesh të përgjithshme si:

- U verifikua tabela e lëvizjeve të aktiveve të qëndrueshme në raport me gjendjet dhe ndryshimin e tyre gjatë periudhës ushtrimore;
- U ekzaminua tabela e lëvizjeve, nëse ka ndodhura ndonjë variacion anormal mbi aktivitetet e qëndrueshme;
- U ekzaminuan të gjitha shpjegimet që janë paraqitur lidhur me shmangiet dhe përjashtimet e veçanta;
- U verifikua nëse parimet kontabël të ndjekura prej subjektit për vlerësimin dhe kontabilizimin janë konform parimeve të përgjithshme të pranuar dhe udhëzimeve përkatëse.
- U verifikua nëse shifrat e çeljes rakordojnë me ato të mbylljes së ushtrimit të mëparshëm;
- U krahasuan investimet e realizuara gjatë ushtrimit me ato të planifikuara në buxhet, evidentimi kontabël.

**c. Disa nga parimet e zbatuara për auditimin e aktiveve të qëndrueshme:**

1. Gjatë hyrjes së aktiveve në pronësinë e subjektit, duhet të sigurohemi se:

- *Aktivitetet e blera kontabilizohen sipas vlerës së tyre të marrjes. (çmimit të blerjes shtuar shpenzimet e tjera të nevojshme për vënien në gjendje përdorimi të pasurisë);*
- *Aktivitetet e marra falas kontabilizohen duke i vlerësuar ato me vlerën e shitjes;*
- *Aktivitetet e sjella në subjekt nga të tretët nëse kontabilizohen me vlerën e tyre të sjelljes.*

(UMF nr. 30, dt. 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar).

2. Për inventarin, duhet të sigurohemi që subjekti:

- *Procedon për regjistrimin dhe vlerësimin e aktiveve të saj të qëndrueshme sipas rregullave kontabël përgjithësisht të pranuar;*



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Muzeun Historik Kombëtar

- Përdor referencat ose teknikat më të përshtatshme për natyrën e pasurisë (çmimi i tregut, tabelat e publikuara, treguesit specifike, etj.);
- Ka ruajtur të njëjtat rregulla vlerësimi nga një inventar në tjetrin.

Nga auditimi rezultoi se, Aktivet e Qëndrueshme për vitin ushtror 2017 janë në vlerën 1,594,308 mijë lekë dhe përbëhen në masën 89% nga “Inventar Ekonomik”, ndërsa pjesa tjetër prej 11% shpërndahet mes zërave të tjerë të aktivitetit si : “Ndërtime dhe Konstruksione”, dhe “Instalime teknike,makineri,paisje,vegla pune”, si vijon:

Nr.llog.	EMERTIMI I LLOGARIVE TE AKTIVIT	Viti 2017	Viti 2016	Pesha 2017	Ndryshimi
	<b>II.Akt.Qendr.te Trupezuara</b>	<b>1,594,308,000</b>	<b>1,588,560,643</b>	<b>100%</b>	<b>5,747,739</b>
212	Ndertime e Konstruksione	164,148,281	164,227,168	10%	-78,887
214	Instalime teknike,makineri,paisje,vegla pune	13,949,163	17,093,936	1%	-3,144,773
218	Inventar ekonomik	1,416,210,938	1,407,239,539	89%	8,971,399
219	Amortizimi aktiv.Qendr.te trupezuara(-)	-61,347,110	-40,758,842		

Nga verifikimi I normave të amortizimit të aplikuar rezultoi se normat e amortizimit janë bërë sipas ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” (neni 22).

Nisur ng apesha specifike ndaj totalit të AQT-ve, grupi i auditimit vendosi të përziejdh për të verifikuar llogarinë 218 “Inventar Ekonomik” në shumën 1,416,210 mijë lekë, si përfaqësuese e zërit “AQT”, vlera e të cilit është rakorduar me vlerën e dalë pas inventarizimit fizik të kryer, reflektuar në relacionin e komisioni i inventarizimit. Nga auditimi rezultoi se ky proces është kryer në përputhje me kërkesat e Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për inventarizimin e aktiveve”, i ndryshuar, për të dhënë pohimet mbi:

- Ekzistencën
- Plotësinë;
- Saktësinë
- Paraqitjes dhe
- Klasifikimit të AQT-ve

Për sa më sipër jemi mbështetur në raportet e inventarizimit.

### Aktivitet Qarkulluese

Më 31.12.2017 Aktivitet Qarkulluese të MHK rezultuan në masën 42,440 mijë lekë, të shpërndara në masën 42% “Inventare”, 53% “Kërkesa Arkëtimi mbi Debitorët”, dhe rreth 5% “Llogari Financiare”.

		VITI 2017	VITI 2016	PESHA	NDRYSHIMI
<b>B</b>	<b>AKTIVE QARKULLUESE</b>	<b>42,439,923</b>	<b>27,996,304</b>	<b>100%</b>	
<b>Klasa 3</b>	<b>I.Gjendja e Inventarit</b>	<b>17,865,122</b>	<b>17,989,539</b>	<b>42%</b>	<b>-124,417</b>
31	Materiale	2,466,324	1,928,880		537,444
32	Objekte inventari	13,566,854	14,149,253		(582,399)
35	Mallra	1,831,944	1,911,406		(79,462)
<b>Klasa 4</b>	<b>II.Kerkesa arketimi mbi Debitorët</b>	<b>22,619,604</b>	<b>8,247,752</b>	<b>53%</b>	<b>14,371,852</b>
411-418	Kliente e llogari te ngjashme/gjendja tek biletaria	125,460	128,620		(3,160)
4342	Te tjera operacione me shtetin(debitor)	3,838,167	4,944,155		(1,105,988)
45	Mardh. instit.brenda dhe jasht sistemit Ikona IMK	18,632,000	3,151,000		15,481,000
468	Debitorë te ndryshem	23,977	23,977		-
<b>50,59</b>	<b>III.Llogarite financiare</b>	<b>1,955,197</b>	<b>1,759,013</b>	<b>5%</b>	<b>196,184</b>



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Muzeun Historik Kombëtar

520	Disponibilitete ne thesar llog. 466	983,299	787,115		196,184
531	Llogari ne arke / monedha metalike	6,898	6,898		-
532	Vlera te tjera/ biletat	965,000	965,000		-

Nga auditimi i klasës 3 “Gjendje e inventarit”, nga auditimi rezultoi se ky zë për vitin 2017 ka zënë rreth 42% të inventarit (në shumën 17,865 mijë lekë), ose 124 mijë lekë më pak, në krahasim me vitin 2016. Nga këto, me rritje për vitin 2017 rezultojnë vetëm materialet (llog. 31) në shumën 2,466 mijë lekë (ose 537 mijë lekë më shumë), e cila përbëhet nga materiale zyre, kancelari, materiale pastrimi, elektrike, etj të ngjashme, të cilat me hollësisht do të trajtohen sipas urdhërshpenzimeve të përzgjedhura për auditim, në pikën respektive të këtij projektraporti. Nga auditimi i këtij zëri u konstatua se përgjithësisht regjistrimet kontabël ajnë bërë në përputhje me

Nga klasa 4, zgjodhëm si përfaqësuese e popullatës me rreth 53% ndaj total Aktiveve Qarkulluese, llogarinë 45 “Marrëdhënie institucioni brenda dhe jashtë sistemit” në shumën 18,632 mijë lekë duke konsideruar gjatshu materialitetin cilësor për nga vetë rëndësia që këto aktive kanë – konkretisht ikona, objekte të trashëgimisë kulturore.

Mbështetur në Urdhrin e brendshëm nr. 854, datë 27.10.2017 dhe procesverbalit të vlerësimit është bërë hyrje në llogarinë 45 (klasa 4) vlera prej 17,450 mijë lekë (me kundërparti llogarinë 218 si dalje nga aktivet për të njëjtën vlerë). Po njëjloj është vepruar për vlerën 2,329,000 lekë e cila ka prekur llogaritë 45 dhe 218 për të njëjtën vlerë që konsiston në ikona të kthyera nga IMK. Procesi i zhvendosjes së ikonave është trajtuar më hollësisht në pikën përkatëse të materialit në vazhdim.

### PËR VITIN 2018

Në kushtet kur verifikuam edhe rezultatet e inventarizimit të kryer për vitin 2017, na rezultoi se, aktivet e qëndrueshme, të pasqyruara në pasqyrat financiare **plotësojnë pohimet** si më poshtë:

- **Ekzistencës** - konfirmuar nga grupet e inventarizimit
- **Saktësia** - vlera fizike ka rakorduar me vlerën kontabël
- **Paraqitja** – Aktivet janë paraqitur të grupuara sipas kërkesave të kuadrit ligjor dhe rregullativ, por nga pikëpamja e kuptueshmërisë ofrojnë pak për audituesin e jashtëm si dhe për përdoruesit e pasqyrave financiare. Për shembull, nëse inventarizimi kryhet sipas: pavijoneve; fondeve; zyrave’ magazinës; dhe bibliotekës, vlerësojmë se Sektori I Financës duhet që edhe regjistrin e Aktiveve ta ndërtojë në mënyrë të tillë që t’i përshtatet këtij grupimi, me qëllim lehtësimin e leximit të informacionit nga përdoruesit e pasqyrave financiare, menaxhimit si dhe auditeusve të jashtëm e të brendshëm.

Dhe për vitin 2018 aktivet e qëndrueshme **nuk plotësojnë** pohimin e:

- **Klasifikimi** – asetet nuk janë regjistruar në llogaritë përkatëse (rasti I rampave për invalidët)
- **Plotësisë** – të gjitha aktivet që duhet të ishin regjistruar nuk janë regjistruar (sistemi elektronik I biletarise në shumën 1,222,392 lekë. Konkretisht, konstatuam se, sistemi elektronik I biletarise, edhe pse “de facto” operon në ambjentet e Muzeut dhe është aktiv që prej datës 27.07.2018, ai nuk është marrë në dorëzim nga asnjë komision, në kundërshtim me sa dikton Udhezimi nr. 30, date 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit public”, I ndryshuar, ku parashikohet se, “Titullari i njesise



miraton urdherin për ngritjen e komisionit për marrjen në dorezim të aktiveve të furnizuara për sasinë, cilësinë, llojin, plotësinë e tyre dhe të dokumentacionit shoqerues<sup>49</sup>. Komisioni përbëhet nga specialistë të fushës sipas llojit të aktiveve dhe, në rast nevojë, edhe nga ekspertë të jashtëm. Në komision bëjnë pjesë jo më pak se tre veta, duke përfshirë edhe punonjësin me përgjegjësi materiale<sup>50</sup>. Si pasojë e sa më sipër, **Spektori** i Financës nuk ka bërë regjistrimin e në librat e kontabilitetit dhe kartelat e aktiveve, jo më vonë se dita e nesërme e paraqitjes së tyre, sikundër parashikohet në pikën 60 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011. Në fund të çdo muaji dokumentat e regjistruar duhet të vendosen në dosjen përkatëse.

### PASIVI I BILANCIT KONTABËL

Nag auditimi u konstatua se, Pasivi i Bilancit kontabël është i kuadruar me Aktivin e PF. “Detyrime afatshkurtër” (Klasa 4) pasqyrohen në bilanc Formatin nr. 2 për vlerën 1,575,304 mijë lekë.

Në mijë lekë

Nr.	EMERTIMI I LLOGARIVE		
llog.	TË PASIVIT	Viti 2017	Viti 2016
<b>10</b>	<b>I. Fonde të veta</b>	<b>1,550,480</b>	<b>1,565,404</b>
101	Fonde baze	1,550,480	1,565,404
<b>B</b>	<b>DETYRIME</b>		
<b>Klasa 4</b>	<b>II.Detyrime afatshkurtër</b>	<b>23,544</b>	<b>9,192</b>
<b>419</b>	Kreditore, parapagese pjesore (eagle)	39	1,151
401-408	Furnitore e llogari të lidhura me to	466	476
42	Personeli e llogari të lidhura me to	2,338	2,324
431	Detyrime ndaj Shtetit për tatim-taksa dhe sig. shoq.	192	182
4341	Te tjera operacione me shtetin(kreditor)	24	24
435	Sigurime shoqërore	707	703
436	Sigurime shëndetsore		
437	Organizma të tjerë shoqërore	18,632	3,151
	Marrëdhnie jashtë sistemit	7	7
466	Kreditore për mjete në ruajtje	794	787
467	Kreditore tëndryshëm( kreditor për investime)	346	387
<b>C</b>	<b>LLOGARI TË TJERA</b>	<b>1,090</b>	<b>1,094</b>
	Te ardhura për tu regjistruar në vitet pasardhës	1,090	1,094
<b>85</b>	<b>REZULTATI I USHTRIMIT</b>	<b>190</b>	
	<b>TOTALI I PASIVIT</b>	<b>1,575,304</b>	<b>1,575,689</b>

### b. Auditimi i të ardhurave dhe shpenzimeve

#### Shpenzimet e ushtrimit 2017 (Formati 3/1)

-**Formati nr. 3/1 “Shpenzime të ushtrimit”**, nga auditimi rezultoi se formulat e miratuara nga Ministria e Financave ishin zbatuar. Janë kryer veprimet përkatëse si llogaria 85 e formatit nr. 3/1 e barabartë me llog. 85 në pasiv të bilancit kontabël. Ndryshimi i gjendjes në formatin nr. 3/1 ishte e barabartë me diferencën e klasës 3 në aktiv të bilancit, si dhe llogaritë 8423 e paraqitur në formatin nr. 3/1.

<sup>49</sup> Pika 42 e Udhëzimit

<sup>50</sup> Pika 43 e Udhëzimit



Nga auditimi u konstatua se Nëpunësi zbatues rakordon me strukturën përgjegjëse për thesarin deri në datën 5 të çdo muaji, mbi shpenzimet mujore/progresive që ka kryer njësia e qeverisjes së përgjithshme, në bazë të formatit të raportit të përcaktuar nga struktura përgjegjëse për thesarin. Nga grupi i auditimit u bë rakordimi i shpenzimeve të pasqyrës 3/1 me thesarin ku konstatohet: Vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare formati nr. 3/1 përputhen me vlerat e paraqitura në akt rakordimit me degën e thesarit Tiranë. “Mallra dhe shërbime të tjera” sipas bilancit paraqiten në vlerën 18,309,022 lekë, ndërsa sipas akt rakordimit me degën e thesarit vlera e tyre është 17,804,714 lekë, ku diferenca prej **504,308 lekë** është diferenca midis detyrimeve të institucionit ndaj operatoreve ekonomike për shërbimet e kryera nga ana e tyre për llogari të MHK, sipas kontratave të nënshkruara, por ende të pa likuiduara deri në mbylljen e bilancit të veprimtarisë të tilla si për shërbimet për energji elektrike, ujë, telefoni, etj, ku për Dhjetor 2016 janë paguar në Janar 2017 dhe për Dhjetor 2017 do të paguhet me fondet buxhetore të 2018 . Kjo diferencë rakordon me shumën e llogarive 419 “Klientë parapagesa vjetore”, në shumën 38,688 lekë dhe llogarinë 401-408 “Furnitore dhe llogarë të lidhura me to” në shumën 465,620 lekë.

Paga, shpërblime e të tjera personeli sipas bilancit paraqiten në vlerën 37,479,286 lekë, ndërsa sipas akt rakordimit me degën e thesarit vlera e tyre është 34,949,315 lekë, ku diferenca prej 2,529,971 lekë vjen si rezultat i diferencës së pagës dhe tatimit mbi të, për dhjetor 2017 me atë të dhjetor 2016. Sa më sipër rakordon më shumën e paraqitur në pasivin e bilancit kontabël mes llogarisë 42 “Personeli dhe llogari të lidhura me to” në shumën 2,338,441 lekë dhe llogarisë 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa” në shumën 191,530 lekë

Në thesar në muajin janar të vitit 2017 kanë kaluar pagat e dhjetor 2016, ndërsa në pasqyrën 3/1 vlera e “Paga, shpërblime e të tjera personeli” është totali për periudhën Janar-Dhjetor 2017, ku vlera e pagave Dhjetor 2017 kalon në thesar në janar të 2018. E njëjti fenomen ndodh dhe me llogarinë 601 “Kontrib.te sig.shoq.e shëndets”.

Nr. Llog	Shpenzimet e ushtrimit	Pasqyrat financiare	Rakordimi me thesarin	Diferenca
60	I. Shpenzime Korrente	127,204,556	126,623,442	581,114
600	Paga, shpërblime e të tjera personeli	97,440,531	97,041,653	398,878
601	Kontrib.te sig.shoq.e shëndets.	13,085,558	12,925,327	160,231
602	Mallra dhe shërbime të tjera	16,438,467	16,416,462	22,005
605	Transferta korentë me jashtë	0	0	0
606	Transferta për buxh. familjare e individë	240,000	240,000	0

### ***Mbi auditimin e shpenzimeve për vitin 2018 (12-mujori)***

Në pasqyrën e shpenzimeve të ushtrimit, për periudhën 01.01.2018-31.12.2018, janë të pasqyruara shpenzimet korrente të konstatuara të ndara sipas zërave:

- ✓ Llog.(600) “Paga, shpërblime e të tjera shpenzime personeli” në vlerën 34,796 mijë lekë ose 70% të totalit të shpenzimeve, ku përfshihen shpenzimet për pagat e personelit të përhershëm dhe të përkohshëm de kontributet për sigurime shoqërore dhe shëndetsore;
- ✓ Llog. (602) “Mallra dhe Shërbime” në vlerën 14,072 mijë lekë ose 28 % të totalit të shpenzimeve



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Muzeun Historik Kombëtar

Nga analiza e shpenzimeve operative sipas muajve rezultoi se, rreth 19% e shpenzimeve operative janë kryer në muajin dhjetor; 24% në muajt tetor dhe nëntor, duke bërë kështu që rreth 43% e total shpenzimeve operative të kryehen në tre mujorin e fundit të vitit:

**Tabela: Ecuria e shpenzimeve operative sipas muajve, viti 2018**

Muaji / 2018	Shpenzime llog. 602	Pesha
Janar	570,620	4%
Shkurt	970,474	7%
Mars	1,676,381	12%
Prill	851,415	6%
Maj	411,745	3%
Qeshor	648,251	5%
Korrik	1,125,683	8%
Gusht	1,154,547	8%
Shtator	635,121	5%
Tetor	1,638,148	12%
Nentor	1,757,436	12%
Dhjetor	2,632,900	19%
<b>Total</b>	<b>14,072,721</b>	<b>100%</b>

Përgatiti: Grupi I auditimit të KLSH

Nga auditimi I shpenzimeve operative u konstatua se, ato përfshijnë në masën 64 % (ose 946 mijë lekë me shumë se viti 2016) “Shërbime” në shumën 9,026,117 lekë, të cilat përbëhen nga shpenzime për energjinë elektrike në masën 1,842 mijë (ose 13% ndaj totalit të artikullit 6022); si dhe shpenzime për shërbimin e rojeve 6,237 mijë lekë (ose 44% ndaj totalit të artikullit 6022). Ndërsa llogaria 6021 “Materiale shërbime speciale” në shumën 2,585,840 lekë (ose rreth 20% të total shpenzimeve operative) përbëhet nga shpenzime për material trajnimi, bileta elektronike , material për ekzpozita etj. Sa më sipër, e detajuar në tabelën në vijim:

*në lekë*

Artikulli	Emertimi	Fakti 2016	Fakti 2017	Fakti 2018	Pesha 2018	Ndryshimi %	Ndryshimi (lekë)
<b>602</b>	<b>Total - Mallra, shërbime</b>	<b>18,309,022</b>	<b>13,447,990</b>	<b>14,072,721</b>	<b>100%</b>	<b>5%</b>	<b>624,731</b>
6020	Materiale e shërbime	677,756	806,677	1,459,222	10%	81%	652,545
6021	Materiale shërbime speciale	760,310	1,369,528	2,858,840	20%	109%	1,489,312
6022	Sherbime	13,679,776	8,080,102	9,026,117	64%	12%	946,015
6023	Shpenzime transporti	234,891	169,024	179,999	1%	6%	10,975
6024	Shpenzime udhëtimi	667,149	156,789	284,193	2%	81%	127,404
6025	Mirembajtje të zakonshme	495,266	533,600	216,000	2%	-60%	(317,600)
6027	Vendime gjyqsore	1,106,520	2,332,270		0%	-100%	(2,332,270)
6029	Te tjera (taksa)			48,350	0%	!	48,350

Në zërin “Mirëmbajtje të zakonshme” për vitin 2018 u përfshihen shpenzimet për dezinfektimin e pavijoneve, sipas kërkesave që burojnë nga *Rregullorja e Brendshme për Organizimin dhe Funkionimin e MHK-së*. Në fakt rezultoi se i njëjti lloj shpenzime nuk ishte kontabilizuar në të njëjtin artikull nga njëri vit në tjetrin si vijon:

Llogaria	Emertimi sipas Planit Kontabel	Viti 2017	Viti 2018
6025200	Shpenzime për mirembajtjen e objekteve specifike – Dezinfektimi vetëm	-	216,000
6022099	Sherbime të tjera – edhe dezinfektimi	229,200	235,200

Vihet re ndryshim i llogarive kontabël ku është regjistruar ky shpenzim, nga njëri vit në tjetrin, konkretisht në vitin 2017, shpenzimet për dezinfektim në shumën 229,200 lekë janë kontabilizuar në llogarinë 6022099, ndërkohë që gjatë vitit 2018, kjo llogari ka kontabilizuar shpenzimet për shërbimin e transportit të materialeve për ekzpozita në shumën 235,200 lekë,



ndërsa shpenzimet e dezinfektimit paraqiten në një llogari të re që është 6025200. Paraqitja e të njëjtit tip shpenzimi në llogari të ndryshme nga njëri vit në tjetrin, por edhe reflektimi në të njëjtën llogari i dy llojeve të ndryshme shpenzime, nga njëri vit ushtrimor në tjetrin, cënon parimin e qendrueshmërisë dhe krahasueshmërisë së pasqyrave financiare i cili kërkon që, për përgatitjen e pasqyrave financiare të përdoren vazhdimisht të njëjtat politika kontabël, e njëjta paraqitje dhe të njëjtat formate të pasqyrave financiare. Informacioni që paraqitet në pasqyra përbën bazën për krahasimin e të dhënave financiare. Sa më sipër është vecanërisht i nevojshëm për një krahasim objektiv të të dhënave të treguesve të performancës financiare të njësisë. Sektori i Financës të marrë masa që në asnjë rast në vijim të mos ndryshojë llogaritë ekonomike, nëse lloji i shpenzimit nuk ndryshon. Sa më sipër në respekt të parimit të qëndrueshmërisë dhe krahasueshmërisë së pasqyrave financiare, për qëllime krahasimi objektiv të të dhënave të treguesve të performancës financiare të njësisë por edhe për qëllime të buxhetimeve reale. Për shpenzimet e dezinfektimit, të vijohet me kontabilizimin në llogarinë 6025200, sikundër është bërë përgjatë vitit 2018, por ky ndryshim dhe të tjerë nëse do të rezultojnë, të trajtohet në relacionin shpjegues të pasqyrave financiare të vitit ushtrimor 2018,

**Në pasqyrën e të ardhurave të ushtrimit** për vitin 2017 formati nr. 3/2 janë pasqyruar llog. 720 financimi nga buxheti i shtetit për vitin 2017 (*grant korrent i brendshëm*) në shumën 54,457 mijë lekë, ku financimi i pritshëm nga buxheti i shtetit për vitin 2018 paraqitet në vlerën 3,840 mijë lekë. Të ardhurat jo tatimore janë pasqyruar në bilanc në formatin 3/2 në vlerën 8,812 mijë lekë, e cila është rakorduar dhe sipas aktit të rakordimit me Degën e Thesarit Tiranë.

Në lekë

Viti 2017	Arketuar	Pjesa e Institucionit	Rritja e autorizuar	Derdhur ne buxhet
Qera salle	1,867,000	560,100	418,500	1,448,500
Pika e shitjes	551,342	165,402	141,211	410,131
Bileta	6,391,622	1,917,486	1,440,289	4,951,333
Sponsorizime	541,936	541,936	541,936	-
korrigjime	17,000	17,000		17,000
te tjera	2,000	600		2,000
Grante	2,004,292	2,004,292	2,004,292	-
<b>Total</b>	<b>11,375,192</b>	<b>5,206,816</b>	<b>4,546,228</b>	<b>6,828,964</b>

Sic edhe vihet re nga tabela sipas aktrakordimit me Thesarin, për vitin 2017 Ministria i ka miratuar MHK-së rreth 661mijë lekë më pak nga sa i lejon limiti maksimal prej 30% e shumës së siguruar nga të ardhurat dytësore<sup>51</sup>, sipas VKM nr. 432, datë 28.06.2006 "Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave që krijojnë institucionet buxhetore"

**Në pasqyrën e të ardhurave të ushtrimit** për vitin 2018 sipas aktrakrodimeve me Thesarin, të ardhurat dytësore janë reziluzr në masën 13,142 mijë lekë ose rritur me 15,5% (ose 1,767 mijë lekë më shumë se një vit më parë). Këto të ardhura janë realizuar në masën 66% nga shitja e biletave për të vizituar muzeun, 30% nga qeratë e sallave, dhe 4% nga pika e shitjes në muze, si në tabelën e mëposhtme:

Në lekë

<sup>51</sup> (viti 2017) Bëhet fjalë për të ardhurat nga qeratë e sallës, pika e shitjes dhe biletaria, të cilat janë autorizuar nga MK për tu përdorur nga Muzeu në masat respektivisht 22%, 25% dhe 23%.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në "Muzeun Historik Kombëtar"

Viti 2018	Arketuar	Pjesa e Institucionit	Rritja e autorizuar	Derdhur ne buxhet
Qera salle	3,930,000	765,900	765,900	3,164,100
Pika e shitjes	476,972	104,259	104,259	372,713
Bileta	8,723,580	1,729,841	1,729,841	6,993,739
Shitje librash	3,900		-	3,900
te tjera	8,030		-	8,030
<b>Total</b>	<b>13,142,482</b>	<b>2,600,000</b>	<b>2,600,000</b>	<b>10,542,482</b>

*Sic edhe vihet re nga tabela sipas aktrakordimit me Thesarin, për vitin 2018 Ministria i ka miratuar MHK-së rreth 1,339 mijë lekë më pak nga sa i lejon limiti maksimal prej 30% e shumës së siguruar nga të ardhurat detyësore<sup>52</sup>, sipas VKM nr. 432, datë 28.06.2006 "Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave që krijojnë institucionet buxhetore"*

**-Formati nr. 4 "Burimet dhe shpenzimet për investime 2017"**. Nga auditimi rezulton se Zëri "Shpenzime për rritjen e AQ" formati 4/e e plotësuar për shumën 27,605,889 lekë, në analizë rakordon me të njëjtën vlerë në pasqyrën "gjendja dhe ndryshimet e aktiveve të qëndrueshme" kolona e tretë "shtesa pa pagesë brenda sistemit" formati 6. Totali i shtesave të krijuara pa pagesë është i barabartë me burimet dhe shpenzimet lidhur me investimet në formatin 6.

- **Formati nr. 9 "Numri i punonjësve dhe fondi i pagave"**, në përfundim të auditimit rezultoi se totali i shpenzimeve për pagat e personelit të përhershëm dhe të përkohshëm, të pasqyruar në formatin nr. 3/1, në postet përkatëse përputhej me atë të paraqitur në formatin nr. 9.

#### **d. Auditimi i pasqyrës së fluksit të mjeteve monetare (Formati nr. 5)**

**Formati nr. 5 "Pasqyrë e lëvizjes në CASH"** në përfundim të auditimit rezultoi që të dhënat për disponibilitetin në thesar përkojnë me situacionet faktike të pagesave dhe arketimeve të rakorduar për vitin 2017, dokumente të cilat janë bashkëlidhur edhe bilancit kontabël.

Formati ka të plotësuar edhe kontrollin sipas formulës së miratuar nga Ministria e Financave, ku llogaria 520 "Disponibilitete në thesar" dhe llogaria 512 "llogari në bankë" në çelje formati nr. 5 barabartë sa paraqit bilanci. Gjithashtu nga auditimi rezultoi se edhe totali i derdhjeve në buxhet (pasqyra e lëvizjes në "CASH", formati nr. 5 të ardhura jo tatimore në "CASH") ishte i barabartë me shumën e rubrikave përkatëse të derdhjeve në buxhet, të pasqyruar në akt rakordimin me Degën e Thesarit Tiranë, të pasqyruar në formatin nr. 3/2.

Në mbyllje të vitit ushtrimor, debia e llogarisë 520 "Disponibilitete në thesar" në Aktivin e Bilancit Kontabël të MHK-së, në shumën 983,299 lekë përfaqëson vlerën e mjeteve në ruajtje në kredi të llogarisë 466 në po të njëjtën shumë.

Nr.	EMERTIMI	Disponibilitet ne Thesar	
		Debi	Kredi
1	I.TEPRICA NE CELJE TE USHTRIMIT	787,115	
2	II.ARKETIMET E VITIT "CASH"	65,880,086	-
3	1. Fonde nga buxheti	54,456,774	
4	- Fonde buxhetore korente (Plani me ndryshimet)	54,456,774	
6	2. Te ardhura e te hyra gjate vitit ne "Cash"	11,423,312	-

<sup>52</sup> (viti 2018) Bëhet fjalë për të ardhurat nga qeratë e sallës, pika e shitjes dhe biletaria, të cilat janë autorizuar nga MK për tu përdorur nga Muzeu në masat respektivisht 19%, 22% dhe 20%.



## KONTROLLI I LARTË I SHITIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në "Muzeun Historik Kombëtar

7	- Te ardhura tatimore ne "Cash"	8,811,964	
11	- Sponsorizime, grante e te ardhura te tjera "Cash"	2,563,228	
13	- Te hyra nga mjetet ne ruajtje "Cash"	48,120	
<b>14</b>	<b>III.PAGESAT E VITIT "CASH"</b>	<b>0</b>	<b>58,703,135</b>
15	1, Pagesa nga buxheti per shpenzime korente		54,304,971
17	3, Pagesa nga te ardhurat per shpenzime korente		4,356,724
19	5, Pagesa nga mjetet ne ruajtje		41,440
<b>21</b>	<b>IV. TRANSFERTA</b>	<b>0</b>	<b>6,980,767</b>
22	1, Derdhe te ardhurave buxhet		6,828,964
23	2, Autorizime buxhetore te pa perdorura(korente dhe kapitale)		151,803
24	3, Levizje te brendshme e transferata te tjera(diferenca limiti ardhur-planiMK		
<b>25</b>	<b>V. SHUMA E LEVIZJEVE ( I deri IV )</b>	<b>66,667,201</b>	<b>65,683,902</b>
<b>26</b>	<b>VI. TEPRICA NE MBYLLJE TE USHTRIMIT</b>	<b>983,299</b>	

#### Pasqyra e lëvizjes së fondeve (pasqyra 8), ka të pasqyruar:

Tepricën në celjen e vitit ushtrimor, llog. 101 "Fonde bazë" në shumën 1,565,403,565 lekë e pasqyruar edhe në pasivin e bilancit llog. 101 "Fonde bazë" si Tepricë në mbyllje të vitit paraardhës

Teprica në fund e llog. 101, është e njëjtë me tepricën e saj në pasiv të bilancit kontabël, pasqyra nr. 2 është në vlerën 1,550,480,059 lekë.

Në lëvizjet gjatë periudhës ushtrimore në debi dhe kredi të kësaj llogarie rezultojë se :

- Vlera prej 0 lekë "Pakesime te fondeve baze" që nuk përputhet me Llogarin 63 "Ndryshim i gjendjeve të inventarit", evidentuar në Formatin nr. 3/1, për 124,417 lekë ne fund të vitit 2017,
- vlera prej 24,662,124 lekë "Konsumi i aktiveve te qendrushme"përputhet me amortizimin vjetor te aktiveve te qendrushme nëpasqyrën e amortizimit të bilancit në formatin nr. 7,
- vlera prej 17,810,860 lekë "Pakesim nga nxjerrja jashtë përdorimit" përputhen me vlerën e aktiveve të dala jashtë përdorimit sipas formatit nr. 6 "Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve të qëndrueshme", e cila është 3,831,798 lekë dhe "Pakesime të tjera" në shumën 18,052,918 lekë si dhe shumën e amortizimit të tyre prej 4,073,856 lekë.
- Vlera prej 27,549,478 lekë " Shtesë fondi bazë" përputhet me llogarinë 218 "Inventar ekonomik" shtesë pa pagesë e pasqyruar në formatin nr. 6 "Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve të qëndrueshme".

Pasqyra e e lëvizjes së fondeve 2017

Në lekë

Nr.llog.	E M E R T I M I	Levizjet per periudhen			Teprica mbyllje
		Teprice celje	Debi	Kredi	
<i>b</i>	<i>c</i>	<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4=1+3-2</i>
<b>101</b>	<b>FONDE BAZE</b>	<b>1,565,403,565</b>	<b>42,472,984</b>	<b>2,972,388</b>	<b>1,550,480,059</b>
1,010	Fondi baze gjendje	1,565,403,565			1,565,403,565
1,011	Shtesa fondi baze			27,549,578	27,549,578
1012	Pakesime te fondit baze				
1013	Pekesim nga konsumi i aktiveve qendrushshme		24,662,124		(24,662,124)
1014	Pakesim nga shitja e aktiveve te qendrushme				0
1015	Pakesim nga nxjerrja jasht perdorimit e AQ		17,810,860		(17,810,860 )
1016	Pekesim nga transfertat e AQ		0		0
<b>109</b>	<b>DIFERENCA RIVLERSIMI AQ</b>				<b>0</b>
	<b>FONDI I BRENDESEM</b>	<b>0</b>	<b>189,504</b>		<b>189,504</b>
105	Grante brendeshme kapitale				<b>0</b>
107	Vlera te caktuara ne perdorim				<b>0</b>
11	Fonde te tjera veta / ndryshim gjendje				<b>0</b>



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Muzeun Historik Kombëtar

12	Rezultat I mbartur				0
13	Subveçione jashtzakoneshme				0
145	Grante brendsh.kapitale per investime per trete				0
15	Shuma te parashikuara rreziqe e shpenzime				0
85	Rezultati I ushtrimit (amortizim transferim kapitali)			189,504	189,504
<b>106</b>	<b>FONDI I JASHEM</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	
106	Grante te Huaja Kapitale				
146	Grante huaja.kapitale per investime per trete				0
	<b>FONDI I KONSOLIDUAR ( 1 deri 4)</b>	<b>130,573,359</b>	<b>7,490,050</b>	<b>2,972,388</b>	<b>126,055,697</b>

**Formati “Pyetësor dhe shënime shpjeguese”:** është plotësuar relacioni shpjegues për pasqyrat financiare dhe janë përfshirë informacionet shpjeguese që kërkohen, në pajtim me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar ku jepen informacionet shpjeguese të nevojshme për të arritur paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare. Dhënia e shënimeve shpjeguese të pasqyrave financiare vjetore nga MHK është bërë sipas formatit të miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, të emërtuar: “Pyetësor dhe shënime shpjeguese për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore”,

#### **Rakordimet e pasqyrave të bilancit financiar:**

*Auditimi u bë me të zgjedhur për këto llogari, formate e pasqyra financiare:*

- Auditimi për barazimin e vlerës totale të Pasivit me Aktivin:

- *Totali i aktiveve është i barabartë me totalin e pasiveve të bilancit kontabël (formatet 1 dhe 2), në shumën 1,575,402,625 lekë.*

Në pasiv të bilancit janë paraqitur A/I “fondet e veta” të institucionit që arrijnë në vlerën 1,550,480,059 lekë, e cila konfirmohet si diferencë ndërmjet vlerës së aktivitetit të bilancit 1,575,402,625 lekë dhe grupeve B “detyrimeve” dhe C “llogari të tjera” të pasivit në vlerën 24,733,062 leke,; diferenca paraqitet në llogarinë 85 si saldo kreditore, në shumën 189,504 lekë.

- Totali në pasqyrën e shpenzimeve është i barabartë me totalin në pasqyrën e të ardhurave të funksionimit (formatet 3/1 e 3/2), në shumën 69,795,980 lekë.

Llogaria 85 “Rezultati i veprimtarisë nga funksioni” në Formatin nr. 3/1 “Shpenzime të ushtrimit” është e barabartë me llogarinë 85 “Rezultati i ushtrimit” në Pasivin e bilancit kontabël. Rezultati është 189,504 lekë.

- Llogaria 63 “Ndryshim i gjendjeve të inventarit”, evidentuar në Formatin nr. 3/1, për 124,417 lekë në fund të vitit 2017, rakordon me ndryshimin e gjendjes të magazinës dhe është sa diferenca e klasës 3 “Gjendja e inventarit” (kolona nr. 28) në aktivin e bilancit.

**Në përfundim të konstatimeve nga auditimi i llogarive vjetore të administratës së Muzeut Historik Kombëtar, po paraqesim gjetjet dhe rekomandimet si më poshtë:**

<b>Titulli i Gjetjes 1:</b>	<b>Ndryshimi i llogarisë kontabël nga njëri vit në tjetrin</b>
<b>Situata</b>	Nga auditimi i llogarive vjetore të Muzeut Historik Kombëtar, rezultoi se në vitin 2017, shpenzimet për dezinfektim në shumën 229,200 lekë janë kontabilizuar në llogarinë 6022099, ndërkohë që gjatë vitit 2018, kjo llogari ka regjistruar shpenzimet për shërbimin e transportit të materialeve për ekspozita në shumën 235,200 lekë, ndërsa shpenzimet e dezinfektimit paraqiten në një llogari të re që është 6025200. Edhe



	<p>pse është një rast i vetëm, paraqitja e të njëjtit tip shpenzimi, nga njëri vit në tjetrin, në llogari të ndryshme, cenon parimin e qëndrueshmërisë dhe krahasues së pasqyrave financiare, i cili kërkon që për përgatitjen e pasqyrave financiare të përdoren vazhdimisht të njëjtat politika kontabël, e njëjta paraqitje dhe të njëjtat formate të pasqyrave financiare. Informacioni që paraqitet në pasqyra përbën bazën për krahasimin objektiv të të dhënave të treguesve të performancës financiare të njësisë si dhe i shërben në mënyrë efektive procesit të vendimmarrjes.</p>
<b>Kriteri:</b>	Parimi i qëndrueshmërisë dhe krahasueshmërisë së pasqyrave financiare
<b>Ndikimi/Efekti</b>	Informacioni që paraqitet në pasqyra përbën bazën për krahasimin e të dhënave fiannciare, që është vecanërisht i nevojshëm për një krahasim objektiv të të dhënave të treguesve të përformancës financiare të njësisë
<b>Shkaku:</b>	Mosrespektimi i parimeve të qëndrueshmërisë dhe krahasueshmërisë
<b>Rëndësia:</b>	E ulët
<b>Rekomandime:</b>	Spektori i Financës, në respekt të parimit të qëndrueshmërisë dhe krahasueshmërisë së pasqyrave financiare, të marrë masa që në asnjë rast të mos ndryshojë llogaritë ekonomike, nëse lloji i shpenzimit nuk ndryshon. Për shpenzimet e dezinfektimit, të vijohet me kontabilizimin në llogarinë 6025200, sikundër është bërë përgjatë vitit 2018, por ky ndryshim dhe ndryshime të tjera nëse do të rezultojnë, të trajtohen në relacionet shpjeguese të pasqyrave financiare të vitit ushtrimor 2018.
<b>Afati për zbatim:</b>	<b>Në vazhdim</b>

## 6. PROKURIMET E FONDEVE PUBLIKE

### a. Mbi zbatimin e legjislacionit për realizimin e procedurave të prokurimit publik për vitin 2017, si dhe lidhja dhe zbatimi i kontratave deri më marrjen në dorëzim të mallrave, punëve dhe shërbimeve

*Nga auditimi mbi zbatimin e ligjshmërisë në procedurat e prokurimit publik, si dhe lidhjen dhe zbatimin e kontratave, deri në marrje në dorëzim të mallrave, punëve dhe shërbimeve për vitin 2017, ka rezultuar si më poshtë:*

Në regjistrin e realizimit të procedurave të prokurimeve publike për vitin 2017 janë pasqyruar se me burim financiar buxhetin e shtetit janë realizuar 42 procedura prokurimi publik, 1 procedurë është prokuruar nga donacion dhe 8 procedura janë financuar nga fondet e BE-së. Vlerat në total janë pasqyruar si në tabelën më poshtë.

Burimi Financiar	Totali
------------------	--------



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Muzeun Historik Kombëtar

Buxheti i Shtetit	14,252,292.24 lekë
Donacion	451,613.70 lekë
Fondet e BE	1,945,500 lekë

Me shkresat nr. 993 prot, datë 19.12.2017 Muzeu Historik Kombëtar, ka dërguar në Agjencinë e Prokurimit Publik (APP) regjistrin e parashikimit të prokurimeve publike për vitet 2017 për procedurat e prokurimit të Institucionit qendror dhe institucioneve të varësisë. Sipas tabelës bashkëlidhur, në Muzeun Historik Kombëtar ishte parashikuar të kryheshin tendera me procedure të hapura, kërkesë për propozim dhe blerje me vlera të vogla. Me shkresën nr.25/1 prot, datë 30.01.2015 Prokuroria e Përgjithshme ka dërguar në APP regjistrin e realizimit të prokurimeve për vitin 2014, dhe rezultojnë të realizuar:

1- Tenderi me objekt “**Blerje Karburanti**”, REF-38787-12-19-2017 me këto të dhëna:

Të dhëna për tenderin	Komisioni i vlerësimit të ofertave	Njësia e prokurimit ose hartuesit e dokumenteve të tenderit
a	b	c
U.Prokurimi nr.1001 prot, datë 19.12.2017 Fondi limit 92,900 lekë pa tvsh Procedura: Prokurim me vlerë të vogël. Data e zhvillimit të tenderit 21.12.2017 Firma fituese: ..... Data e marrjes së mallit në dorëzim 21.12.2017 Vlera e kontratës: 91,675 lekëpa TVSH Diferenca nga fondi limit 1,225 lekë	S.T, kryetar A.S, anëtar A.LL, anëtar	A.S,(Jurist) S.T, anëtar A.LL , anëtar

#### **Nga auditimi u konstatua se:**

Me kërkesën drejtuar titullarit të MHKNr. 990 Prot., datë 19.12.2017 Përgjegjësi i Sektorit të menaxhimit dhe Shërbimit të Vizitorve ka vënë në dijeni nevojën për blerje naftë për gjeneratorin e institucionit pasi sasia e mbetur ka dispozicion është drejt përfundimit. Në dokument ka parashikuar edhe sasinë e litrave (620 litra) dhe një vlerëçmimi që nuk e shpjegon se ku referohet.

Procesverbali mbi përlllogaritjen e fondit limit, është mbajtur në datën 9.12.2017 nga Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël i krijuar me urdhrin e brendshëm nr.27, datë 24.01.2017 i ndryshuar me urdhrin e brendshëm nr.126, datë 27.02.2017. Gjendet një gabim material në citimin e nenin 59 të vkm nr. 914 datë 29.12.2014, e cila është shënuar neni 5. Pas referimit të të dhënave që ka nxjerrë APP, fondi limit është përlllogaritur në vlerën 92.000 lekë pa tvsh.

Specifikimet teknike janë hartuar sipas formularit tip Nr.3 me shkresën Nr. 1002, datë 19.12.2017. Data e hapjes së ofertave është caktuar 21.12.2017 ora 08:30. Pas hapjes së ofertave nga 4 operator ekonomik është përzgjedhur fituese oferta me marzhin e fitimit 7.5%, që është dhe vlera më e ulët ndër ofertat e tjera. Kjo ofertë nuk plotëson specifikimin teknik se “*raporti i analizës së karburantit para zhdoganimit të jetë e lëshuar jo më parë se 30 ditë nga hapja e ofertave*”, pasi kjo fletë analizë është e datës 28.09.2017, pra është e lëshuar 84 ditë më parë së dita e hapjes së ofertave. Por, referuar analizës malli i prokuruar është brenda parametrave.

Në momentin e marrjes së mallit (tollona) në dorëzim është mbajtur procesverbali me datë 21.12.2017 dhe kanë qenë prezent komisioni i blerje te vogla dhe tre punonjës të tjerë ndër të cilët ka qenë edhe Përgjegjësi i Sektorit të Menaxhimit dhe Shërbimit të Vizitorëve i cili ka bërë edhe kërkesën për blerje naftë për gjeneratorin e institucionit, por nuk është nxjerrë një urdhër i brendshëm nga titullari i institucionit si edhe parashikohet në udhëzimin Nr.30, datë



27.12.2011 “PËR MENAXHIMIN E AKTIVEVE NË NJËSITË E SEKTORIT PUBLIK”, pika 42, për marrjen në dorëzim të aktiveve.

Anëtarët e KVO sipas nenit 58 të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 i ndryshuar, duhet të jenë jo më pak se 3, ku të paktën njëri duhet të jetë ekspert i fushës, onkretisht anëtarët e KVO janë njëri me profesion jurist, njëri arkivist me profesion historian ( cili në eksperiencën e tij ka punuar në kompani karburanti) dhe njëri me profesion teolog. Në këto kushte kemi shkëlqej të vëkëm sipër cituar dhe rrjedhimisht vlerësimi i ofertave nuk është bërë nga persona të specializuar në fushën e hidrokarbureve si edhe përcaktohet specifikisht nga baza ligjore në fuqi. VKM madje krijon dhe hapsirën e kontraktimit të ekspertit të jashtëm në rast se në strukturën e institucionit nuk ka një punonjës tëspecializuar në fushën ku dhe zhvillohet kjo procedurë prokurimi.

2- Tenderi me objekt “**Blerje bileta elektronike**”, REF-25782-09-07-2017 me këto të dhëna:

Të dhëna për tenderin	Komisioni i vlerësimit të ofertave	Njësia e prokurimit ose hartuesit e dokumenteve të tenderit
a	b	c
U.Prokurimi nr.688prot, datë 07.09.2017 Fondi limit83.333 lekë pa tvsh Procedura: Prokurim me vlerë të vogël. Data e zhvillimit të tenderit Firma fituese: procedurë e anuluar	S.T, kryetar A.S, anëtar A.LL, anëtar	A.S (Jurist) S.T, anëtar A.LL , anëtar

### **Nga auditimi u konstatua se:**

Me anë të shkresës Nr. 681 Prot me datë 06.09.2017 ështëkërkuarSektorit të Menaxhimit dhe Shërbimit të Vizitorëve furnizimime 10.500 bileta elektronike për një periudhë 3 mujore, e cila është miratuar nga titullari i institucionit. **Në këtë kërkesë mungon një arsyetim ku të analizohet pse pikërisht është nevojë për këtë sasi dhe jo më shumë apo më pak. Analiza do jepte nje panoramë me të qartë se sa është gjendja në magazinë dhe sa është gjendja e biletave tëpashitura në biletarinë e MHK. Nga komunikimi me subjektin ky lloj bilanci nuk bëhet, madje nuk ka gjurmë të njërakordimi midis magazinës dhe biletarisë. MHK duhet të analizojë në bazë të shitjeve sipas periudhave me fluks vizitorësh edhe nevojën për furnizim me bileta elektronike.**

Në bazë të procesverbalit i mbajtur në datën 06.09.2017 mbajtur nga komisioni për blerjet e vogla është përcaktuar fondi në vlerën 83,333 lekë pa tvsh duke u bazuar nëçmimet e furnizimeve të mëparshme dhe konkretisht çmimet fituese.

Është miratuar nga titullari i MHK urdhri i prokurimit me nr.688, datë 07.09.2017 për blerjen e 10,500 copë bileta elektronike. Me anë të procesverbalit të mbajtur në datën 07.09.2017 është caktuar si person i autorizuar për të kryer veprimet në sistemin e prokurimit elektronik në emër të tyre për procedurën me objekt “Blerje bileta elektronike”.

Nëftësën për ofertëjanë parashikuar edhe specifikimet teknike për ofertat konkurrenente. Pas shpalljes fitues të OE me ofertën me vlerë më të ulët, ky i fundit është tërhequr nga konkurrimi dhe është kaluar tek OE tjetër me ofertë më të ulët i cili edhe ky është tërhequr nga konkurrimi dhe së fundi është kaluar tek konkurrenti i tretë nërradhë por edhe ky është tërhequr nga konkurrimi. Ndaj, kjo procedurëështë anuluar me anë të vendimit me Nr. 716, datë 13.09.2017.



3- Tenderi me objekt “**Blerje bileta elektronike**”, REF-26308-09-13-2017 me këto të dhëna:

Të dhëna për tenderin	Komisioni i vlerësimit të ofertave	Njësia e prokurimit ose hartuesit e dokumenteve të tenderit
a	b	c
U.Prokurimi nr.688prot, datë 07.09.2017 Fondi limit 83.333 lekë pa tvsh Procedura: Prokurim me vlerë të vogël. Data e zhvillimit të tenderit 15.09.2017 Firma fituese: A... Data e marrjes së mallit në dorëzim:18.09.2017 Vlera e kontratës: 82,454 lekë pa TVSH Diferencanga fondi limit:879 lekë pa tvsh Urdhër Shpenzimi: 144, datë 21.09.2017	S.T, kryetar A.S, anëtar A.LL, anëtar	A.S (Jurist) S.T, anëtar A.LL , anëtar

Më pas është rihapur me po të njëjtat të dhëna dhe fond limit, me urdhrin e prokurimit me Nr.718 datë 13.09.2017 dhe në të njëjtën datë procesverbalin për caktimin e nëpunësit të autorizuar të komisionit të prokurimit me vlerë të vogël për kryerjen e veprimeve në sistemin e prokurimit elektronik. Data e zhvillimit është caktuar 15.09.2017 ora 10:30 në adresën [eëe.app.gov.al](http://eëe.app.gov.al). Nga konkurrimi është përzgjedhur oferta me vlerë më të vogël, konkretisht OE A.... me ofertë 82,454 lekë.

4- Tenderi me objekt “**Blerje bileta elektronike**”, REF-26308-04-07-2017 me këto të dhëna:

Të dhëna për tenderin	Komisioni i vlerësimit të ofertave	Njësia e prokurimit ose hartuesit e dokumenteve të tenderit
a	b	c
U.Prokurimi nr.268prot, datë 07.04.2017 Fondi limit83.333 lekë pa tvsh Procedura: Prokurim me vlerë të vogël. Data e zhvillimit të tenderit 11.04.2017 Firma fituese: A... Data e marrjes së mallit në dorëzim 13.04.2017 Vlera e kontratës: 82,454 lekë pa TVSH Diferenca nga fondi limit 879 lekë pa tvsh Urdhër Shpenzimi: 51, datë 19.04.2017	S.T, kryetar A.S, anëtar A.LL, anëtar	A.S (Jurist) S.T, anëtar A.LL , anëtar

#### **Nga auditimi u konstatua se:**

Me anë të shkresës Nr. 263 Prot me datë 05.04.2017 është kërkuar *Sektorit të Menaxhimit dhe Shërbimit të Vizitorëve* furnizimi me 10.500 bileta elektronike për një periudhë 3 mujore, e cila është miratuar nga titullari i institucionit.

Në bazë të procesverbalit i mbajtur në datën 06.04.2017 mbajtur nga komisioni për blerjet e vogla është përcaktuar fondi në vlerën 83,333 lekë pa tvsh duke u bazuar nëçmimet e furnizimeve të mëparshme dhe konkretisht çmimet fituese.

Është miratuar nga titullari i MHK urdhri i prokurimit me nr.268, datë 07.04.2017 për blerjen e 10,500 copë bileta elektronike. Me anë të procesverbalit të mbajtur në datën 07.04.2017 është caktuar si person i autorizuar për të kryer veprimet në sistemin e prokurimit elektronik në emër të tyre për procedurën me objekt “Blerje bileta elektronike”.

Nëftësen për ofertë janë parashikuar edhe specifikimet teknike për ofertat konkurrenente dhe dita e zhvillimit të tenderit në datën 11.04.2017. Pas shpalljes fitues të OE I.... me ofertën me vlerë



më të ulët, ky i fundit është tërhequr nga tenderi dhe më pas është shpallur fitues “AdelCo”. Ky i fundit ka bërë dorëzimin e mallit në datë 13.04.2017.

5- Tenderi me objekt “**Blerje bileta elektronike**”, REF-19566-07-05-2017 me këtotëdhëna:

Të dhëna për tenderin	Komisioni i vlerësimit të ofertave	Njësia e prokurimit ose hartuesit e dokumenteve të tenderit
a	b	c
U.Prokurimi nr.268prot, datë 05.07.2017 Fondi limit 83.333 lekë pa tvsh Procedura: Prokurim me vlerë të vogël. Data e zhvillimit të tenderit 11.04.2017 Firma fituese: A.. Data e marrjes së mallit në dorëzim 13.04.2017 Vlera e kontratës: 82,454 lekë pa TVSH Diferenca nga fondi limit 879 lekë pa tvsh	S.T, kryetar A.S, anëtar A.LL, anëtar	A.S (Jurist) S.T, anëtar A.LL, anëtar

**Nga auditimi u konstatua se:**

Me anë të shkresës Nr. 551 Prot me datë 04.07.2017 është kërkuar Sektorit të Menaxhimit dhe Shërbimit të Vizitorëve furnizimi me 10.500 bileta elektronike për një periudhë 3 muajë gjatë sezonit turistik veror, e cila është miratuar nga titullari i institucionit.

*Vihet re që është kërkuar të prokurohet e njëjta sasi biletash si për periudhën që nuk është sezoni turistik edhe për 3 muajorin sezon turistik, sërish në kuadër të mungesës së analizës që duhet të kryhet referuar shitjeve sipas periudhave me fluks vizitorësh për të përcaktuar nevojën të shprehur në shifra konkrete për furnizim me bileta elektronike.*

Në bazë të procesverbalit i mbajtur në datën 04.07.2017 mbajtur nga komisioni për blerjet e vogla është përcaktuar fondi në vlerën 83,333 lekë pa tvsh duke u bazuar nëçmimet e furnizimeve të mëparshme dhe konkretisht çmimet fituese në vitin 2016 dhe prill 2017.

Është miratuar nga titullari i MHK urdhri i prokurimit me nr.553, datë 05.07.2017 për blerjen e 10,500 copë bileta elektronike. Me anë të procesverbalit të mbajtur në datën 05.07.2017 është caktuar si person i autorizuar për të kryer veprimet në sistemin e prokurimit elektronik në emër të tyre për procedurën me objekt “Blerje bileta elektronike”.

Nëftësen për ofertë janë parashikuar edhe specifikimet teknike për ofertat konkurrenente dhe dita e zhvillimit të tenderit në datën 11.04.2017. Pas shpalljes fitues me procesverbalin e mbajtur në datën 07.07.2017 të OE Sh.K, me ofertën me vlerë më të ulët, ky i fundit është tërhequr nga konkurrimi dhe më pas është shpallur fitues me procesverbalin e mbajtur në datën 10.07.2017 OE i renditur i dyti nërradhë “O.H” shpk. Për shkak se edhe ku OE është tërhequr nga konkurrimi është kaluar tek OE i renditur i treti nërradhë. Operatori ekonomik i shpallur fitues me anë të formularit për njëtimn e fituesit të mbajtur në datën 10.07.2017 “A..”. Oferta e shpallur fituese është në vlerën 82.454 lekë pa tvsh. Ky i fundit ka bërë dorëzimin e mallit në datë 11.07.2017 ku ka marr pjesë komisioni për blerjet e vogla dhe prezent kanë qenë magazinieria e kohës kur është zhvilluar prokurimi, përgjegjësi i Sektorit të Menaxhimit të Shërbimeve për Vizitorët dhe njëspecialist i po këtij sektori.

6- Tenderi me objekt “**Blerje bileta elektronike**”, REF-31607-10-27-2017 me këtotëdhëna:

Të dhëna për tenderin	Komisioni i vlerësimit të ofertave	Njësia e prokurimit ose hartuesit e dokumenteve të tenderit
a	b	c



## KONTROLLI I LARTË I SHTËTIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Muzeun Historik Kombëtar

<b>U.Prokurimi</b> nr.858prot, datë 27.10.2017 <b>Fondi limit</b> 250,000 lekë pa tvsh <b>Procedura:</b> Prokurim me vlerë të vogël. <b>Data e zhvillimit të tenderit</b> 31.10.2017 <b>Firma fituese:</b> A... <b>Data e marrjes së mallit në dorëzim</b> 03.11.2017 <b>Vlera e kontratës:</b> 245,700 lekëpa TVSH <b>Diferenca nga fondi limit</b> 4300lekëpa tvsh	S.T, kryetar A.S, anëtar A.LL, anëtar	A.S (Jurist) S.T, anëtar A.LL , anëtar
---	---	--

#### Nga auditimi u konstatua se:

Me anë të shkresës Nr. 764 Prot me datë 29.09.2017 është kërkuar nga përgjegjësi i *Sektorit të Menaxhimit dhe Shërbimit të Vizitorëve*, furnizimi me 31.500 bileta elektronike për një periudhë 9 mujore e cila është miratuar nga titullari i institucionit.

Në bazë të procesverbalit i mbajtur në datën 03.10.2017 mbajtur nga komisioni për blerjet e vogla është përcaktuar fondi në vlerën **250,000 lekë pa tvsh** duke u bazuar në çmimet e furnizimeve të mëparshme dhe konkretisht çmimet fituese ne vitin 2016 dhe 2017.

Është miratuar nga titullari i MHK urdhri i prokurimit me nr.858, datë 27.10.2017 për blerjen e **31,500 copë** bileta elektronike. Në ftësën për ofertë janë parashikuar edhe specifikimet teknike për ofertat konkurrencte dhe dita e zhvillimit të tenderit në datën 31.10.2017. Me anë të procesverbalit të mbajtur në datën 27.10.2017 është caktuar si person i autorizuar për të kryer veprimet në sistemin e prokurimit elektronik në emër të tyre për procedurën me objekt “Blerje bileta elektronike”. Pas shpalljes fitues me procesverbalin e mbajtur në datën 31.10.2017 të OE “J...Group” me ofertën me vlerë më të ulët, ky i fundit është tërhequr nga konkurrimi dhe më pas është shpallur fitues me procesverbalin e mbajtur në datën 01.11.2017 OE i renditur i dyti në rradhë “A....” shpk. Oferta e shpallur fituese është në vlerën 245,700 lekë pa tvsh. Ky i fundit ka bërë dorëzimin e mallit në datë 03.11.2017 ku ka marr pjesë komisioni për blerjet e vogla dhe prezent kanë qenë magazinieria e kohës kur është zhvilluar prokurimi, përgjegjësi i Sektorit të Menaxhimit të Shërbimeve për Vizitorët dhe njëspecialist i sektorit të menaxhimit të ekspozitave.

Nr.	Gjendja në magazinë përpara kërkesës	Data e kërkesës për furnizim	Nr. i urdhër shpenzimit	Data e USh.	Kompania fituese	Copë	Shuma	çmimi lekë për copë
1	6,500	05.04.2017	51	19.04.2017	A....	10,500	98,910	9.42
2	4,000	04.07.2017	115	14.07.2017	A....	10,500	98,910	9.42
3	2,500	06.09.2017	144	21.09.2017	A....	10,500	98,910	9.42
4	-	29.09.2017	210	21.12.2017	A....	31,500	294,840	9.36

#### 7- Tenderi me objekt “Shërbimi privat i sigurisë fizike i Muzeut Historik Kombëtar”, REF-66242-01-31-2017 me këto të dhëna:

Të dhëna për tenderin	Komisioni i vlerësimit të ofertave	Njësia e prokurimit ose hartuesit e dokumenteve të tenderit
<b>a</b>	<b>b</b>	<b>c</b>



<b>U.Prokurim</b> nr.45prot, datë 30.01.2017 <b>Fondi limit</b> 4,788,000 lekë pa tvsh <b>Procedura:</b> Prokurim me vlerë të vogël. <b>Data</b> e zhvillimit të tenderit 31.10.2017 <b>Firma fituese:</b> "S..." SH.P.K. Data lidhjes së kontratës 28.04.2017 <b>Vlera e kontratës:</b> 3,620,336.24 pa TVSH <b>Diferenca</b> nga fondi limit 1,167,663.76 lekë pa tvsh	T.H, kryetare E.D, anëtare B.B, anëtare	A.S ,(Jurist) S.T, anëtar K.H , anëtar
---	---	--

**Nga auditimi u konstatua se:**

Në procesverbalit me Nr.42, datë 27.01.2017 është pasqyruar analiza e kostos për përlogaritjen e fondit limit, kjo përlogaritje është bërë sipas udhëzimit të përbashkët të KPP dhe APP të datë 01.04.2015 ku parashikohen zërat e preventivit të çmimit për njësi pra të vlerës së koston së një punonjësi shërbimi në muaj.

Konkretisht është mbajtur si referencë:

**Paga bazë** 33,000 lekë

**Shtesa për turnin e II** - 189.65 lek x 20% x 3 orë x 30.41 ditë : 5 roje = 692.07 lekë

**Shtesa për turnin e III** - 189.65 lek x 50% x 8 orë x 30.41 ditë : 5 roje = 4,613.80 lekë

**Sigurimet Shoqërore** - 38,305.87 lekë x 16.7 = 6,397.08 lekë

**Shpenzime armatimi** = 0

**Shpenzime uniforme dhe ndërlihdje** = 0

**Fitimi i shoqërisë** = 128.51 lekë

**Totali** = 44,831.46 lekë pa tvsh për një roje në muaj

Fondi limit = 44,831.46 lekë pa tvsh për një roje në muaj x 10 roje x 10.68 muaj = 4,788,000 lekë pa tvsh. Titullari i MHK ka miratuar urdhrin e prokurimit me nr.45, datë 30.01.2017 për prokurimin me objekt "Shërbimi privat i sigurisë fizike të Muzeut Historik Kombëtar për vitin 2017", lloji i procedurës së prokurimit është caktuar "Kërkesë për propozime" meqenëse vlera e fondit limit është nënën kufirin e ulët monetar dhe aëtarët e ngarkuar me hartimin e dokumenteve të tenderit janë caktuar këta anëtarë A.S, (Jurist), S.T anëtar, K.H anëtar. Me anë të urdhrin me nr. 46 prot., datë 30.01.2017 është ngritur KVO. Anëtarët e njësisë së prokurimit kanë nëshkruar formularin për deklaratën e konfliktit të interesit në datën 30.01.2017. Në procesverbalin e mbajtur në datën 31.01.2017 janë vendosur kriteret e përgjithshme dhe specifikimet teknike për dokumentet e tenderit. Në dokumentet e tenderit me këtë objekt dhe fond limit si më sipër përmendur është caktuar edhe kohëzgjatja e kontratës afati kohor për ekzekutimin e cila fillon 10.02.2017 dhe përfundon në 31.12.2017, afati kohor për hapjen e ofertave është data 13.02.2017 ora 10:00 në MHK. Njoftimi i kontratës për t'u plotësuar nga AK, i cili do të publikohet në Buletinim e Njoftimeve Publike me të dhënat e kësaj procedure prokurimi ka si kohëzgjatje të kontratës ose afat kohor për ekzekutim: nga lidhja e kontratës deri më 31.12.2017. Me anë të shkresës nr.50/1 prot., datë 01.02.2017 është publikuar ftesa për ofertë nga MHK. KVO ka nëshkruar formularin e deklaratimit të konfliktit të interesit.

Me shkresën nr.129 prot. datë 28.02.2017 është marrë një ankesë nga OE "S..." shpk, ku arsyetohet se ka oferta ekonomike e tyre ka qënë 4,474,257.06 lekë dhe se është kualifikuar me arsyetimin se nuk ka paraqitur 10 certifikata të vlefshme me afat sipas ligjit nr. 75/2014, nuk ka



paraqitur faturë tatimore blerje pranga, shkop gome, dedektor dhe për spray ka paraqitur blerje vetëm për 2 cope ndërkohe që është kërkuar për 10. Ky OE arsyeton se referua vërtetimit të performancës së DVP ajo i përmbush mangesitë e supozuara nga AK ndaj edhe kërkon pezullimin e procedurës, kualifikimin e ofertës dhe marrjen në konsideratë të vërtetimit të performancës së Drejtoria Vendore e Policisë, Tiranë. Nga AK është pezulluar me anë të shkresës nr. 138 prot. datë 01.03.2017, procedura e prokurimit deri në shqyrtimin e ankesës. Me anë të shkresës me nr. 129/1 datë 07.03.2017 është arsyetuar se OE nuk ka paraqitur 10 certifikata të vlefshme brenda afatit 4 vjeçar, gjithashtu pretendimi i ankuesit se ato janë të vlefshme sipas rekomandimit të A.P.P dhe K.P.P datë 06.02.2017 nuk qëndron pasi ky rekomandim thuhet se i shtrin efektet për të gjitha procedurat e prokurimit që do të shpallen pas datës 13.02.2017. OE nuk disponon faturat tatimore të pajisjeve si më sipër përmendur. Ndaj vendimi për skualifikimin e këtij OE është i drejtë dhe me anë të shkresës nr. 129/2 prot. datë 07.03.2017 është vënë në dijeni OE.

Me shkresën nr.129 prot. datë 28.02.2017 është marrë një ankesë nga OE “I...S. A.” sh.p.k me arsyetimin se i kanë aploduar në sistemin e prokurimit elektronik të dhënat se i disponon 60 certifikata shërbimi të kapacitetin 18-MB dhe 10 copa hekura lidhëse dhe 10 copë shkopinj gome. Ndaj edhe kërkon pezullimin e procedurës, kualifikimin e ofertës. AK ka marrë në konsideratë kërkesat e OE duke i arsyetuar se nuk disponon faturat tatimore për të gjitha sendet e vendosura si kritere për tu kualifikuar si edhe parashikohet në nenin 53 të ligjit nr. 9643, datë 0.11.2006. Ndaj vendimi për s’kualifikimin e këtij OE është i drejtë dhe me anë të shkresës nr. 137/2 prot. datë 08.03.2017 është vënë në dijeni OE.

Me shkresën nr.146 prot. datë 02.03.2017 është marrë një ankesë nga OE SHPSF “D.... S..” sh.p.k kjo ankesë i referohet faktit se AK e ka s’kualifikuar ofertën pasi është nën koston minimale ligjore të detyrueshme për këtë shërbim, por OE arsyeton se i ka respektuar të gjitha kriteret ligjore për pagën minimale, shtesën e turnit të II dhe të III, për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore sipas rekomandimit të APP dhe KPP datë 06.02.2017. AK ka arsyetuar se vendimi për s’kualifikim është i drejtë pasi pretendimi i ankuesit se ato janë të vlefshme sipas rekomandimit të A.P.P dhe K.P.P datë 06.02.2017 nuk qëndron sepse ky rekomandim parashikon se i shtrin efektet për të gjitha procedurat e prokurimit që do të shpallen pas datës 13.02.2017. Ndaj vendimi për s’kualifikimin e këtij OE është i drejtë dhe me anë të shkresës nr. 146/1 prot. datë 09.03.2017 është vënë në dijeni OE.

Me shkresën nr.145 prot. datë 02.03.2017 është marrë një ankesë nga OE N... SHPSF, ku parashtrihen arsyet e s’kualifikimit për disa nga OE që kanë marrë pjesë, konkretisht OE S.S.S sh.p.k, A..S.. shpk, “S..” shpk pasi nuk kanë përmbushur kërkesën e AK shtojca 6, “Autorizim për ngritjen dhe shfrytëzimin e sistemit të pavarur radiokomunikacioni dhe radio alarmi lëshuar nga AKEP. AK duhet të s’kualifikoj OE S.S.X sh.p.k, A..S.., dhe “S..” pasi nuk kanë përmbushur kërkesën e AK shtojca 6, **kapaciteti ligjor i operatorëve ekonomikë, pika d.** AK duhet të s’kualifikoj OE S.S.X sh.p.k, A..S.., “S..” pasi nuk kanë përmbushur kërkesën e AK shtojca 6, *“Vërtetim për pagesën e taksave vendore për vitin 2016 sipas vendeve të ushtrimit të aktivitetit të pasqyruar në Q.K.B”*. AK duhet të s’kualifikoj OE S. .S.X sh.p.k, A..S.., “S..” pasi nuk kanë



përmbyshur kërkesën e AK shtojca 6, "Formulari i ofertës do të shoqërohet me analizë kosto ku të jenë parashikuar të gjitha detyrimet ligjore në lidhje me pagën minimale, shtesat mbi pagën sipas 81 dhe 87.

Në vendimin nr. 4, me shkresën nr. 145/1 datë 09.03.2017, këto ankesa nuk janë marrë parasysh pasi nuk janë të arsyetuara dhe të mbështetura në fakte dhe në dyshime të bazuara por janë thjesht pretendime a-priori, ky OE duhet ti mbështesë në fakte dhe rrethana pretendimet e tij për mospërmbyshje kriteri/kriteresh dhe me shkresën nr.45/2 datë 09.03.2017 është vënë në dijeni OE.

Me anë të vendimit nr.437/1 prot. datë 1.03.2017 KPP ka vendosur të kalojë për shqyrtim ankesën e paraqitur nga OE "I...S.A..." sh.p.k. Të pezulloj procedurën e prokurimit dhe AK duhet të dërgoj KPP informacion të detajuar për procesin e vlerësimit të ofertave dhe të jepen argumentet përkatëse mbi pretendimet e OE "I...S.A..." sh.p.k.

Me anë të shkresës nr.207 prot. datë 20.03.2017 MHK i ka sqaruar KPP arsyet mbi të cilat ka mbështetur mos marrjen parasysh (si më sipër referuar) të OE "I...S.A..." shpk. KPP ka dërguar me anë të shkresës Nr.218/1 prot. datë 1.04.2017, ku vendos të pranohet pretendimi i OE dhe të anulohet skulifikimi i tij dhe të dokumentoj veprimet e tij .

AK ka nxjerrë urdhrin e brendshme me nr.303 prot. datë 14.04.2017 për zbatimin e menjëhershëm të vendimit nr.217/2017 datë 12.04.2017 duke e kualifikuar OE "I...S.A..." sh.p.k. Me anë të shkresës nr. 305 prot. datë 14.04.2017 është kërkuar nga titullari i MHK të kryej SPE të rivlerësimit të ofertave me qëllim të futet në kualifikim OE "I...S.A..." SHPK.

Me anë të shkresës nr.311 Prot. datë 20.04.2017 është mbajtur procesverbali për hedhjen e shortit për 6 oferta me vlerë të barabartë, ku janë njoftuar OE. Shorti u hodh me zarfe në të cilët ndodheshin numrat nga 1 deri tek 6 ku u vendos që numri 1 do të ishte fituesi i garës, dhe u shpall OE "S..." SH.P.K.

Në raportin përmbledhës me shkresën nr. 317 prot. datë 21.04.2017 ka përshkruar të gjitha ngjarjet që nga urdhri i prokurimit e deri tek shpallja e fituesit. Me anë të shkresës nr. 334, datë 27.04.2017 është publikuar formulari i njoftimit të fituesit. Me anë të procesverbalit të mbajtur në datën 27.04.2017 është bërë verifikimi i dokumenteve të OE fitues. Së fundmi në datën 28.04.2017 është lidhur kontrata në vlerën 3,620,336.24 pa TVSH me OE fitues "S..." SH.P.K. Është plotësuar shtojca 17 me nr. 353 prot. datë 03.05.2017, formulari i publikimit të njoftimit të kontratës së nënshkruar. Referua urdhër shpenzimeve këto janë pagesat mujore të kontratës:

MUAJI	Kësti në lekë me tvsh	Kësti në lekë pa tvsh	Vlera e kontratës
Maj	543,050	452,542	
Qershor	543,050	452,542	
Korrik	543,050	452,542	
Gusht	543,050	452,542	
Shtator	543,050	452,542	
Tetor	543,050	452,542	
Nëntor	543,050	452,542	
Dhjetor	543,050	452,542	
<b>TOTALI</b>	<b>4,344,400</b>	<b>3,620,336</b>	



## 8- Tenderi me objekt "Shërbimi privat i sigurisë fizike i Muzeut Historik Kombëtar", REF-66242-01-31-2017 me këto të dhëna:

Të dhëna për tenderin	Komisioni i vlerësimit të ofertave	Njësia e prokurimit ose hartuesit e dokumenteve të tenderit
a	b	c
<b>U.Prokurimi</b> nr.75, datë 15.02.2017 <b>Fondi limit</b> 896,629.2 lekë <b>pa tvsh</b> <b>Procedura:</b> Procedurë me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit <b>Data e zhvillimit të tenderit</b> 15.02.2017 <b>Firma fituese:</b> "M." SH.P.K. Data lidhjes së kontratës 15.02.2017 <b>Vlera e kontratës:</b> 3,620,336.24 pa TVSH <b>Diferenca nga fondi limit</b> 2,570.2 lekë pa tvsh	A.LL, kryetare L.XH, anëtare F.B, anëtare	A.S , (Jurist) S.T, anëtar K.H, anëtar

**Nga auditimi u konstatua se:**

Në procesverbalin me Nr.42, datë 27.01.2017 është pasqyruar analiza e koston për përllogaritjen e fondit limit, kjo përllogaritje është bërë sipas udhëzimit të përbashkët të KPP dhe APP të datë 01.04.2015 ku parashikohen zërat e preventivit të çmimit për njësi pra të vlerës së koston së një punonjësi shërbimi në muaj. Konkretisht është mbajtur si referencë:

**Paga bazë** 33,000 lekë

**Shtesa për turnin e II** - 189.65 lek x 20% x 3 orë x 30.41 ditë : 5 roje = 692.07 lekë

**Shtesa për turnin e III** - 189.65 lek x 50% x 8 orë x 30.41 ditë : 5 roje = 4,613.80 lekë

**Sigurimet Shoqërore** - 38,305.87 lekë x 16.7 = 6,397.08 lekë

**Shpenzime armatimi** = 0

**Shpenzime uniforme dhe ndërlihdje** = 0

**Fitimi i shoqërisë** = 128.51 lekë

**Totali** = 44,831.46 lekë pa tvsh për një roje në muaj

Titullari i MHK ka miratuar urdhrin e prokurimit me nr.75, datë 15.02.2017 për prokurimin me objekt "Shërbimi privat i sigurisë fizike të Muzeut Historik Kombëtar" me fond limit 896,629.2 lekë pa tvsh. Lloji i procedurës së prokurimit të jetë: "Procedurë me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit" referuar nenit 33, pika 2, germa "c" të VKM nr.914 datë 29.12.2014me arsyetimin ligjor, AK në datë 31.01.2017 ka filluar procedurën standarde të prokurimit "Kërkesë për Propozim" të këtij shërbimi për vitin 2017, procedurë kjo e cila kërkon një kohë të caktuar për procesin e hapjes, shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave si dhe procesit të mundshëm të ankimeve. Periudha e cila do të mbulohet me këtë procedurë negociimi është 2 (dy) muaj por kontrata do të ndërpritet menjëherë me nënshkrimin e kontratës së shërbimit pas përfundimit procedurës standarde "Kërkesë për Propozime".

Me shkresën me nr.76 prot., datë 15.02.2017, titullari i MHK ka nxjerrë urdhrin për krijimin e KVO. Në datën 15.02.2017 njësia e prokurimit ka firmosur formularin deklarimin e konfliktit të interesit. Proçesver për hartimin e dokumenteve të tenderit është mbajtur në datën 15.02.2017. Tek dokumentet standarde të tenderit kohëzgjatja është 2 muaj por nuk është përcaktuar kur fillon dhe kur përfundon afati.



Shkresa me nr. 79 prot. për ftesën për negocim për procedurën e prokurimit “Procedurë me negocim, pa shpallje paraprake të njoftimit” me objekt “Shërbimi privat i sigurisë fizike të Muzeut Historik Kombëtar” është mbajtur në datën 15.02.2017 dhe i është drejtuar shoqërisë private të sigurisë fizike “T...” shpk, me shkresën nr. 77prot. datë 15.02.2017 “F..” shpk, me shkresën nr. 81 prot. datë 15.02.2017 “B...” shpk, me shkresën nr. 78 prot. datë 15.02.2017 “R.. S..” shpk, me shkresën nr. 80 prot. datë 15.02.2017 “M...S..” shpk. Në datën 15.02.2017 është plotësuar formulari i deklaramit të konfliktit të interesit nga KVO. Në datën 15.02.2017 është mbajtur procesverbali i hapjes dhe shqyrtimit dhe negocimit të ofertave ku thuhet se vetëm një OE “MyrtoSecurity” shpk ka paraqitur ofertë., e cila i ka plotësuar kriteret e vendosura. Me shkresën nr.84 prot.,datë 15.02.2017 është njoftuar klasifikimi ku në vend të parështë klasifikuar **OE i vetëm** me ofertën në vlerë 894,059 lekë pa tvsh.

Me anë të shkresës nr.85 prot., datë 15.02.2017 është përpiluar nga KVO raporti përmbledhës për procedurën me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës me objekt “Shërbimi privat i sigurisë fizike të institucionit Muzeu Historik Kombëtar”, drejtuar titullarit të MHK. Formulari i njoftimit të fituesit është sigluar nga titullari me shkresën e mbajtur në datë 15.02.2017, me nr. 86 prot.

Kontrata e shërbimit është nënshkruar në datën 15.02.2017, nr. 87 prot. vlera mujore e kësaj kontrate është 536,435.4 dhe afati i kontratës është 2 muaj nga data e nënshkrimit të saj nga palët. Është paguar edhe sigurimi i kontratës në datën 15.02.2017, në po këtë datë është bërë edhe nr.88 prot. Me shkresën nr.89 prot, datë 15.02.2017 është plotësuar shtojca 17/1, ku thuhet se **fondi limit është 896,629.2 lekë pa tvsh** dhe vlera e kontratës është 1,072,870.8 me tvsh (894,059 pa tvsh). Shkresa nr. 91 prot. datë 15.02.2017 është formulari i publikimit të njoftimit të kontratës së nënshkruar.

Fatura e muajit të dytë për shërbimin e rojeve është paguar në Korrik 2017 dhe jo në muajin Prill kur edhe ka përfunduar si marrëdhënie kontraktore por referuar udhëzimit nr.2, datë 06.02.2012, pika 6 ...*Pagesat nga fondet publike kryhen në bazë të regjistrimit kronologjik të urdhërave të shpenzimit të njërive të qeverisjes së përgjithshme në sistemin informatikë financiar të qeverisë, sipas parimit hyrje e parë-dalje e parë.* Edhe pse ky urdhër shpenzim mban datën e ditës kur edhe është kryer likuidimi, referuar kontratës së shërbimit, **parimi hyrje e parë – dalje e parë nuk është respektuar sepse shërbimi është dhënë në muajin prill dhe pagesa e kontratës së re (pasardhëse) ka filluar të likuidohet ndërkohë që ende nuk ka përfunduar likuidimi i kontratës para ardhëse. Në kuadër të kësaj, MHK duhet të respektojë shlyerjen e detyrimeve monetare sipas kontratës dhe jo të vonojë pagesat sepse në këtë mënyrë rrishton që OE të aplikoj penalitetet për mos përmbudhje të detyrimeve të palëve sipas kontratës së nënshkruar.**

#### **Analiza për të gjithë periudhën e mbuluar me shërbimin e rojeve:**

Për periudhën 01.01.2017 deri në 09.02.2017 është bërë 20% shtesë kontrate, më pas për periudhën 15.02.2017 deri në 15.04.2017 është prokuruar procedurë me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit, MHK ka prokuruar me negocim pa shpallje për 2 muaj.

Për shkak të shtyrjes në kohë të procedurave të prokurimit pasi pati disa ankesa nga OE nga data 15.02.2017 kur mbaroi afati i kontratës me firmën fituese të procedurës së prokurimit



paraardhëse e deri në datën 28.04.2017 kur u lidh kontrata me OE fitues të kësaj procedure prokurimi, MHK ka qenë i pa mbuluar nga shërbimi i ruajtjes fizike të Muzeut

Nga sa më sipër dalim në konkluzionin se periudha nga 15.04.2017 deri ne 28.04.2017 ngelet e pa mbuluar me shërbimin e rojeve. Por garantimi i sigurisë së mjediseve dhe fondeve muzeore është detyrim ligjor i parashikuar në nenin 13 të Ligjit nr.9386, datë 4.5.2005 “Për muzetë”: *Drejtuesit e muzeve, publike dhe private, detyrohen të garantojnë sigurinë e mjediseve dhe të fondit muzeor, që kanë në administrim, ndaj të gjitha rreziqeve të mundshme, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi”.*

Në kuadër të kësaj krahas risqeve për cënimin e pasurisë që MHK ka në administrim, kjo mungesë e rojeve përbënshkelje ligjore.

*AK nuk ka vepruar drejtë për faktin se i ka filluar procedurat e prokurimit në 31.01.2017, duhet të ishte prokuruar që 03.01.2017 për të mos e lënë institucionin të pa mbuluar me shërbimin e rojeve për 13 ditë kalendarike, por me një planifikim më të saktë nga sektori përgjegjës nuk do ishte e nevojshme të realizoheshin dy procedura prokurimi.*

**b. Mbi zbatimin e legjislacionit për realizimin e procedurave të prokurimit publik për vitin 2018, si dhe lidhja dhe zbatimi i kontratave deri më marrjen ne dorëzim të mallrave, punëve dhe shërbimeve.**

Për zbatimin e legjislacionit dhe realizimin e procedurave të prokurimit Publik u shqyrtua dokumentacioni ligjor vënë në dispozicion nga subjekti, nga ku rezultoi se procedurat janë planifikuar dhe realizuar si më poshtë:

**Planifikimi i regjistrave:** Me shkresën nr.25 prot, datë 10.01.2018, në zbatim të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “ Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, udhëzimit të APP nr.1, datë 05.01.2018 “ Për hartimin e regjistrit të parashikimeve të procedurave të prokurimit publik dhe regjistrit të realizimeve të procedurave të prokurimit dhe krijimi i tyre në sistemin e prokurimit elektronik” Institucioni i Muzeut Historik Kombëtar ka dërguar në Ministrinë e Kulturës dhe Degën e Thesarit regjistrin e parashikimeve të procedurave të prokurimit publik për vitin 2018, Regjistri i parashikimit është ndryshuar gjatë vitit për nevoja të institucionit.

**Realizimi regjistrit:** Me shkresën nr.07 prot, datë 08.01.2019, në zbatim të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar dhe udhëzimit të APP, nr.1 datë 05.01.2018 “ Për hartimin e regjistrit të parashikimeve të procedurave të prokurimit publik dhe regjistrit të realizimeve të procedurave të prokurimit publik dhe krijimin e tyre në sistemin e prokurimit elektronik” është dërguar në Ministrinë e Kulturës regjistri i realizimit të prokurimeve publike.

Regjistri përfundimtar i realizimit të procedurave të prokurimit me vlerat e parashikimit, vlerën e prokuruar dhe vlerën e kontratës paraqitet sipas tabelës me të dhënat e mëposhtme:

Prokurime 2018	Parashikimi	Vlera Prok. (pa tvsh)	Vlera kontratës (me tvsh)
Vlera në total	13,026,319 lekë	12,473,544	7,853,579



**Realizimi i procedurave:** Nga auditimi i dokumentacionit ligjor të procedurave të prokurimit vënë në dispozicion nga subjekti nën auditim, si dhe verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik të APP-së u konstatua se procedurat e ndjekura për prokurimin e mallrave dhe shërbimeve në funksion të veprimtarisë së institucionit, janë kryer bazuar në Ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar. Autoriteti kontraktor në të gjitha procedurat e audituara ka vlerësuar dhe ka shpallur fitues operatori ekonomik i cili ka ofruar vlerën e çmimit më të ulët. Titullari i Ak në përputhje me nenin 29 pika 5 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar dhe nenin 40, pika 3, kreu IV i VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" ka lëshuar urdhrat e prokurimit për zhvillimin e procedurave. Në përputhje me nenin 57 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, me urdhër të brendshëm nr.11, datë 05.01.2018, ka ngritur Njësinë e Prokurimit . Në përputhje me nenin 61 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 "Për rregullat e prokurimit publik " i ndryshuar në përgjithsi janë mbajtur proces verbale nga Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël mbi dokumentimin e përlogaritjes së fondit limit, mbi specifikimet teknike dhe kriteret e veçanta të kualifikimit në përputhje me udhëzimin nr.3, datë 08.01.2018 të APP-së "Për zhvillimin e procedurave të prokurimit me vlerë të vogël". KPVV ka mbajtur proces-verbal mbi caktimin e nënpunësit të autorizuar i cili do kryejë veprimet në sistemin e prokurimit elektronik në emër të Komisionit të Prokurimit me Vlerë të Vogël. Në përputhje me nenin 56 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar janë plotësuar në përgjithsi formularët e deklarimit të konfliktit të interesit nga anëtarët e Komisionit të Prokurimit me Vlerë të Vogël. Për regjistrimin në sistemin e APP të procedurës së prokurimi janë respektuar në përgjithsi kriteret dhe është kryer arkivimi i procedurës në sistemin e SPE. Me Me Proces Verbal është dorëzuar në zyrën e financës dokumentacioni i dosjeve të prokurimit, në prani të përgjegjëses të financës dhe juristit. Janë inventarizuar dosjet e procedurave të prokurimit në përputhje me ligjin për arkivën.

U shqyrtua dokumentacioni ligjor dhe u krye verifikimi në SPE të APP-së për **15** procedurat e prokurimit të kryera nga Autoriteti Kontraktor Muzeu Historik Kombëtar, **për vitin 2018**, si më poshtë vijon:

1. Shërbim i sigurisë fizike të MHK me roje private për nevoja emergjente të vitit 2018
2. Shërbim i sigurisë fizike të MHK me roje private për nevoja të vitit 2018
3. Blerje tonera kancelari
4. Blerje tonera kancelari
5. Blerje material pastrimi
6. Blerje materiale pastrimi
7. Blerje material elektrike
8. Blerje material elektrike
9. Blerje material për laboratorin e konservimit
10. Blerje Bileta Elektronike
11. Blerje Bileta Elektronike
12. Dërgimi i katalogut dhe një dhuratë, partnerëve në përmbyllje të projektit të Shkollës Verore "Unë isha qytetar i Qytetit Stalin .



13. Blerje Karburanti
14. Dezinfektimi, dezinfektizimi dhe deratizimi i ambienteve të Muzeut Historik Kombëtar.
15. Blerje baner për printim fotografish për ekspozitën në kuadër të projektit Shkolla Verore “Unë isha qytetar i Qytetit Stalin”

### 1. “ Blerje tonera kancelari”

Nga auditimi i procedurave të prokurimit në rastin e blerjeve me vlerë të vogël me objekt materiale elektrike, tonera dhe kancelari, material pastrimi, blerje bileta elektronike janë zhvilluar dhe realizuar procedurat dy here gjatë vitit , si më poshtë:

Të dhëna për tenderin	Komisioni i Blerjeve me vlerë të vogël	Njësia e prokurimit ose hartuesit e dokumenteve të tenderit
<b>a</b>	<b>b</b>	<b>c</b>
<b>U.Prokurimi</b> nr.586 prot, datë 05.07.2018 <b>Fondi limit</b> 123.000.000 lekë pa tvsh <b>Procedura:</b> Prokurim me vlerë të vogël. <b>Data e zhvillimit të tenderit</b> 9.07.2018 <b>Firma fituese:</b> “L...” Data lidhjes së kontratës dt.10.07.2018 <b>Vlera e kontratës:</b> 126.000.00 pa TVSH <b>Diferenca</b> nga fondi limit 3000 lekë pa tvsh	A.S ,(Jurist) S.T, anëtar A.LL , anëtar	A.S ,(Jurist) S.T, anëtar A.LL , anëtar

Me shkresën nr.583 prot, datë 04.07.2018 për nevoja pune i është paraqitur titullarit të institucionit kërkesa për blerje bojë printerash, bojë fotokopje dhe kancelari në përdorim të punonjësve të institucionit, nga Z.F.B me cilësinë e Përgjegjës të sektorit të menaxhimit dhe shërbimit të vizitorëve, R.M Specialist, V.M magazinier .

Komisioni për përlllogaritjen e fondit limit, ka firmosur secili anëtar formularin e deklaramit të konfliktit të interesit datë 04.07.2018. Me datë 04.07.2018 KPVV bazuar në nenin 59 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 “ Për rregullat e prokurimit Publik” i ndryshuar , bazuar në pikën 5 të udhëzimit nr .1, datë 08.01.2018 “Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël” ka dokumentuar përlllogaritjen e fondit limit në vlerën 123 000 lekë pa tvsh. Me Proces-Verbal datë 05.07.2018 mbajtur nga KPVV, mbi caktimin e nënpunësit zbatues, nënpunësi i autorizuar i cili do kryejë veprimet në sistemin e prokurimit elektronik për KPVV caktohet Z. A.LL, i cili kryer dhe veprimet në SPE. Me datë 05.07.2018, KPVV i krijuar me Urdhrin nr.11 datë 05.01.2018 ka mbajtur Proces-Verbal mbi specifikimet teknike dhe kriteret e veçanta të kualifikimit. Me shkresën nr.587 prot, datë 05.07.2018 është bërë nga titullari i Ak ftesa për ofertë. Me datë 09.07.2018 nga KPVV është plotësuar formulari mbi deklaramin e konfliktit të interesit. Me datë 09.07.2018 KPVV ka mbajtur Proces-verbalin nr.1 dhe ka kualifikuar ofertat e OE nën vlerën e fondit limit dhe ka skualifikuar ofertat mbi vlerën e fondit limit referuar rekomandimit të APP nr.6559 datë 27.06.2018.Në klasifikimin përfundimtar janë kualifikuar 6 OE, si vijon:

#### 1.A...

Vlerën e ofertës 78.000

#### 2.I...

Vlerën e ofertës 105000

#### 3.Sh...K..

Vlerën e ofertës 119 999

**4.E..A..**

Vlerën e ofertës 120.000

**5.R...**

Vlerën e ofertës 120.000

**6.T..K..**

Vlerën e ofertës 123.000

Nga auditimi rezultoi se, komisioni ka skualifikuar 6 OE, M.B, C., E.L, A...., A.K, J.... Group. Me datë 09.07.2018 KPVV, ka mbajtur PV nr.2 pasi pas vlerësimit të ofertave për procedurën e prokurimit ka konstatuar se dy OE E.A person fizik dhe read 2000 shpk janë me vlerë ekonomike të barabartë 120.000 lekë. Në bazë të udhëzimit nr.3 datë 08.01.2018 “ Për përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike” KBVV ka vendosur të njoftojë këta OE në SPE për hedhjen e shortit për klasifikimin e ofertave në vend të 4 dhe të pestë. Me datë 09.07.2018 KPVV, ka mbajtur PV nr.3 KPVV dhe pse nuk është paraqitur asnjë nga OE , ka hedhur shortin dhe ka klasifikuar E.A person fizik në vend të pestë dhe R.. 2000 shpk në vend të katërt. Me PV.nr.4 datë 10.07.2018 KPVV ka skualifikuar OE A...shpk i renditur i pari në klasifikimin përfundimtar sepse ky OE ka deklaruar me mesazh në SPE tërheqjen nga kjo procedurë për shkak të shitjeve të paparashikuara. Me datë 09.07.2018 KPVV ka mbajtur PV për verifikimin e dokumentacionit të OE Infosoft Office. Pas verifikimit të dokumentacionit të KPVV ka rezultuar i rregullt dhe plotëson kriteret. Komisioni ka vendosur ta njoftojë këtë operator për të furnizuar mallin-objekt prokurimi. Shpallje fituesi datë 10.07.2018. Me faturën tatimore të shitjes datë 11.07.2018 është kryer veprimi në vlerën 126.000.000 vlera me tvsh. Me fletëhyrje nr.13, nr 14, datë 11.07.2018 është bërë hyrje malli në magazinë sipas specifikimeve të kërkuara. Me datë 11.07.2018 është mbajtur PV nga KPVV mbi dorëzimin e mallrave sipas specifikimeve të kërkuara në ftesën për ofertë. Marrja në dorëzim është bërë nga komisioni i blerjeve me vlerë të vogël.

Me nr. REF-78133-07-05-2018 është regjistruar procedura në SPE të APP-së. Me datë 11.07.2018 është mbajtur PV mbi dorëzimin e mallrave nga KBVV sipas specifikimeve të kërkuara në ftesën për ofertë. Me urdhër shpenzimi nr.107 prot,datë 24.07.2018 likujduar OE Infosoft Office., në vlerën 126.000 lekë.

**2.“Blerje Materiale pastrimi”**

Të dhëna për tenderin	Komisioni i Blerjeve me vlerë të vogël	Njësia e prokurimit ose hartuesit e dokumenteve të tenderit
<b>a</b>	<b>b</b>	<b>c</b>
<b>U.Prokurimi</b> nr.603 prot, datë 06.07.2018 <b>Fondi limit</b> 240.000 lekë pa tvsh <b>Procedura:</b> Prokurim me vlerë të vogël. <b>Data</b> e zhvillimit të tenderit 09.07.2018 <b>Firma fituese:</b> “D...sh.pk ” Data lidhjes së kontratës dt. 15.08.2018 <b>Vlera e kontratës:</b> 207.540 lekë <b>pa TVSH</b> Diferenca nga fondi limit 32,460 lekë	A.S ,(Jurist) S.T, anëtar A.LL , anëtar	A.S ,(Jurist) S.T, anëtar A.LL , anëtar

Në zyrën e financës për dorëzimin e dokumenteve të procedurës nga kryetari i KPVV z. A.S dhe Përgjegjëses së Sektorit të Financës është mbajtur Proces-Verbal. Praktika ligjore në origjinal. Me shkresën nr.585 prot datë 04.07.2018 është bërë kërkesa për blerje material pastrimi. Grupi i



punës për përlogaritjen e fondit limit ka firmosur deklaratën e konfliktit të interesit me datë 04.07.2018. Me datë 04.07.2018 është mbajtur PV mbi përlogaritjen e fondit limit nga Komisioni i Blerjeve me Vlerë të Vogël. Me urdhër prokurimi nr.603 datë 06.07.2018 titullari i AK ka lejuar përdorimin e procedurës prokurimit me vlerë të vogël. Me procesverbalin e datës 06.07.2018 mbi caktimin e nënpunësit të autorizuar të Komisionit të prokurimit me vlerë të vogël, i cili do të kryejë veprimet në sistemin e prokurimit elektronik në emër të komisionit është vendosur Z. A.S. Me shkresën nr.604, datë 06.07.2018 AK ka plotësuar formularin e ftesës për ofertë. Me datë 10.07.2018 KPVV ka firmosur formularin e deklaratimit të konfliktit të interesit. Me Proces-Verbalin e datës 06.07.2018 Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël ka vendosur që specifikimet teknike dhe kriteret e veçanta të kualifikimit të jenë sipas kërkesës nr. 585, datë 04.07.2018 për fillimin e procedurës. Nga KPVV janë firmosur deklaratat e konfliktit të interesit.Me PV nr.1 datë 09.07.2018 KPVV ka vendosur të kualifikojë të gjitha ofertat e operatorëve ekonomikë nën vlerën e fondit limit duke përfunduar klasifikimin e ofertave në bazë të kriterit të vlerësimit çmimi më i ulët. Në klasifikimin përfundimtar ka rezultuar se janë kualifikuar 11 OE i renditur i pari L.XH me vlerë 99,310 lekë pa tvsh , dhe janë skualifikuar 4 OE të cilët kishin ofruar vlera mbi fondin limit. KPVV ka kryer skualifikimin e OE mbi vlerën e fondit limit bazuar në rekomandimin e APP nr.6559 datë 27.06.2018.Me datë 10.07.2018 është mbajtur Proces-Verbal nr.2 nga komisioni i blerjeve të vogla i cili ka vendosur që pas vlerësimit të ofertave të njoftojë OE i renditur i pari L.XH. Ky OE ka deklaruar me mesazh në SPE, tërheqjen nga kjo procedurë prokurim për shkak të përlogaritjes gabim të ofertës. Me datë 11.07.2018 është mbajtur Proces-Verbal nr.3, nga komisioni i blerjeve të vogla mbi verifikimin e dokumentacioni të OE N....shpk i renditur i dyti në klasifikim. Me shkresën nr.616 datë 10.07.2018 është protokolluar dokumentacioni i OE Nirupa shpk, i cili pas verifikimit ka rezultuar me mangësi sepse nuk ka paguar detyrimet e OSHE për muajin prill 2018. KPVV ka vendosur skualifikimin e tij për mosplotësim të kriterëve të kualifikimit. Me shkresën nr.621 prot, datë 13.07.2018 ofertuesi D..SHPKL ka paraqitur dokumentacionin bazuar në kriteret e kualifikimit përcaktuara .Me datë 16.07.2018 është mbajtur Proces-Verbal nga komisioni i blerjeve të vogla mbi verifikimin e dokumentacioni të OE D...shpk i renditur i treti në klasifikim me vlerë oferte 172.950 lekë pa tvsh. Nga verifikimi dokumentacionit ka rezultuar se dokumentacioni i paraqitur nga ky OE është i rregullt dhe plotëson kriteret. Kriteri i vlerësimit çmimi më i ulët. Me fletëhyrje nr.15, nr.16 dhe nr.7 datë 16.07.2018 janë bërë hyrje në magazinë mallrat. Me faturë tatimore nr.165, datë 16.07.2018 është kryer veprimi në favor të blerësit MHK në vlerën 67050 lekë pa tvsh ose 80.460 me tvsh. Me faturë tatimore nr.165/1, datë 16.07.2018 është kryer veprimi në favor të blerësit MHK në vlerën 105. 900 pa tvsh ose 127.080 me tvsh. Mallrat janë marrë në dorëzim nga Komisioni i blerjeve me vlerë të vogël, sipas PV datë 16.07.2018. Me nr. Referencë -78210-07-06-2018 në sistemin e SPE është regjistruar procedura prokurimit “ Blerje materiale pastrimi” lloj procedurës blerje me vlerë të vogël, tipi kontratës mallra. Fondi limit 240,000.00 lekë pa tvsh. Autoriteti Kontraktor Muzeu Historik Kombëtar. Nuk u konstatuan parregullsi në fazën e zhvillimit të procedurës prokurimit. Nga KPVV është kryer arkivimi i procedurës në SPE.Komisioni i Prokurimit blerjeve me Vlerë të Vogël ka firmosur Proces verbalin e dorëzimit të mallit sipas specifikimeve teknike.

### 3. Blerje Materiale pastrimi

	Komisioni i BVV	Njësia e prokurimit ose hartuesit e
--	-----------------	-------------------------------------



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Muzeun Historik Kombëtar

Të dhëna për tenderin		dokumente të tenderit
a	b	c
<b>U.Prokurimi</b> nr.189, datë 20.02.2018 <b>Fondi limit 158,397,000</b> lekë pa tvsh <b>Procedura:</b> Prokurim me vlerë të vogël. <b>Dt e zhvillimit të tenderit</b> 20.02.2018 <b>Firma fituese:</b> “T...” shpk. Data lidhjes së kontratës 21.02.2018 <b>Vlera e kontratës:</b> 125.268 lekë <b>pa TVSH</b> <b>Diferenca</b> nga fondi limit 33,111 lekë <b>pa tvsh</b>	A.S ,(Jurist) S.T, anëtar A.LL , anëtar	A.S ,(Jurist) S.T, anëtar A.LL , anëtar

Me urdhër shpenzimi nr. 33 datë 02.03.2018 është likujduar nga Muzeu Historik Kombëtar T&M chemicaldistributor shpk në vlerën 125,268.00 lekë me objekt shpenzimi “Blerje material pastrimi” , lloji procedurës së prokurimit blerje me vlerë të vogël, lloji kontratës mallra. Në zyrën e financës për dorëzimin e dokumenteve të procedurës nga kryetari i KPVV i dhe Përgjegjëses së Sektorit të Financës është mbajtur Proces-Verbal datë 22.06.2018. Praktika ligjore në origjinal. Me shkresën nr. 188 prot datë 20.02.2018 është bërë kërkesa për blerje material pastrimi, duke parashikuar një vlerë 190,075 lekë me Tvsh.

Grupi i punës për përllogaritjen e fondit limit ka firmosur deklaratën e konfliktit të interesit me datë 04.07.2018. Me datë 20.02.2018 është mbajtur PV mbi përllogaritjen e fondit limit nga Komisioni i Blerjeve me Vlerë të Vogël. Me urdhër prokurimi nr.189 datë 20.02.2018 titullari i AK ka lejuar përdorimin e procedurës prokurimit me vlerë të vogël, me fond limit 158.397 lekë pa TVSH . Me procesverbalin e mbajtur me datë 22.01.2018 nga KPVV mbi caktimin e nëpunësit të autorizuar të Komisionit të prokurimit me vlerë të vogël, i cili do të kryejë veprimet në sistemin e prokurimit elektronik në emër të komisionit është vendosur Z. A.S. Me shkresën nr.190, datë 20.02.2018 AK ka plotësuar formularin e ftesës për ofertë. Në praktikën e dorëzuar në zyrën e financës nga Z. A.S mungon deklarimi i Komisionit të Prokurimit me vlerë të vogël për kushtet e konfliktit të interesit. Me PV nr.1, mbajtur me datë 20.02.2018 në MHK mbi verifikimin e dokumentacionit të dorëzuar nga OE . KPVV ka vendosur të kualifikojë të gjitha ofertat e operatorëve ekonomikë në bazë të kriterit të vlerësimit çmimi më i ulët. Në klasifikimin përfundimtar ka rezultuar se janë kualifikuar 15 OE i renditur i pari Tim chemical distribution me vlerë ofertës 104390 lekë pa tvsh. Me datë 22.02.2018 në SPE është bërë njoftimi i OE i renditur i pari i shpallur fitues. Tim chemical distribution me nr.CN/49842/02222018. Kriteri i vlerësimit çmimi më i ulët. Me fletëhyrje nr.15 dhe nr.16 datë 16.07.2018 janë bërë hyrje në magazinë mallrat. Me faturë tatimore nr.846, datë 23.02.2018 është kryer veprimi në favor të blerësit MHK. Me fletëhyrje nr.3 datë 23.02.2018 është bërë hyrje e mallrave në magazinë në vlerën 117, 180 lekë. Me faturë tatimore nr.847, datë 23. 02. 2018 është kryer veprimi në favor të blerësit MHK në vlerën 6,740 pa tvsh ose 8,088 me tvsh. Me datë 23.02.2018 KPVV ka mbajtur PV mbi marrjen në dorëzim të mallrave. Me nr. Referencë -49342-02-20-2018 në sistemin e SPE është regjistruar procedura prokurimit “ Blerje materiale pastrimi” lloji procedurës blerje me vlerë të vogël, tipi kontratës mallra. Fondi limit 158,397.lekë pa tvsh, AK MHK. Nuk u konstatuan parregullsi në fazën e zhvillimit të procedurës prokurimit. Nga KPVV është kryer arkivimi i procedurës në SPE.



#### 4. Blerje Materiale elektrike

Të dhëna për tenderin	Komisioni i BVV	Njësia e prokurimit ose hartuesit e dokumenteve të tenderit
a	b	c
<b>U.Prokurimi nr. 923</b> prot.datë 31.10.2018 <b>Fondi limit 416.000 lekë</b> pa tvsh <b>Procedura:</b> Prokurim me vlerë të vogël. <b>Data</b> e zhvillimit të tenderit 2.11.2018 <b>Firma fituese:</b> “E.J” person fizik Data lidhjes së kontratës 2.11.2018 <b>Vlera e kontratës:</b> 359,999 lekë pa tvsh <b>Diferenca</b> nga fondi limit 56,001 lekë <b>pa tvsh</b>	A.S ,(Jurist) S.T, anëtar A.LL , anëtar	A.S ,(Jurist) S.T, anëtar A.LL , anëtar

Me urdhër shpenzimi nr.175 datë 15.11.2018 është likuaduar nga Muzeu Historik Kombëtar E.J Person fizik në vlerën 359,999.00 lekë me objekt shpenzimi “Blerje material elektrike”, lloji procedurës së prokurimit blerje me vlerë të vogël, lloji kontratës mallra. Në zyrën e financës për dorëzimin e dokumenteve të procedurës nga kryetari i KPVV dhe Përgjegjëses së Sektorit të Financës është mbajtur Proces-Verbal. Praktika ligjore në origjinal. Me shkresën nr.919 prot datë 31.10.2018 është bërë kërkesa për blerje material elektrike nga punonjësit:

1. F.B, Përgjegjësi i Sektorit për menaxhimin e Shërbimeve për Vizitorët
2. R.M, specialist
3. V.M, magazinier

Me urdhërin e brendshëm nr.11 datë 05.01.2018 është krijuar Komisioni i Prokurimit me Vlerë të vogël në përbërje:

Grupi i punës për përllogaritjen e fondit limit ka firmosur deklaratën e konfliktit të interesit me datë 30.10.2018..Me datë 30.10.2018 është mbajtur PV mbi përllogaritjen e fondit limit nga Komisioni i Blerjeve me Vlerë të Vogël në vlerën 416.000.00 lekë pa tvsh. Me procesverbalin e datës 31.10.2018 mbi caktimin e nënpunësit të autorizuar të Komisionit të prokurimit me vlerë të vogël, i cili do të kryejë veprimet në sistemin e prokurimit elektronik në emër të komisionit është vendosur Z. A.S. Me shkresën nr.924, datë 31.10.2018 AK ka plotësuar formularin e ftesës për ofertë. Me Proces-Verbalin e datës 31.10.2018 Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël ka vendosur që specifikimet teknike dhe kriteret e veçanta të kualifikimit të jenë sipas kërkesës 919 datë 30.10.2018 për fillimin e procedurës. Nga KPVV janë firmosur deklaratat e konfliktit të interesit.Me PV nr.1 datë 02.11.2018 KPVV ka vendosur të kualifikojë të gjitha ofertat e operatorëve ekonomikë nën vlerën e fondit limit duke përfunduar klasifikimin e ofertave në bazë të kriterit të vlerësimit çmimi më i ulët. Në klasifikimin përfundimtar ka rezultuar se janë kualifikuar 20 OE dhe është renditur në vendin e I-rë, “S...” shpk me vlerë të ofertës 217.000 lekë dhe janë skualifikuar 3 OE të cilët kishin ofruar vlera mbi fondin limit , ky skualifikim është kryer bazuar në rekomandimin e APP nr.6559 datë 27.06.2018. Me datë 05.11.2018 është mbajtur Proces-Verbal nr.2 nga komisioni i blerjeve të vogla për skualifikimin e OE “S...” shpk shpk i renditur në vend të parë pasi dokumentacioni i paraqitur në zyrën e protokollit nr.937 prot, datë 02.11.2018, nuk kishte përfshirë pagesën e energjisë për muajin shtator të 2018. KPBVV ka njoftuar shpalljen e fituesit për operatorin ekonomik të renditur në vend të dytë, O.D person fizik, me vlerë të ofertës 219900 lekë. Me datë 05.11.2018 është mbajtur Proces-Verbal nr.3 nga komisioni i blerjeve të vogla, pasi OE O.D person fizik i shpallur fitues ka deklaruar me mesazh në SPE mbi tërheqjen nga procedura prokurimit për arsye të llogaritjes gabim të



ofertës duke shpallur fitues S.RR me vlerë të ofertës 226.000 lekë. Me datë 06.11.2018 është mbajtur Proces-Verbal nr.4 nga komisioni i blerjeve të vogla, pas tërheqjes së OE në vend të tretë, ka njoftuar D.B person fizik i renditur i katërti me vlerën e ofertës 284.000 lekë. Kriteri i vlerësimit çmimi më i ulët. KPVV ka konstatuar se ky OE ka deklaruar me mesazh në SPE mbi tërheqjen nga procedura prokurimit për arsye objektive në hedhjen e ofertës dhe komisioni ka vendosur të njoftojë OE “I...-A...” shpk, me vlerë të ofertës 299.990 dhe me PV, nr.5 datë 06.11.2018, ka vendosur ta shpallë fitues. Me PV nr.6 pas tërheqjes së OE “I...-A...”, i cili ka njoftuar mesazh tërheqjen ka shpallur fituese personin fizik E.J e renditur e gjashta në klasifikim me vlerë të ofertës 299.999. Me faturën tatimore nr.155, datë 08.11.2018, është dokumentuar shitja në vlerën 299.999 lekë pa tvsh ose 359.999 lekë me tvsh sipas formularit të ofertës nr.27 datë 08.11.2018, është bërë hyrje në magazinë materialeve. Mallrat janë marrë në dorëzim nga Komisioni i blerjeve me vlerë të vogël. Me nr. Referencë -92286-10-31-2018 në sistemin e SPE është regjistruar procedura prokurimit “Blerje materiale elektrike” lloj procedurës blerje me vlerë të vogël, tipi kontratës mallra. Fondi limit 416.000 lekë pa tvsh. Nga KPVV është kryer arkivimi i procedurës në SPE.Me datë 08.11.2018 është mbajtur PV nga KPVV mbi dorëzimin e mallrave sipas specifikimeve të kërkuara në ftesën për ofertë. Marrja në dorëzim është bërë nga komisioni i blerjeve me vlerë të vogël :

Komisioni i Prokurimit të blerjeve me Vlerë të Vogël ka firmosur Proces verbalin e dorëzimit të mallit sipas specifikimeve teknike.

## 5. Blerje Materiale elektrike

Të dhëna për tenderin	Komisioni i BVV	Njësia e prokurimit ose hartuesit e dokumenteve të tenderit
<b>a</b>		
<b>U.Prokurimi</b> nr. 588 datë 05.07.2018 <b>Fondi limit 156,000 lekë pa tvsh</b> <b>Procedura:</b> Prokurim me vlerë të vogël. <b>Data</b> e zhvillimit të tenderit 09.07.2018 <b>Firma fituese:</b> R.Ç Pers. fizik Data lidhjes së kontratës dt. 09.07.2018 <b>Vlera e kontratës: 150.000 lekë pa TVSH</b> <b>Diferenca</b> nga fondi limit lekë 6,000 lekë <b>pa tvsh</b>	A.S ,(Jurist) S.T, anëtar A.LL , anëtar	A.S ,(Jurist) S.T, anëtar A.LL , anëtar

Me urdhër shpenzimi nr.108 datë 24.07.2018 është likujduar nga Muzeu Historik Kombëtar Riza Cera Person fizik në vlerën 150,000.00 me objekt shpenzimi “Blerje material elektrike”, lloji procedurës së prokurimit blerje me vlerë të vogël, lloji kontratës mallra. Në zyrën e financës për dorëzimin e dokumenteve të procedurës nga kryetari i KPVV z. Alban Saqellari dhe Përgjegjëses së Sektorit të Financës është mbajtur Proces-Verbal. Praktika ligjore në origjinal. Me shkresën nr.584 prot datë 04.07.2018 është bërë kërkesa për blerje material elektrike nga:

1. F.B, Përgjegjësi i Sektorit për menaxhimin e Shërbimeve për Vizitorët

2. R.M, specialist

V.M, magazinier

Me urdhërin e brendshëm nr.11 datë 05.01.2018 është krijuar Komisioni i Prokurimit me Vlerë të vogël

Grupi i punës për përllogaritjen e fondit limit ka firmosur deklaratën e konfliktit të interesit me datë 04.07.2018. Me datë 04.07.2018 është mbajtur PV mbi përllogaritjen e fondit limit nga Komisioni i Blerjeve me Vlerë të Vogël. Me procesverbalin e datës 05.07.2018 mbi caktimin e



nëpunësit të autorizuar të Komisionit të prokurimit me vlerë të vogël, i cili do të kryejë veprimet në sistemin e prokurimit elektronik në emër të komisionit është vendosur Z. Alban Saqellari. Me shkresën nr.589, datë 05.07.2018 AK ka plotësuar formularin e ftesës për ofertë. Me Proces-Verbalin e datës 05.07.2018 Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël ka vendosur që specifikimet teknike dhe kriteret e veçanta të kualifikimit të jenë sipas kërkesës nr. 584, datë 04.07.2018 për fillimin e procedurës. Nga KPVV janë firmosur deklaratat e konfliktit të interesit. Me PV nr.1 datë 09.07.2018 KPVV ka vendosur të kualifikojë të gjitha ofertat e operatorëve ekonomikë nën vlerën e fondit limit duke përfunduar klasifikimin e ofertave në bazë të kriterit të vlerësimit çmimi më i ulët. Në klasifikimin përfundimtar ka rezultuar se janë kualifikuar 11 OE dhe është renditur në vendin e I-rë: S.Rr Person Fizik, janë skualifikuar OE të cilët kishin ofruar vlera mbi fondin limit, ky skualifikim është kryer bazuar në rekomandimin e APP nr.6559 datë 27.06.2018. Me datë 09.07.2018 është mbajtur Proces-Verbal nr.2 nga komisioni i blerjeve të vogla ka vendosur hedhjen e shortit për përcaktimin e klasifikimit të ofertave për vendin e 10 dhe të 11, pasi ka konstatuar që pas vlerësimit të ofertave OE T. K dhe G.A shpk ishin me vlerë ekonomike të barabartë prej 156,000.00 lekë. Me datë 09.07.2018 është mbajtur Proces-Verbal nr.3 nga komisioni i blerjeve të vogla I cili ka vendosur hedhjen e shortit për përcaktimin e klasifikimit të ofertave për vendin e 10 dhe të 11, megjithse nuk janë paraqitur asnjëri nga OE duke vendosur pas hedhjes së shortit në T.K në vendin e dhjetë dhe G.A në vendin e 11. Me datë 09.07.2018 është mbajtur Proces-Verbal nr. 4 nga komisioni i blerjeve të vogla është përfunduar klasifikimi i ofertave mbi procedurën e prokurimit me vlerë të vogël ku ka rezultuar në vendin e parë OE S.RR, vlera 69,500.000. Kriteri i vlerësimit çmimi më i ulët. OE i shpallur fitues ka deklaruar me mesazh në SPE mbi tërheqjen nga procedura prokurimit për arsye objektive. Me datë 09.07.2018 është mbajtur Proces-Verbal nr. 5 nga komisioni i blerjeve të vogla, pas tërheqjes së OE S.RR vlera 69,500.000, ka njoftuar OE A.I person fizik i renditur i dyti me vlerën e ofertës 79,000.00 lekë. Kriteri i vlerësimit çmimi më i ulët. KPVV ka konstatuar se ky OE ka deklaruar me mesazh në SPE mbi tërheqjen nga procedura prokurimit për arsye të gabimit njerëzor në hedhjen e ofertës..Me faturën tatimore nr.167, datë 02.05.2018, dokumentuar veprimi në vlerën 78,880 lekë pa tvsh ose 94,560 me Tvsh. Me fletëhyrje nr.12 datë 11.07.2018 është bërë hyrje në magazinë materialeve. Me faturë tatimore nr.335, datë 11.07.2018 është kryer veprimi në favor të blerësit MHK në vlerën 125,000.00 pa tvsh ose 150,000.00 me tvsh. Mallrat janë marrë në dorëzim nga Komisioni i blerjeve me vlerë të vogël. Me nr. Referencë -78052-07-05-2018 në sistemin e SPE është regjistruar procedura prokurimit "Blerje materiale elektrike" lloj procedurës blerje me vlerë të vogël, tipi kontratës mallra. Fondi limit 156,000.00 lekë. Autoriteti Kontraktor Muzeu Historik Kombëtar. Nuk u konstatuan parregullsi në fazën e zhvillimit të procedurës prokurimit. Nga KPVV është kryer arkivimi I procedurës në SPE. Me datë 11.07.2018 është mbajtur PV nga KPVV mbi dorëzimin e mallrave sipas specifikimeve të kërkuara në ftesën për ofertë. Marrja në dorëzim është bërë nga komisioni i blerjeve me vlerë të vogël: A.S, A.LL, S.T.

Komisioni i Prokurimit blerjeve me Vlerë të Vogël ka firmosur Proces verbalin e dorëzimit të mallit sipas specifikimeve teknike. Me faturën tatimore nr.335 datë 11.07.2018 është kryer shitja e mallit në vlerën 150.000 lekë. Me fletë hyrje nr.12 datë 11.07.2018 është bërë hyrje malli në magazinë.

**6. "Shërbim i sigurisë fizike të MHK me roje private për nevoja emergjente të vitit 2018".**

Të dhëna për tenderin	Komisioni i vlerësimit të ofertave	Njësia e prokurimit ose hartuesit e dokumenteve të tenderit
a	b	c
<b>U.Prokurimi nr.195 datë 20.02.2018</b> <b>Fondi limit 971,975.48 lekë pa tvsh</b> <b>Procedura Negocim pa shpallje njoftimit kontratës .</b> <b>Data e zhvillimit të tenderit</b> <b>Firma fituese: R.Ç Pers. fizik</b> Data lidhjes së kontratës dt. 09.07.2018 <b>Vlera e kontratës: 150.000 lekë pa TVSH</b> <b>Diferenca nga fondi limit lekë 6,000 lekë pa tvsh</b>	F.B, kryetar A.LL, anëtar S.T, anëtar	A.S Jurist R.M, anëtar S.N , anëtar

Me urdhrin e brendshëm me nr.141 prot, datë 09.02.2018, titullari i autoritetit kontraktor bazuar në ligjin 9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar nenin 59 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për rregullat e prokurimit publik" ka urdhëruar të ngrihet grupi i punës për llogarijen e fondit limit në përbërje: M.K, Kryetare (Përgjegjëse Finance) dhe F.L, anëtare (specialiste finance).

**7. Shërbimi privat i sigurisë fizike të Muzeut Historik Kombëtar - Marrëveshje - Kuadër- me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara.**

Të dhëna për tenderin	Komisioni i vlerësimit të ofertave	Njësia e prokurimit ose hartuesit e dokumenteve të tenderit
a	b	c
<b>U. Prokurimi nr.4 datë 04.01.2018</b> <b>Fondi limit 5, 976,000 lekë pa tvsh</b> <b>Procedura:</b> kërkesë për propozim <b>Data e zhvillimit të tenderit 15.01.2018</b> <b>Firma fituese: "S... SH.P.K.</b> Data lidhjes së kontratës 25.04.2018 <b>Vlera e kontratës: 6,998,328.96 (4,812,549.5</b> lekë viti 2018 dhe 2,185,779.46 lekë viti 2019 <b>Diferenca nga fondi limit 1,163,451 lekë</b>	F.B Kryetar S.B, anëtar S.T anëtar	A.S Jurist R.M, anëtar S.N , anëtar

Me urdhrin e brendshëm me nr.987 datë 19.12.2017 titullari i autoritetit kontraktor bazuar në nenin 59 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 " Për rregullat e prokurimit publik" ka urdhëruar të ngrihet grupi i punës për llogarijen e fondit limit në përbërje:

*M.K, Kryetare*

*A.LL, anëtar*

*F.L, anëtar*

Nga grupi i punës për llogarijen e fondit limit me datë 19.12.2017 janë nënshkruar formulari deklarimit të konfliktit të interesit.

Me shkresën nr.981/1 prot, datë 20/12/2017 është bërë dokumentimi i përlllogaritjes fondit limit për këtë shërbim si më poshtë:

Vlera për një roje në muaj = 50 000 lekë pa tvsh,

Vlera për një vend roje në muaj në muaj= 249 000 lekë pa tvsh,

Vlera për dy vend roje në muaj=498 000 lekë pa tvsh,

Vlera totale për 12 muaj = 5 976 000 lekë pa tvsh .



Në datë 04.01.2018 ka dalë Urdhëri i Prokurimit nr. 4 prot. për fillimin e procedurës me objekt “Shërbimi privat i sigurisë fizike të Muzeut Historik Kombëtar - Marrëveshje Kuadër- me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara-me afat 12 muaj- me vlerë 5 976 000 lekë pa tvsh, dhe fondi limit 8 186.30 lekë pa tvsh për një vend/roje ditore, lloji procedurës prokurimit “kërkesë për propozim”.

Me datë 04.01.2018 është mbajtur proces-verbal nga njësia e hartimit dokumentave për hartimin e dokumentave të prokurimit me objekt “Shërbimi privat i sigurisë fizike të Muzeut Historik Kombëtar - Marrëveshje Kuadër- me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara-me afat 12 muaj- me vlerë 5 976 000 lekë pa tvsh. Proces verbal i firmosur nga të gjithë anëtarët e komisionit.

Me proces-verbalin e mbajtur me datë 04.01.2018 në Muzeun Historik Kombëtar mbi caktimin e nënpunësit i cili do kryejë veprimet në sistemin e prokurimit elektronik njësia e hartimit të dokumentave ka miratuar dokumentat e tenderit dhe ka vendosur që nënpunësi i autorizuar që do kryejë veprime në emër të komisionit është Z. A.S.

(Proces- verbal i firmosur nga anëtarët e komisionit). Me datë 04.01.2018 ka dalë urdhëri nr. 5 prot, për krijimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

Me datë 04.01.2018 ka dalë urdhëri i titullarit nr. 5 prot, për ngritjen e Komisioni i Vlerësimit të Ofertav (K.V.O).

Me shkresën nr.6 prot, datë 04.01.2018 është plotësuar njoftimi i kontratës nga Autoriteti Kontraktor për tu publikuar në Buletinin e Njoftimeve publike. Në buletin nr.1 datë 08.01.2018 të APP është bërë publikimi i procedurës. Me shkresën nr.7 datë 05.01.2018 në përputhje me kërkesat e VKM nr.914, datë 29.12.2014 neni 34 “Kërkesa për propozime” pika 4, nga AK është bërë ftesa për ofertë për 5 OE. Kriteri i vlerësimit është përcaktuar çmimi më i ulët. Afati i hapjes së ofertave data 15.01.2018. Me datë 15.01.2018 janë firmosur deklaratat e konfliktit të interesit.

Në datë 15.01.2018, është zhvilluar procedura e hapjes së ofertave nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ku ka rezultuar se kanë paraqitur oferta 28 operatorë ekonomikë Pas përfundimit të shqyrtimit të ofertave në datë 18.01.2018, KVO ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton se, janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

- |    |               |             |
|----|---------------|-------------|
| 1. | “C..M” shpk   | L02308019F  |
| 2. | “L..S” shpk   | L31519018N  |
| 3. | “A..” SHA     | K21310002U  |
| 4. | “S..S..” shpk | K77217701L  |
| 5. | “D..S..” shpk | K51521007J  |
| 6. | “S...” shpk   | K31320001R  |
| 7. | “A...” shpk   | K26307202E  |
| 8. | “F...” shpk   | K31404040 G |



9.	"O..." shpk	K72002014B
10.	"S..." shpk	K41424040P
11.	"O.." shpk	K31515076S
12.	"F...S" shpk	K61628006R
13.	"F...S ..Group" shpk	L22309011R
14.	"K...." shpk	K72407001H
15.	"M...S.." shpk	K23323401N
16.	"B..." shpk	K31426033S
17.	"R.." shpk	K26513468E
18.	"N.." shpk	K31422029Q
19.	"T..." shpk	K19303605O
20.	"G..S.." shpk	L01614030H
21.	"P..S.." shpk	K11423005T
22.	"E...S..." shpk	K31929010K
23.	"T..S.." shpk	K94010201F
24.	"A.." shpk	K72117028D

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1. Ofertim nën koston minimale ligjore të detyrueshme për këtë shërbim.
2. Mosplotësim të kriterëve të kualifikimit.
3. Mungesë dokumentacioni kualifikues

Janë kualifikuar ofertuesit e mëposhtëm

1.	"S..." shpk	J61817070O
2.	"A..S.." shpk	K39003551E
3.	"S.." shpk	K01625002K
4.	"I.." shpk	L02004016V

Komisioni ka arritur në konkluzionin se pas zbatimit të formulës oferta anomalisht të ulëta nuk kishte. Komisioni i vlerësimit të ofertave ka kryer verifikimin e veprimeve aritmetike dhe ka rezultuar se nuk kishte gabime aritmetike në asnjë prej ofertave.

Nga verifikimi i dokumentacionit për këtë procedurë prokurimi u konstatua se ka patur disa ankesa nga OE pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi. Më konkretisht.

Me shkresën e protokolluar në Muzeun Historik Kombëtar nr.40 datë 12.01.2018 është paraqitur pranë AK formulari i ankesës OE "L..S.." sh.p.k.

Me shkresën nr.40/1 prot, datë 15.01.2018, AK pasi ka marrë në shqyrtim ankesën ka kthyer përgjigje brenda afatit ligjor duke arsyetuar ndër të tjera se nuk qëndron ankesa në lidhje me skualifikimin e padrejtë të ofertës pasi ofertat për këtë procedurë hapen me datë 15.01.2018.

Me shkresën e protokolluar në Muzeun Historik Kombëtar nr. nr.61 prot, datë 22.01.2018 është paraqitur pranë AK formulari i ankesës "K..S.." shpk.

Po në datë 22.01.2018 me shkresën nr.62 prot datë 22.01.2018 Titullari i Autoritetit Kontraktor mbështetur në nenin 63, pika 3, të ligjit 9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, neni 78, pika 6 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të



prokurimit publik“ ka vendosur pezullimin e procedurës së prokurimit deri në shqyrtimin e plotë të ankesës. Pas shqyrtimit të ankesës komisioni i shqyrtimit të ankesave me përbërje A.LL, B.B, E,K, me vendimin nr.1 datë 23.01.2018 ka vendosur të refuzoj ankesën e shoqërisë “**K..S..**“ shpk. Shkresa nr.61/1 datë 23.01.2018.

Përgjigjja e ankesës i është dërguar OE dhe në rrugë elektronike.

Me shkresën nr.65 prot, datë 22.01.2018 është paraqitur pranë AK formulari i ankesës i O.E. “**T..S..**“ shpk. Titullari i Autoritetit Kontraktor mbështetur në nenin 63, pika 3, të ligjit 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik i ndryshuar , neni 78, pika 6 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik“ ka vendosur pezullimin e procedurës së prokurimit deri në shqyrtimin e plotë të ankesës. Komisioni i shqyrtimit ankesave , pas shqyrtimit ankesës me vendimin nr.2 datë 23.01.2018 ka vendosur të refuzoj ankesën e shoqërisë “**T..S..**” shpk. Shkresa nr.65/1 datë 23.01.2018. Me shkresën 65/2 prot, datë 23.01.2018 AK i ka kthyer përgjigje ankesës OE. Përgjigjja e ankesës i është dërguar OE dhe në rrugë elektronike.

Me shkresën nr.66 prot, datë 22.01.2018 është paraqitur pranë AK formulari i ankesës i O.E. “**F..S..Group**” shpk. Titullari i Autoritetit Kontraktor mbështetur në nenin 63, pika 3, të ligjit 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik i ndryshuar , neni 78, pika 6 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik“ ka vendosur pezullimin e procedurës së prokurimit deri në shqyrtimin e plotë të ankesës. Komisioni i shqyrtimit ankesave pas shqyrtimit ankesës me vendimin nr.3 datë 23.01.2018 ka vendosur të refuzoj ankesën e shoqërisë “**F..S..Group**” shpk. Shkresa nr.66/1 datë 23.01.2018. Me shkresën 66/2 prot, datë 23.01.2018 AK i ka kthyer përgjigje ankesës OE. Përgjigjja e ankesës i është dërguar OE dhe në rrugë elektronike.

Me shkresën nr.72 prot, datë 23.01.2018 është paraqitur pranë AK formulari i ankesës i O.E. “**S...**” shpk. Titullari i Autoritetit Kontraktor mbështetur në nenin 63, pika 3, të ligjit 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik i ndryshuar , neni 78, pika 6 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik“ ka vendosur pezullimin e procedurës së prokurimit deri në shqyrtimin e plotë të ankesës. Komisioni i shqyrtimit ankesave pas shqyrtimit ankesës me vendimin nr.4 datë 23.01.2018 ka vendosur të refuzoj ankesën e shoqërisë “**S..**” shpk. Shkresa nr.72/1 datë 24.01.2018. Me shkresën 72/2 prot, datë 24.01.2018 AK i ka kthyer përgjigje ankesës OE. Përgjigjja e ankesës i është dërguar OE dhe në rrugë elektronike.

Me shkresën nr.73 prot, datë 23.01.2018 është paraqitur pranë AK formulari i ankesës i O.E. “**R..**” shpk. Titullari i Autoritetit Kontraktor mbështetur në nenin 63, pika 3, të ligjit 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik i ndryshuar , neni 78, pika 6 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik“ ka vendosur pezullimin e procedurës së prokurimit deri në shqyrtimin e plotë të ankesës. Komisioni i shqyrtimit ankesave pas shqyrtimit ankesës me vendimin nr.5 datë 23.01.2018 ka vendosur të refuzoj ankesën e shoqërisë “**R..**” shpk. Shkresa nr.73/1 datë 24.01.2018. Me shkresën 73/2 prot, datë 24.01.2018 AK i ka kthyer përgjigje ankesës OE. Përgjigjja e ankesës i është dërguar OE dhe në rrugë elektronike.

Me shkresën nr.75 prot, datë 23.01.2018 është paraqitur pranë AK formulari i ankesës i O.E. “**E..S..**” shpk. Titullari i Autoritetit Kontraktor mbështetur në nenin 63, pika 3, të ligjit 9643 datë



20.11.2006 "Për prokurimin publik i ndryshuar , neni 78, pika 6 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" ka vendosur pezullimin e procedurës së prokurimit deri në shqyrtimin e plotë të ankesës. Komisioni i shqyrtimit ankesave pas shqyrtimit ankesës me vendimin nr.6 datë 23.01.2018 ka vendosur të refuzoj ankesën e shoqërisë "E..S..." shpk. Shkresa nr.75/1 datë 24.01.2018. Me shkresën 75/2 prot, datë 24.01.2018 AK i ka kthyer përgjigje ankesës OE. Përgjigjja e ankesës i është dërguar OE dhe në rrugë elektronike.

Me shkresën nr.76 prot, datë 23.01.2018 është paraqitur pranë AK formulari i ankesës i O.E. "N..." shpk. Titullari i Autoritetit Kontraktor mbështetur në nenin 63, pika 3, të ligjit 9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik i ndryshuar , neni 78, pika 6 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" ka vendosur pezullimin e procedurës së prokurimit deri në shqyrtimin e plotë të ankesës. Komisioni i shqyrtimit ankesave pas shqyrtimit ankesës me vendimin nr.7 datë 24.01.2018 ka vendosur të refuzoj ankesën e shoqërisë "N..." shpk. Shkresa nr.76/1 datë 24.01.2018. Me shkresën 76/2 prot, datë 24.01.2018 AK i ka kthyer përgjigje ankesës OE. Përgjigjja e ankesës i është dërguar OE dhe në rrugë elektronike.

Me shkresën nr.77 prot, datë 23.01.2018 është paraqitur pranë AK formulari i ankesës i O.E. "D..S..." shpk. Titullari i Autoritetit Kontraktor mbështetur në nenin 63, pika 3, të ligjit 9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik i ndryshuar , neni 78, pika 6 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" ka vendosur pezullimin e procedurës së prokurimit deri në shqyrtimin e plotë të ankesës. Komisioni i shqyrtimit ankesave pas shqyrtimit ankesës me vendimin nr.8 datë 24.01.2018 ka vendosur të refuzoj ankesën e shoqërisë "D..S..." shpk. Shkresa nr.78/1 datë 24.01.2018. Përgjigjja e ankesës 78/2 datë 24.01.2018 i është dërguar OE dhe në rrugë elektronike.

Me shkresën nr.78 prot, datë 23.01.2018 është paraqitur pranë AK formulari i ankesës i O.E. "O...." shpk. Titullari i Autoritetit Kontraktor mbështetur në nenin 63, pika 3, të ligjit 9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik i ndryshuar , neni 78, pika 6 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" ka vendosur pezullimin e procedurës së prokurimit deri në shqyrtimin e plotë të ankesës. Komisioni i shqyrtimit ankesave pas shqyrtimit ankesës me vendimin nr.9 datë 24.01.2018 ka vendosur të refuzoj ankesën e shoqërisë "O..." shpk. Shkresa nr.78/1 datë 24.01.2018. Përgjigjja e ankesës 78/2 datë 24.01.2018 i është dërguar OE dhe në rrugë elektronike.

Me shkresën nr.81 prot, datë 24.01.2018 është paraqitur pranë AK formulari i ankesës i O.E. "S..." shpk. Titullari i Autoritetit Kontraktor mbështetur në nenin 63, pika 3, të ligjit 9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik i ndryshuar , neni 78, pika 6 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" ka vendosur pezullimin e procedurës së prokurimit deri në shqyrtimin e plotë të ankesës. Komisioni i shqyrtimit ankesave pas shqyrtimit ankesës me vendimin nr.10 datë 25.01.2018 ka vendosur të refuzoj ankesën e shoqërisë "S..." shpk. Shkresa nr.81/1 datë 25.01.2018. Përgjigjja e ankesës 81/2 datë 25.01.2018 i është dërguar OE dhe në rrugë elektronike.

Me shkresën nr.86 prot, datë 25.01.2018 është paraqitur pranë AK formulari i ankesës i O.E. "S..." shpk. Titullari i Autoritetit Kontraktor mbështetur në nenin 63, pika 3, të ligjit 9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik i ndryshuar , neni 78, pika 6 të VKM nr.914 datë



29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" ka vendosur pezullimin e procedurës së prokurimit deri në shqyrtimin e plotë të ankesës. Komisioni i shqyrtimit ankesave pas shqyrtimit ankesës me vendimin nr.11 datë 25.01.2018 ka vendosur të refuzoj ankesën e shoqërisë "S.." shpk. Shkresa nr.86/1 datë 25.01.2018. Përgjigjja e ankesës 86/2 datë 25.01.2018 i është dërguar OE dhe në rrugë elektronike.

Nga O.E. ankimues nga shqyrtimi i dokumentacionit ligjor të dosjes dosjes rezulton se kanë paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik shoqëria "K.." shpk, "T..S.." shpk, "N..." shpk, "O..." shpk, "F..S.." shpk, "D..S.." shpk, "S..." shpk dhe "S.." shpk. Më konkretisht: Me shkresën nr.982 prot, datë 01.02.2018 është paraqitur pranë KPP formulari i ankesës i O.E. "S.." shpk.

Me datë 26.01.2018 është paraqitur pranë KPP formulari i ankesës i O.E. "N..." shpk.

Me datë 31.01.2018 është paraqitur pranë KPP formulari i ankesës i O.E. "D..S..." shpk.

Me vendimin nr.102/1 datë 26.01.2018 KPP ka udhëruar pezullimin e procedurës prokurimit dhe shqyrtimin në themel të çështjes.

Me shkresën nr.01/2 prot, datë 01.02.2018 është paraqitur pranë KPP formulari i ankesës i O.E. "S.." shpk.

Me vendimin nr.142/1 prot, datë 01.02.2018 ka vendosur shqyrtimin në themel të çështjes dhe ka kërkuar pranë AK informacion dhe dokumentacion mbi procedurën e prokurimit.

Me shkresën 98/1 prot, datë 29.01.2018 AK MHK, i ka dërguar informacion Komisioni Prokurimit Publik (KPP) mbi procedurën e prokurimit.

Me shkresën nr.11 prot, datë 01.02.2018 AK MHK,i ka dërguar informacion KPP mbi procedurën e e prokurimit .

Me shkresën nr.122 prot, datë 06.02.2018 është dërguar nga AK informacion KPP mbi procedurën e prokurimit.

Komisioni i Prokurimit Publik në përfundim të shqyrtimit të ankesave me Vendimin nr. 97/2018 datë 05.03.2018, korrigjuar me Vendimin nr. 119/2018 datë 13.03.2018 ka vendosur:

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik "K.." shpk për procedurën e prokurimit "Kërkesë për propozim", me Nr. REF-39764-01-04-2018, me objekt "Shërbimi privat i sigurisë fizike të Muzeut Historik Kombëtar - Marrëveshje Kuadër – me nje operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj", me fond limit 5,976,000.00 pa tvsh, zhvilluar më datë 15.01.2018, nga autoriteti kontraktor Muzeu Historik Kombëtar.
2. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik "T.S" shpk për procedurën e prokurimit të lartpërmendur.
3. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik "N.." shpk për procedurën e prokurimit të lartpërmendur.
4. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik "O.." shpk për procedurën e prokurimit të lartpërmendur.
5. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik "F..S.. Group" shpk për procedurën e prokurimit të lartpërmendur.
6. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik "D..S.." shpk për procedurën e prokurimit të lartpërmendur.



7. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “S...” shpk për procedurën e prokurimit të lartpërmendur.
8. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “S...” shpk për procedurën e prokurimit të lartpërmendur.

Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.

Në datë 23.03.2018 Autoriteti Kontraktor me shkresën nr.298 prot, datë 23.03.2018 ka paraqitur kërkesë për rishikim vendimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik. Në datë 16.04.2018 është bërë në SPE rivlerësimi i ofertave duke kualifikuar ofertën e O.E. “T.S” shpk, “N..” shpk “O..” shpk “F...S...Group” shpk dhe “D..S...” shpk. Në këto kushte në garë mbetën 3 (tre) operatorë ekonomikë të kualifikuar me vlerë të barabartë të ofertës. Në zbatim të nenit 66 pika 8 të V.K.M. nr. 914 datë 29.12.2017 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar në datë 18.04.2018 është hedhur shorti për shpalljen e fituesit ku në klasifikimin përfundimtar fituese ka rezultuar oferta e O.E. “D..S...” shpk. Në zbatim të nenit 68 të V.K.M. nr. 914 datë 29.12.2017 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar nga KVO është mbajtur raporti përmbledhës për procedurën e prokurimit. **Shkresa nr.357 prot, datë 18.04.2018.** Me shkresën nr.298/1 prot, datë 18.04.2018 AK ka kërkuar KPP heqjen e pezullimit të procedurës. Me vendimin nr.119/4 /2018 KPP ka vendosur heqjen e pezullimit për procedurën e prokurimit. Me shkresën nr.366 prot, datë 24.04.2018 është plotësuar nga AK formulari i njoftimit të fituesit “ D..S..”. Në buletin nr.17 datë 30.04.2018 të APP është publikuar formulari i njoftimit të fituesit . Nga OE i shpallur fitues është plotësuar formulari i deklaramentit të ofertës me çmimi njësi dite në vlerën 7 988.96 pa tvsh ose 9 586.75 me tvsh. Nga anëtarët e KVO është mbajtur dhe PV mbi verifikimin e dokumentacionit të paraqitur nga OE “ D..S..” në rrugë shkresore me dokumentacionin e paraqitur në rrugë elektronike , ku ka rezultuar se dokumentacioni është i njëjtë. Me shkresën nr.373 prot, datë 25.04.2018 është lidhur **Marrëveshje Kuadër ( ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara)**, midis institucionit MHK me cilësinë e AK dhe shoqërisë “ D..S..” shpk përfaqësuar nga administrator A.M, me cilësinë e Kontraktuesit. Lloji marrëveshjes shërbim. Me shkresën nr.374 prot, datë 25.04.2018 është lidhur kontrata e shërbimit midis institucionit MHK me cilësinë e AK dhe shoqërisë “ D..s..” shpk përfaqësuar nga administrator A.M me cilësinë e Kontraktuesit. Vlera e kontratës 5,831 940.8 lekë pa tvsh ose 6,998 328.96 lekë me tvsh nga të cilat vlera 4,010 457.92 lekë pa tvsh ose 4,812 549.50 lekë me tvsh janë nga buxheti i vitit 2018, ndërsa vlerat 1,821 482.88 lekë pa tvsh ose 2.185 779.46 lekë me tvsh janë nga buxheti i vitit 2019. Me shkresën nr.380 prot, datë 26.04.2018 AK ka plotësuar dhe formularin e njoftimit të kontratës. Me shkresën nr.381 prot, datë 26.04.2018 AK ka plotësuar dhe formularin e publikimit të kontratës. Nga verifikimi në SPE të APP për AK u konstatua se:

**Në datën 05.01.2018 në sistemin e prokurimeve elektronike me nr. REF-39764-01-04-2018,** është publikuar procedura e prokurimit, me objekt “Shërbimi privat i sigurisë fizike të Muzeut Historik Kombëtar - Marrëveshje Kuadër – me nje operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj”, me fond limit 5,976,000.00 pa tvsh, zhvilluar më datë 15.01.2018, nga autoriteti kontraktor Muzeu Historik Kombëtar. Me urdhër shpenzimi nr.72 datë 07.05.2018 me objekt shpenzimi Shërbim roje private viti 2018 periudha 25.03.2018 deri 30.04.2018 është likuiduar OE “ D..S..” në vlerën 95 868 lekë pa tvsh ose 115,041.00 lekë me



tvsh. Me urdhër shpenzimi nr. datë me objekt shpenzimi Shërbim roje private viti 2018 periudha Maj 2018 është likujduar OE në vlerën 594 378 me tvsh. Me urdhër shpenzimi nr.100 datë 16.07.2018 me objekt shpenzimi Shërbim roje private viti 2018 periudha qershor 2018 është likujduar OE në vlerën 575,204.00 lekë me tvsh. Me urdhër shpenzimi nr. datë me objekt shpenzimi “ Shërbim roje private viti 2018” periudha Korrik 2018 është likujduar OE në vlerën 594 378 lekë me tvsh.Me urdhër shpenzimi nr. datë me objekt shpenzimi “ Shërbim roje private viti 2018” periudha Gusht 2018 është likujduar OE në vlerën 594 378 lekë me tvsh. Me urdhër shpenzimi nr. datë me objekt shpenzimi “ Shërbim roje private viti 2018” periudha Shtator 2018 është likujduar OE në vlerën 575 204 lekë me tvsh. Me urdhër shpenzimi nr. datë me objekt shpenzimi “ Shërbim roje private viti 2018” periudha Tetor 2018 është likujduar OE në vlerën 594 378 lekë me tvsh. Me urdhër shpenzimi nr. datë me objekt shpenzimi “ Shërbim roje private viti 2018” periudha Nëntor 2018 është likujduar OE në vlerën 594 378 lekë me tvsh. Me urdhër shpenzimi nr. datë me objekt shpenzimi “ Shërbim roje private viti 2018” periudha Nëntor 2018 është likujduar OE në vlerën 575 204 lekë me tvsh. Me urdhër shpenzimi nr. datë me objekt shpenzimi “ Shërbim roje private viti 2018” periudha Nëntor 2018 është likujduar OE në vlerën 594 378 lekë me tvsh.

Vlera e likujduar në total 4, 812 543 lekë sipas vlerës kontratës. Inventarizuar dosja në përputhje me ligjin për arkivën.

*Për sa më sipër, u mbajt akt konstatimi nr.5 datë 28.02.2019 mbi përfshirjen Përgjegjëses së Financës në grupin e punës për përlogaritjen e fondit limit*

## 7. “ Blerje tonera kancelari”

Nga shqyrtimi dhe verifikimi i dokumentacionit të procedurës së prokurimit blerje me vlerë të vogël me objekt “blerje tonera kancelari”u konstatua mangësi në mosrespektim të kërkesave ligjore në plotësimin e formularit për parandalimin e konfliktit interes.

Të dhëna për tenderin	Komisioni i Blerjeve me vlerë të vogël	Njësia e prokurimit ose hartuesit e dokumenteve të tenderit
a	b	c
<b>U.Prokurimi</b> nr.228 prot, datë 05.03.2018 <b>Fondi limit 166.667.000</b> lekë pa tvsh <b>Procedura:</b> Prokurim me vlerë të vogël. <b>Data</b> e zhvillimit të tenderit 07.03.2018 <b>Firma fituese:</b> “K...” Data lidhjes kontratës dt. 15.08.2018 <b>Vlera e kontratës:</b> 158.400.000 <b>pa TVSH</b> <b>Diferenca</b> nga fondi limit lekë <b>pa tvsh 7,067 lekë</b>	A.S ,(Jurist) S.T, anëtar A.LL, anëtar	A.S ,(Jurist) S.T, anëtar A.LL, anëtar

Me shkresën nr.227 prot, datë 02.03.2018 për nevoja pune i është paraqitur titullarit të institucionit kërkesa për blerje bojë printerash, bojë fotokopje dhe kancelari në përdorim të punonjësve të institucionit. Me urdhër të brendshëm nr.11, datë 05.01.2018, nga titullari institucionit është ngritur KPVV.Me urdhër prokurimi nr. 228 datë 05.03.2018 titullari AK ka urdhëruar prokurimin me vlerë të vogël me objekt “Blerje tonera kancelari”. Me datë 05.03.2018, KPVV ka dokumentuar përlogaritjen e fondit limit në vlerën 166.666.00 lekë pa tvsh. Me Proces-Verbal datë 05.03.2018 mbi caktimin e nënpunësit zbatues, KPVV ka vendosur që nënpunësi i autorizuar i KPVV të jetë Z. A.S, i cili ka kryer veprimet në SPE. Me shkresën nr.229 prot, datë 05.03.2018 është bërë nga AK ftesa për ofertë. Me datë 07.03.2018 KPVV ka



mbajtur Proces-verbalin nr.1, dhe ka kualifikuar ofertat e OE të cilët e kishin të përfshirë objektin e prokurimit në fushën e veprimtarisë së tyre. Në klasifikimin përfundimtar janë kualifikuar 20 OE. Me datë 07.03.2018 KPVV, ka mbajtur PV nr.2 pasi pas vlerësimit të ofertave për procedurën e prokurimit ka konstatuar se dy OE Klodjan Kamberi person fizik, R..shpk dhe E.D janë me vlerë ekonomike të barabartë 150.000 lekë. Në bazë të udhëzimit nr.3 datë 08.01.2018 “ Për përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike” KBVV ka vendosur të njoftojë këta OE në SPE për hedhjen e shortit për klasifikimin e ofertave në vend të nëntë, të dhjetë dhe të njëmbëdhjetë. Gjithashtu me vlerë ekonomike të barabartë kanë rezultuar OE I..O...shpk dhe P..-L.. shpk me vlerë oferte 155000 lekë. Me datë 07.03.2018 KPVV, ka mbajtur PV nr.3, për hedhjen e shortit dhe ka klasifikuar OE K.K person fizik në vend të 9-të, R.. shpk në vend të dhjetë, E.D në vend të njëmbëdhjetë. Me PV.nr.4 datë 08.03.2018 KPVV ka skualifikuar OE E...shpk i renditur i pari në klasifikimin përfundimtar me vlerë oferte 102.350 lekë sepse ky OE nuk është paraqitur brenda afateve dhe nuk ka deklaruar tërheqjen nga kjo procedurë. Me PV.nr.5 datë 08.03.2018 KPVV ka skualifikuar OE E.L person fizik i renditur i dyti në klasifikimin përfundimtar me vlerë oferte 115000 lekë sepse ky OE nuk është paraqitur brenda afateve për arsye se nuk ka gjendje sasinë e kërkuar të mallit. Me PV.nr.6 datë 09.03.2018 KPVV ka skualifikuar OE A.B person fizik i renditur i treti në klasifikimin përfundimtar me vlerë oferte 127220 lekë sepse ky OE nuk është paraqitur brenda afateve dhe ka deklaruar tërheqjen nga oferta për arsye të përlogaritjes gabim të vlerës së ofertës dhe komisioni ka kualifikuar OE të klasifikuar në vend të katërt A.K person fizik me vlerë oferte 132 000 lekë. Komisioni ka vendosur ta njoftojë këtë operator për të furnizuar mallin-objekt prokurimi.

Me nr. Reference 53127-03-05-2018 është regjistruar procedura me objekt “ Blerje tonera dhe kancelari” me fond limit 166.666.00 lekë. KPVV ka arkivuar dosjen në SPE.

Me urdhër shpenzimi nr.44, datë 20.03.2018 është likujduar OE Adenis Kastrati, person fizik në vlerën 158.000 lekë, bashkëlidhur urdhrat faturë tatimore e shitjes nr.34 datë 13.03.2018 në vlerën 132000 pa tvsh ose 158.400 me tvsh sipas preventivit. Me fletëhyrje nr.6, datë 13.03.2018 është bërë hyrje malli në magazinë sipas specifikimeve të kërkuara në preventiv. Me fletëhyrje nr.7, datë 13.03.2018 është bërë hyrje malli në magazinë sipas specifikimeve të kërkuara në preventiv. Me datë 13.03.2018 është mbajtur PV nga KPVV mbi dorëzimin e mallrave sipas specifikimeve të kërkuara në ftesën për ofertë.

## 8. Blerje Materiale elektrike

Të dhëna për tenderin	Komisioni i BVV	Njësia e prokurimit ose hartuesit e dokumenteve të tenderit
a	b	c
<b>U.Prokurimi nr. 923</b> prot.datë 31.10.2018 <b>Fondi limit 416.000 lekë</b> pa tvsh <b>Procedura:</b> Prokurim me vlerë të vogël. <b>Data</b> e zhvillimit të tenderit 2..11.2018 <b>Firma fituese:</b> “E.J” person fizik Data lidhjes së kontratës 2.11.2018 <b>Vlera e kontratës:</b> 359,999 lekë pa tvsh <b>Diferenca</b> nga fondi limit 56,001 lekë <b>pa tvsh</b>	A.S ,(Jurist) S.T, anëtar A.LL, anëtar	A.S ,(Jurist) S.T, anëtar A.LL, anëtar



Me urdhër shpenzimi nr.175 datë 15.11.2018 është likujduar nga Muzeu Historik Kombëtar E.J Person fizik në vlerën 359,999.00 lekë me objekt shpenzimi "Blerje material elektrike", lloji procedurës së prokurimit blerje me vlerë të vogël, lloji kontratës mallra. Në zyrën e financës për dorëzimin e dokumenteve të procedurës nga kryetari i KPVV z. A.S dhe Përgjegjëses së Sektorit të Financës është mbajtur Proces-Verbal. Praktika ligjore në origjinal. Me shkresën nr.919 prot datë 31.10.2018 është bërë kërkesa për blerje material elektrike nga punonjësit:

F.B Përgjegjësi i Sektorit për menaxhimin e Shërbimeve për Vizitorët

R.M specialist

V.M magazinier

Me urdhërin e brendshëm nr.11 datë 05.01.2018 është krijuar Komisioni i Prokurimit me Vlerë të vogël. Grupi i punës për përlllogaritjen e fondit limit ka firmosur deklaratën e konfliktit të interesit me datë 30.10.2018. Me datë 30.10.2018 është mbajtur PV mbi përlllogaritjen e fondit limit nga Komisioni i Blerjeve me Vlerë të Vogël në vlerën 416.000.00 lekë pa tvsh. Me procesverbalin e datës 31.10.2018 mbi caktimin e nënpunësit të autorizuar të Komisionit të prokurimit me vlerë të vogël, i cili do të kryejë veprimet në sistemin e prokurimit elektronik në emër të komisionit është vendosur Z. A.S. Me shkresën nr.924, datë 31.10.2018 AK ka plotësuar formularin e ftesës për ofertë. Me Proces-Verbalin e datës 31.10.2018 Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël ka vendosur që specifikimet teknike dhe kriteret e veçanta të kualifikimit të jenë sipas kërkesës 919 datë 30.10.2018 për fillimin e procedurës. Nga KPVV janë firmosur deklaratat e konfliktit të interesit. Me PV nr.1 datë 02.11.2018 KPVV ka vendosur të kualifikojë të gjitha ofertat e operatorëve ekonomikë nën vlerën e fondit limit duke përfunduar klasifikimin e ofertave në bazë të kriterit të vlerësimit çmimi më i ulët. Në klasifikimin përfundimtar ka rezultuar se janë kualifikuar 20 OE dhe është renditur në vendin e I-rë S...shpk me vlerë të ofertës 217.000 lekë dhe janë skualifikuar 3OE të cilët kishin ofruar vlera mbi fondin limit, skualifikim i kryer bazuar në rekomandimin e APP nr.6559 datë 27.06.2018. Me datë 05.11.2018 është mbajtur Proces-Verbal nr.2 nga komisioni i blerjeve të vogla për skualifikimin e OE S... shpk i renditur në vend të parë pasi dokumentacioni i paraqitur në zyrën e protokollit nr.937 prot, datë 02.11.2018, nuk kishte përfshirë pagesën e energjisë për muajin shtator të 2018. KPBVV ka njoftuar shpalljen e fituesit për operatorin ekonomik të renditur në vend të dytë, O.D person fizik, me vlerë të ofertës 219900 lekë. Me datë 05.11.2018 është mbajtur Proces-Verbal nr.3 nga komisioni i blerjeve të vogla, pasi OE O.D person fizik i shpallur fitues ka deklaruar me mesazh në SPE mbi tërheqjen nga procedura prokurimit për arsye të llogaritjes gabim të ofertës. KPVV ka shpallur fitues S.RR person fizik me vlerë të ofertës 226.000 lekë. Me datë 06.11.2018 nga KBVV është mbajtur Proces-Verbal nr.4 pas tërheqjes së OE në vend të tretë dhe komisioni ka njoftuar D.B person fizik i renditur i katërti me vlerën e ofertës 284.000 lekë. Kriteri i vlerësimit çmimi më i ulët. KPVV pasi ka konstatuar se ky OE ka deklaruar me mesazh në SPE mbi tërheqjen nga procedura prokurimit për arsye objektive në hedhjen e ofertës ka vendosur të njoftojë OE I.-A.. Company me vlerë të ofertës 299.990. Me PV, nr.5 datë 06.11.2018, komisioni ka shpallur fitues OE I.-A.. Company, por ky operator ka njoftuar me mesazh tërheqjen dhe për këtë qëllim është mbajtur PV nr.6 dhe komisioni ka shpallur fituese personin fizik E.J e renditur e gjashta në klasifikim me vlerë të ofertës 299.999. Me faturën tatimore nr.155, datë 08.11.2018, është dokumentuar shitja në vlerën 299.999 lekë



**pa tvsh ose 359.999 lekë me tvsh** . Me fletëhyrje nr.27 datë 08.11.2018, është bërë hyrje në magazinë e materialeve. Mallrat janë marrë në dorëzim nga Komisioni i blerjeve me vlerë të vogël A.S Jurist,S.T, anëtar, A.LL anëtar të pranishëm F.B, R.M, V.M magazinier. Me nr. Referencë -92286-10-31-2018 në sistemin e SPE është regjistruar procedura prokurimit. Nga KPVV është kryer arkivimi i procedurës në SPE. Me datë 08.11.2018 është mbajtur PV nga KPVV mbi dorëzimin e mallrave sipas specifikimeve të kërkuara në ftesën për ofertë. Marrja në dorëzim është bërë nga komisioni i blerjeve me vlerë të vogël

### 9. Prokurimi “Blerje material për laboratorin e konservimit”

Të dhëna për tenderin	Komisioni i BVV	Njësia e prokurimit ose hartuesit e dokumenteve të tenderit
a	b	c
<b>U.Prokurimi nr.</b> prot, 367 prot datë 24.04.2018 <b>Fondi limit 80.000 lekë</b> pa tvsh <b>Procedura:</b> Prokurim me vlerë të vogël. <b>Data</b> e zhvillimit të tenderit <b>Firma fituese:</b> Sh.K person fizik Data lidhjes së kontratës <b>Vlera e kontratës:</b> 94,560 <b>Diferenca</b> nga fondi limit 14,560 lekë <b>pa tvsh</b>	A.S ,(Jurist) S.T, anëtar A.LL, anëtar	A.S ,(Jurist) S.T, anëtar A.LL, anëtar

Me urdhër shpenzimi nr.71 datë 07.05.2018 është likujduar nga Muzeu Historik Kombëtar Sh.K Person fizik në vlerën 94,560.00 me objekt shpenzimi “Blerje material për laboratorin e konservimit” , lloji procedurës së prokurimit blerje me vlerë të vogël.

Me datë 04.05.2018 është mbajtur me zyrën e financës Proces-Verbal për dorëzimin e dokumenteve të procedurës nga kryetari i KPVV z. A.S. Praktika ligjore në origjinal.

Me urdhërin e brendshëm nr.11 datë 05.01.2018 është krijuar Komisioni i Prokurimit me Vlerë të vogël.

Nga treguesit e çmimeve të tregut , janë marrë çmimet në tre studio,“ D.K..A..S..” në vlerën 96020 lekë, “A...G..P..” ne vlerën 98930 lek,“ Amos Art Studio” 95200 lekë. Me datë 25.04.2018 është mbajtur PV nga Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël, i krijuar me Urdhrin e Brendshëm nr.11, datë 05.01.2018, për përlogaritjen e fondit limit.

Me procesverbalin e datës 25.04.2018 mbi caktimin e nënpunësit të autorizuar të Komisionit të prokurimit me vlerë të vogël, i cili do të kryejë veprimet në sistemin e prokurimit elektronik në emër të komisionit është vendosur Z. A.S. Me shkresën nr.379 datë 25.04.2018 AK ka plotësuar formularin e ftesës për ofertë. Me Proces-Verbalin e datës 27.04.2018 Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël ka vendosur të kualifikojë të gjitha ofertat e operatorëve ekonomikë duke përfunduar klasifikimin e ofertave në bazë të kriterit të vlerësimit çmimi më i ulët. Me datë 30.04.2018 është mbajtur Proces-Verbal nr.2 nga komisioni i blerjeve të vogla i cili ka kualifikuar Operatorin Ekonomik të renditur në vend të dytë “ Sh.K” person fizik me vlerën 788000 lekë, pasi OE me vlerën e ofertës më të ulët “D.B” person fizik vlera ofertës 78000 nuk është paraqitur brenda afateve pranë Autoritetit Kontraktor dhe nuk ka njoftuar me mesazh në SPE. Nga personi fizik është dorëzuar dokumentacioni kërkuar .

Me faturën tatimore nr.167, datë 02.05.2018, dokumentuar veprimi në vlerën 78,880 lekë pa tvsh ose 94,560 me Tvsh. Me fletëhyrje nr.10 datë 02.05.2018 është bërë hyrje në magazinë



materialeve. Mallrat janë marrë në dorëzim nga Komisioni i blerjeve me vlerë të vogël, të pranishëm F.B, A.Ç, M.P, dhe V.M.

Me nr. Referencë -64939-04-25-2018 në sistemin e SPE është regjistruar procedura prokurimit “Blerje material për laboratorin e konservimit” lloj procedurës blerje me vlerë të vogël, tipi kontratës mallra, Autoriteti Kontraktor Muzeu Historik Kombëtar.

Me datë 11.07.2018 është mbajtur PV nga KPVV mbi dorëzimin e mallrave sipas specifikimeve të kërkuara në ftesën për ofertë.

Marrja në dorëzim është bërë nga komisioni i blerjeve me vlerë të vogël mbështetur në urdhrin e titullarit, nr.prot. 11/1, datë 05.01.2018, për të gjitha procedurat por nuk administruar si pjesë e dosjeve të blerjeve të vogla. Kështu në komisionin e marrjes në dorëzim të mallrave/punëve/shërbimeve/punëve të prokuruar me blerje me vlerë të vogël për vitin 2018 ka qenë në çdo blerje Komisioni i Blerjeve të Vogla dhe të pranishëm punonjësi i ngarkuar me magazinën si dhe punonjësit që kanë bërë kërkesën e mallit dhe kanë hartuar specifikimet teknike.

*Me observacionet e ardhura nga MHK, pas projekt raportit të dërguar në subjekt nga KLSH, me shkresën me nr. 02/8, datë 25.04.2019, sa i takon prokurimeve të fondeve publike, konkretisht gjetjes që lidhet me mbi shërbimin privat të sigurisë fizike, subjekti observon se, për periudhën në 15.04.2017 – 28.04.2017 shërbimi i ruajtjes ka qenë i mbuluar dhe është kryer nga shoqëria e shpallur fituese por jo kundrejt pagesës. Në këtë mënyrë MHK pretendo t'i ketë kursyer buxhetit të shtetit paratë për këtë shërbim.*

*Në këtë observacion gjithashtu pretendohet se vonesa për lidhjen e kontratës nuk ka ardhur për shkak të MHK, por për shkak të vonesës së KPP-së në dhënien e vendimit final përtej afatit ligjor të përcaktuar.*

*Në përgjigje të observacionit, grupi i auditimit sqaron se për sa kohë që kryerja e shërbimit të pretenduar nuk është e dokumentuar, pretendimi i mësipërm nuk qëndron. Risku që objektet e trashëgimisë kulturore të qëndrojnë të pasigurta është më i vlefshëm se kursimi i buxhetit të shtetit, i cili nuk është objekt veprimtaria i MHK-së.*

*Sa i takon pretendimit se shkak vonese për procedurën e prokurimit ka qenë KPP dhe jo MHK, grupi i auditimit observon se MHK duhet të kishte nisur procedurën e prokurimit që më datë 03.01.2017 dhe jo sikundër ka ndodhur (dërguar me vonesë nga MHK).*

*Sa më sipër observacioni nuk merret parasysh dhe KLSH i qëndron konstatimit.*

**Në përfundim të konstatimeve nga auditimi i procedurave të prokurimit në Muzeut Historik Kombëtar, po paraqesim gjetjet dhe rekomandimet si më poshtë:**

<b>Titulli i Gjetjes 1:</b>	Mbi shërbimin e munguar të ruajtjes fizike të MHK për një periudhë 13 ditore
<b>Situata:</b>	Mbështetur në Ligjin nr.9386, datë 4.5.2005 “Për muzetë”, neni 13 “Drejtuesit e muzeve, publike dhe private, detyrohen të garantojnë sigurinë e mjediseve dhe të fondit muzeor, që kanë në administrim, ndaj të gjitha rreziqeve të mundshme, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi”,



<b>Kriteri:</b>	MHK ka realizuar procedura prokurimi për shërbimin privat të sigurisë fizike të Muzeut Historik Kombëtar. Nga auditimi i këtyre procedurave u konstatua se: Për periudhën 01.01.2017 deri në 09.02.2017 për shërbimin privat të sigurisë fizike të Muzeut Historik Kombëtar është kryer procedura e prokurimit "me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit" (20% e shtesës së kontratës së fillestare të mëparshme). Më pas për periudhën 15.02.2017 deri në 15.04.2017 përsëri ky shërbim është prokuruar me procedurën "negocim pa shpallje paraprake të njoftimit" për të mbuluar periudhën 2 mujore. Finalizimi i procedurës së prokurimit që zgjati përtej afateve të parashikuar për shkak të trajtimit të disa ankesave nga OE-të, bëri që nga data 15.04.2017 (data e përfundimit të kontratës ekzistuese) deri në datën 28.04.2017 (data e lidhjes së kontratës së re) MHK ka qenë i pambuluar nga shërbimi i ruajtjes fizike të Muzeut. Mungesa e këtij shërbimi për periudhën prej 13 ditësh, ka vënë MHK përpara risqeve që siguria objekteve me vlera të trashëgimisë kulturore të cenohej. Ligjit nr.9386, datë 4.5.2005 "Për muzetë", neni 13 " <i>Drejtimesit e muzeve, publike dhe private, detyrohen të garantojnë sigurinë e mjediseve dhe të fondit muzeor, që kanë në administrim, ndaj të gjitha rreziqeve të mundshme, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi</i> ".
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Për këtë periudhë ka ekzistuar risku që siguria e MHK dhe objekteve me vlerë të lartë që ai administron të cenohej.
<b>Shkaku:</b>	<b>Mos marrja e masave për një planifikim në kohën e duhur (MHK i ka filluar procedurat e prokurimit në 31.01.2017) në kushtet kur prokurimi i shërbimit vlerësojmë se nevojitej të bëhej më herët (psh më datë 03.01.2017) për të mos e lënë institucionin të pa mbuluar me shërbimin e rojeve për 13 ditë kalendarike</b>
<b>Rëndësia:</b>	I ulët/i mesëm /i lartë
<b>Rekomandime:</b>	Në kushtet kur ruajtja dhe siguria e objekteve të trashëgimisë kulturore është ndër funksionet primare të MHK, drejtimi duhet të marr masa që në çdo rast të vlerësohet, planifikohet dhe ndiqet me kujdes situata e afateve për mbulimin pa asnjë ndërprerje të këtij shërbimi gjatë gjithë vitit kalendarik. MHK të marr masa që në çdo rast të respektohen kushtet e kontratës sa i takon respektimit të afateve të likuidimit pas marrjes së shërbimit të kërkuar.
<b>Afati i zbatimit:</b>	<b>Në vijimësi</b>

<b>Titulli i gjetjes 2: Situata:</b>	<b>Mosplotësimi i formularit të deklaramit të interesit</b> Nga shqyrtimi i dokumentacioni të procedurës prokurimit me objekt "Blerje tonera kancelari" me vlerë kontrate 158,400 lekë, u konstatua se në dosjen e inventarizuar, kanë munguar formularët mbi deklaramin e konfliktit të interesit, të cilat detyrimisht duhet të plotësohen dhe
--	---



<b>Kriteri:</b>	nënshkruhen nga anëtarët e KPVV-së (sipas urdhrorit të brendshëm nr.11, datë 05.01.2018) Neni 56 " Titullari i autoritetit kontraktor ose zyrtari i autorizuar" pika 1, VKM nr.914, datë 29.12.2014 " Për rregullat e prokurimit publik " i ndryshuar citon:.. <i>"Kërkesat ligjore për parandalimin e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi, duhet të mbahen parasysh në emërimin e një nëpunësi prokurimi. Çdo nëpunës, që merr pjesë në procesin e prokurimit nënshkruan një deklaratë, përmes së cilës deklaron se nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit"</i> .
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Mos-deklarimi i konfliktit të interesit nga KPVV mbart rrisqë që lidhen me trajtimin jo të barabartë të operatorëve pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik, në rastet e ekzistencës së konfliktit të vazhdueshëm të interesit, si dhe ndikon në shmangjen e kryerjes së detyrës nga punonjësi me paanësi dhe ndershmëri.
<b>Rëndësia:</b>	I mesëm
<b>Rekomandimi:</b>	Për çdo procedurë prokurimi, njësia e prokurimit, të verifikojë që çdo nëpunës, që merr pjesë në procesin e prokurimit të ketë nënshkruar deklaratën e konfliktit të interesit në përputhje me rregullat e prokurimit publik. Sa më sipër në funksion të kryerjes së punës me ndershmëri, paanësi dhe profesionalizëm.
<b>Afati i zbatimit:</b>	<b>Në vazhdim</b>

## 6. MBI VLERËSIMIN E FUNKSIONIMIT TË SITEMEVE TË MENAXHIMIT FINANCIAR DHE KONTROLLIT

### a. Analiza e sistemit të kontrollit të brendshëm në funksion të gjetjeve të konstatuara në projekt raport:

Në referencë të të standardeve të kontrollit të brendshëm që sugjerojnë kuadri COSO, si dhe praktikën më të mirë në fushën e auditimit publik, që kontrollet e brendshme të vlerësohen si efektive, **duhet** që:

- Të jenë **hartuar** saktë (pra në termin e bazës ligjore dhe rregullative mbi të cilat mbështeten proceset) – Faza 1;
- Të jenë **implementuar** drejtë – Faza 2; si dhe
- Të **operojnë** në funksion të realizimit të objektivave të njësisë- Faza 3.

Në këtë kuptim është përgjegjësi e drejtimit që të hartojë procedura dhe politika që I përshtaten rrethanave të njësisë dhe të kërkojë implementimin e tyre si pjesë integrale e operacioneve të njësisë. Mbështetur mbi pikat e programit të auditimit të KLSH, dhe parë rezultatet e këtij auditimi në raport me plotësimin e të tre kriterëve të efektivitetit të KB konstatojmë:

**NË FAZËN 1: Cënimin e kontrolleve të brendshme në fazën e hartimit të tyre, më konkretisht:**



1. Komponenti “Mjedisi i Kontrollit”: Janë cënuar kontrollet e brendshme në funksion të Mjedisit të Kontrollit që lidhen me:

- ✓ mungesën e akteve nënligjore në zbatim të ligjit të ri “Për Muzetë dhe Trashëgiminë Kulturore”, hyrë në fuqi, më datë \_\_\_/\_\_\_/ 2018. **Por kjo është së pari detyrim i Ministrisë Përgjegjëse.**
- ✓ Struktura organizative - Është pjesë e rëndësishme e krijimit të strukturës organizative, mënyra se si njësitë/sectorët ndërveprojnë më njëri-tjetrin, në mënyrë që të përmbushin përgjegjësitë e tyre, në funksion të përmbushjes së objektivave të njësisë si e tërë. Mungesa e një sektori (ose punonjës i detyruar) i BNJ, apo magazinieri;
- ✓ Rekrutimet – Rekrutimi bëhet në funksion të punësimit të personelit kompetent me qëllim arritjen e objektivave të njësisë. Në kushtet kur kanë munguar procedurat transparente të rekrutimit, shtuar kësaj mungesën e përshkrimit të punës dhe si pasojë mungesën e kualifikimeve të kërkuara për pozicionet, risqet për mos arritjen e objektivave janë të mëdha.

2. Komponenti “Vlerësimi i Riskut” : Janë cënuar kontrollet e brendshme në funksion të Vlerësimit të Riskut që lidhen me:

- ✓ Mungesën e identifikimit, analizës dhe përgjigjet ndaj risqeve që lidhen me zhvendosjen e ikonave (Parimi 7). Kontrollet paraprake dhe kalendarët e punimeve janë hallka të munguara të procesit të zhvendosjes së tyre;
- ✓ Nevojën për plotësim me elementë sigurie të pasaportave dhe kartelave të objekteve të trashëgimisë kulturore

3. Komponenti “Aktivitetet e Kontrollit” : Janë cënuar kontrollet e brendshme në funksion të Aktiviteteve të Kontrollit që lidhen me:

- ✓ Mungesën e dokumentimit të qartë dhe detajuar të përgjegjësive përmes rregullores së përshkrimit të detyrave (ose përshkrimi punës), urdhrave të brendshëm , etj.
- ✓ Mungesa e ndarjes së qartë të detyrave brenda sektorëve, por edhe mes sektorëve.
- ✓ Mungesë e procedurave të brendshme për aktivet që hyjnë dhe dalin pa kaluar nga magazina;
- ✓ Mungesën e aktiviteteve të kontrollit që lidhen me transferimin e objekteve të trashëgimisë kulturore, për restaurime, etj (më konkretisht nuk janë hartuar procedura të qarta, duke bërë që procesi i zhvendosjes së objekteve të trashëgimisë kulturore të mbështetet vetëm mbi Udhëzimin nr. 30, datë 26.12.2011)

4. Komponenti “Komunikimi dhe Informimi” : kërkon **dokumentimin e të gjitha veprimtarive, proceseve dhe transaksioneve**, me qëllim që të sigurohet gjurma e auditimit për vijueshmërinë dhe monitorimin

**NË FAZËN 2: Cënimin e kontrolleve të brendshme në fazën e implementimit të tyre, më konkretisht:**

1. Komponenti “Vlerësimi i Riskut”: Janë cënuar kontrollet e brendshme në funksion të Vlerësimit të Riskut, që lidhen me:

- ✓ Mosidentifikimin e risqeve që ka sjellë mos funksionimi sistemit elektronik të biletarisë dhe si pasojë mos marrjen e masave për rregullimin e tij. Sistemi i biletarisë duhet të



kishte shërbyer si hallkë e forte kontrolli për verifikimin nga ana e NZ të saktësisë së të ardhurave të deklaruara nga shitja e biletave.

- ✓ Mos plotësimin e e kartelave dhe pasaportave të ikonave me gjithë informacionin historik mbi restaurimet/konsrvimet e kryera mbi ndër vite, edhe pse me formatet të miratuara, duke cënuar gjurmimin e procesit ndër vite dhe shtuar risqet e mashtrimit.

2. Komponenti “Aktivitetet e Kontrollit” : Janë cënuar kontrollet e brendshme në funksion të Aktiviteteve të Kontrollit, që lidhen me:

- ✓ Mungesa të planeve të shpërndarjes së aktiveve materiale;
- ✓ Mos kryerja e inventarizimeve periodike mbi biletat; kontrollet e dyfishta mbi procesin (sistemi IT, kasa fiskale);

3. Komponenti “Monitorimi” : Janë cënuar kontrollet e brendshme në funksion të Monitorimit, që lidhen me:

- ✓ Kanë munguar raportet e monitorimit të buxhetit të cilat janë esenciale për vlerësimin e rezultateve dhe analizimin e shkaqeve për mosrealizimin e tyre. Kontrollet e vazhdueshme mbi zbatimin e buxhetit lidhen drejtpërdrejt me objektivat e njësisë.

**Në përfundim gjykojmë se, kontrollet nuk mund të funksionojnë në mënyrë efektive, nëse ato nuk janë hartuar e më pas implementuar në mënyrë efektive;** Cfarë do të thotë se, gjithë konstatimet e mësipërme në dy fazat e hartimit dhe implementimit, pa diskutim që çënojnë edhe funksionimin e kontrolleve të brendshme, duke rrezikuar realizimin e objektivave për të cilat këto kontrolle duhej të ishin hartuar e më pas implementuar

*Theksojmë se, vlerësimi I dhënë me sipër është I kufizuar vetëm në aktivitete që lidhen me drejtimit e auditimit, sipas programit të auditimit dhe informacionit të vënë në dispozicion grupit të auditimit.*

## **b. Analiza e MFK-së sipas 5 komponentëve të kontrollit të brendshëm**

Në zbatim të pikës 6 të programit të auditimit Nr. 1441/1, datë 04.01.2019 i ndryshuar u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Hartimi i objektivave dhe zbatimi i planeve strategjik dhe vjetorë në përputhje me objektivat e miratuara nga titullari.
- Pyetësorët e vetëvlerësimit të komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, deklaratat e cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm
- Politikat dhe praktikatat e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe aftësitë profesionale të punonjësve.

Në drejtim të vlerësimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm në MHK, nga grupi i auditimit janë kryer verifikimet për implementimin dhe plotësimin e kërkesave në lidhje me funksionimin, përgjegjshmërinë menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit, për të gjithë komponentët si: “Mjedisi i kontrollit”, “Menaxhimi i riskut”, “Aktivitetet e kontrollit”, “Informimi dhe Komunikimi” si dhe “Monitorimi”, në referim të nenit 19 të Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015 “Për disa shtesa dhe ndryshime”, ku titullari i njësisë në sektorin publik zbaton menaxhimin financiar dhe kontrollin nëpërmjet këtyre komponentëve të lidhur me njëri tjetrin.



Këta komponentë janë trajtuar në drejtim të hartimit, implementimit dhe funksionimit të integruar të tyre, me qëllim realizimin e objektivave të MHK-së.

Me synimin e implementimit të këtij ligji dhe të akteve rregullatore është kërkuar: regjistri i riskut, pyetësorët e vetëvlerësimit të komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, deklaratat e cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm, raportet vjetor mbi cilësinë dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm<sup>53</sup>, shkresat mbi ndarjen dhe delegimin e kompetencave, caktimit të Nëpunësit Autorizues dhe Nëpunësit Zbatues, koordinatorit të riskut, sekretarit të GMS, procesverbalet e mbledhjeve të GMS, rishikimi i regjistrit të riskut, rivlerësimi dhe plani i veprimit me masa korrigjuese, dokumentimi i gjurmës së auditimit, harta e proceseve të punës etj.

- Për vitin 2017 dhe 2018, MHK ka funksionuar me strukturën e miratuar nga Kryeministri me urdhrin nr. 43, datë 07.04.2017 “Për disa ndryshime në urdhrin nr. 19, datë 25.01.2014 “Për miratimin e strukturës dhe Organikës të MHK”

Grupi i auditimit pas bisedës me nëpunësin zbatues për zbatimin e përgjegjësive menaxheriale sipas nenit 11 të ligjit nr.10296 datë 08.07.2010 “ Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, posedoi disa informacione lidhur me përgjegjësitë dhe raportimin që nëpunësi zbatues ka si detyrim ndaj nëpunësit autorizues. Mbështetur në vetëvlerësimin e bërë nga ana e MHK-së për periudhën objekt auditimi, si dhe referuar përgjigjeve të pyetësorit, më poshtë rendisim punën e bërë nga ky institucion, si dhe mangësitë e konstatuara në plotësimin e kërkesave që kërkojnë komponentët në drejtim të funksionimit me përgjegjshmëri menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij:

### 1. Mjedisi i kontrollit

Mjedisi i kontrollit është një element i menaxhimit financiar dhe kontrollit, duke siguruar vendosjen e objektivave në përmbushjen e misionit të institucionit, Integritetin personal dhe etikën profesionale të nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike; Politikën menaxheriale dhe stilin e punës; Strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit; Politikën dhe praktikën e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe aftësitë profesionale të punonjësve.

**a. Integriteti personal dhe etika profesionale e nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të kësaj njësie publike.** Nëpunësit e këtij institucioni duhet të respektojnë rregullat dhe parimet e ligjit nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”. Lidhur me **respektimin e etikës** nga punonjësit është e përcaktuar në rregulloren e brendshme të këtij institucioni, por ky institucion, në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, neni 20 “Mjedisi i kontrollit”, pika 2, germa a dhe në Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, të hartuar dhe miratuar nga Ministria e Financës, Kap II, pika 2.5.1 “Mjedisi i Kontrollit (ose mjedisi i brendshëm i njësisë)”, paragrafi “Integriteti dhe vlerat etike”, **nuk ka një Kod të Brendshëm Etik ose një Kod Sjellje**, apo udhëzim për zbatimin e etikës, si dhe nuk ka procedurë për të raportuar shkeljet e legjislacionit mbi etikën dhe për marrjen e masave për shkeljet e konstatuara. Por sa më sipër është rregulluar me një nen të vecantë në rregulloren e institucionit (neni 25)

<sup>53</sup> Është dërguar vetëm deklara. Raport nuk ka



*MHK, në observacionet pas projekt raportit të auditimit, të dorëzuara me shkresën nr. 2/8, datë 25.04.2019 thekson se, Kodi i Etikës iu është vënë në dispozicion punonjësve të KLSH-së në fillim të auditimit.*

*Në përgjigje të sa më sipër, KLSH pohon se asnjë Kod Etike nuk na është vënë në dispozicion as gjatë auditimit në terren dhe as me këto observacione, në mënyrë që sa më sipër të na shërbejë si evidencë e besueshme.*

**b.Struktura organizative, garantimi i ndarjes së detyrave, rregullat e qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit.** MHK ka funksionuar me strukturën e miratuar nga Kryeministri me urdhrin nr. 43, date 07.04.2017 “Për disa ndryshime në urdhrin nr. 19, datë 25.01.2014 “Për miratimin e strukturës dhe Organikës të MHK”, si dhe ushtron veprimtarinë mbështetur në aktet ligjore dhe nënligjore dhe Rregulloren se Brendshme të miratuar nga titullari i Muzeut i Urdhri i brendshëm nr.608/1 prot, datë 14.07.2016.

*Nga auditimi rezultoi se edhe pse ligji për muzeta ka ndryshuar që në maj të vitit 2018, rregullorja nuk është përditësuar për të reflektuar ndryshimet ligjore, sa më sipër e kushtëzuar gjithashtu nga dalja e akteve nënligjore për zbatimin e ligjit të ri.*

Detyrat dhe përgjegjësitë e sektorëve përkatëse të njësisë janë të përcaktuara në rregulloren e brendshme të institucionit, nga ku na rezultoi se ka mospërputhje të sektorëve sipas kësaj rregulloreje dhe organikës së MHK-së.

Nga drejtuesi i institucionit **duhet** të sigurohet mbikëqyrja e monitorimi i punës, për secilin punonjës në mënyrë që të sigurohet si duhet integriteti personal dhe etika profesionale, duke përjashtuar konfliktin e interesit në kryerjen e detyrave funksionale, në përputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar në lidhje me “ndarjen e detyrave në fushën e dhënies së autorizimit në atë formë, në mënyrë që i njëjti punonjës të mos jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për propozimin, miratimin, zbatimin, kontabilitetin dhe kontrollin”.

-Përcaktimi i NA dhe NZ është bërë në përputhje me kërkesat e ligjit nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, ligjin “Për menaxhimin e sistemit buxhetor të RSH”, si dhe ligjit nr.90 datë 27.09.2012 “Për organizimin e administratës shtetërore” **si dhe janë njoftuar Njësia Qendrore e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në Ministrinë e Financës** Nëpunësi Autorizues dhe Zbatues plotësojnë kriteret e kërkuara nga ligji si: (kriteri i varësisë NA-NZ, kriteri i arsimimit dhe kriteri i nivelit menaxherial).

-*Krijimi i grupeve të menaxhimit strategjik (GMS).* Në zbatim të ligjit nr.10269 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, nga MHK është formuar Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS), me urdhrin nr. 448/1 datë 18.05.2018 “Urdhër për ngritjen e Grupit për Menaxhimin Strategjik” i miratuar nga Drejtori i MHK-së që është edhe Kryetar i GMS-së.

**c. Stili i të vepruarit dhe filozofia e menaxhimit.** Punonjësit e MHK-së i rregullojnë marrëdhëniet e punës me punëdhënësin në bazë të Kodit të Punës.

Në bazë të ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin, ligjit për menaxhimin e sistemit buxhetor, ligjit për prokurimin publik, ligjit për kontabilitetin, si dhe të dispozitave ligjore të kodit të punës etj, titullari i institucionit, në rast të shkeljes së normave ligjore apo të rregullave ka të drejtë të ndër marrë hapat e duhura duke propozuar masa disiplinore dhe administrative për punonjësit, deri në largim nga puna.



#### **d. Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore.**

Në rregulloren e brendshme të institucionit, ky institucion ka përcaktuar rregullat e funksionimit të brendshëm lidhur me strukturën organike, të drejtat dhe detyrimet e punonjësve, orarin dhe kohën e punës etj, por vumë re se, **mungon** përcaktimi i marrëdhënieve ndërmjet strukturave të njësisë. Nga institucioni **nuk** është bërë vlerësimi vjetor i punës për çdo punonjës. **Në kushtet e mungesës së përshkrimeve** të qarta të pozicioneve të punës si dhe kualifikimeve që kërkon secili pozicion, e kishim të pamundur të shprehemi nëse stafi i MHK është në përputhje me kriteret e përcaktuara sipas kërkesave të vendit të punës. Procedurat e rekrutimit të stafit nuk janë të dokumentura për të dhënë siguri të arsyeshme grupit të auditimit.

Ky institucion *nuk ka program specifike për trajnimin* e punonjësve të administratës, në kundërshtim me Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kap. II, pika 2.5.1 "Mjedisi i kontrollit (ose mjedisi i brendshëm i njësisë", paragrafit "Politikat dhe praktikat që lidhen me burimet njerëzore" dhe "Profesionalizmi i stafit". Për ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të punonjësve gjatë viteve të objekt auditimit në MHK janë kryer disa trajnime shkëmbyer përvojë mbi praktikat më të mira në fushën e Informacionit.

#### **2. Menaxhimi i riskut**

Menaxhimi i riskut është procesi i identifikimit, vlerësimit dhe monitorimit të riskut. Pas planifikimit të fondeve buxhetore, institucioni analizon dhe bën kontrollin e risqeve, të cilët mund të venë në rrezik realizimin e treguesve buxhetore

*Përgjegjësitë:* Sipas përcaktimeve të bëra në nenin 10 të Ligjit "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", strukturat përgjegjëse janë:

- Titullari i njësive publike është përgjegjës për hartimin e politikave, miratimin dhe monitorimin e strategjisë për menaxhimin e risqeve brenda njësisë së tij.
- Nëpunësi Autorizues është përgjegjës për zbatimin e sistemeve të menaxhimit financiar; është Koordinatori i Riskut dhe përgjigjet për monitorimin e kontrolleve për minimizimin e risqeve brenda njësisë. Sidoqoftë, sipas Nenit 10 të Ligjit mbi Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Nëpunësi autorizues mund të delegojë detyra që kanë lidhje me koordinimin e riskut, një menaxheri tjetër të njësisë në vartësi direkt prej tij.
- Auditimi i brendshëm në rolin e vlerësuesit të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe këshilluesit. Në rastin e MHK funksioni i auditimit të brendshëm kryhet nga Njësia e AB-së në Ministrinë e Kulturës. Auditimi i fundit ka mbuluar periudhën 2014-2016, dhe gjetjet dhe rekoamdnimet janë reflektuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit të dërguar me shkresën ne. 5223/3, datë 21.03.2017 të Ministrisë së Kulturës.

Në lidhje me *identifikimi i riskut, vlerësimi i riskut, adresimi i riskut dhe shqyrtimi i riskut*, nga auditimi rezultoi se:

- **Nuk na u vu ne dispozicion asnjë dokument që vërteton se është hartuar strategjia për menaxhimin e riskut** në kundërshtim me nenin 21, pika 2 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", ku citohet se, titullari i njësive publike miraton një strategji risku, e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut. Ndërsa sa më sipër pohohet nga subjekti në PyetëSORIN e Vetëvlerësimit.

Duhet theksuar se në procesin e miratimit të planeve vjetore të punës, duhet të merren parasysh risqet më të rëndësishme që mund të ndikojnë në arritjen e objektivave të përcaktuara. Edhe pse



MHK ka miratuar regjistrat e risqeve, kemi konstatuar se ka nevojë për përmirësime në mënyrë që planet vjetore të punës të lidhen me planin strategjik të njësisë publike. Lidhjet e qarta midis planit strategjik, planit vjetor të punës dhe buxhetit vjetor shërbejnë si pikënisje për procesin e menaxhimit të riskut në çdo nivel të njësisë publike. **Strategjia e riskut** përcakton mënyrën se si sillen organizata ndaj risqeve dhe vendos kuadrin e përgjithshëm të procesit të menaxhimit të riskut. Strategjia e riskut e një njësie duhet të miratohet nga titullari i njësisë dhe duhet t'u vihet në dispozicion punonjësve dhe të njihet prej tyre.

*MHK, në observacionet pas projekt raportit të auditimit, të dorëzuara me shkresën nr. 2/8, datë 25.04.2019 thekson se, bashkëlidhur observacioneve është edhe Strategjia e Riskut të MHK-së.*

*KLSH konfirmon marrjen e dokumentit "Urdhër për miratimin e strategjisë së riskut në MHK" nr. 412 Prot., datë 16.05.2017, ku titullari i institucionit urdhëron "miratimin e regjistrat të riskut" dhe jo "strategjisë së riskut". Dhe përmbajtja e këtij urdhri gjithashtu përkon me regjistrin e riskut dhe jo strategjinë sikundër pretendohet. Për sa më sipër observacioni nuk merret parasysh dhe KLSH i qëndron konstatimit.*

- Për vitet objekt auditimi, nga MHK është hartuar regjistri i riskut, në përcaktimin e risqeve sipas objektivave për çdo sektor në përputhje me nenit 21 Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" i ndryshuar.

**Hapi I** "Organizimi i procesit", përgjegjësitë e menaxherëve të tjerë të njësisë publike.

Zhvillimi i MFK-së kërkon gjithashtu zhvillimin e menaxhimit të riskut në mënyrë sistematike duke krijuar një mjedis të tillë në të cilin diskutimet për riskun të jenë pjesë e operacioneve të përditshme. GMS duhet të kontrollojë si janë menaxhuar risqet brenda njësisë publike, si dhe të përgatisë një raport vjetor lidhur me këtë, gjë e cila **nuk** është realizuar.

- Për vitin 2018, janë kryer takime periodike me stafin menaxherial mbi diskutimin e problematikave dhe dokumentimin e veprimtarisë së përditshme të menaxhimit të riskut, si dhe janë trajtuar disa aspekte të risqeve (ndër të tjera kërkohen plan pune javor nga cdo sektor, kur në rregulloren e brendshme është e paqartë ndarja e detyrave specifike mes punonjësve brenda secilit sektor). Ndërsa për vitin 2017 nuk kemi asnjë dokument që të pohojë kryerjen e këtyre takimeve.

Punonjësit e për vitin 2017 **nuk kanë zhvilluar trajnime** për menaxherët apo stafin të cilët janë përgjegjës për menaxhimin financiar dhe kontrollin, duke përfshirë trajnimin lidhur me aktivitetet e kontrollit të brendshëm hartimin e regjistrat të riskut si dhe të nxitjen ndaj parregullsive, raportimin e tyre si dhe hartimi i masave për parandalimin e këtyre risqeve.)

Ehe pse referuar referuar regjistrat të risqeve, sektori i financës shprehet se punonjësit nuk kanë njohuri të mjaftueshme në lidhje me procesin e menaxhimit të riskut, ndërsa në pyetësorin e vetëvlerësimit parashikohet se MHK ka politika dhe praktika të burimeve njerëzore që garantojnë përmirësimin e aftësive profesionale të stafit, konstatuam se nga ana e MHK nuk janë kryer trajnimeve/seminareve në fushën e menaxhimit të riskut, hartimit të dokumenteve si dhe regjistrat apo strategjisë së tij. Për më tepër që MHK nuk ka një strukturë të Burimeve Njerëzore.

### 3. Aktivitetet e kontrollit



Aktivitetet e kontrollit janë rregullat, procedurat dhe veprimet që kanë si qëllim reduktimin e risqeve me synim arritjen e objektivave. Proceset kryesore të punës janë të shkruara në rregulloren e brendshme në mënyrë të përgjithshme, **por pa u specifikuar detyrat dhe përgjegjësitë e secilit pozicion që duhet të përfshihet në një proces specifik**. Në bazë të strukturës së miratuar konstatoam raste ku ka **mospërputhje** mes strukturës dhe rregullores si dhe vumë re **mbivendosje** të detyrave si në rastin e Sektorit të Menaxhimit të Koleksioneve dhe Sektorit të Konservimit të Koleksioneve<sup>54</sup>. Gjithashtu **ndarja e detyrave mes punonjësve të sektorëve është e paqartë** dhe mjaftohet me sa parshkohet në nenin 11 të rregullores ku citohet se: *“Specialistët varen direkt nga përgjegjësi i sektorit dhe zbaton me përpikmëri dhe në nivel të lartë profesional të gjitha detyrat e ngarkuara prej tij”*. Në kushtet kur edhe në dosjet personale mungon përshkrimi i detyrave, vështirësohet monitorimi i eficiencës së aktivitetve të kontrollit me qëllim arritjen e objektivave.

Metoda e përgjithshme e rekomanduar për krijimin, vlerësimin dhe raportimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit përmbledh 9 hapa kryesore

**Hapi IV**-Lista ose harta e proceseve të punës.

Nga auditimi u konstatua se në vitet objekt auditimi **nuk është hartuar një listë mbi proceset e punës**, e cila të shërbejë për përgatitjen dhe dokumentimin e gjurmës së auditimit, duke u mjaftuar vetëm me përshkrimin e shkurtër të detyrave për cdo sektor në rregullore. Më konkretisht kjo është vënë re te procesi i shitjes së biletave, proces i cili vlerësohet të ketë mbetur jashtë monitorimit pikërisht për shkak të mungesës së aktivitetve të kontrollit.

Nëpunësi autorizues në bazë të ligjit për buxhetin merr përsipër angazhimet për realizimin e programit buxhetor. Referuar ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar neni 16, Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kap. III “Procesi i implementimit të Menaxhimin Financiar dhe Kontrollit”, pika 3.2 “Cikli i MFK-se”, Hapi 5 “Gjurmët e auditimit”, institucioni **ka hartuar gjurmët e auditimit për menaxhimin e aktiveve (shkresa nr.405, datë 15.05.2017<sup>55</sup>)**. Ka mungur hartimi i gjurmëve të auditimit për aktivet-objekt të trashëgimisë kulturore, të cilat për nga rëndësia dhe specifika duhet të mbështetet mbi gjurmë auditimi specifike (për shembull rasti i zhvendosjes së objekteve vlerësojmë se duhet rregulluar me një proces te vecante si dhe te krijohen gjurmët përkatëse).

Nga auditimi i KLSH-së u konstatua se në funksion të kontrolleve parandaluese ka vend për përmirësime sa i takon ndarjes së detyrave; përgjithësisht në lidhje me kryerjen e transaksioneve financiare<sup>56</sup>.

<sup>54</sup> Neni 13: Sektori i Menaxhimit të Koleksioneve është përgjegjës për regjistrimin, dokumentimin, kërkimin dhe ruajtjen e koleksioneve si ato që janë të ekspozuara dhe ato të fondeve në bashkëpunim me Sektorin e Konservimit të Koleksioneve

Neni 14: Sektori i Konservimit të Koleksioneve kryen regjistrimin, dokumentimin, kërkimin dhe ruajtjen e koleksioneve si ato që janë të ekspozuara dhe ato të fondeve në bashkëpunim me Sektorin e Menaxhimit të Koleksioneve

<sup>55</sup> Këto gjurmë në fakt janë Anekset e udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit public”

<sup>56</sup> është përdorur sistemi me dy firma, përvec rastit të të të ardhurave nga shitja e biletave



*MHK, në observacionet pas projekt raportit të auditimit, të dorëzuara me shkresën nr. 2/8, datë 25.04.2019 thekson se, MHK ka listë të proceseve të punës që shërbejnë për përgatitjen e gjurmës së auditimit, dhe që i është vënë në dispozicion grupit të punës.*

*Në përgjegjje të observacionit KLSH thekson se me shkresën e sipërcituar MHK ka bashkëlidhur dokumentin nr. 407 Prot, datë 15.05.2017 dhe nr. 456/3, datë 24.05.2018 "Urdhër për përgatitjen e PBA-së në MHK", i cili nuk i përgjigjet konstatimeve tona.*

*Në kushtet kur nuk na është dorëzuar asnjë evidencë shtesë, KLSH vijon t'i qëndrojë konstatimit.*

#### **4. Informim dhe komunikimi.**

Informimi është baza e komunikimit që nevojitet për kryerjen me cilësi të detyrave të ngarkuara. Komunikimi me titullarin dhe nëpunësit e tjerë duhet bërë në formën dhe kohën e duhur për ti ndihmuar ata në përmbushjen e detyrave dhe të përgjegjësisive. Punonjësit e njësisë zotërojnë informacion, por jo te mjaftueshëm për qëllimet dhe rëndësinë e menaxhimit financiar dhe të kontrollit pasi, zbatimi i ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin, nuk është respektuar nga të gjithë hallkat e njësisë dhe se, institucioni nuk ka kryer trajnime për kuptimin dhe zbatimin e ligjit.

Sektori i Financës, ka raportuar tek nëpunësi autorizues me anë të evidencave buxhetore mujore dhe vjetore të krahasuar me planin, **por kanë munguar raportet periodike të monitorimit 4-mujore** ku përvec analizës së realizimit të buxhetit sipas programit, artikujve, objektivave etj, analizohen dhe shkaqet e mosrealizimit të tyre. Pra nëpërmjet raportimit tek eprori i drejtpërdrejtë, sigurohet dhe komunikimi mbi parregullsitë dhe problemet e mundshme.

**Hapi VIII**-Masat korigjuese, nga auditimi i KLSH-së u konstatua se: MHK ka ndërmarrë plan masash korigjuese për përmirësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, proces ky në zbatim të gjetjeve dhe rekomandimeve të dhëna nga Auditimi i Brendshëm i Ministrisë së Kulturës.

Punonjësit brenda institucionit komunikojnë me postë elektronike dhe në mënyrë verbale ndërsa, jashtë institucionit komunikohet kryesisht në formë shkresore zyrtare dhe ka korrespondencë të rregullt me subjektet kryesore të jashtme, pa përjashtuar komunikimin elektronik dhe atë telefonik.

MHK ka faqen e saj zyrtare dhe nëpërmjet këtij **website** të gjithë të interesuarit mund të informohen rreth punës së përditshme të saj.

#### **5. Monitorimi.**

Monitorimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, bëhet për të vlerësuar cilësinë e sistemit dhe të performancës në kohë.

Vlerësimi dhe monitorimi i sistemit të MFK-së bëhet nëpërmjet:

- Monitorimit të vazhdueshëm;
- Vetëvlerësimit;
- Auditimit të brendshëm.

Vlerësimi i vazhdueshëm i sistemit të kontrollit të brendshëm dhe komponentëve të tij duhet të jetë detyrë e titullarit të njësisë, nëpunësit autorizues dhe menaxherëve të tjerë. Ky vlerësim mund të kryhet ose nëpërmjet monitorimit të vazhdueshëm të komponentëve të sistemit të



kontrollit, ose nëpërmjet mekanizmave individuale të kontrollit dhe zbatimit të tyre gjatë punës së përditshme.

Nga auditimi u konstatua se:

- Nga MHK është plotësuar Pyetësori i vetëvlerësimit dhe Deklarata për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm të MHK-së është dërguar në Ministrinë e Financave me shkresën nr. 128, datë 06.02.2018 (kjo për vitin 2017, pasi për vitin 2018 sa më sipër dorëzohet përgjatë vitit 2019, periudhë kjo jashtë objektit të auditimit të KLSH-së)
- Monitorimi i buxhetit faktik **nuk** është raportuar çdo 4 muaj
- Si pasojë e mungesës së raporteve të monitorimit sipas udhëzimit nr. 22/2016 kanë munguar konkluzionet në lidhje me realizimin e objektivave dhe qëllimit të politikës së programit.

***Për periudhën objekt auditimi 2017 dhe 2018, nga auditimi ndër të tjera rezultoi se:***

- Përgjatë periudhës objekt auditimi, Institucioni nuk ka hartuar planin strategjik, në mënyrë periodike për të reflektuar objektivat strategjike, prioritetet e institucionit dhe planet e veprimit. Mos hartimi i Planin Strategjik, në institucion ka shkaktuar mos rishikimin e vazhdueshëm të objektivave të programeve, aktiviteteve dhe projekteve, që duhet të realizohen përmes proceseve të punës, e cila ka ndikuar dhe në mospërcaktimin e qartë të proceseve të punës
  - Institucioni nuk ka një Kod të Brendshëm Etik ose një Kod Sjellje, apo udhëzim për zbatimin e etikës, si dhe nuk ka procedurë për të raportuar shkeljet e legjislacionit mbi etikën dhe për marrjen e masave për shkeljet e konstatuara.
  - GMS për vitin 2018, ka kryer takime periodike, në përputhje me nenin 27 të ligjit "Për MFK", si dhe Manualin mbi zbatimin e MFK-së pika 4.2.9 "Grupi për menaxhimin strategjik", ku cilësohet: "*GMS të kryejë takimet 4 herë në vit si dhe vendimet e grupit duhet të merren në mënyrë kolegjiale dhe objektive duke patur në vëmendje interesin publik dhe në përputhje me standardet etike të sektorit publik. Vendimet e Grupit duhet të pasqyrohen në dokumente dhe t'i vihen në dispozicion menaxhimit të njësisë*". Zhvillimi i MFK-së kërkon zhvillimin e menaxhimit të riskut në mënyrë sistematike duke krijuar një mjedis të tillë në të cilin diskutimet për riskun të jenë pjesë e operacioneve të përditshme.
- GMS duhet në mënyrë të vazhdueshme të kontrollojë si janë menaxhuar risqet brenda njësisë publike, gjë e cila është realizuar, për aq sa janë identifikuar risqet.
- Në MHK konstatuam se janë organizuar trajnime me qëllim njohjen dhe shkëmbimin e përvojave mbi praktikën më të mirë në fusha të ndryshme, **por nuk janë** organizuar trajnime mbi njohuritë e ligjit të MFK-së
  - Në MHK janë marrë masa për hartimin e gjurmës së auditimit vetëm formalisht. Gjurma e auditimit është një instrument menaxhimi që mundëson nga njëra anë ndjekjen e ecurisë së një procesi nga fillimi në fund dhe në anën tjetër, ndjekjen e ecurisë së këtij procesi përgjatë strukturave të njësisë, apo ndërmjet vetë njësisë dhe institucioneve të jashtme.
  - Nga MHK, ka një plan masash korrigjuese për përmirësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, në zbatim të gjetjeve dhe rekomandimeve të dhëna nga Auditimi i Brendshëm I Ministrisë së Kulturës.



**Në përfundim të konstatimeve mbi vlerësimin e funksionimit të shtemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, po paraqesim gjetjet dhe rekomandimet si më poshtë:**

<b>Titulli i Gjetjes 1:</b>	Mbi forcimin e kontrolleve të brendshme
<b>Situata:</b>	<p><b>a.</b> Sa I takon respektimin të etikës nga punonjësit konstatuam se, sa më sipër është e përcaktuar në vec në një nen në rregulloren e brendshme të këtij institucioni, por ky institucion<sup>57</sup>, , <i>nuk ka një Kod të Brendshëm Etik të mirëfilltë ose një Kod Sjelljeje</i>, apo udhëzim për zbatimin e etikës, si dhe nuk ka procedurë për të raportuar shkeljet e legjislacionit mbi etikën dhe për marrjen e masave për shkeljet e konstatuara.</p> <p><b>b.</b> Për periudhën object auditimi rezultoi se, MHK ka funksionuar me strukturën e miratuar nga Kryeministri me urdhrin nr. 43, date 07.04.2017 “Për disa ndryshime në urdhrin nr. 19, datë 25.01.2014 “Për miratimin e strukturës dhe Organikës të MHK”, si dhe ushtron veprimtarinë mbështetur në aktet ligjore dhe nënligjore dhe Rregulloren se Brendshme të miratuar nga titullari i Muzeut i Urdhri i brendshëm nr.608/1 prot, datë 14.07.2016. <i>Nga auditimi rezultoi se edhe pse ligji për muzeta ka ndryshuar ëe në maj të vitit 2018, rregullorja nuk është përditësuar për të reflektuar ndryshimet ligjore, sa më sipër e kushtëzuar gjithashtu nga dalja e akteve nënligjore për zbatimin e ligjit të ri.</i></p> <p><b>c.</b> Proceset kryesore të punës janë të shkruara në rregulloren e brendshme në mënyrë të përgjithshme, pa u specifikuar detyrat dhe përgjegjësitë e secilit pozicion që përfshihet në një proces specifik. Në bazë të strukturës së miratuar konstatuam raste, ku ka mospërputhje mes strukturës dhe rregullores si dhe shumë re mbivendosje të detyrave, si në rastin e Sektorit të Menaxhimit të Koleksioneve dhe Sektorit të Konservimit të Koleksioneve<sup>58</sup>. Gjithashtu ndarja e detyrave mes punonjësve të sektorëve është e paqartë dhe mjaftohet me sa parshikohet në nenin 11 të rregullores ku citohet se: <i>“Specialistët varen direkt nga përgjegjësi i sektorit dhe zbaton me përpikmëri dhe në nivel të lartë profesional të gjitha detyrat e ngarkuara prej tij”</i>.</p> <p>Në kushtet e mungesës së përshkrimeve të qarta të pozicioneve të punës si dhe kualifikimeve që kërkon secili pozicion, e kishim të pamundur të shprehemi nëse stafi i MHK është në përputhje me kriteret e përcaktuara sipas kërkesave të vendit të punës. Procedurat e rekrutimit të stafit nuk janë të dokumentura për të dhënë siguri të arsyeshme grupit të auditimit.</p>

<sup>57</sup> në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, neni 20 “Mjedisi i kontrollit”, pika 2, germa a dhe në Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, të hartuar dhe miratuar nga Ministria e Financës, Kap II, pika 2.5.1 “Mjedisi i Kontrollit (ose mjedisi i brendshëm i njësisë)”, paragrafi “Integriteti dhe vlerat etike”

<sup>58</sup> Neni 13: Sektorit të Menaxhimit të Koleksioneve është përgjegjës për regjistrimin, dokumentimin, kërkimin dhe ruajtjen e koleksioneve si ato që janë të ekspozuara dhe ato të fondeve në bashkëpunim me Sektorin e Konservimit të Koleksioneve

Neni 14: Sektorit të Konservimit të Koleksioneve kryen regjistrimin, dokumentimin, kërkimin dhe ruajtjen e koleksioneve si ato që janë të ekspozuara dhe ato të fondeve në bashkëpunim me Sektorin e Menaxhimit të Koleksioneve



	<p><b>d.</b> Nga auditimi rezultoi se, ky institucion <i>nuk ka programe specifike për trajnimin</i> e punonjësve të administratës<sup>59</sup>,</p> <p><b>e.</b> Ndërsa pohohet nga subjekti në Pyetësorin e Vetëvlerësimit, grupit të auditimit nuk iu u vu ne dispozicion asnjë dokument që vërteton se është hartuar strategjia për menaxhimin e riskut<sup>60</sup>, e cila të jetë përditësuar çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut. Strategjia për menaxhimin e riskut përcakton mënyrën se si sillet organizata ndaj risqeve dhe vendos kuadrin e përgjithshëm të procesit të menaxhimit të riskut. Edhe pse MHK ka miratuar regjistrat e risqeve, kemi konstatuar se ka nevojë për përmirësime në mënyrë që planet vjetore të punës të lidhen me planin strategjik të njësisë publike, pasi lidhjet e qarta midis planit strategjik, planit vjetor të punës dhe buxhetit vjetor shërbejnë si pikënisje për procesin e menaxhimit të riskut në çdo nivel të njësisë publike</p> <p><b>f.</b> GMS nuk ka përgatitur një raport vjetor me qëllim kontrollin se si janë menaxhuar risqet brenda njësisë publike<sup>61</sup></p> <p><b>g.</b> Nga auditimi u konstatua se në vitet objekt auditimi nuk është hartuar një liste mbi proceset e punës, e cila të shërbejë për përgatitjen dhe dokumentimin e gjurmës së auditimit, duke u mjaftuar vetëm me përshkrimin e shkurtër të detyrave për cdo sektor në rregullore. Më konkretisht kjo është vënë re te procesi i shitjes së biletave, proces i cili vlerësohet të ketë mbetur jashtë monitorimit pikërisht për shkak të mungesës së aktivitetve të kontrollit.</p>
<b>Kriteri:</b>	Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, I ndryshuar, Manuali I Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit; Kuadri Coso, Praktika të mira të fushës
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Dobësim I kontrolleve të brendshme, cfarë çënon përmbushjen e objektivave të njësisë me eficiencë, efektivitet dhe ekonomicitet
<b>Shkaku:</b>	Mosrespektimi i kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi
<b>Rëndësia:</b>	I lartë
<b>Rekomandime:</b>	<p><b>a.</b> Titullari I Institucionit të marrë masa për hartimin dhe miratimin e Kodit Etik për MHK-në.</p> <p><b>b.</b> Titullari I Institucionit të marrë masa për të iniciuar propozimin për ndryshimet në strukturë ku të reflektohen ndryshimet që dikton ligji I ri për muzetë dhe trashëgiminë kulturore. Paralelisht me sa më sipër të merren masa për ngritjen e grupeve të punës për plotësimin e rregullores së brendshme me ndryshimet që dikton ligji I ri.</p> <p><b>c.</b> Titullari I Institucionit të marrë masa për ngritjen e grupit të punës me qëllim hartimin dhe miratimin e Rregullores së pozicioneve të punës ku: të përshkruhen proceset kryesore të punës duke u specifikuar detyrat dhe përgjegjësitë e secilit pozicion që përfshihet në procesin specifik; të rishikohen sektorët me mbivendosje të detyrave duke u qartësuar dhe ndarë përgjegjësitë</p> <p><b>d.</b> Titullari i MHK-së të marrë masa për miratimin e programeve specifike për trajnimin e punonjësve</p>

<sup>59</sup> në kundërshtim me Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kap. II, pika 2.5.1 “Mjedisi i kontrollit (ose mjedisi i brendshëm i njësisë”, paragrafit “Politikat dhe praktikat që lidhen me burimet njerëzore” dhe “Profesionalizmi i stafit”.

<sup>60</sup> në kundërshtim me nenin 21, pika 2 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, ku citohet se,

<sup>61</sup> Hapi I “Organizimi i procesit”, përgjegjësitë e menaxherëve të tjerë të njësisë publike



	<p><b>e.</b> Nëse dokumenti I strategjisë për menaxhimin e riskut është hartuar të na vihet në dispozicion me observacionet pas project raportit. Nëse nuk është hartuar, titullari i njësisë publike të marr masa për hartimin e këtij dokumenti të rëndësishëm për mirë funksionimin e kontrolleve të brendshme.</p> <p><b>f.</b> GMS të marr masa për të përgatitur një raport vjetor me qëllim kontrollin se si janë menaxhuar risqet brenda njësisë publike</p> <p><b>g.</b> Të merren masa për hartimin e një liste mbi proceset e punës, si element i rëndësishëm për përgatitjen dhe dokumentimin e gjurmës së auditimit.</p>
<b>Afati për zbatim:</b>	<b>Menjëherë dhe në vazhdim</b>

***Në përfundim për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:***

### **A. MASA ORGANIZATIVE**

**1. Gjetja nga auditimi:** Në lidhje me inventarizimin e pronës shtetërore u konstatua se, në **pasaportat** e 3 ikonave: “Shën Athanasi” me vlerë 2,055,000 lekë ; “Fjetja e Shën Mërisë ” me vlerë 12,330,000 lekë; dhe “Ngritja e Kryqit”, me vlerë 3,425,000 lekë, të cilat iu nënshtruan restaurimeve nga IMK, mungonte informacioni përkatës rreth ndërhyrjeve të kryera mbi to ndër vite (përfshirë edhe ndërhyrjet e fundit). Konkretisht, nga verifikimi i këtyre pasaportave u konstatua se:

- mungon firma dhe vula e Drejtorit të Qendrës Kombëtare të Inventarizimit të Pasurisë Kombëtare (QKIPK), sikundër e kërkon vetë formati, çfarë e bën këtë pasaportë të pasigurve (Pasaporta mban firmën vetëm të skeduesit që njëkohësisht është edhe punonjësi që ka në ngarkim objektin në fjalë - përgjegjësi i Sektorit të Konservimit);
- Nuk është plotësuar Nr. i Regjistrimit dhe Nr. i Inventarit të ikonës;
- Pasaporta nuk është firmosur as nga Drejtori i Muzeut Historik Kombëtar, në kundërshtim me kërkesat e Rregullores së Brendshme së MHK-së dhe formatit të vetë pasaportës.

Po kështu edhe nga verifikimi i **kartelave** u konstatua se, formati “Kartela e restaurimit dhe Konservimit” nuk përmban elementë sigurie si dhe:

- në asnjë rast nuk është plotësuar/identifikuar fusha “Konstatuesi”, sikundër e kërkon rregullorja, ku konstatimi i nevojës duhet të vijë gjithmonë nga Sektori i Konservimit.
- datat se kur ka hyrë dhe kur ka dalë objekti nga Laboratori nuk janë plotësuar me informacionin përkatës;
- emrat e personave që kanë kryer punimet janë plotësuar, por jo firmat për secilin prej tyre, sikundër e kërkon vetë formati;
- Paragrafi “Nga kontrolli i bërë me datë \_\_\_\_\_ rezultoi se gjendja e objektit është si më poshtë \_\_\_\_\_” është i paplotësuar për rastet objekt auditimi që janë: a. Objekti “Aureolë e Krishtit”, me nr inventari 5727; b. Objekti “Mbulesa e ikonës së Shën e Premtes” me nr inventari 5677; dhe c. Objekti “Mbulesa e ikonës së Shën Gjergjit”, me nr. inventari 5675.

Mungesa e informacionit historik, cenon gjurmimin e procesit ndër vite dhe shton risqet e mashtrimit. (Më hollësisht trajtuar në faqet 61-73, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)



**1.1. Rekomandim:** Për ikonat që janë restauruar deri tani por edhe ato që do t'i nënshtrohen këtij procesi në vijim, të merren masa që të gjitha ndërhyrjet të pasqyrohen në pasaportën dhe në kartelën e objektit të restauruar.

**1.2. Rekomandim:** Në kushtet kur këto dokumente të rëndësishëm nuk kanë asnjë element sigurie, të merren masa që pasi të plotësohen me informacionin e përditësuar, të protokollohen dhe arkivohen.

**Brenda datës 30.09.2019 dhe në vijimësi**

**2. Gjetja nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se, aktualisht zhvendosja e vlerave të trashëgimisë kulturore me qëllim ruajtjen e vlerave të tyre në mjedise të përshtatshme, nga pikëpamja e sigurisë ose mikroklimës, në varësi të natyrës së objektit, deri tani është bërë nga Instituti i Monumenteve të Kulturës (IMK). Por konstatohet se nuk ka gjurmë të dokumentuara për përgatitjen e studimeve paraprake, përpara kryerjes së zhvendosjes së objekteve të trashëgimisë kulturore, sikundër e dikton neni 10 i ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003 "Për trashëgiminë kulturore", i shfuqizuar me ligjin nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë". Aktualisht zhvendosja e aktiveve është bërë në përputhje vetëm me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 .

Kontrollet teknike paraprake krijojnë kushtet edhe për parashikimin e kalendarit të punimeve mbi afatin e fillimit dhe mbarimit të punimeve, i cili gjithashtu ka munguar

Në këto kushte konstatohet se proceset e restaurimit kanë zgjatur edhe mbi 4 vjet . Konkretisht, në bazë të Urdhrit të Ministrit të Kulturës nr. 69, datë 26.03. 2014 "Për dhënien e 4 ikonave Institutit të Monumenteve të Kulturës (IMK), për restaurim", MHK ka dorëzuar 4 ikonat, shoqëruar me procesverbalin date 10.04.2014 (Urdhri i brendshëm i titullarit nr. 344/1, date 10.04.2014)., nga ku vihet re se ikona "Shën Athanasi" është restauruar dhe kthyer në MHK në 27.05.2015 (pra rreth 1 vit me pas), 2 ikonat e tjera, Mandili i Krishtit dhe Shën Maria me Krishtin janë kthyer pas më shumë se 3 vitesh , ndërsa "Mbledhja e Krye-engjëjve" është kthyer pas më shumë se 4 vitesh. *(Më hollësisht trajtuar në faqet 61-73, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**2.1 Rekomandimi:** Në kushtet kur MHK nuk ka ekspertë për restaurimin, në çdo rast të zhvendosjes së vlerave të trashëgimisë kulturore për qëllime restaurimi, konservimi, etj, të kërkohet që nga ekspertët e IMK-së të kryhen kontrolle teknike paraprake, ku në përfundim të specifikohen nevojat konkrete për restaurim, të shoqëruara me kalendarët e punimeve. Këto dokumente të rëndësishëm duhet t'i bashkëngjiten praktikës së dosjes, pasi vetëm duke pasur një relacion fillestar mbi kushtet e objektit dhe nevojat për restaurim, arrihet të monitorohet procesi duke u identifikuar në përfundim punimet që u kryen dhe a i shërbyen këto punime përmirësimi të kushteve sipas relacionit fillestar. Dokumentimi tejet i kujdesshëm i këtij procesi forcon kontrollet e brendshme që lidhen me zhvendosjen e objekteve të trashëgimisë kulturore dhe minimizon risqet e abuzimit/mashtrimit me to.

**Në vijimësi**



**3. Gjetja nga auditimi:** U konstatua se, ikona e "Shën Athanasit", e cila është kthyer e restauruar nga IMK më 27.05.2015, është ridërguar për restaurim më 23.10.2017. Referuar shkresës së IMK nr. 1649, datë 01.08.2018, që shoqëron relacionin mbi ndërhyrjet konservuese-restauruese në ikonat e Pavijonit të Artit Mesjetar, në MHK, nga auditimi u konstatua se në relacionin e IMK-së, cilësohet fakti që: *"në rastin e ikonës "Shën Athanasi" problematika e përsëritur është pasojë e kushteve të papërshtatshme të konfortit ku ato konservohen dhe ekspozohen. Ato ekspozohen jo vetëm në kushte të papërshtatshme të mikroklimës, por edhe nën ndikimin e luhatjeve të theksuara të temperaturës dhe të % së lartë të lagështisë. Këto temperatura gjatë verës arrijnë vlera maksimale ekstreme."*

Duke konsideruar sa më sipër, në PBA 2018-2020 (faza I), MHK ka propozuar miratimin e projektit të investimeve "Ruajtja e temperaturës në ambientet e MHK-së, mbrojtja nga degradimi" për total shumë 58,023 mijë lekë, i cili gjithashtu është propozuar edhe në fazën e dytë të PBA 2018-2020, propozime këto të cilat nuk janë marrë parasysh nga Ministria e Kulturës.

Propozime të tjera të paraqitura nga MHK për investime që lidhen me ruajtjen dhe përmirësimin e kushteve të objekteve të trashëgimisë kulturore, konstatuam gjithashtu edhe në PBA 2017-2019 (faza II-të) ku MHK ka propozuar buxhet për investime për "Sigurimin e temperaturës për pajisje ngrohje-ftohje" në shumë 53,200 mijë lekë; investime për rikonstrukcion në total 316,509 mijë lekë konkretisht për rikonstrukcionin e pavijonit të arkeologjisë, 220,000 mijë lekë, si dhe për rikonstrukcionin e pavijonit të pavarësisë 40.000 mijë lekë. Rikonstrukcion i vetratave 38,601 mijë lekë).

Të gjitha sa më sipër nuk janë miratuar nga Ministria e Kulturës, duke mos u çelur asnjë fond për investime si për vitin 2017 ashtu edhe për vitin 2018. Të rrezikuarit e kushteve në të cilat mbahen objektet muzeale, veçanërisht ikonat rrezikon të çënojë funksionin primar të muzeut që ka të bëjë me ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore. (Më hollësisht trajtuar në faqe 61-73, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

**3.1. Rekomandimi:** Muzeu Historik Kombëtar t'i kërkojë Ministrisë së Kulturës, si ministri përgjegjëse, miratimin e fondeve për investime në buxhetet pasardhëse, të cilat lidhen direkt me përmbushjen e funksionit primar të Muzeut si ruajtja dhe mbrojtja e trashëgimisë kulturore, dhe kryesisht për: *administrimin e koleksioneve, sigurinë e tyre, konservimin parandalues e përmirësues, si dhe restaurimin e objekteve muzeore, etj.* Veçanërisht konservimi parandalues merr rëndësi të vecantë si një ndër strategjitë e menaxhimit të aktiveve në MHK, pasi duhet të përfshijë të gjitha masat e ndërmarra që nuk kërkojnë ndërhyrje direkte në pasuritë kulturore materiale, siç janë krijimi i kushteve të përshtatshme (lagështi relative, temperatura, pastërti nga ndotja atmosferike, dëmtimi biologjik dhe fizik në fonde, ekspozimi dhe transporti), me qëllim parandalimin e çdo lloji dëmtimi, dhe si i tillë i duhet dhënë rëndësia që i takon në buxhetet vjetore.

**Në vijimësi**

**4. Gjetja nga auditimi:** MHK nuk ka hartuar raporte periodike të monitorimit të buxhetit, duke mos bërë gjithashtu një analizë të (mos) realizimit të zërave (artikujve) krahasuar me planin, si dhe një analizë të faktorëve që kanë ndikuar në mosrealizim të tyre. MHK edhe pse Njësi e



Qeverisjes Qendrore e krijuar me VKM të veçantë, nuk ka zbatuar kërkesat e Udhëzimit nr. 22, datë 18.11.2016 "Për procedurat standard të monitorimit të buxhetit në NJQQ".

Monitorimi sipas treguesve që dikton Udhëzimi nr. 22, datë 18.11.2016, është procesi i vlerësimit të performancës së institucionit, i cili realizohet nëpërmjet krahasimit të treguesve faktikë të performancës me ata të planifikuar dhe si pasojë në kushtet kur kanë munguar raportet e monitorimit mbart, edhe shkaqet se përse objektivat nuk janë realizuar, nuk janë analizuar. Kryerja e raporteve të monitorimit në vetvete është hallkë e rëndësishme e sistemeve të kontrollit të brendshëm. *(Më hollësisht trajtuar në faqet 13-23, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**4.1. Rekomandimi:** Me qëllim ndjekjen dhe arrijten e objektivave të synuar, MHK nevojitet që të përgatisë raportet periodike të monitorimit të buxhetit ku ndër të tjera:

- të analizojë shkallën e realizimit të buxhetit dhe faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e tij; si dhe

- të evidentojë nëse realizimi i produkteve është në përputhje me planin dhe nëse jo, të propozojë ndërmarrjen e veprimeve korrigjuese, duke evidentuar ndikimin e mundshëm të tyre, në performancën e objektivave përkatëse, nëpërmjet plotësimit të: "Raportit të Shpenzimeve sipas Programeve", "Raportit të Shpenzimeve të Programit sipas Shpenzimeve", "Raportit përmbledhës të realizimit të treguesve të performancës/produkteve të programit", "Raportit të realizimit të objektivave të politikës së programit", "Projektet e investimeve me financim të brendshëm dhe me financim të huaj" .

#### Në vijimësi

**5. Gjetja nga auditimi:** MHK nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat që burojnë nga Rregullorja e Brendshme e Muzeut (neni 17) si dhe Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar për sa më poshtë:

**a.** Nga verifikimet e grupit të auditimit, rezultoi se në praktikën e të ardhurave dytësore që dorëzohet në Sektorin e Financës, në asnjë rast Biletaria nuk ka dorëzuar kuponin tatimor që të shoqërojë raportimet ditore të të ardhurave nga shitja e biletave, duke mos dhënë siguri mbi shifrën e të ardhurave të realizuara (për vitin 2018 sipas deklaratës në tatime, të ardhurat nga biletaria rezultuar 8,428 mijë lekë, ose 295 mijë lekë më pak nga sa deklaruar nga MHK).

**b.** Gjithashtu rezultoi se procesverbalet, dorëzuar nga punonjësja e Biletarisë, në Sektorin e Financës mbajnë vetëm një firmë, atë të punonjësës së Biletarisë, në kundërshtim me vetë kërkesat e Rregullores së Brendshme të Muzeut, ku në nenin 17 të saj parashikohet se, procesverbalet dorëzohen çdo të premte në zyrën e financës pasi të konfirmohen me siglën e drejtorit. Sistemi i dy nënshkrimeve merr rëndësi nga pikëpamja e veprimtarive të kontrollit në kuadër të forcimit të kontroleve të brendshme.

**c.** Sektori i Financës raportoi se gjendja fizike e biletave në Biletarinë e MHK-së, më datë 21.02.2019 është 2,662 copë , ndërsa shitjet deri në këtë datë janë 1,959 copë. Nga kryqëzimi i të dhënave me Magazinën rezultoi se për biletat, për vitin 2019 nuk është bërë asnjë dalje nga magazina, por grupit të auditimit nuk iu vu në dispozicion asnjë evidencë e saktë dhe e besueshme mbi gjendjen kontabël të biletave më datë 31.12.2017 dhe 31.12.2018 (veçanërisht tek Biletaria), duke krijuar kështu kushtet që grupi i auditimit të mos ofrojë siguri të arsyeshme mbi saktësinë e shifrës së raportuar.



**d.** U konstatuan raste të pa raportuara të biletave të pavlefshme dhe të pa dorëzuara në Sektorin e Financës, (me procesverbalet përkatëse), duke shtuar kështu riskun e rishitjes së tyre, në kushtet e mungesës së kontrolleve mbi procesin.

**e.** Grupi i auditimit kreu testime ku përzgjedhi muajt shtator, tetor, nëntor , dhjetor nga ku rezultoi se kishte mospërputhje edhe mes të dhënave që gjeneron Raporti i IT-së, dhe atyre të deklaruara, për më tepër që dy formatet kanë përmbajtje jo të njëjtë, çfarë e bën të vështirë krahasimin. Gjithashtu konstatuam se Nëpunësi Zbatues nuk ka akses në sistemin elektronik të biletave, i cili në fakt duhet t'i shërbejë këtij të fundit për të gjeneruar raportet me qëllim verifikimin e të ardhurave. Në kushtet kur këto raporte duhet t'i shërbejnë funksionimit të kontrolleve të brendshme, mungesa e aksesit ka eliminuar kontrollet mbi këtë proces.

Në përfundim, në asnjë rast nuk është kryqëzuar informacioni i sjellë nga Biletaria me: (1) deklarin sipas kasës fiskale; (2) raportin e gjeneruar nga sistemi elektronik i Biletarisë<sup>62</sup>; (3) nuk janë mbajtur procesverbale dhe nuk janë dorëzuar fizikisht biletat e dala "te pavlefshme", si dhe (4) nuk janë kryer inventarizime periodike mbi gjendjen e biletave pas shitjes. *(Më hollësisht trajtuar në faqet 23-31, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**5.1. Rekomandimi:** Me qëllim mirë menaxhimit e të ardhurave dytësore (nga shitja e biletave), Drejtori i institucionit duhet të marrë masa të menjëhershme për të çuar procesin drejt rregullshmërisë ligjore dhe financiare.

Në funksion të sa më sipër, Sektori i Financës duhet të krijojë dhe ndjekë proceset e nevojshme për të përmbushur këtë misionin, nëpërmjet:

- kryerjes së inventarizimeve periodike gjendjes fizike të biletave për të verifikuar saktësinë e shifrës së deklaruar.
- çeljes së aksesit në sistemin elektronik të biletave (Nëpunësit Zbatues) për të gjeneruar të gjitha ato raporte që vlerëson se forcojnë kontrollet që lidhen me deklarin e të ardhurave nga shitja e biletave.
- kontrollit nëse procesverbalet e dorëzuar nga biletaria po respektojnë sistemin e dy nënshkrimeve
- kontrollit nëse bashkëngjitur procesverbalit është edhe kuponi tatimor i gjeneruar nga kasa, i cili duhet të rakordojë me shifrën e raportuar në procesverbal dhe arkëtuar në bankë;
- të verifikojë nëse ka pasur raste të biletave të pavlefshme dhe të sigurohet që ato të dorëzohen fizikisht në Financë shoqëruar me procesverbalet përkatëse

**Menjëherë**

**6. Gjetja nga auditimi:** Administrata e Muzeut Historik Kombëtar zhvillon aktivitetin e saj në zbatim të rregullores së brendshme, e cila është miratuar me urdhrin e brendshëm të Drejtorit të Muzeut me Nr.608/1 prot., datë 14.07.2016. Kjo rregullore e brendshme nuk është e përditësuar me strukturën e vitit 2017 dhe 2018, ndaj ka mospërputhje midis tyre, në kundërshtim me kërkesat e Ligjit Nr.10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, neni 20 "Mjedisi i kontrollit", pika 1 dhe 2. Konkretisht:

- në rregullore parashikohet funksioni i zv/drejtorit, i cili në fakt, në strukturat e përmendura me lart nuk parashikohet si pozicion pune, në kundërshtim me VKM nr. 893, datë 17.12.2014 pika 3;

<sup>62</sup> Attendance & Revenue Report



- në nenin 21, pika 5 të rregullores është parashikuar një pozicion për specialistin e burimeve njerëzore, ndërkohe që në fakt, në strukturë nuk ekziston një pozicion i tillë, në kundërshtim me pikën 28, të VKM nr.893, datë 17.12.2014 ku përcaktohet se: *“Në institucionet, që kanë të paktën 30 (tridhjetë) pozicione pune, duhet të ekzistojë një pozicion pune për menaxhimin e burimeve njerëzore.”*

- në strukturën e miratuar mungon pozicioni i punës së një magazinieri dhe konkretisht në bazë të urdhrin Nr. 181, datë 19.02.2018 të Drejtorit të Muzeut, një punonjës mirëmbajtjeje është ngarkuar që të kryejë punën e magazinierit, pozicion ky i rëndësishëm në kushtet kur në vetë strukturën e MHK-së parashikohet një vend pune i dedikuar për të kryer këtë funksion, jo në përputhje me pikën 29, të VKM nr. 893, datë 17.12.2014;

- në sektorin e komunikimit dhe zhvillimit dhe në sektorin e programeve edukative të strukturës së vitit 2017 dhe strukturës së vitit 2018, nuk ka pozicion pune që të kryejë funksionin e përgjegjësit të sektorit, në kundërshtim me neni 22, pika 3, të ligjit nr.10296, datë 8.7.2010 *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, i ndryshuar.*

Gjithashtu u konstatua se, në ligjin e ri për *“Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”* në nenin 201, pika b) parashikohet që: *“Muzeu realizon punë kërkimore dhe siguron hulumtimin e plotë të koleksioneve të muzeut e të studimit në disiplinën shkencore.”* Për sa u trajtua më sipër, bëhet absolutisht i domosdoshëm ristrukturimi i organikës dhe përditësimi i rregullores së brendshme, në përputhje me përmbushjen e objektivave që parashikon ligji për Muzeun Historik Kombëtar. *(Më hollësisht trajtuar në faqe 32-37, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**6.1 Rekomandim:** Drejtimi të marrë masa për krijimin e një strukture organizative që të mundësojë funksionimin e institucionit me qëllim përmbushjen e objektivave të tij. Në këto kushte, MHK jo vetëm që duhet të plotësojë strukturën me pozicionet e specialistit të BNJ, magazinierit dhe Zv/Drejtorit por gjithashtu duhet ta rishikojë këtë strukturë nën dritën e kërkesave që burojnë nga Ligji i ri *“Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”*, duke konsideruar edhe funksionet e reja që i shtohen veprimtarisë së tij (si p.sh. kërkimi shkencor).

**Brenda datës 31.12.2019**

**7. Gjetja nga auditimi:** Nga auditimi rezultoi se, subjekti nuk disponon dokumentacionin që vërteton:(a) kryerjen e procedurave të rekrutimit, në mënyrë që të garantojë se personat e përzgjedhur përmbushin kriteret (pasi këto kriterë mungojnë); si dhe (b) të jenë përzgjedhur nëpërmjet një procesi të drejtë dhe transparent (sikundër parashikohet në Rregulloren e Brendshme, miratuar me urdhrin e Drejtorit të Muzeut, me nr.608/1 Prot., datë 14.07.2016, neni 21 *“Procedurat e rekrutimit të punonjësve të rinj”*.) Risku i mospërputhjes së pozicioneve të punës me kualifikimet e kërkuara, çënojnë realizimin e objektivit të pozicionit përkatës. Nga auditimi i dokumenteve që na u vunë në dispozicion nga MHK rezultoi se: nuk gjendeshin dokumentet e rekrutimit sipas fazave të parashikuara në nenin 21, të Rregullores së Brendshme, pra nuk ka një publikim në faqen zyrtare me datën reale për shpalljen e vendit vakant; nuk ka një njoftim për vend të lirë pune, të shoqëruar me emërtimin e pozicionit të punës, dokumentacionin ligjor që duhet të paraqesin kandidatët, kriteret dhe specifikat përkatëse në varësi të pozicionit të punës; nuk është mbajtur procesverbal se sa kandidatë kanë marrë pjesë dhe pse pikërisht është



zgjedhur ky kandidat fitues dhe jo një tjetër. Gjithashtu vumë re se, në përbërjen e grupit të punës, i cili shqyrton dokumentacionin, në asnjë rast nuk ka pasur punonjës të burimeve njerëzore, për faktin se në strukturën e MHK një pozicion i tillë nuk ekziston; dhe së fundi shpallja e fituesit në internet nuk është e dokumentuar. (Më hollësisht trajtuar në faqe 32-37, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

**7.1. Rekomandim:** Titullari i Institucionit të marrë masa për hartimin e rregullores për përshkrimet e punës; si dhe për lidhjen në mënyrë racionale të fazave të rekrutimit të parashikuara në rregulloren e brendshme të MHK-së, me përshkrimet e punës dhe kualifikimet për secilin pozicion, për të cilin do të zhvillohen procedura rekrutimi.

**Brenda datës 31.12.2019**

**8. Gjetja nga auditimi:** U konstatuan problematika që lidhen me inicimet e kërkesave për bazë materiale jo nga sektorët përkatës; procesverbale të marrjes në dorëzim të shërbimeve pa u konfirmuar nga MHK; mungesë të planeve të shpërndarjes; mungesë procedurash për aktivet që hyjnë dhe dalin në të njëjtën datë, më konkretisht:

**a.** Në disa raste nuk gjetëm gjurmë të justifikimit të nevojës për materiale, përpara hartimit të kërkesës për këto të fundit, nëpërmjet vlerësimit fillimisht të gjendjes së inventarit në magazinë për materialin në fjalë, si dhe dokumentimin e nevojës sipas sektorëve, në kundërshtim me sa parashikon Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011.

Sa më sipër përforcohet edhe nga analiza e nën-llogarisë 6020100 "Blerje material kancelari-bojra printeri", në shumën 441,035 lekë (ose rreth 3% të total llogarisë 602) nga ku rezultoi se, kërkesa është iniciuar nga Sektori i Menaxhimit të Vizitorëve dhe jo nga sektorët që kanë nevojë konkrete për materialet. Për më tepër që konstatuam se, ky artikull kërkon rreth 189 ditë për të qarkulluar ose rreth 2 herë në vit, gjë e cila nuk justifikon furnizimet më të shpeshta se kjo normë.

Në urdhër-shpenzimin nr. 141, datë 03.10.2018 "Shërbim dezinfektimi dhe deratizim ambienti, faza e dytë", në shumën 108,000 lekë u konstatua se, bashkëngjitur praktikës është kërkesa për dezinfektim e iniciuar nga përgjegjësi i Sektorit të Menaxhimit të Shërbimeve për Vizitorët dhe nga një specialist nga Sektori i Konservimit të Koleksioneve, në kundërshtim me Rregulloren e Brendshme për Organizimin dhe Funksionimin e MHK-së, neni 14/j ku parashikohet se Sektori i Konservimit të Koleksioneve propozon dhe ndjek dezinfektimin e përvitshëm të gjithë pavijoneve dhe fondeve të MHK-së;

**b.** Në disa raste, praktikës së urdhër shpenzimeve për shërbimin e rojeve, nuk i është bashkëngjitur procesverbali i marrjes në dorëzim, mbi bazë të të cilit duhet të bëhet edhe likuidimi i fondeve, ose dhe në rastet kur ky procesverbal ka qenë pjesë e praktikës, nuk është firmosur nga pala e MHK-së, në mënyrë që të konfirmohet marrja e plotë e shërbimit që siguron se, cilësia e shërbimeve është e njëjtë me sa parashikuar në kontratë, në përputhje me kërkesat e Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", neni 165.

**c.** Janë konstatuar raste të dërgimit të aktiveve drejtpërdrejt nga furnizuesi dhe bërë hyrje-dalje pa kaluar në magazinë, ku për këto lloj lëvizjesh, NA i njësisë publike nuk ka miratuar procedura standarde të lëvizjes, të shoqëruara me përgjegjësitë respektive sipas parashikimit në paragrafin 41, të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, (rastet e cilësuar në Aneksin 2 bashkëngjitur Raportit



Përfundimtar të Auditimit janë bërë hyrje dalje pa kaluar në magazinë; rastet e ikonave gjithashtu).

*(Më hollësisht trajtuar në faqet 41-73, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**8.1.** Me qëllim gjetjen e një balance të saktë midis mbajtjes së një gjendjeje të mjaftueshme aktivesh për përmbushjen e kërkesave operacionale, me minimumin e riskut dhe kostos për mbajtjen e tyre, nevojitet që në zbatim të kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi, kërkesa për aktive të iniciohet nga sektorët përkatës nga buron nevoja dhe jo ndryshe.

**Në vijimësi**

**8.2.** Përpara kryerjes së pagesës, me qëllim forcimin e kontroleve që vërtetojnë kryerjen e shërbimit të rojeve, në çdo rast Nëpunësi Zbatues (NZ), të kërkojë procesverbalet nga punonjësit e autorizuar të MHK-së, ku të konfirmohet se cilësia e shërbimeve është e njëjtë me sa parashikuar në kontratë. Ky dokument duhet të jetë pjesë e praktikës bashkëngjitur urdhërshpenzimit përkatës.

**Në vijimësi**

**8.3.** Nëpunësi Autorizues (NA) i njësisë publike, të marrë masa për ngritjen e grupit të punës me specialistë të fushës, për hartimin dhe miratimin e procedurave standarde dhe të qarta, të shoqëruara me përgjegjësitë respektive, për lëvizjet e aktiveve, të cilat deri më tani janë bërë hyrje-dalje formalisht në magazinë. Veçanërisht për zhvendosjen e objekteve të trashëgimisë kulturore (si p.sh. ikonat) të përshkruhen proceset që duhen ndjekur për zhvendosjen e tyre, duke parashikuar qartë rolet dhe përgjegjësitë e sektorëve/pozicioneve të përfshirë në proces.

**Brenda datës 31.12.2019**

**9. Gjetja nga auditimi:** U konstatuan problematika që lidhen me mos regjistrime në kohë të faturave të hyrje-daljeve në ditarët e magazinës apo në disa raste regjistrime jo të saktë në kontabilitet të objekteve me vlera mbi 10,000 lekë si inventar i imët. Më konkretisht:

-Nga verifikimi i fletë hyrjeve dhe fletë daljeve të magazinës dhe krahasimit të tyre me urdhërshpenzimet përkatëse, si dhe me ditarët e bankës konstatuam se, kishin mbetur pa u regjistruar në ditarët e magazinës 8 fatura "hyrje mallrash në magazinë" në shumën totale prej 580,240 lekë.

- Janë harruar të kontabilizohen në kohë urdhërshpenzimet, në rastet si vijon:

1) Urdhërshpenzimi nr.78 datë 30.05.2017, me objekt shpenzimi 'Udhëtim jashtë shtetit', me shumë totale 70,522 lekë, i takon muajit maj por që për nga rendi kronologjik i korrespondon muajit qershor;

2) Urdhërshpenzimet nr.115 datë 14.07.2017, dhe nr.116 datë 14.07.2017, me objekt respektivisht 'Blerje bileta elektronike', në shumën totale 98,910 lekë dhe 'Blerje material pastrimi' në shumën totale 123,744 lekë, i takojnë muajit korrik, por për nga rendi kronologjik I korrespondojnë muajit gusht;

3) Gjatë muajit gusht, 2018, janë harruar të kontabilizohen: urdhërshpenzimin nr.111, që mbulohet edhe nga data 01.08.2018 me objekt shpenzimi 'Rrogat' me shumën totale 2,008,295 lekë, dhe nga data 16.08.2018 me objekt shpenzimi 'Sigurimet shoqërore' me shumën totale 517,781 lekë; urdhërshpenzimi nr.112 që mbulohet edhe nga data 01.08.2018, me objekt shpenzimi 'Rrogat' me shumën totale 167,697 lekë, edhe nga data 15.08.2018, me objekt shpenzimi 'Blerje



baneri, roli, broshura për ekspozitën “Unë jam Shqiptar” Prishtinë’, me shumën totale 69,600 lekë, duke mos u ruajtur kështu rendi kronologjik.

- Tre objektet si vijon: (1) *Portret me mollë*”, me vlerë 12.960 lekë. (2) *Pasqyrë dekorative*” me vlerë 10,000 lekë, dhe (3) *“Stativ flamuri bronxi”* me vlerë 13,000 lekë, ishin kontabilizuar si inventar i imët, edhe pse me vlerë mbi pragun e vlerësimit të aktiveve afatgjata (AAGJ) materiale prej 10,000 lekë, në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, paragrafi 29.

*(Më hollësisht trajtuar në faqe 41-73, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**9.1. Rekomandimi:** Sektori i Financës, në çdo rast të bëjë në kohën e duhur regjistrimet në kontabilitet të urdhër shpenzimeve dhe të çdo dokumenti tjetër financiar dhe justifikues.

**Në vijimësi**

**9.2. Rekomandimi:** Me qëllim eliminimin e riskut operacional të shtuar, që vjen si pasojë e mungesës së një sistemi të mirëfilltë kontabël (deri tani është punuar me “Excel sheets”), MHK duhet të mundësojë blerjen e një sistemi elektronik kontabël.

**Në vijimësi**

**9.3. Rekomandimi:** NA të marrë masa për rivlerësimin e 3 objektet me vlera mbi kufirin e vlerësimit prej 10,000 lekë me qëllim njohjen dhe kontabilizimin e drejtë të tyre sipas klasifikimit përkatës, si Aktive Afatshkurtra Materiale (imët/konsum) apo AAGJ materiale.

**Brenda datës 30.09.2019**

**10. Gjetja nga auditimi:** Me urdhër-shpenzimin nr. 188, datë 26.11.2018, janë likuiduar fonde në shumën 343,200 lekë për blerje materiale dhe shërbime speciale (rampat). Sipas dokumentacionit bashkëlidhur urdhër shpenzimit, objekti i prokurimit është “Rampat e shkallëve për personat me aftësi të kufizuara”, si dhe specifikimet teknike të mallit janë materiale ndërtimi si: tubular celiku profil 60\*30 mm, strukturë e varfër panele druri, vida vetëfiletuese, veshje me linoleum, pragje alumini, këndorë alumini, etj. Pra ky objekt është prokuruar si kontratë pune, e vërtetuar kjo edhe nga fatura tatimore e shitjes, e cila është prerë për “Materiale për rampat e shkallëve”. Mirëpo vlera e këtij objekt prej 343,200 lekë është kontabilizuar si mall konsumi (llogaria 31), në fakt është kontratë pune (investim) dhe duhej të prekte llogarinë 212 “Ndërtime dhe Konstrukione”, duke shtuar me po të njëjtën shumë, vlerën e ndërtesës, në përputhje me paragrafët 74, 75, të udhëzimit nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit. *(Më hollësisht trajtuar në faqe 50, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**10.1. Rekomandimi:** Të merren masa që vlera e investimit prej 343,200 leke, për ndërtimin e rampave të shkallëve për personat me aftësi të kufizuara, të kontabilizohet në llogarinë 212 “Ndërtime dhe Konstrukione.”

**Menjëherë**

**10.2. Rekomandimi:** Me qëllim mos shtrembërimin e destinacionit të shpenzimit, në çdo rast, Nëpunësi Zbatues duhet të kontrollojë nëse kërkesa për kryerjen e një shpenzimi është në përputhje me buxhetin e miratuar. Në raste të nevojës për rishpërndarje fondesh që sjellin ndryshime midis kapitujve dhe artikujve buxhetorë dhe/ose projekteve të investimeve brenda një



programi buxhetor, NZ duhet të depozitohet zyrtarisht pranë Nëpunësit të Parë Autorizues, kërkesën për sa më sipër, shoqëruar me analizë ku të identifikohet arsyeja, rezultatet e pritshme, kontributi në arritjen e qëllimit dhe objektivave, risqet respektive, dhe pasojat.

**Në vijimësi**

**11. Gjetja nga auditimi:** Me urdhrin nr. 1002, datë 28.12.2016, të Drejtorit të MHK-së, është ngritur Komisioni për Vlerësimin e Aktiveve; ndërsa me Urdhrin nr. 1003, datë 30.12.2016, i ndryshuar me Urdhrin nr. 493, datë 09.06.2017 të Drejtorit të MHK-së, është ngritur Komisioni për Nxjerrje Jashtë Përdorimi të Aktiveve, në MHK. Konstatuam se janë nxjerrë jashtë përdorimit ndër të tjera edhe 3 kompjuterë (me vlerë totale prej 130,000 lekë) dhe 2 kamera profesionale (me vlerë totale prej 246,594 lekë), të cilat janë vlerësuar "në prani të punonjësit të IT-së", roli i të cilit si "i pranishëm" në këtë proces, është i paqartë, në kushtet kur specialisti i fushës (në rastet e kompjuterëve dhe televizorit - punonjësi i IT-së) duhet të ishte në përbërjen e Komisionit të Vlerësimit, sikundër e dikton Udhëzimi nr.30, datë 27.12.2011, paragrafi 99. Në këto kushte gjykojmë që procesi i vlerësimit të jetë kryer në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011. Po kështu, ky punonjës ka qenë në përbërje të Komisionit për Nxjerrje Jashtë Përdorimit, në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011, paragrafi 97. *(Më hollësisht trajtuar në faqe 66-68, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**11.1 Rekomandim:** Në çdo rast të vlerësimit të aktiveve specifike (si kompjuterë apo pajisje elektronike), Komisioni i Vlerësimit të Aktiveve duhet të ketë në përbërje, një specialist të fushës. Anëtarë të këtij komisioni, në asnjë rast, nuk duhet të jenë në përbërje të Komisionit për nxjerrje jashtë përdorimi të aktiveve.

**Në vijimësi**

**12. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i llogarive vjetore të Muzeut Historik Kombëtar, rezultoi se në vitin 2017, shpenzimet për dezinfektim në shumën 229,200 lekë janë kontabilizuar në llogarinë 6022099, ndërkohë që gjatë vitit 2018, kjo llogari ka regjistruar shpenzimet për shërbimin e transportit të materialeve për ekspozita në shumën 235,200 lekë, ndërsa shpenzimet e dezinfektimit paraqiten në një llogari të re që është 6025200. Edhe pse është një rast i vetëm, paraqitja e të njëjtit tip shpenzimi, nga njëri vit në tjetrin, në llogari të ndryshme, çënon parimin e qëndrueshmërisë dhe krahasues së pasqyrave financiare, i cili kërkon që për përgatitjen e pasqyrave financiare të përdoren vazhdimisht të njëjtat politika kontabël, e njëjta paraqitje dhe të njëjtat formate të pasqyrave financiare. Informacioni që paraqitet në pasqyra përbën bazën për krahasimin objektiv të të dhënave të treguesve të performancës financiare të njësisë si dhe i shërben në mënyrë efektive procesit të vendimmarrjes. *(Më hollësisht trajtuar në faqet 73-83, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**12.1 Rekomandim:** Sektori i Financës, në respekt të parimit të qëndrueshmërisë dhe krahasueshmërisë së pasqyrave financiare, të marrë masa që në asnjë rast të mos ndryshojë llogaritë ekonomike, nëse lloji i shpenzimit nuk ndryshon. Për shpenzimet e dezinfektimit, të vijohet me kontabilizimin në llogarinë 6025200, sikundër është bërë përgjatë vitit 2018, por ky



ndryshim dhe ndryshime të tjera nëse do të rezultojnë, të trajtohen në relacionet shpjeguese të pasqyrave financiare të vitit ushtrimor 2018.

### Në vijimësi

**13. Gjetja nga auditimi:** Mbështetur në Ligjin nr.9386, datë 4.5.2005 "Për muzetë", neni 13 "Drejtuesit e muzeve, publike dhe private, detyrohen të garantojnë sigurinë e mjediseve dhe të fondit muzeor, që kanë në administrim, ndaj të gjitha rreziqeve të mundshme, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi", MHK ka realizuar procedura prokurimi për shërbimin privat të sigurisë fizike të Muzeut Historik Kombëtar. Nga auditimi i këtyre procedurave u konstatua se: Për periudhën 01.01.2017 deri në 09.02.2017 për shërbimin privat të sigurisë fizike të Muzeut Historik Kombëtar është kryer procedura e prokurimit "me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit" (20% e shtesës së kontratës fillestare të mëparshme). Më pas për periudhën 15.02.2017 deri në 15.04.2017 përsëri ky shërbim është prokuruar me procedurën "negocim pa shpallje paraprake të njoftimit" për të mbuluar periudhën 2 mujore. Finalizimi i procedurës së prokurimit që zgjati përtej afateve të parashikuara, për shkak të trajtimit të disa ankesave nga OE-të, bëri që nga data 15.04.2017 (data e përfundimit të kontratës ekzistuese) deri në datën 28.04.2017 (data e lidhjes së kontratës së re), MHK ka qenë i pambuluar nga shërbimi i ruajtjes fizike të Muzeut. Mungesa e këtij shërbimi për periudhën prej 13 ditësh, ka vënë MHK përpara risqeve që siguria objekteve me vlera të trashëgimisë kulturore, të cenohet.  
(Më hollësisht trajtuar në pikën III.3 faqe 61-73, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

**13.1 Rekomandimi:** Në kushtet kur ruajtja dhe siguria e objekteve të trashëgimisë kulturore është ndër funksionet primare të MHK, drejtimi duhet të marrë masa që në çdo rast të vlerësohet, planifikohet dhe ndiqet me kujdes situata e afateve për mbulimin pa asnjë ndërprerje të këtij shërbimi gjatë gjithë vitit kalendarik. MHK të marrë masa që në çdo rast të respektohen kushtet e kontratës sa i takon respektimit të afateve të likuidimit pas marrjes së shërbimit të kërkuar.

### Në vijimësi

**14. Gjetja nga auditimi:** Nga shqyrtimi i dokumentacioni të procedurës së prokurimit me objekt "Blerje tonera kancelari" me vlerë kontrate 158,400 lekë, u konstatua se në dosjen e inventarizuar, kanë munguar formularët mbi deklarinë e konfliktit të interesit, të cilat detyrimisht duhet të plotësohen dhe nënshkruhen nga anëtarët e KPVV-së (sipas urdhrorit të brendshëm nr.11, datë 05.01.2018), në kundërshtim me kërkesat e VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për rregullat e prokurimit publik" i ndryshuar, ku Neni 56 "Titullari i autoritetit kontraktor ose zyrtari i autorizuar" pika 1 citon: "Kërkesat ligjore për parandalimin e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi, duhet të mbahen parasysh në emërimin e një nëpunësi prokurimi. Çdo nëpunës, që merr pjesë në procesin e prokurimit nënshkruan një deklaratë, përmes së cilës deklaron se nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit". Mos-deklarimi i konfliktit të interesit nga KPVV mbart risqe që lidhen me trajtimin jo të barabartë të operatorëve pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik, në rastet e ekzistencës së konfliktit të vazhdueshëm të interesit, si dhe ndikon në shmangien e kryerjes së detyrës nga punonjësi me paanësi dhe ndershmëri. (Më hollësisht trajtuar në pikën III.3 faqe 61-73, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)



**14.1 Rekomandimi:** Për çdo procedurë prokurimi, njësia e prokurimit, të verifikojë që çdo nëpunës, që merr pjesë në procesin e prokurimit të ketë nënshkruar deklaratën e konfliktit të interesit në përputhje me rregullat e prokurimit publik.

**Në vijimësi**

**15. Gjetja nga auditimi:** Nga auditimi mbi vlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, u konstatuan këto problematika:

**a.** MHK nuk ka hartuar një Kod Etik të mirëfilltë ose një Kod Sjelljeje, për zbatimin e etikës, si dhe nuk ka procedurë për të raportuar shkeljet e legjislacionit mbi etikën dhe për marrjen e masave për shkeljet e konstatuara. Më sipër është rregulluar thjesht me një nen të veçantë në rregulloren e brendshme të institucionit (neni 25), në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" i ndryshuar, neni 20 "Mjedisi i kontrollit", pika 2, germa a dhe në Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, të hartuar dhe miratuar nga Ministria e Financës, Kap II, pika 2.5.1 "Mjedisi i Kontrollit (ose mjedisi i brendshëm i njësisë)", paragrafi "Integriteti dhe vlerat etike."

**b.** Për periudhën objekt, MHK ka funksionuar me strukturën e miratuar nga Kryeministri me urdhrin nr. 43, datë 07.04.2017 "Për disa ndryshime në urdhrin nr. 19, datë 25.01.2014 "Për miratimin e strukturës dhe Organikës të MHK", si dhe ushtron veprimtarinë mbështetur në aktet ligjore dhe nënligjore dhe Rregulloren se Brendshme të miratuar nga titullari i Muzeut me Urdhrin e brendshëm nr. 608/1 prot, datë 14.07.2016. Nga auditimi rezultoi se edhe pse ligji për muzetë ka ndryshuar në maj të vitit 2018, rregullorja nuk është përditësuar për të reflektuar ndryshimet ligjore, sa më sipër e kushtëzuar gjithashtu nga dalja e akteve nënligjore për zbatimin e ligjit të ri.

**c.** Proceset kryesore të punës janë të shkruara në rregulloren e brendshme në mënyrë të përgjithshme, pa u specifikuar detyrat dhe përgjegjësitë e secilit pozicion që përfshihet në një proces specifik. Në bazë të strukturës së miratuar konstatuam raste, ku ka mospërputhje mes strukturës dhe rregullores si dhe vumë re mbivendosje të detyrave, si në rastin e Sektorit të Menaxhimit të Koleksioneve dhe Sektorit të Konservimit të Koleksioneve, ku në Nenin 13 të rregullores parashikohet se: *Spektori i Menaxhimit të Koleksioneve është përgjegjës për regjistrimin, dokumentimin, kërkimin dhe ruajtjen e koleksioneve si ato që janë të ekspozuara dhe ato të fondeve në bashkëpunim me Sektorin e Konservimit të Koleksioneve*, ndërsa në nenin 14 të saj parashikohet se: *"Spektori i Konservimit të Koleksioneve kryen regjistrimin, dokumentimin, kërkimin dhe ruajtjen e koleksioneve si ato që janë të ekspozuara dhe ato të fondeve në bashkëpunim me Sektorin e Menaxhimit të Koleksioneve."*

Gjithashtu ndarja e detyrave mes punonjësve të sektorëve është e paqartë dhe mjaftohet me sa parashikohet në nenin 11 të rregullores ku citohet se: *"Specialistët varen direkt nga përgjegjësi i sektorit dhe zbaton me përpikmëri dhe në nivel të lartë profesional të gjitha detyrat e ngarkuara prej tij"*.

Në kushtet e mungesës së përshkrimeve të qarta të pozicioneve të punës si dhe kualifikimeve që kërkon secili pozicion, e kishim të pamundur të shprehemi nëse stafi i MHK është në përputhje me kriteret e përcaktuara sipas kërkesave të vendit të punës. Procedurat e rekrutimit të stafit nuk janë të dokumentuara për t'i dhënë siguri të arsyeshme grupit të auditimit.

**d.** Nga auditimi rezultoi se, ky institucion *nuk ka programe specifike për trajnimin e punonjësve*



të administratës, në kundërshtim me Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kap. II, pika 2.5.1 “Mjedisi i kontrollit (ose mjedisi i brendshëm i njësisë”, paragrafit “Politikat dhe praktikrat që lidhen me burimet njerëzore” dhe “Profesionalizmi i stafit”.

**e.** MHK nuk ka miratuar Strategjinë për Menaxhimin e Riskut, e cila ka për qëllim të përcaktojë mënyrën se si sillet organizata ndaj risqeve dhe vendos kuadrin e përgjithshëm të procesit të menaxhimit të riskut, në kundërshtim me nenin 21, pika 2 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin .

**f.** GMS nuk ka përgatitur një raport vjetor me qëllim kontrollin se si janë menaxhuar risqet brenda njësisë publike, në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, hapi I, “Organizimi i procesit” .

**g.** Nga auditimi u konstatua se në vitet objekt auditimi nuk është hartuar një listë mbi proceset e punës, e cila të shërbejë për përgatitjen dhe dokumentimin e gjurmës së auditimit, duke u mjaftuar vetëm me përshkrimin e shkurtër të detyrave për çdo sektor në rregullore. Më konkretisht kjo është vënë re te procesi i shitjes së biletave, proces i cili vlerësohet të ketë mbetur jashtë monitorimit pikërisht për shkak të mungesës së aktiviteteve të kontrollit.

*(Më hollësisht trajtuar në faqet 115-125, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**16.1. Rekomandim:** Të merren masa për hartimin dhe miratimin e Kodit Etik për MHK-në.

**Menjëherë**

**16.2. Rekomandim:** Të merren masa për të bërë ndryshimet në strukturë ku të reflektohen ndryshimet që dikton ligji i ri për muzetë dhe trashëgiminë kulturore. Paralelisht me sa më sipër të merren masa për ngritjen e grupeve të punës për plotësimin e rregullores së brendshme me ndryshimet që dikton ligji i ri.

**Brenda datës 31.12.2019**

**16.3. Rekomandim:** Të merren masa për miratimin e programeve specifike për kryerjen e trajnimit të punonjësve.

**16.4. Rekomandim:** Të merren masa për hartimin e Strategjisë për Menaxhimin e Riskut në mënyrë që planet vjetore të punës të lidhen me planin strategjik të njësisë publike, pasi lidhjet e qarta midis planit strategjik, planit vjetor të punës dhe buxhetit vjetor shërbejnë si pikënisje për procesin e menaxhimit të riskut në çdo nivel të njësisë publike.

**16.5. Rekomandim:** GMS të marr masa për të përgatitur një raport vjetor me qëllim kontrollin se si janë menaxhuar risqet brenda njësisë publike

**16.6. Rekomandim:** Të merren masa për hartimin listës mbi proceset e punës, si element i rëndësishëm për përgatitjen dhe dokumentimin e gjurmës së auditimit.

**Brenda datës 31.12.2019**

## V. KONKLUZIONE DHE OPINIONI I AUDITIMIT

Në kuptimin e hartimit, implementimit dhe funksionimit të kontrolleve të brendshme është përgjegjësi e drejtimit që të marrë masa për hartimin e procedurave dhe politikave që I përshtaten rrethanave të njësisë dhe të kërkojë implementimin e tyre si pjesë integrale e operacioneve të njësisë. Mbështetur mbi pikat e programit të auditimit të KLSH, dhe parë rezultatet e këtij auditimi në projekt-raport **gjykojmë se, kontrollet nuk mund të funksionojnë në mënyrë**



**efektive, nëse ato nuk janë hartuar e më pas implementuar në mënyrë efektive;** Cfarë do të thotë se, gjithë konstatimet KLSH-së nrajuara gjerësisht në këtë material, pa diskutim që cënojnë edhe funksionimin e kontroleve të brendshme, duke rrezikuar realizimin e objektivave për të cilat këto kontrole duhej të ishin hartuar e më pas implementuar.

### **Opinion mbi përputhshmërinë (i kualifikuar)**

Ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së MHK me kriteret e vlerësimit përfshirë kuadrin ligjor, rregullat, rregulloret dhe marrëveshjet që lidhen dhe ndikojnë në përdorimin e fondeve/burimeve të MHK-së. Gjithashtu auditimi përfshiu një analizë të sistemeve të kontrollit të brendshëm (KB) me qëllim vlerësimin e hartimit, implementimit dhe funksionimit me efektivitet të kontroleve të brendshme, ku në përfundim u konstatuan thyerje të tyre përgjatë hartimit dhe implementimit e si pasojë edhe funksionimit të këtyre sistemeve. Është përgjegjësi e drejtimit që të hartojë procedura dhe politika që i përshtaten rrethanave të njësisë dhe të kërkojë implementimin e tyre si pjesë integrale e operacioneve të njësisë, në mënyrë që kontrollet e brendshme të funksionojnë në mënyrë efektive, duke mundësuar kufizimin e risqeve të keqpërdorimit të fondeve publike, dhe duke mos rrezikuar realizimin e objektivave të institucionit.

Mbështetur mbi punën audituese në përfundim rezultoi se, në opinionin tonë, aktiviteti i Muzeut Historik Kombëtar, me përjashtim të çështjeve të trajtuara në bazën për kualifikimin e opinionit ku u konstatuan shmangie nga kuadri rregullator ose mungesë e tij, është në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e vlerësimit, si dhe me parimet dhe rregullat e aplikueshme.

### **Baza për kualifikimin e opinionit mbi përputhshmërinë**

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAIs). Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin "Përgjegjësitë e Audituesit për auditimin e Pasqyrave Financiare", pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 4000 "Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë". Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin nr. 27, datë 20.04.208, të Kryetarit të KLSH-së. Auditimi ynë përfshin kryerjen e procedurave me qëllim marrjen e evidencave të auditimit mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e transaksioneve. Procedurat janë përzgjedhur mbështetur mbi gjykimin profesional të audituesit, përfshirë marrjen në konsideratë të risqeve të mospërputhshmërisë materiale të transaksioneve me kriteret e parashikuara.

Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen **e opinionit të kualifikuar të auditimit**.

- Nga evidencat e marra rezultuan thyerje materiale të sistemeve të kontrollit përgjatë procesit të transferimit të ikonave për qëllime restaurimi, pasi kanë munguar procedura/rregullore të brendshme që të përshkruajnë proceset që duhen ndjekur për zhvendosjen e tyre shoqëruar me përcaktimin e qartë të roleve dhe përgjegjësi të sektorëve/pozicioneve/palëve të përfshira në



proces; gjithashtu mosplotësimi i kartelave dhe pasaportave të ikonave, me informacionin përkatës mbi historikun e restaurimeve/konservimeve të kryera ndër vite, ka çënuar gjurmimin e procesit në vetvete; mungesa e buxheteve për krijimin e kushteve të përshtatshme të konfortit ka shkaktuar dëmtime dhe problematika të përsëritura (rasti i ikonës së Shën Athanasit).

Sa më sipër ka bërë që këto objekte të trashëgimisë kulturore, me vlera të pazëvendësueshme të pasurisë kombëtare, të jenë vazhdimisht të ekspozuara përpara riskut të prishjes, humbjes, vjedhjes, pra “degradimit” të tyre.

- Nga evidencat e marra rezultuan thyerje të kontroleve përgjatë procesit të krijimit të të ardhurave dytësore (shitja e biletave), duke kufizuar audituesit në dhënien e sigurisë së arsyeshme mbi shifrat e deklaruara për këtë zë. Duke qenë burim kryesor i të ardhurave që menaxhohen nga vetë Muzeu, për proceset që gjenerojnë këtë kategori të ardhurash, duhet të tregohet kujdesi i duhur në mënyrë që ato t'i nënshtrohen menjëherë rregullave të disiplinës financiare.

- Nga evidencat e marra rezultuan thyerje të sistemeve të kontrollit që lidhen me mungesën e procedurave transparente të rekrutimit, shtuar kësaj mungesën e përshkrimit të punës dhe si pasojë mungesën e kualifikimeve të kërkuara për pozicionet.

#### **Opinion mbi pasqyrat financiare (I pakualifikuar)**

Ne audituam pasqyrat financiare të MHK-së më datë 31.12.2017, të cilat përbëhen nga Bilanci, Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve, Pasqyra e Fluksit të Arkës, dhe Pasqyra e Lëvizjes së Kapitalit si dhe shënimet shpjeguese që shoqërojnë pasqyrat.

Në opinionin tonë, veprimet përgjatë raportimit financiar dhe transaksionet e kryera për ekzekutimin e buxhetit janë në përputhje me ligjin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, si dhe me ligjet dhe rregullat përkatëse të financave publike, përfshirë rregullat për prokurimet dhe ato të buxhetit.

#### **Baza për opinionin mbi pasqyrat financiare**

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAIs). Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare”, pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 4000 “Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë”. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin nr. 27, datë 20.04.2008, të Kryetarit të KLSH-së. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e **opinionit të pakualifikuar të auditimit**.

#### **Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjet nën auditim:**



Drejtimi i MHK<sup>së</sup> është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Staf i drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjithë bazën ligjore dhe rregullatorë në fuqi.

**Përgjegjësia e Audituesve të KLSH:**

Objektivi ynë lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme mbi përputhshmërinë e aktivitetit të MHK, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, si dhe mbi përdorimin e duhur dhe eficient të burimeve financiare të institucionit. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese.

Gjithashtu ne krijojmë një ide fillestare mbi kontrollin e brendshëm në mënyrë që të planifikojmë procedurat e auditimit që i përshtaten situatës aktuale.

Ne komunikojmë me drejtuesit ndër të tjera, edhe për planifikimin në kohë dhe përmbajtjen e auditimit si dhe konkluzionet/gjetjet, duke përfshirë edhe të metat e kontrollit të brendshëm, që ne kemi identifikuar gjatë auditimit tonë.

Ne identifikojmë çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

***Shënim i grupit të auditimit:***

***Pika 7 – vlerësimi i Auditimit të Brendshëm nuk mund të realizohet pasi Muzeu nuk ka Njësi të Auditimit të Brendshëm.***

***Pika 8 – Zbatimi i rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme, nuk mund të realizohet pasi ky është auditimi i parë që KLSH kryen mbi aktivitetin ekonomik dhe financiar të MHK-së***

Përsa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi.